Lëvizja Gylen

Lëvizja Gylen

HELEN ROSE EBAUGH

PRIZMI

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

The Gülen Movement
by Helen Rose Ebaugh
Copyright © 2010 Springer Netherlands
Springer Netherlands is a part of Springer Science+Business Media
All Rights Reserved

Copyright © në shqip, Shtëpia botuese "Prizmi"

HELEN ROSE EBAUGH

LËVIZJA GYLEN

Një analizë sociologjike e një lëvizjeje civile me rrënjët në Islamin modern

Përktheu: Dritan Hoxha
Redaktoi: Silvester Manaj

ISBN: 978-9928-156-13-6

Design: Indrit Isufi

Shtëpia Botuese "PRIZMI"
Adresa: Rr. Abdi Toptani
Torre Drin
K. 11, Nr. 112, Tiranë
www.prizmi.com

Tiranë, 2014

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT **9**

PROLOG **11**

HYRJE **16**

Islami i "Moderuar" 17

Vëmendja në rritje nga ana e medieve ndaj Lëvizjes Gylen 19

Zoti Gylen dhe Lëvizja Gylen si rrufepritëse 22

Korniza teorike 25

Teoria e mobilizimit të burimeve *25*

Teoria e përpjekjeve organizative *27*

Çështje të kërkimit 28

Burimet e të dhënave ne libër 30

ISLAMI DHE SHTETI PËRGJATË HISTORISË SË TURQISË **36**

Perandoria Osmane 36

Islami dhe shteti në fillimet e Republikës së Turqisë 37

Botëkuptimi i Ataturkut për laicitetin 39

Sistemi shumëpartiak në Turqi 42

FETULLAH GYLEN:
JETA, BESIMI DHE LËVIZJA E FRYMËZUAR PREJ TIJ **53**

Historia e jetës së Fetullah Gylenit 53

Vitet e tij të rinisë *53*

Vitet e para të predikimit *56*

Themelimi i projekteve të para edukative *59*

Hapja e shkollave të frymëzuara nga Gyleni *63*

Institucionet mediatike të frymëzuara nga Gyleni *65*

Zoti Gylen si rrufepritëse e kritikave *67*

Idetë kryesore të z. Gylen 69
Ndërtimi i urave lidhëse mes Islamit dhe Perëndimit *69*
Arsimi *71*
Financimi i projekteve të Hizmetit në aspektin shpirtëror të bamirësisë dhe shërbimit ndaj njerëzve *74*
Dialogu ndërfetar dhe ndërkulturor *77*
Islami nuk mund të mbështesë apo tolerojë terrorizmin *80*
Marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë *82*
Zhvillimi i Lëvizjes Gylen *84*
Një trajtim përmbledhës i aspekteve të Lëvizjes Gylen *88*
ORGANIZIMI SHOQËROR I LËVIZJES: RRJETI I QARQEVE LOKALE **95**
Struktura e qarqeve lokale 98
Donacione në rritje për projektet e frymëzuara nga Gylen 104
Kontributet financiare 108
Motivet që shpien në ofrimin e kontributeve financiare 117
Konfidenca dhe besimi në projektet e frymëzuara nga Gyleni 122
Pjesëmarrja e anëtarëve në lëvizje 123
Përpjekjet e përgjithshme 125
KULTURA TURKO-ISLAME E BAMIRËSISË 129
Konceptet më kryesore të traditës turke në lidhje me bamirësinë 136
Sadakaja *136*
Zekati *139*
Kurbani *144*
Vakëfi *145*
Organizatat Ahi *148*
Begatia *150*
Fqinjësia *151*
Karz-i-hasen *153*
Ringjallja e filantropisë turko-islame nga Levizja Gylen 153

UJI I NEVOJSHËM PËR TA VËNË NË LËVIZJE MULLIRIN: FINANCIMI I PROJEKTEVE TË SHËRBIMIT TË FRYMËZUARA NGA GYLENI 157

Institucionet e frymëzuara nga Gyleni 159

Banka "Asya" *159*

Stacioni televiziv "Samanyolu" *162*

Gazeta "Zaman" *164*

Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve *167*

Universiteti "Fatih" *170*

Spitalet e frymëzuara nga idetë e Fethullah Gylen *173*

Spitali "Bahar", Bursa *178*

Institucionet arsimore: Konviktet, kolegjet dhe qendrat e kurseve përgatitore *181*

Institucionet arsimore: Shkollat e frymëzuara nga Gylen *183*

Shoqata e ndihmës dhe solidaritetit Kimse Yok Mu? *191*

Modele të brendshme që kanë të bëjnë me institucionet e frymëzuara nga Gyleni ... 194

Frymëzimi fillestar *194*

Idetë përshkuese *197*

Angazhimi i personelit *198*

Mbështetja financiare *199*

Cilësia e institucioneve *201*

PËRMBLEDHJE **204**

Përfundimet e studimit 206

SHTOJCË

Zërat e kritikëve karshi Lëvizjes Gylen **214**

Frika e krijimit të një shteti islam 215

Gyleni si një agjent i mundshëm i SHBA-ve 218

Shpërlarja e trurit e njerëzve të varfër dhe analfabetë 220

Po e kthen Turqinë nga rruga e saj drejt modernizimit 222

Lëvizja Gylen mbështet vetëm njerëzit e vet 224

Lëvizja si një shoqëri apo sekt i fshehtë 226

Dëshmi të mëtejshme 227
Integrimi në shoqëri (përkundër izolimit) 228
Kontrolli autoritar 230
Dukshmëria/Transparenca 231
Modernizmi (kundrejt refuzimit të shkencave nëfavor të vlerave tradicionale) ... 233
Jo dhunës 235
BIBLIOGRAFIA **239**

ABSTRAKT

Ky është një libër rreth Fethullah Gylenit, studiues dhe **teolog** turk, si dhe rreth lëvizjes civile të frymëzuar prej tij, fillimisht në Turqi, e së fundmi në mbarë botën. Gjatë dekadave të viteve '60, '70 dhe '80 të shekullit që lamë pas, ai ka predikuar përballë turmave të mëdha që mblidheshin nëpër xhami dhe vende publike në mbarë Turqinë, si dhe ka shkruar me qindra editoriale dhe artikuj nëpër gazeta, e po ashtu mban autorësinë e mjaft librave të cilët shpalosin idetë e tij. Gradualisht, shumë turq nga të gjitha sferat e jetës i janë përgjigjur pozitivisht ideve të tij mbi arsimin, modernizimin, marrëdhëniet e mira me Perëndimin, si dhe në lidhje me dialogun ndërfetar e ndërkulturor, duke themeluar mjaft institucione, që nga konviktet, qendrat e kurseve përgatitore për në universitet e deri tek shkollat, në të cilat një theks i veçantë i vihet cilësisë së arsimit, veçanërisht në fushën e shkencave dhe teknologjisë, iniciativa të cilat mbështeten në angazhimin për të çuar përpara idealet islame. Me rënien e Bashkimit Sovjetik, idetë dhe projektet e tij për shërbim civil u përhapën gjerësisht në ish-vendet sovjetike me rrënjë të përbashkëta kulturore me popullin turk, dhe së fundmi edhe më gjerësisht në Evropën Perëndimore, në Amerikën e Veriut, në Azi, në Afrikë, Australi, dhe në vendet e Lindjes së Mesme. Sot, lëvizja e frymëzuar nga Gylen numëron mbi 1.000 shkolla nëpër mbi 100 shtete në 5 kontinente. Kjo është një lëvizje civile, e cila i ka rrënjët në Islamin e moderuar, që i është përkushtuar edukimit të të rinjve, nxitjes së dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor, duke ndihmuar gjithkënd në nevojë brenda shoqërisë, çka përbën një kontribut të drejtpërdrejtë për paqen

globale. Bazuar mbi të dhënat e grumbulluara gjatë intervistave dhe vizitave që unë kam kryer nëpër institucionet e frymëzuara prej tij në Turqi dhe në Shtetet e Bashkuara, ky libër e përshkruan lëvizjen duke e vënë theksin mbi strukturën dhe mekanizmat e angazhimit, të cilat tregojnë qoftë angazhimin ndaj lëvizjes, qoftë njëkohësisht edhe përpjekjet e njëkohshme nga ana e të gjithë pjesëmarrësve të lëvizjes.

PROLOG

Në maj 2005 unë mora një ftesë për të mbajtur fjalimin çelës në Konferencën Ndërkombëtare Harran në Göteborg të Suedisë. Gjithçka që unë dija rreth kësaj konference ishte se ajo do të përfaqësonte një takim në lidhje me dialogun ndërfetar mes njerëzve të të gjitha feve abrahamike, takim ky i sponsorizuar nga ambasadori suedez në Turqi. Pas një kërkim të shpejtë në Google, mësova se Harrani është një qytet në Turqinë Jug-Lindore ku ka jetuar Profeti Ibrahim për njëfarë kohe dhe se kjo ishte konferenca e tretë Harran, e cila fokusohej në dialogun ndërfetar. Ajo do të mbahej në Suedi kësaj radhe, me qëllim që udhëheqësit fetarë nga Turqia (p.sh. ata armenë, sirianë, si dhe ata të patriarkanës greko-ortodokse, e po ashtu edhe disa prej imamëve kryesorë dhe rabinëve hebrenj, të ishin në një territor neutral duke shmangur në këtë mënyrë presionin që mund t'u vinte nga zonat e tyre respektive. Në vazhdën e përgatitjeve të fjalimit tim, unë drekova me Lynn Mitchell, një profesor i fesë në universitetin tonë, për të cilin unë dija se ishte kthyer kohët e fundit nga një udhëtim i sponsorizuar me karakter ndërfetar në Turqi, dhe ai më foli rreth lëvizjes lokale Gylen. Për domethënien e saj e pyeta fillimisht atë. Ai vijoi përshkrimin e z. Gylen, si dijetar fetar, i cili ishte burimi i frymëzimit që qëndronte prapa lëvizjes, si një mysliman i moderuar, i përkushtuar për të çuar më tej arritjet në shkencë dhe modernizim përmes projekteve arsimore, si dhe duke e vënë theksin mbi globalizimin dhe dialogun ndërfetar.

Profesor Mitchell gjithashtu më ftoi në një seminar të titulluar

"Dialogu i qytetërimeve", në të cilin ai ishte një prej organizatorëve, dhe që synonte të nxirrte në pah idetë e z. Gylen. Pikërisht në këtë konferencë unë kam takuar dy studentë të laureuar që ishin anëtarë të Lëvizjes, të cilët gjendeshin në Departamentin tonë të Sociologjisë, tezat e të cilëve unë i kam udhëhequr më vonë. Në bashkëpunimin tim me këta studentë dhe me të tjerë si ata që i pasuan ata në programin tonë, unë kam mësuar më shumë rreth historisë, ideve, qëllimeve dhe projekteve të *hizmetit* (shërbimit) të frymëzuara nga lëvizja. Unë kam dhënë mësim nëpër kurset e Sociologjisë së Feve Botërore dhe e di mjaft mirë, se sidomos pas ngjarjeve të 11 shtatorit, është kërkuar vazhdimisht ndonjë burim ku zëri i myslimanëve të moderuar do të mund të dëgjohej për t'iu kundërvënë imazheve të Islamit radikal që paraqiteshin vazhdimisht nëpër mediet amerikane. Sa më shumë mësoja në lidhje me Lëvizjen Gylen, aq më shumë mendoja se në të gjendej ndoshta shembulli më i mirë i Islamit të moderuar, që ishte në kundërshtim me shumicën e atyre çfarë paraqiteshin nëpër media. Gjatë vizitës sime të parë në Turqi në vitin 2006, kam vizituar një numër shkollash të frymëzuara nga Gyleni, duke përfshirë edhe një universitet, si dhe disa spitale që ishin ndërtuar duke e marrë shtysën prej idealeve e mësimeve të z. Gylen. Ishte e qartë se kjo ishte një lëvizje që tregonte rritje të vazhdueshme, si në Turqi, ashtu edhe në diasporën turke në mbarë botën. Ishte gjithashtu mjaft e dukshme nga cilësia e institucioneve që vizitova, se kjo ishte një lëvizje e mirëfinancuar.

Për dekada me radhë hulumtimet e mia akademike ishin fokusuar në lëvizjet fetare dhe së fundmi po merresha me ndikimin e grupeve fetare në jetën e emigrantëve të rinj, të cilët vendoseshin në Shtetet e Bashkuara, e në veçanti në Hjuston, Teksas. Kështu, unë po bëhesha përherë e më aktive nëpër qarqet e dialogut ndërfetar. Si rezultat, interesi im në lidhje me Lëvizjen Gylen si një lëvizje fetare ndërkombëtare në lulëzim e sipër, përbënte dicka krejtësisht «të natyrshme» për mua. Përveç

kësaj, unë admiroja përditë e më shumë projektet e shërbimit të sponsorizuara nga lëvizja, duke përfshirë edhe hapjen e shkollave mjaft cilësore, spitalet e nivelit të lartë, lulëzimin e një agjensie ndihmash, si dhe mjaft veprimtari të ndryshme ndërfetare që mbanin firmën e lëvizjes.

Nga pikëpamja sociologjike, duke pasur parasysh natyrën vullnetare të pjesëmarrjes në lëvizje, si dhe strukturën jo-hierarkike që ishte mjaft evidente, unë isha veçanërisht e interesuar në mënyrat me të cilat njerëzit organizoheshin, me synim për të maksimizuar angazhimin e tyre në realizimin e qëllimeve dhe projekteve të lëvizjes. Një tjetër çështje e lidhur me këtë aspekt ka të bëjë me shumat e mëdha të parave të nevojshme për të ndërtuar dhe për të shpënë përpara këto projekte të *shërbimit*. Cili ishte burimi i parave? Nëse vërtet ato vinin nga kontributet individuale, çfarë i motivonte njerëzit për t'i dhuruar këto shuma parash?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve unë vendosa të bëja disa intervista gjysmë të strukturuara me një kampion të gjerë njerëzish në Turqi dhe në Hjuston të Teksasit. Gama dhe karakteristikat e njerëzve që unë intervistova janë përshkruar më detajueshëm edhe në «Hyrje». Nga pikëpamja metodologjike, unë u përpoqa që studimi im ishte të ishte sa më objektiv dhe shkencor, duke shtruar pyetje, duke dëgjuar përgjigjet dhe duke bërë regjistrimin sa më saktë të mundshëm të tyre, me qëllim arritjen e një analize të thellë të çështjes në shqyrtim. Secili nga individët e intervistuar e dinte mirë se unë isha një studiuese dhe profesoreshë universiteti, që po përpiqesha të kuptoja filozofinë e lëvizjes, me qëllim që më pas të mund të shkruaja një libër, i cili ta përshkruante me hollësi këtë lëvizje së bashku me mbështetësit dhe projektet e saj.

Përveç raportimit të atyre çfarë kam dëgjuar, me shkrimin e këtij libri unë gjithashtu synoja të shtjelloja interpretime më të thelluara analitike, të deduktuara nga edukimi im si sociologe. Pra unë e kam shkruar këtë libër jo si një person i brendshëm

që ka arritur ta kuptojë thelbin e lëvizjes nga brenda saj, por më tepër si një akademike e huaj, e cila i ka dëgjuar pjesëmarrësit dhe është përpjekur që të kapë këndvështrimin e tyre sa më thellë të jetë e mundur, e në të njëjtën kohë, duke mbartur një perspektivë analitike të mundësuar nga formimi im akademik. Qëllimi im për ta shkruar këtë libër, ishte raportimi sa më i saktë që të jetë e mundur i asaj që kam mësuar prej njerëzve që kam intervistuar, duke analizuar vërejtjet e tyre përmes lupës së interpretimit sociologjik.

Ekziston një numër njerëzish të cilët unë do të doja t'i falënderoja veçanërisht për kontributet e tyre të vlefshme për realizimin e këtij studimi dhe botimin e këtij libri. Dr. Y. Alp Aslandogan, i cili shërbeu si përkthyes gjatë intervistave që mua m'u desh të bëja në Turqi. Përveç aftësive të tija në përkthim, unë kam mësuar shumë nga ai rreth historisë dhe kulturës turke gjatë udhëtimeve që kemi kryer ndërmjet pjesës aziatike dhe asaj evropiane të Stambollit, e po ashtu dhe nëpër qytetet e tjera të Turqisë. Dr. Muhammed Çetin, i cili nuk u kursye që ta lexonte dorëshkrimin, duke më bërë sugjerime të vlefshme, sidomos në lidhje me faktet historike dhe kulturore që më mundësuan rritjen e shkallës së të kuptuarit të kontributeve të zotit Gylen në periudha të caktuara gjatë të cilave ai ka predikuar në Turqi. Kam biseduar gjithashtu me profesoreshë Maria Curtis nga Universiteti i Hjuston, Clearlake, për të arritur një nivel më të mirë të të kuptuarit të rolit të grave në këtë lëvizje. Simay Ozlu-Deniz, një studente e diplomuar në Departamentin tonë të Sociologjisë, më ka ndihmuar në kryerjen e intervistave me kritikët e lëvizjes, çështje të cilën e kam trajtuar edhe në Shtojcë. Vajzën time, Sara Ebaugh, që e lexoi dorëshkrimin dhe si për të më sfiduar, veçanërisht në kapitullin e fundit, është përpjekur ta shtjellojë më qartë argumentin tim se lëvizja në fjalë aktualisht nuk zotëron asnjë nga karakteristikat e një lëvizjeje të «rrezikshme» apo sektare. Willemijn Arts, editori im në shtëpinë botuese Springer, ishte personi i cili më ka inkurajuar më së shumti

në çdo etapë të procesit të botimit, ndaj ishte mjaft e këndshme të punoje me të. Unë falënderoj çdonjërin prej njerëzve të cilët kaluan kohën e tyre të çmuar duke folur me mua rreth lëvizjes. Ky është me të vërtetë një libër rreth tyre. Dhe, në fund dëshiroj të falënderoj bashkëshortin tim, Albert L. Ebaugh, i cili më ka shoqëruar në secilin prej katër udhëtimeve të mia në Turqi, duke qëndruar edhe si i pranishëm në disa prej intervistave të kryera. Ai meriton një çmim për faktin e të qenit një partner entuziast, mbështetës dhe bashkëpunues.

HYRJE

Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, shënuan një ngjarje që la gjurmë jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por në mbarë globin. Brenda pak orëve pas ngjarjeve në Nju Jork dhe Uashington, myslimanët u vunë në shënjestër si autorët e tyre. Papritmas, amerikanët, të cilët po i ndiqnin ngjarjet nëpër televizione dhe ekranet e tyre kompjuterike, mësuan se myslimanët nuk ishin vetëm disa grupime amorfe në Lindjen e Mesme, por jetonin nëpër lagjet amerikane, punonin nëpër vendet amerikane të punës, dhe shkolloheshin po nëpër universitetet amerikane dhe madje edhe fëmijët e tyre e mësonin gramatikën nëpër këto shkolla. Njerëzit në mbarë Amerikën pyesnin: Kush janë këta njerëz? Çfarë besojnë? Si është e mundur që një fe të nxisë shkatërrimin e mijëra jetëve njerëzore? Papritmas, vëmendja e medieve informative, si dhe e njerëzve në mbarë Shtetet e Bashkuara u fokusua pas një feje që ishte e huaj për shumicën e tyre.

Të nesërmen, më 12 shtator, Presidenti Bush, duke njoftuar "luftën e tij kundër terrorizmit" paralajmëroi popullin amerikan, se jo të gjithë myslimanët janë terroristë, dhe se Islami është një fe paqësore, që nuk e toleron dhunën. Ai mori rolin e liderit në përkufizimin e ngjarjeve të një dite më parë si veprime të një grupi radikal dhe ekstremist brenda një feje tejet të ndryshme, paqësore. Ai u bëri thirrje amerikanëve që të mos shfaqnin kundërpërgjigje të asnjë lloj forme, duke sulmuar myslimanët nëpër qytetet e tyre, apo në rrethina.

Që prej ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, në Shtetet e Bashkuara

ka pasur një rritje drastike të interesit për Islamin, siç dëshmohet edhe nga numri në rritje i librave, gazetave, tregimeve dhe artikujve të revistave, të fokusuara në Islamin; mjaft programeve televizive që synojnë përshkrimin e besimit dhe praktikave Islame, si dhe lulëzimin e një numri mjaft të madh të kurseve nëpër universitete në lidhje me Islamin dhe fetë botërore në përgjithësi. Për rrjedhojë, përherë e më shumë, amerikanët po informohen rreth formave të ndryshme të praktikimit të Islamit, si dhe për faktin se ekstremistë ekzistojnë në çdo fe, dhe se një fe e tërë nuk mund të fajësohet për veprimet e një pakice aderuesish të saj. Megjithatë, mbeten ende prezente mjaft keqkuptime të përhapura në lidhje me Islamin, dhe se vazhdon të ekzistojë një tendencë mes shumë njerëzve për të vënë shenjën e barazimit midis myslimanëve dhe terroristëve.[1]

Islami i "Moderuar"

Si një përgjigje ndaj radikalizmit islamik nga ana e myslimanëve në mbarë botën ka qenë rritja dhe dalja në skenë e lëvizjeve myslimane "të moderuara" apo jo të dhunshme. Një lëvizje e tillë, e cila është duke përjetuar një rritje të shpejtë në Turqi, që është edhe vendi i saj i origjinës, si dhe në vendet e ish-BRSS, Evropë, Australi, Kanada, Afrikë dhe së fundmi edhe në Shtetet e Bashkuara, është Lëvizja Gylen. Kjo lëvizje është frymëzuar prej një dijetari mysliman dhe ish-klerik, z. Fethullah Gylen, i cili ka lindur në Turqi në vitin 1941. E më pas është bërë një imam dhe predikues i famshëm, mësues, autor librash dhe poet, sidomos në vitet '70 dhe '80, i cili jeton aktualisht në Shtetet e Bashkuara qysh prej vitit 1999. Të nesërmen e sulmeve të 11 shtatorit, z. Gylen bëri një deklaratë që zuri tërësisht faqen e parë të gazetës *New York Times*, ku ai dënonte sulmet duke e vënë theksin në faktin se autorët nuk ishin asesi përfaqësues të Islamit. Mesazhi i tij ishtë ai i domosdoshmërisë së tolerancës, respektit, dialogut ndërfetar dhe krijimit të qendrave humanitare për njerëzit në nevojë, për të

krijuar kështu ura bashkëpunimi ndërmjet botës myslimane dhe Perëndimit. Z. Gylen këmbëngul në jetikën e krijimit të kushteve për progres shkencor dhe teknologjik në botën myslimane, çka mund të arrihej vetëm përmes arsimimit. Ashtu siç e përshkruan edhe Ibrahim M. Abu Rabi, "Gyleni mbron një nocion 'progresist' të Islamit, sipas të cilit myslimanët të jenë në gjendje për t'u angazhuar plotësisht në këtë botë, pa pasur asnjë lloj frike apo paragjykimi, si edhe pa u bërë objekt i tyre."[2]

Edhe pse hartuesit e politikave kanë përkrahur idenë e mbështetjes së Islamit të moderuar si një strategji për përballimin e grupeve islamike radikale, termi "mysliman i moderuar" është kontestuar mjaft në mesin e dijetarëve dhe hartuesve të politikave[3], e po ashtu edhe ndërmjet myslimanëve vetë, të cilët argumentojnë se termi është përdorur në mënyrë tendencioze për të treguar një variant të shtrembëruar të myslimanit që është më tepër laik dhe më pak fetar sesa "norma", e cila varion nga bashkësia në bashkësi.[4] Steven Cook, bashkëpunëtor i Douglas në Këshillin për Marrëdhëniet me Jashtë, argumenton se termi moderim është dicka që ka të bëjë me "perceptimin e vëzhguesit" dhe se politikëbërësit duhet të përqendrohen në identifikimin e atyre që mund të kontribuojnë në zgjidhjet pragmatike për problemet në rajon, qofshin ata të "moderuar" ose jo.[5] Në të njëjtën linjë, Jay Tolson pretendon se përcaktimet e termit "moderim" pasqyrojnë konceptet ideologjike dhe politike të vetë përkufizuesve, në kuptimin që konservatorët ruajnë pikëpamje më të ngushta dhe më të rrepta në lidhje me moderimin, ndërsa liberalët shohin më tepër nuanca të së pranueshmes.[6] Kështu që, meqënëse vetë kuptimi i termit "moderim" është i diskutueshëm, unë e kam përdorur atë në titullin e këtij libri për të treguar një grupim mysliman që është i gatshëm për të bashkëekzistuar në paqe me popujt e besimeve të tjera; i cili mbështet demokracinë, ushqen lirinë e mendimit dhe synon progres arsimor, duke njohur rolin e besimit dhe fesë, dhe duke dënuar përdorimin e dhunës në emër

të fesë, dhe Islamit në veçanti. Brenda këtyre parametrave, Lëvizja Gylen është një shembull i fuqishëm i Islamit të moderuar në botën moderne.

Vëmendja në rritje nga ana e medieve ndaj Lëvizjes Gylen

Kohët e fundit, një numër revistash me tirazh të gjerë dhe me mjaft reputacion e kanë trajtuar gjerësisht z. Gylen, si dhe shumë prej projekteve të *Hizmetit*[1] si shkollat, spitalet, konviktet dhe veprimtaritë jofitimprurëse të bamirësisë, që janë frymëzuar nga idetë e paraqitura prej tij nëpër predikime, libra, artikuj, CD apo audiokaseta, adresat zyrtare të internetit, dhe takimet e tij personale me pasuesit, të cilët vijnë në shtëpinë e tij në Pensilvani që të kalojnë ca kohë në shoqërinë e Gylenit dhe të kërkojnë këshillën e tij për probleme të caktuara. *Oxford Analytica* e revistës *Forbes* botoi një artikull (18.1.2008) me titull *"Gyleni frymëzon myslimanët në mbarë botën*", në të cilin theksohet "aftësia e lëvizjes për të mobilizuar burime të konsiderueshme dhe ndikimi i saj në mesin e vendimmarrësve." Në maj të po atij viti (05.04.2008) *New York Times* botoi një artikull në faqe të parë rreth shkollave të lëvizjes në Pakistan, të cilat ofrojnë «një Islam të butë» duke prezantuar një vizion të Islamit «të moderuar dhe fleksibël, që mund të bashkëekzistojë qetësisht me Perëndimin duke mbetur njëkohësisht i dallueshëm nga ai.» Revista franceze, *Le Monde*, ka bërë një pasqyrim (5.11.2006) të arritjeve të shkollave të hapura nga ndjekësit e Gylenit në Gjermani, duke theksuar se këto shkolla trajtojnë me efikasitet problemet e arsimit të fëmijëve të emigrantëve dhe mund të merren si shembull edhe nga shkollat gjermane.

International Herald Tribune (18.1.2008) shkroi se zoti Gylen ishte "një burim frymëzimi për myslimanët, që të ndihen si në

1 ***Hizmet – gj. shq.*** ≈ Shërbim. Emërtimi popullor i kësaj lëvizjeje në vendin e saj amë, pra në Turqi, çka bart domethënien e të qenit në shërbim ndaj njerëzimit dhe vlerave dhe parimeve të larta që e karakterizojnë qenien njerëzore. Këtej e tutje do të përdoret me të dyja trajtat, *hizmet* dhe *shërbim,* çka do të qëndrojnë si shënjuese të së njëjtës gjë.

shtëpinë e tyre në botën moderne.» Artikulli është cituar më vonë edhe nga revista *Forbes*. *The Economist* ka publikuar së fundmi tre artikuj kushtuar vetëm lëvizjes Gylen. Njëri nga artikujt (30.1.2008), ndërsa flet rreth çështjes kurde në Turqi, e identifikon z. Gylen si një "klerik liberal mysliman, i cili jeton në një mërgim të detyruar nga rrethana vetjake në Amerikë.» Aty gjithashtu përmendet fakti se pasuesit e z. Gylen kanë shpërndarë mish për rreth 60.000 familje kurde gjatë festës së Kurban Bajramit dhe se mjekët që janë ndjekës të ideve të z. Gylen kanë ofruar ekzaminime dhe trajtime mjekësore falas nëpër tërë rajonet kurde, duke shprehur në këtë mënyrë mesazhin se kurdët dhe turqit janë vëllezër në Islam. Një rubrikë e mëvonshme e *The Economist* (3.6.2008) realizoi dy artikuj rreth lëvizjes Gylen dhe vlerësoi projektet arsimore dhe shërbimin që ajo është duke ofruar në mbarë botën. Përveç kësaj, gjatë takimit të mbajtur në Forumin Vjetor Ekonomik Botëror në Davos, Zvicër 2008, u shpalos një raport me titull *"Islami dhe Perëndimi: Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Dialogut"*, në të cilin u përmend edhe lëvizja Gylen me rrjetin e saj të mbi 100 shkollave të përhapura në të gjithë vendet e Azisë Qendrore, si një shembull i një përpjekjeje të rëndësishme për dialog të mëtejshëm ndërkulturor.

Në gusht të vitit 2008, revista *Foreign Policy* i ftoi lexuesit e saj të votonin për intelektualin publik më të shquar në botë, ku Fethullah Gylen fitoi në një sasi tejet të konsiderueshme votash, ndoshta për shkak të miliona votave nga mbështetësit e tij, të cilët kishin lexuar për ekzistencën e sondazhit nëpërmjet gazetës *Zaman*, një gazetë turke e lexuar nga shumë njerëz ithtarë të lëvizjes. Është interesant të theksohet fakti, se të dhjetë intelektualët e parë në listë ishin që të gjithë myslimanë, ndoshta si rezultat i votave të hedhura nga mbështetësit e Gylenit që votuan jo vetëm për udhëheqësin e tyre, por edhe për myslimanët e tjerë në sondazh. Edhe pse sondazhi nuk ishte i realizuar nga premisa të mirëfillta shkencore në drejtim të marrjes së mostrave të rastit të të anketuarve,

prapseprapë rezultatet e saj të demonstrojnë ekzistencën e miliona mbështetësve të Gylenit dhe fuqinë e rrjetit që i bashkon ata.

Që nga viti 2005, me qindra amerikanë janë njohur me lëvizjen Gylen si rezultat i pjesëmarrjes nëpër udhëtime në kuadër të dialogut ndërfetar në Turqi të sponsorizuara nga grupet lokale të lëvizjes Gylen si dhe nga mikpritësit përkrahës të Gylenit në Turqi. Këto udhëtime dialogu e patën zanafillën e tyre në Hjuston, Teksas, dhe tani janë përhapur në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Në këto udhëtime 8-10 ditore, pjesëmarrësit shoqërohen ndërsa kryejnë vizita nëpër vende të rëndësishme historike, kulturore dhe fetare në Turqi, si dhe u ofrohet mundësia për të bashkëpunuar me familjet myslimane lokale, shumë prej anëtarëve të të cilave janë aderues të lëvizjes Gylen. Qëllimi i këtyre udhëtimeve nuk është kurrsesi të shndërrohen në një mjet rekrutimi në radhët e lëvizjes, përkundrazi ato janë të strukturuara për të nxitur dialogun ndërfetar mes grupimeve fetare, si në SHBA, ashtu edhe në Turqi. Megjithatë, meqë këto udhëtime organizohen nga mbështetësit e Gylenit, ato zakonisht përfshijnë disa darka në shtëpitë e myslimanëve turq që janë pjesë e Lëvizjes Gylen, si dhe vizitat në disa shkolla dhe spitale të financuara nga lëvizja, në mënyrë që njerëzit pjesëmarrës në këto udhëtime të njihen me këto aspekte të saj.

Duke pasur parasysh se lëvizja Gylen është themeluar mbi baza popullore dhe nuk posedon ndonjë gjurmë burokracie të centralizuar, është e pamundur të përcaktohet me saktësi se sa njerëz janë të përfshirë në të, qoftë si anëtarë apo edhe si ithtarë të saj. Megjithatë, sipas disa vlerësimeve të përafërta, mendohet se rreth 10-15% e 70 milion shtetasve në Turqi janë të lidhur me lëvizjen, dhe se ajo ka 8-10.000.000 anëtarë në mbarë botën, që gjenden në më shumë se 100 vende të ndryshme në pesë kontinente.[7] Gjithashtu, është e pamundur për të numëruar tërësinë e projekteve dhe shërbimet e ndryshme që kanë qenë

të frymëzuara nga idetë e z. Gylen dhe të nismuara nga anëtarët e lëvizjes. Megjithatë, vlerësimet më të sakta janë: më shumë se 1.000 shkolla të themeluara në pesë kontinentet në mbi 100 vende ku banojnë anëtarët e lëvizjes; gjashtë spitalet private lëvizëse, një universitet privat, qindra konvikte për studentët, si dhe mjaft kurse përgatitore për provimin kombëtar të universitetit në Turqi; një organizatë ndërkombëtare ndihmash; mjaft organizata lokale të anëtarëve të lëvizjes anembanë botës, që sponsorizojë udhëtime dialogu ndërfetar në Turqi, shtrimin e një numri të konsiderueshëm darkash iftari për të përmbyllur agjërimin gjatë Ramazanit, si dhe një numër të madh konferencash rreth ideve të Gylen dhe veprimtarisë së lëvizjes, pa lënë në hije eventet e shumta të dialogut ndërfetar në zonat rajonale dhe lokale.

Zoti Gylen dhe Lëvizja Gylen si rrufepritëse

Ndërkohë që lëvizja po lulëzon, si në Turqi ashtu edhe në mbarë botën, dhe ndoshta edhe për shkak të suksesit të saj, kanë dalë në pah edhe kritikët e zotit Gylenin dhe lëvizjes së tij, të cilët kundërshtojnë me forcë idetë e lëvizjes, duke u trembur nga pasojat e saj për Turqinë.[8] Ata kanë frikë se zoti Gylen është duke u përpjekur të vërë në jetë kapjen politike të Turqisë, sikurse ka ndodhur në lëvizjen e orkestruar nga Ajatollah Khomeini gjatë viteve ’70 në Iran, gjë që solli një ndryshim të sistemit, i cili përmbysi përpjekjet e Shahut për modernizim duke vënë në vend të tij një qeveri islamike shumë konservatore. Gjithashtu, kritikët frikësohen se lëvizja do ta kthejë prapa Turqinë në drejtim të tradicionalizmit, duke krijuar një barrierë për modernizimin e Turqisë dhe përpjekjet e saj për t’u pranuar në Bashkimin Evropian. Në themel të kësaj frike qëndron pretendimi i kritikëve, se Perëndimi, e veçanërisht Shtetet e Bashkuara, po bëjnë financimin e projekteve të tilla të lëvizjes së Shërbimit, si shkollat, spitalet, dhe të perandorisë së saj të gjerë mediatike, në mënyrë që

të krijojnë një prani të Islamit të moderuar në Lindjen e Mesme, si një antidot për terrorizmin islamik radikal. Shkurtimisht, z. Gylen është shndërruar në një rrufepritëse, duke krijuar kështu një vorbull jo vetëm në Turqi, por në gjithë botën, ku pasuesit e tij kanë emigruar.

Në nëntor të vitit 2007, Zyra Amerikane e Shërbimit për Shtetësinë dhe Emigracionin (USCIS) i mohoi z. Gylen, i cili kishte jetuar në Shtetet e Bashkuara për nëntë vjet me radhë, lejen e përhershme të qëndrimit në shtetin amerikan, të njohur ndryshe si "Green Card." Ai humbi gjithashtu gjyqin në apel, pasi e kishte paraqitur çështjen për rishqyrtim të aktgjykimit. Gjykata e argumentoi vendimin, se megjithëse zoti Gylen ishte një "akademik jashtëzakonisht i talentuar", kjo ishte e pamjaftueshme për të merituar statusin e përhershëm si studiues në SHBA. Në argumentet e prokurorit, jepeshin të detajuara burimet financiare të Gylenit, duke pretenduar se Arabia Saudite, Irani, qeveria turke dhe CIA ishin financuesit e vërtetë të lëvizjes Gylen, shumë të cilën avokatët e Departamentit Amerikan të Shtetit e vlerësuan diku mbi 25 miliard dollarë. Më 16 korrik 2008, një gjykatë federale e hodhi poshtë vendimin fillestar duke u bazuar në mungesën e provave të mjaftueshme dhe urdhëroi Sekretariatin e Sigurisë Kombëtare për të miratuar kërkesën origjinale të zotit Gylen për një leje të përhershme qëndrimi.[9] Në tetor të vitit 2008, atij iu dha zyrtarisht leja e qëndrimit nga qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Tetë vjet më parë, më 31 gusht 2000, z. Gylen ishte akuzuar nga prokurori i shtetit turk, Nuh Mete Yüksel, për organizimin e një lëvizjeje që synonte të përmbyste parimin e laicitetit të themeluar nga Mustafa Kemal Ataturku në vitin 1923, kur Turqia u bë republikë, dhe ta kthente atë në një shtet teokratik. Pas vitesh të tëra seancash gjyqësore, si dhe hetimeve të shumta dhe dokumenteve të gjykatës, më 5 maj 2006, çështja kundër z. Gylen u mbyll nga Gjykata e Sigurisë së Shtetit, duke e çlirua atë nga çdo lloj akuze.[10]

Kush është pra ky njeri, i cili ka bërë që rreth tij të mblidhet një vëmendje të këtillë, qoftë nga mediet, nga sistemi gjyqësor dhe nga të gjitha palët, si nga pasuesit ashtu edhe nga kritikët e tij? A është ai një Gandi[11] siç pretendojnë disa nga ndjekësit e tij, apo një Khomeini[12], ashtu siç shumë nga kritikët frikësohen? A duhet të kthehet në idhull dhe të ngrihet në qiell apo duhet denoncuar dhe dënuar si një tiran i mundshëm? Çfarë është Lëvizja Gylen, e cila tani pretendon se ka miliona ndjekës në mbarë botën dhe po tërheq pas vetes burime të tilla financiare, saqë janë duke u ngritur mjaft dyshime se pas kësaj lëvizjeje mund të fshihen disa qeveri njëherësh? Nga e kanë burimin paratë e përdorura për të ndërtuar dhe mbajtur në këmbë qindra shkolla në mbi 100 vende, gjashtë spitalet private më të vlerësuara, gazetën me numrin më të madh të lexuesve në Turqi, bankën më të madhe me natyrë islame në Turqi, si dhe një shoqatë humanitare që financon mbi 16 milionë dollarë në vit për të ndihmuar njerëzit më në nevojë në raste fatkeqësish? Pse është ky burrë i moshuar turk, rreth të 70-ave dhe me shëndet të dobët, i cili tani jeton në Shtetet e Bashkuara, rrufepritësi i një urrejtjeje dhe frike të tillë sarkastike nga ana e disa qytetarëve turq? Çfarë e ka bërë Lëvizjn Gylen aq të suksesshme gjatë tridhjetë apo më shumë viteve të ekzistencës së saj dhe si shpjegohet fakti se ajo tashmë është zgjeruar përtej Turqisë për të synuar përfshirjen në lëvizje të të dyja palëve, si për popullin turk, ashtu edhe atë joturk në mbarë botën?

Qëllimi i këtij libri është ta prezantojë Fethullah Gylenin dhe lëvizjen që ai ka frymëzuar për lexuesit anglishtfolës, pse jo edhe më gjerë, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të mësipërme përmes të dhënave të grumbulluara gjatë udhëtimeve në terren në Turqi dhe gjatë intervistave me ndjekës e ithtarë të Gylenit në Hjuston të Teksasit. Bazuar në bisedat e mia me kolegët në të gjithë vendin dhe me publikun e gjerë, por edhe me studentët të mi në kurset që unë jap në Universitetin e Hjustonit, duket se Lëvizja Gylen dhe vetë z. Gylen, janë të panjohur për shumicën e amerikanëve. Megjithatë,

sa më shumë vëmendja në rritje e medieve përqendrohet tek kjo lëvizje dhe sa më shumë që amerikanët marrin pjesë nëpër udhëtime me qëllim dialogun ndërfetar në Turqi, dhe në eventet e sponsorizuara nga mbështetësit e Gylenit në Shtetet e Bashkuara, aq më shumë rritet interesi për këtë lëvizje të moderuar turko-islame në lulëzim.

Korniza teorike

Ekzistojnë dy korniza teorike që ndihmojnë për të shpjeguar përse lëvizja Gylen ka rezultuar aq e suksesshme si në Turqi, ashtu edhe jashtë vendit. Së pari, teoria e mobilizimit të burimeve, që hedh dritë mbi burimet financiare dhe njerëzore që i mundësojnë një lëvizjeje të rritet dhe të ketë sukses në qëllimet e saj. Së dyti, teoria e angazhimit organizativ, fokusohet në strategjitë e lëvizjes për të rritur motivimin e anëtarëve, për të siguruar burimet e nevojshme dhe pasojat e një angazhimi të tillë në ndërtimin e ndjenjës së besnikërisë ndaj lëvizjes, duke siguruar vitalitetin dhe rritjen ekonomike të saj.

Teoria e mobilizimit të burimeve

Mobilizimi i burimeve është një teori sociologjike që e vë theksin mbi llojet e burimeve që janë të nevojshme për mirëmbajtjen dhe rritjen e lëvizjeve sociale. Teoritë e mëparshme fokusoheshin në psikologjinë sociale të pjesëmarrësve lëvizjes, të cilët shiheshin si njerëz të cilët ishin të pakënaqur me një ose më shumë aspekte të shoqërisë.[13] Teoria e mobilizimit të burimeve, e cila u shfaq fillimisht në vitet '70, i sheh lëvizjet sociale si rrjete njerëzish të cilët janë të aftë të tërheqin llojet dhe sasitë e nevojshme të financave si dhe të përfitojnë nga puna njerëzore për të kryer ndryshime në shoqëri.[14] Sipas teoricienëve të mobilizimit të burimeve, nuk është gjithmonë e mjaftueshme pakënaqësia në

çdo shoqëri për të siguruar themelet e mbështetjes për një lëvizje. Për ta orientuar dhe organizuar pakënaqësinë në një lëvizje sociale, është e nevojshme ekzistenca e një grupi bazë strategësh të sofistikuar me qëllim organizimin e shfrytëzimt të pakënaqësisë së njerëzve, për të siguruar paratë e nevojshme dhe mbështetjen njerëzore dhe logjistike, si dhe për të tërhequr vëmendjen e medias, për krijimin e aleancave me ata që janë në pushtet dhe për krijimin e një strukturë organizative.[15] Kjo teori supozon se pa burime të tilla, lëvizjet sociale nuk mund të jenë efektive dhe se vetëm mospajtimi dhe pakënaqësia nuk janë të mjaftueshme për të krijuar ndryshime shoqërore me anë të një lëvizjeje shoqërore. Nëse burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në dispozicion për të mbështetur qëllimet e lëvizjes, ajo në fund do të shembet ose të bashkohet me një lëvizje që ka qenë më e suksesshme në sigurimin e burimeve të lartpërmendura. Pra teoria e mobilizimit të burimeve, merret në mënyrë specifike dhe me metodat e rritjes, rënies, si dhe me dinamikën e ndryshimit të lëvizjeve sociale.

Shumica e teoricienëve[16] të teorisë së mobilizimit të burimeve pajtohen me mendimin se burimet e mëposhtme janë të nevojshme për një lëvizje të suksesshme sociale. Ato janë: paratë, legjitimiteti dhe puna. Kanalet e mjaftueshme dhe të qëndrueshme të parave, bëjnë të mundur sigurimin e pagave dhe mbështetjes logjistike të stafit të lëvizjes, sigurojnë hapësirat e nevojshme për zyra, kompjutera, pajisje fotokopjuese, etj., që janë të domosdoshme për të bërë publike dhe për të reklamuar mesazhet dhe qëllimet e lëvizjes; të publikojnë reklama, njoftime, shpallje, faqe interneti dhe burime të tjera mediatike, të mobilizojnë pjesëmarrësit potencialë, si dhe projektet financiare apo eventet e sponsorizuara nga lëvizja. Teoria e mobilizimit të burimeve do të përmendet veçanërisht në kapitullin 4, të titulluar "*Organizimi shoqëror i Lëvizjes: Rrjeti i qarqeve lokale*" si dhe në Kapitullin 6: "*Uji i nevojshëm për mullirin: Financimi i projekteve të shërbimit të frymëzuara nga Gyleni*", për të artikuluar dhe për të analizuar

mekanizmat ku sigurohen burimet e nevojshme për rritjen dhe suksesin e lëvizjes.

Teoria e përpjekjeve organizative

E lidhur ngushtë me çështjen e sigurimit të burimeve të nevojshme për suksesin e lëvizjes, është edhe çështja e motivimit për angazhimin e anëtarëve. Çfarë i shtyn me miliona njerëz të angazhohen në radhët e lëvizjes, duke shpenzuar kështu kohën e tyre, krahun e punës, përfshirjen emocionale, dhe mjetet financiare për të përmbushur qëllimet e lëvizjes? Angazhimi përfshin identifikimin e fatit personal të dikujt me suksesin apo dështimin e gjithë kolektivitetit.[17] Ai është shqyrtuar në mënyrë tipike në drejtim të përzierjes së karakteristikave personale dhe organizative të cilat rrisin gatishmërinë për të ushtruar nivele të larta të përpjekjeve, në mënyrë që një person i angazhuar të mbetet një anëtar aktiv në organizatë, si dhe për të pranuar qëllimet dhe vlerat e saj themelore, si dhe për ta vlerësuar organizatën si diçka të dobishme.

Hulumtimet e kryera nga sociologia Rosabeth Kanter në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70 për sa i përket angazhimit brenda komuniteteve[18] në SHBA, mbeten ende punime të dobishme klasike në fushën e mekanizmave organizative që gjenerojnë angazhimin e anëtarëve. Ajo ishte e interesuar në atë se si grupet e ruajnë kohezionin, ndaj ajo u përqendrua në kërkesat organizative që ndikojnë tek individët, të cilët mendojnë se interesi i tyre personal është i padallueshëm nga ai i bashkësisë – domethënë ka të bëjë me ndjenjën e tyre të përkushtimit. Ajo argumenton se një person është zotuar për një marrëdhënie ose grup në masën që ai ose ajo e sheh atë si shprehjen ose përmbushjen e një pjesë themelore të vetvetes dhe i identifikon objektivat e grupit, si ushqyes të kuptimit të tij apo të saj për vetveten. Një

person i përkushtuar është besnik dhe i angazhuar, posedon një ndjenjë të fortë përkatësie, një sensacion se grupi është një zgjatim i vetes së tij dhe se ai ose ajo është poende një zgjatim i grupit.

Për ta përmbledhur sa thamë më sipër, teoria e mobilizimit të burimeve dhe ajo e angazhimit shërbejnë si lente përmes të cilave arrijmë të studiojmë më në detaje karakteristikat e lëvizjes Gylen dhe të shpjegojmë arsyet se përse ajo është duke përjetuar një lulëzim të tillë. Këto mjete teorike, së bashku me një analizë të kontekstit historik dhe politik gjatë së cilës Fetullah Gyleni ka predikuar në Turqi, si dhe të kuptuarit e duhur të koncepteve turko-islame të bujarisë dhe mikpritjes, sigurojnë një qasje më të afërt në besimet, vlerat dhe dinamikat sociale të cilat janë duke i dhënë kësaj lëvizjeje një rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Çështje të kërkimit

Bazuar në teorinë e mobilizimit të burimeve dhe atë organizative të angazhimit të përshkruara më sipër, ekzistojnë tri çështje themelore që udhëheqin studimin e paraqitur në këtë libër:

1. Nga këndvështrimi sociologjik, cilat janë mekanizmat organizativë të angazhimit që shpjegojnë arsyet përse lëvizja Gylen ka fituar entuziazmin e miliona turqve brenda vendit, si dhe në vendet ku ata kanë emigruar?

2. Në çfarë mënyrash është arritur të bëhet e mundur që mekanizmat financiarë të përfshira në financimin e projekteve të shërbimit, të nxisin entuziazmin, përfshirjen dhe angazhimin e mbështetësve të lëvizjes? Si janë motivuar mbështetësit e lëvizjes për të dhuruar?

3. Cilat janë marrëveshjet financiare të lidhura me institucionet që kanë kontakte me lëvizjen Gylen dhe çfarë marrëdhëniesh financiare kanë mbështetësit e lëvizjes me

projektet e frymëzuara nga Gyleni?

Studimi përshkrues që buron nga të dhënat e raportuara në këtë libër ka rezultuar nga pyetjet e mësipërme të tij. Kështu unë vendosa të vizitoja institucionet e frymëzuara prej ideve të Gylenit dhe të intervistoja të dyja palët, si administratorët ashtu edhe personelin që punonte brenda këtyre organizmave. Përveç kësaj, unë kam intervistuar një larmi të gjerë njerëzish të cilët e mbështesin lëvizjen, si financiarisht ashtu edhe përmes punës së tyre vullnetare. Meqë motivimi për shërbimin fillon brenda qarqeve lokale që karakterizojnë lëvizjen, unë jam përqendruar veçanërisht mbi këto grupe.

Është po aq e rëndësishme të theksohen qartë ato çfarë ky studim përshkrues **NUK** përfshin, si dhe të përvijohen qartazi ato aspekte që ai përfshin. Kjo veçanërisht duke pasur parasysh faktin se tema që përbën fokusin e këtij libri, është shumë e ngarkuar nga pikëpamja ideologjike. Ekzisojnë shumë kritikë të lëvizjes si brenda Turqisë ashtu edhe në radhët e diasporës turke. Ndërsa unë kam folur me disa prej këtyre kritikëve, unë nuk kam kryer intervista sistematike bazuar në mostra të rastit ose me përfaqësues të të intervistuarve. Meqënëse këndvështrimi kritik nuk ka qenë pjesë e studimit tim përshkrues, ky libër **nuk** është një vlerësim i lëvizjes nga këndvështrime të ndryshme. Për më tepër, unë nuk kam për qëllim të bëj një vlerësim kritik të rolit historik apo politik të lëvizjes Gylen në shoqërinë turke. Përkundrazi, të dhënat e mia janë të kufizuara në tri çështjet studimiore të ngritura më sipër, secilës prej të cilave i kam dhënë përgjigje me anë të intervistave të mia me përkrahësit brenda lëvizjes.

Ky libër përbën një analizë sociologjike të lëvizjes Gylen, të bazuar mbi formimin tim akademik si sociologe. Ndërsa kapitulli 2, *"Islami dhe shteti gjatë historisë së Turqisë"* paraqet një histori shumë të shkurtër të lidhjes së Islamit dhe shtetit gjatë gjithë historisë së Turqisë, ai nuk është konceptuar si një punim i mirëfilltë

shkencor dhe historik në lidhje me këtë temë. Përkundrazi, e kam shkruar atë kapitull në terma shumë të përgjithshëm me qëllimin për ta futur lexuesin perëndimor brenda kontureve të mëdha të historisë turke që sigurojnë një kontekst për evoluimin e lëvizjes Gylen, me një theks të veçantë mbi marrëdhëniet ndërmjet fesë dhe shtetit në Turqi. Gjithashtu, kapitulli 5 që bën fjalë mbi *"Kulturën turko-islamike të bamirësisë"* është prezantuar në terma të përgjithshëm për ta njohur lexuesin perëndimor me konceptet historike dhe fetare që përbëjnë sfondin për projektet e shërbimeve të sponsorizuara nga lëvizja Gylen dhe për të treguar se z. Gylen i konsideron mjaft thelbësore këto tipare kulturore në motivimin e mbështetësve të tij për të iniciuar dhe për t'u përfshirë në të shërbyerit ndaj nevojtarëve.

Burimet e të dhënave ne libër

Brenda tri viteve të fundit, unë kam kaluar gjithsej tetë javë në Turqi të ndara në katër vizitave të ndryshme, ku secila prej tyre ka zgjatur dy javë. Këto vizita më kanë dhënë mundësinë të përjetoj edhe kulturën e vendit dhe nënkulturën e lëvizjes Gylen. Gjatë këtyre vizitave unë kam mundur të vizitoj rreth tetë shkolla të Gylenit në Stamboll, Antalia, Izmir, Bursa, Ankara, Konia dhe Urfa. Unë gjithashtu kam intervistuar mjekët dhe administratorët në katër spitale të frymëzuara nga Gyleni në këto qytete si dhe kam vizituar sipërmarrjet që kanë lidhje me lëvizjen si Fondacionin e Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, stacionin televiziv "Samanyolu TV", gazetën "Zaman" si dhe "*Kimse Yok Mu? – gj. shq. A nuk ka njeri?*", një organizatë bamirësie. Dy prej vizitave kanë qenë pjesë e projektit të nxitjes së dialogut ndërfetar, ku njërin prej këtyre udhëtimeve e kam bërë së bashku me rreth një duzinë personash të tjerë nga Shtetet e Bashkuara. Ne ishim të ftuar për darkë në afërsisht dhjetë shtëpi, ku bashkëbiseduam me myslimanët turq të lidhur me lëvizjen. Këto dy udhëtime më siguruan kontekstin

e përgjithshëm dhe njohjen me organizatat dhe njerëzit e lëvizjes në pritje të vizitës sime të tretë, e cila ishte në mënyrë eksplicite e orientuar nga studimi i tipareve të lëvizjes dhe e fokusuar nëpër intervista.

Në prill të vitit 2008, kam kaluar dy javë në Stamboll, Bursa, dhe Mudanja, duke zhvilluar intervista formale me administratorët e lartë të institucioneve të lidhura me Gylenin me qëllim dokumentimin e historisë financiare dhe strukturës së këtyre institucioneve. Unë jam përqendruar më tepër në mënyrën se si ka nisur projekti apo organizimi i lëvizjes së *hizmetit*, kostot e projektit fillestar, burimet e financimit, historinë e mbështetjes financiare të projekteve me kalimin e kohës dhe gjendjen aktuale financiare, duke përfshirë shpenzimet dhe burimet e të ardhurave. Unë kam qenë kureshtare sidomos në lidhje me ndonjë mbështetje të qeverisë për projektet, duke përfshirë jo vetëm paratë, por edhe trojet, ndërtesat dhe lehtësirat tatimore. Institucionet dhe projektet e lidhura me Gylenin, të përfshira në studimin dhe intervistat e mia janë:

- Banka "Asya"
- Stacioni televiziv "Samanyolu TV"
- Gazeta "Zaman"
- Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve
- Universiteti "Fatih"
- Spitalet: "Sema Hospital", Stamboll; "Bahar Hospital", Bursa
- Tri shkolla të frymëzuara nga Gyleni
- Shoqata e bamirëssisë *"Kimse Yok Mu"*

Secila nga intervistat është regjistruar me lejen e personave të përfshirë në to dhe pastaj është transkriptuar më vonë për ta bërë më të lehtë analizën e tyre. Përveç kësaj, kam kryer intervista kryq e tërthor me njerëz të cilët janë pjesëmarrës në lëvizjen Gylen. Disa nga këto intervista ishin tek për tek me individë të

cilët kontribuojnë, si me kohë ashtu edhe me para, për projekte të *hyzmetit*; të tjerat u fokusuan mbi grupe nga qarqet e ndryshme lokale të anëtarëve të lëvizjes së Gylenit. Unë intervistova dy grupe biznesmenësh, të cilët ishin përkrahësit kryesorë të projekteve të lëvizjes, njërin në Stamboll dhe tjetrin në Bursa. Secili prej biznesmenëve të përfshirë në këto grupe, kontribuonte të paktën me 1.000.000 $ në vit për projekte të ndryshme të *Hizmetit*. Unë gjithashtu përdora si target-grupe disa grupime qarqesh lokale inxhinierësh dhe mjekësh, si dhe dy nga grupet e nëpunësve të uniformave blu. Këto intervista më dhanë informacion të vlefshëm në lidhje me shumat e parave të dhuaruara nga individë të sferave të të ndryshme profesionale, si dhe arsyet dhe motivet që i shtyjnë ata për të dhuruar, si dhe të mirat materiale e shpirtërore që kanë të bëjnë me përfshirjen në lëvizje.

Në mars të vitit 2009, unë u ktheva sërish në Turqi, kësaj radhe me një grup sociologësh të fesë nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja. Për shumicën prej tyre, ky udhëtim ishte prezantimi i tyre i parë si me Turqinë ashtu edhe me lëvizjen Gylen. Vizitat nëpër shkollat e frymëzuara prej tij, në një spital dhe në një nga agjencitë e ndihmave, si dhe vajtja për darkë në tri shtëpi të ndryshme myslimane, gjeneruan një sasi të konsiderueshme vërejtjesh dhe diskutimesh lidhur me lëvizjen. Ishte diçka e dobishme për mua të dëgjoja sociologët e tjerë të reflektonin dhe komentonin mbi aspektet e ndryshme të lëvizjes. Unë u sigurova se vëzhgimet dhe përfundimet e mia të mëparshme, ishin konfirmuar në tërësi nga analizat profesionale të kolegëve të mi.

Si shpjegohet që Lëvizja Gylen ka arritur të fitojë përkushtimin dhe entuziazmin e miliona turqve si brenda vendit, ashtu edhe në vendet të cilat ata emigrojnë? Gjithashtu, përse lëvizja ka tërhequr mjaft joturq në zonat ku emigrantët turq jetojnë, punojnë dhe studiojnë? Nëse e masim në aspektin e numrit të anëtarëve, shtrirjen globale, apo angazhimin e anëtarëve, Lëvizja Gylen

është në lulëzim e sipër. Si shpjegohet suksesi i saj? Pjesërisht, këto pyetje përbëjnë fokusin e këtij libri. Kapitulli 2 që bën fjalë mbi *"Islamin dhe Shtetin përgjatë historisë turke"* paraqet një pasqyrë të historisë së Turqisë që nga fundi i Perandorisë Osmane e deri në ditët tona, e parë nga këndvështrimi i marrëdhënieve mes shtetit dhe fesë (d.m.th. Islamit). Ky sfond historik dhe politik është thelbësor për të kuptuar kontekstin shoqëror në të cilin z. Gylen është bërë i njohur, ku ai zhvilloi idetë e tij dhe për të cilat ai ka folur në predikimet dhe shkrimet e tij. Në Kapitullin 3, *"Fetullah Gylen: Jeta, besimi dhe l*ëvizja e frymëzuar prej tij», unë i prezantoj lexuesit me Fethullah Gylenin duke përshkruar historinë e jetës së tij, ndikimet në zhvillimin e tij intelektual dhe shpirtëror, besimet dhe vlerat që ai përqafon, si dhe zhvillimin e lëvizjes të cilën ai ka frymëzuar. Në kapitujt 3, 4 dhe 5, unë kam përdorur lentet e teorisë së lëvizjeve sociale, e veçanërisht njohuritë në lidhje me teorinë e mobilizimit të burimeve dhe atë të përkushtimit, për të përshkruar shumë projekte të *hizmetit* që qëndrojnë në thelb të lëvizjes. Kapitulli 4, *"Organizimi shoqëror i l*ëvizjes: Rrjeti i qarqeve lokale» dhe kapitulli 5, *"Kultura turko-islame e bamirësisë"*, e vënë theksin në mënyrë të veçantë në konceptet kulturore dhe fetare që janë të ngulitura thellë në shoqërinë turke, të cilat sigurojë motivimin dhe frymëzimin që qëndron pas veprave të mira të lëvizjes Gylen. Këto projekte të shumta të *hizmetit* mbështeten në punën vullnetare dhe kontributet monetare të miliona pjesëtarëve të lëvizjes në mbarë botën, duke përfshirë të dy palët, si biznesmenët e pasur, të cilët po dhurojnë sasi të konsiderueshme të pasurisë së tyre për lëvizjen, por edhe ata njerëz të varfër buxhetorë, të cilët bëjnë sakrifica të mëdha për të dhuruar disa dollarë çdo muaj në mënyrë që të ndihmojnë në realizimin e këtyre projekteve. Kapitulli i titulluar *"Uji i nevojshëm për vënien në punë të mullirit: Financimi i projekteve të hizmetit të frymëzuara nga Gyleni"* analizon mbështetjen financiare të lëvizjes dhe rezultatet e dhurimit për sa i takon angazhimit të anëtarëve.

Së fundi, në kapitullin e fundit *"Përmbledhje"*, unë i rikthehem edhe një herë tri çështjeve kërkimore të prezantuara në *"Hyrje"* duke bërë një sintezë të konkluzioneve kryesore të studimit të paraqitur në këtë libër, të cilat u japin përgjigje çështjeve në fjalë.

---

[1] Për të dhënat e anketës mbi qëndrimet e amerikanëve në lidhje me myslimanët, shih *Wuthnow (2005); Eck (2001); CAIR (2006)*.

[2] Abu-Rabi (2008).

[3] Shih: *Cook (2007)* përsa i përket debatit në lidhje me termin "myslimanë të moderuar."

[4] Vetë z. Gylen, e kundërshton idenë se diskursi i tij përfaqëson një lloj të "Islamit të moderuar", meqënëse ai argumenton se Islami është vetvetiu, në natyrën e tij, i moderuar.

[5] Cook (2007).

[6] Tolson (2008).

[7] Agai (2002) vlerëson se pasuesit e Gylenit drejtojnë rreth 150 shkolla private, 150 qendra arsimore, si dhe një numër edhe më të madh konviktesh në Turqi dhe mbi 250 institucione arsimore në pothuajse të gjitha rajonet e botës. Michel (2003) vlerëson se ekzistojnë mbi 300 institucione arsimore (shkolla fillore dhe të mesme, konvikte, kolegje, institucione kursesh përgatitore, dhe universitetete) në rreth pesëdhjetë vende të ndryshme. Vlerësimet e Baskan (2004) janë dukshëm më të larta: 2.000 shkolla në 52 vende nëpër pesë kontinente, duke përfshirë 125 vetëm në Turqi; Kalyoncu (2008) thekson se ekzistojnë mbi 500 institucione arsimore dhe kulturore në më shumë se 90 vende.

[8] Yavuz (2003) bën fjalë për katër aspektet në të cilën Gyleni dhe lëvizja e tij janë të ekspozuara ndaj kritikës në Turqi: (l) marrëdhëniet gjinore; (2) heshtja në çështjen kurde; (3) mbështetja për grushtin e butë të shtetit të 28 shkurtit 1997; dhe (4), një sistem edukativ jokritik dhe të orientuar nga detyra.

[9] Për më tepër në lidhje me këtë problem shih *http://arama.hurriyet.com* e datës 19 korrik 2008; gjithashtu: *http://www.todayszaman.com* e datës 23 korrik 2008.

[10] Për diskutimin e këtij rasti shih *Aslandogan (2006);* gjithashtu *www.sundayszaman.com* e datës 21 tetor 2007.

[11] Mohandas Karamchand Gandhi (1869-1948) ishte një udhëheqës i madh shpirtëror dhe politik në Indi dhe një figurë e rëndësishme e lëvizjes indiane për pavarësi. Si hindu praktikant që ishte, ai mbrojti idenë e paqes, bëri një jetë modeste në një banesë të tjeshtë, hëngri gjithmonë ushqim të thjeshtë vegjetarian dhe iu nënshtrua agjërimit të gjatë si një mjet vetëpastrimi dhe proteste sociale. Ai udhëhoqi fushata mbarëkombëtare për zhdukjen e varfërisë, duke zgjeruar të drejtat e grave, ndërtimin e harmoninë fetare dhe etnike, duke i dhënë fund paprekshmërisë, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe zgjerimin e autonomisë, si dhe mbështeti fort pavarësinë e Indisë nga dominimi i huaj. Ai u bë frymëzues i lëvizjeve për të drejtat civile dhe për liri në mbarë botën.

[12] Ayatollah Ruhollah Khomeini (1900-1989) u bë një dijetar dhe lider i rëndësishëm islam në rezistencën fetare shiite kundër modernizimit të Iranit gjatë viteve '60. Shahu i Iranit e internoi atë së pari në Turqi dhe më pas në Irak, ku ndikimi i tij u rrit. Si reagim ndaj pushtetit të tij në rritje, Sadam Huseini e detyroi atë të mërgonte në Paris në vitin 1978, ku ai vijoi të përhapte mesazhet e tij fetare konservatore, duke përfshirë edhe urrejtjen ndaj Perëndimit dhe thirrjet për revolucionin islamik. Në vitin 1978, Khomeini u kthye në Iran, ku pasuesit e tij përmbysën Shahun e Iranit dhe e caktuan Khomeinin si udhëheqës të vendit, një post të cilin ai e mbajti deri në vitin 1989, kur vdiq nga kanceri.

[13] Teoricienë, të cilët propozojnë një perspektivë psikologjie sociale përfshijnë: Gurr (1970); Turner dhe Killian (1972); Smelser (1963); Byrne (1996); Eyerman dhe Jamison (1991).

[14] Oberschall (1973); Tilly (1978); Snow et al. (1980); McAdam et al. (1996); (Melucci (1999); Edwards dhe McCarthy (2004).

[15] McCarthy dhe Zald (1977); Kendall (2005); Gamson dhe Fireman (1979).

[16] McCarthy dhe Zald (1977); Jenkins (1983); Edwards dhe McCarthy (2004); Garner (1996); McCarthy dhe Wolfson (1996).

[17] Kanter (1972).

[18] Po aty.

ISLAMI DHE SHTETI PËRGJATË HISTORISË SË TURQISË

Për ta kuptuar siç duhet si domethënien e jetës dhe mësimeve të mendimtarit Fethullah Gylen, ashtu edhe shkallën e frikës dhe akuzave që e kanë vënë atë në shënjestër të kritikëve të tij, është e nevojshme që më parë ta vendosim Gylenin në kontekstin e historisë turke, sidomos në lidhje me çështje të komplikuara siç janë feja dhe politika. Përgjatë gjithë historisë turke nuk ka pasur kurrë një ndarje të plotë të Islamit nga shteti. Megjithatë, në republikën e re të krijuar nga Mustafa Kemal Ataturku në vitin 1923, një nga gjashtë shtyllat e shtetit ishte laicizmi, bazuar në modelin francez të kontrollit shtetëror ndaj fesë. Në këtë kapitull, unë do të përshkruaj ndryshimet e mëdha që ndodhën në Turqi gjatë 100 viteve të fundit në përcaktimin e rolit të Islamit në politikën shtetërore.

Perandoria Osmane

Në pjesën më të madhe të kohës së ekzistencës së Perandorisë Osmane (afërsisht 1300-1922), ka ekzistuar një marrëdhënie e ngushtë dhe simbiotike mes sulltanëve (sundimtarët politike) dhe kalifëve (udhëheqësve islamë). Islami iu drejtua sunduesve për mbrojtjen e tij dhe sundimtarët e përdorën shpeshherë Islamin për legjitimitetin e tyre politik.[1] Në këtë mënyrë, lindi një marrëdhënie e ndërlikuar ndërmjet Islamit dhe shtetit. Perandoria Osmane gjithashtu është qeverisur nga ligji islamik i *Sheriatit*, i cili nuk garanton të drejta të barabarta për jomyslimanët. Autoritetet drejtuese zyrtare fetare (*ulematë*) shkuan përtej çështjeve fetare

dhe dominuan sistemet arsimore dhe madje edhe disa prej atyre gjyqësore të perandorisë. *Ulematë* hapën shumë shkolla islame apo siç quhen ndryshe *medrese* ku u shkolluan shumica e oficerëve të rangut të ulët të burokracisë osmane.[2]

Nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë reformat e osmanëve synonin ruajtjen e perandorisë në një kohë kur disfatat ushtarake po i dobësonin dita-ditës pozitat e sulltanëve. Megjithatë në të njëjtën kohë, autoritetet fetare përbënin bërthamën e opozitës ndaj reformave osmane, të cilat kishin sidomos prirjen të shpërfillnin Sheriatit në përpjekjet për të modernizuar shtetin dhe të cilat synonin të siguronin barazinë për të gjithë qytetarët. Pavarësisht kundërshtimit nga ana e ulemave, sunduesit osmanë krijuan shkollat e stilit evropian me instruktorë që vinin nga Europa, së bashku me gjykatat e reja jashtë sistemit të sheriatit. Në 1850 një kod tregtar u bë kodi i parë që do të hartohej jashtë sferës së ndikimit të "sundimtarëve fetarë". Njëkohësisht, një brez i tërë të rinjve u diplomua nëpër shkollat e themeluara rishtazi të stilit evropian dhe u dërguan në Evropë për të ndjekur arsimin e lartë. Ky kuadër i studentëve shndërrua më vonë në ata që u quajtën Osmanët e Rinj, të cilët kërkuan reforma të mëtejshme dhe ia arritën qëllimit, duke hedhur themelet e një monarkie kushtetuese dhe të Kushtetutës së parë Osmane. Kur, një vit më vonë, sulltan Abdulhamidi II, shpërndau parlamentin dhe pezulloi kushtetutën, osmanët e rinj kaluan në ilegalitet dhe evoluan përfundimisht në grupimin e xhonturqve, të cilët u rishfaqën në skenën turke në dekadat e para të shekullit të njëzetë, përmes Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit (KBP), duke e udhëhequr kështu Turqinë drejt epokës republikane.

Islami dhe shteti në fillimet e Republikës së Turqisë

Duke nisur që nga viti 1913, KPB ndërmori një seri reformash që shtruan rrugën për braktisjen e plotë të sheriatit dhe të

nënshtrimit të gjykatave fetare, autoritetit të gjykatave laike. Në vitin 1915, gjykatat juridike të sheriatit u futën nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë. Ulematë u eliminuan, dhe Islami u vu nën kontrollin e shtetit. Pronat në zotërim të fondacioneve islame iu transferuan Ministrisë së Financave. Në vitin 1924 kalifati u shfuqizua, si dhe u themelua Drejtoria e Çështjeve Fetare si një zyrë e shtetit që kujdesej për çështjet fetare islame, ndërsa kontrolli i shkollave islame (medreseve) iu dha si kompetencë Ministrisë së Arsimit. Sistemi kalendarik hënor dhe diellor islam u abrogua, përveçse në rastet kur përdorej në çështjet fetare. Ishte përgatitur kështu terreni për procesin e laicizmit, proces që do të realizohej nga themeluesi i republikës së re turke, Mustafa Kemal Ataturku (1881-1938).

Në vitin 1923, turqit të udhëhequr nga Ataturku, nëpërmjet organizimit të rezistencës kundër forcave pushtuese greke të mbështetura nga fuqitë perëndimore, fituan sovranitetin mbi Thrakën lindore dhe gjithë Anadollin dhe e transformuan vendin në Republikën e Turqisë. Qëllimi kryesor i Ataturkut ishte ecja në një rrugë e cila ishte shumë e ndryshme nga ajo e Perandorisë Osmane, e sidomos krijimi i një shteti laik dhe nacionalist, i drejtuar pa ndikimin e Islamit në politikë.[3] Elita e re republikane, me Ataturkun në krye si udhëheqësin dhe zëdhënësin e saj, favorizuan procesin e modernizimit të plotë, të cilin ata e shihnin si shpëtim nga prapambetja, dhe nuk linin rast pa shprehur antipatinë dhe mosbesimin ndaj të gjitha gjërave që kishin lidhje me regjimin e kaluar dhe me mënyrat e vjetra të jetesës. Në mënyrë të veçantë, feja dhe institucionet fetare ishin mjaft të paragjykuar në atë periudhë dhe konsideroheshin si antitezë e qytetërimit bashkëkohor. Ataturku dhe pasuesit e tij kemalistë synonin të krijonin një shtet-komb të ri turk, të bazuar në mënyrë eksplicite në nacionalizmin etnik, që do të zëvendësonte vlerat multietnike, multifetare dhe me orientim Islamik të Perandorisë Osmane.[4]

Duke qenë një mjeshtër në politikë, Ataturku i aplikoi reformat e tij ngadalë dhe fillimisht e përdori Islamin për të bashkuar dhe mobilizuar njerëzit, veçanërisht kundër ushtrive pushtuese evropiane.[5] Vetëm në vitin 1924, ai deklaroi haptazi se do të ishte nacionalizmi turk e jo Islami, faktori i vetëm që do të ndikojë në bashkimin e popullit turk.[6] Shteti përdori ushtrinë, shkollat dhe medien për të konsoliduar identitetin kombëtar turk dhe për t'u distancuar nga Islami dhe trashëgimia osmane. Për t'ia arritur këtij qëllimi dhe për të zbehur ndikimin e Islamit, ai mbylli teqetë e dervishëve dhe urdhrat sufiste, ndaloi ceremonitë dhe liturgjitë e tyre, si dhe e shpalli të jashtëligjshme veshjen e tyre. Ai e denoncoi fesin si kapele e një populli të prapambetur dhe perçen si përfaqësuese të statusit diskriminues të grave. Thirrja për namaz, ezani, duhej të këndohej në gjuhën turke dhe jo në arabisht e madje edhe Kurani u përkthye në gjuhën turke, duke u shtypur në shkronja latine. Në mënyrë që të dukej më perëndimor dhe modern, ai e zëvendësoi alfabetin arab me atë latin, si dhe miratoi kalendarin gregorian, në vend të atij islam, hënor. Ai gjithashtu promovoi barazinë mes burrave e grave dhe në vitin 1934, shpalli të drejtën e grave për të votuar në Turqi. Në vitin 1928, Islami u hoq nga kushtetuta si fe zyrtare e shtetit të Turqisë. Ndërsa ende mbetet një pjesë integrale e kulturës turke, roli qendror i Islamit në politikë mori fund. Në vitin 1937, parimi i laicitetit zëvendësoi Islamin në Kushtetutë.

Botëkuptimi i Ataturkut për laicitetin

Midis viteve 1925 dhe 1928 parlamenti i fuqishëm kemalist miratoi një sërë masash që synonin laicizimin e jetës publike. Ataturku besonte se Turqia duhet të linte pas të kaluarën e saj dhe të ndiqte shembullin e Evropës. Prandaj, ai mbrojti idenë e eliminimit të të gjitha pengesave që vështirësonin krijimin e një shteti kombëtar, laik dhe perëndimor. Pas fitimit të pavarësisë

kombëtare, republika zbatoi një politikë të ngurtë laike duke i mohuar Islamit çdo lloj roli në formimin e sistemit të ri shtetëror.

Modeli laik që Ataturku futi në Republikën e Turqisë ishte ai i laicizmit ose siç njihet ndryshe *laicite*, një sistem ky i formësuar mbi bazën e atij të Evropës dhe sidomos të Francës në veçanti. *Laicite* zgjeron pushtetin e shtetit dhe kufizon fenë në sferën private. Ajo është një formë e shekularizmit që kërkon përjashtimin e besimeve dhe praktikave fetare nga jeta publike dhe pret që shteti të përdorë fuqinë e tij për të mundësuar këtë përjashtim. *Laicite* është një filozofi antifetare dhe synon ta mbajë nën kontroll apo më keq, ta eliminojë fare fenë, ndryshe nga modeli i shekularizmit anglo-amerikan, i cili synon të mbrojë fetë nga ndërhyrjet shtetërore dhe inkurajon lëvizjet shoqërore të bazuara mbi besimin fetar, për të konsoliduar në këtë mënyrë shoqërinë civile.[8] Shekularizmi turk është i bazuar në nocionin e transformimit të shoqërisë nëpërmjet fuqisë së shtetit duke eliminuar fenë nga sfera publike. Në fakt, në sistemin e *Laicite* çdo përpjekje për të përdorur diskursin fetar në debatin publik, madje edhe në parlamentin turk, mund të përdoret si argument për ta nxjerrë atë parti ose individ jashtë ligjit.

Laicizmi u shndërrua në parimim themelor të përpjekjes kemaliste për ndërtimin e një shteti-komb, në të cilin, në Kongresin e Katërt të Partisë Popullore Republikane në 1935, Mustafa Kemali (i njohur gjerësisht si Ataturku), i kodifikoi idetë dhe qëllimet e tij si «Kemalizmi», doktrinë e cila përbëhej nga gjashtë parime bazë për të udhëhequr partinë dhe popullin: nacionalizmi, shekularizmi, republikanizmi, etatizmi, reformizmi dhe populizmi. Sipas kësaj doktrine, feja zbret në nivelin e praktikës private, duke qenë njëkohësisht e kontrolluar nga shteti. Këto parime janë formuar nga ideologjitë dominuese evropiane në një kohë kur modernizimi perceptohej si perëndimorizim. Ideologjia dhe praktika kemaliste synonte të eliminonte klasat, burimet etnike dhe fetare të konfliktit, duke krijuar një shoqëri

pa klasa, nacionaliste (domethënë turke) dhe laike, e cila do të ishte pa asnjë gjurmë praktike fetare në sferën publike. Për më tepër, për shkak të ndikimit të fuqishëm të pozitivizmit francez dhe laicizmit mes lidershipit të ri kemalist, i vetmi agjent legjitim i ndryshimit, ishte shteti vetë. Kombi dhe shteti ishin një i vetëm dhe të gjitha fetë dhe në veçanti Islami, u përjashtuan nga sfera publike. Çdo formë e trazirave civile ose protestave popullore, shërbente si një burim dyshimi dhe shqetësimi për shtetin.[9]

Laicizmi kemalist kishte besim absolut tek shkenca dhe pozitivizmi dhe i jepte përparësi ristrukturimit të shoqërisë në përputhje me këto parime. Në këtë mënyrë, një politikë e tillë është bërë pengesë për ndikimin fetar në sferat e arsimit, ekonomisë, familjes, kodit të veshjes dhe politikës. Në këtë kontekst, laicizmi merr kuptimin e depërtimit të tepruar të shtetit në jetën e përditshme dhe në përjashtimin e dallimeve etnike dhe fetare. Republika turke themeloi Drejtorinë e Çështjeve Fetare për të administruar dhe për të rregulluar nevojat dhe problemet e besimtarëve dhe përfaqësuesve fetarë në sferën publike. Ataturku i ndaloi të gjitha rrjetet e shoqërisë civile me bazë fetare. Në vitin 1937, këto parime janë përfshirë në kushtetutë si parime themelore të shtetit. Ideologjia dhe sistemi politik që rezultoi nga këto parime ishte dhe ende është i njohur si «Kemalizmi».[10]

Kemalizmi u bë ideologjia e eleminimit të klasave, burimeve etnike dhe fetare të konfliktit duke u përpjekur për të krijuar një shoqëri pa klasa, me përbërje homogjene turke dhe laike. Kështu, frika nga dallimet u bë parimi udhëheqës i shtetit kemalist. Për më tepër, kemalistët e konsideronin ndryshim si legjitim vetëm atëherë kur ai bëhej nga vetë shteti. Prandaj, çdo formë modernizimi i shoqërisë civile nga poshtë-lart përbënte një burim dyshimi dhe shqetësimi, sidomos kur ai ishte i motivuar nga shqetësimet fetare, të cilat konsideroheshin si një kërcënim për shtetin laik.[11]

Parimi i laicizmit apo shekularizmit u bazua në modelin

francez të laicizmit në të cilën feja ishte vendosur nën kontrollin e shtetit, si dhe çdo formë shprehjeje fetare ishte hequr zyrtarisht nga jeta publike. Në vitin 1801 Kisha Katolike në Francë nën varësinë e Napoleon Bonapartit nënshkroi një traktat që ligjëroi kontrollin shtetëror mbi kishën. Sipas këtij traktati, Vatikani ra dakord që peshkopët të emëroheshin nga shteti francez dhe të gjithë priftërinjtë të caktoheshin dhe të paguheshin po nga shteti. Shekularizmi turk, edhe pse në bazë të tij kishte laicizmin francez, shkoi edhe më tej, duke vendosur një kontroll total të shtetit mbi fenë. Jo vetëm imamët caktoheshin nga shteti si punonjës civilë, por edhe përmbajtja e predikimeve të tyre gjatë faljes së të premtes ishte e përcaktuar nga shteti, kontroll ky që vazhdon ende në Turqinë e sotme. Shekularizmi në kontekstin kemalist nënkuptonte depërtimin e shtetit në jetën e përditshme dhe përjashtimin e dallimeve etnike, fetare apo rajonale. Yavuz dhe Esposito argumentojnë se "Në kundërshtim me synimet e saj, projekti kemalist i nacionalizmit dhe laicizmit në fakt ka ndihmuar për të ndërtuar një Islam kundërshtues dhe të ideologjizuar. Kështu, ringjallja fetare u shndërrua në një dialektikë të brendshme të ideologjisë kemaliste."[12] Frika nga dallimet, e sidomos nga dallimet fetare, u bë një parim udhëheqës i shtetit kemalist dhe shihej si kërcënim ndaj shtetit.

Sistemi i *Laicite* (ose laicizmit) dominoi politikën turke gjatë viteve të qeverisjes së Partisë Republikane Popullore (1923-1950), vite në të cilat një parti e vetme sundoi krejt vendin. Filozofia themelore e këtij qëndrimi ishte se shteti ishte ai që e dinte mirë se çfarë ishte në dobinë e popullit dhe se PRP po e mbronte Islamin nga ndikimi i gjuhëve dhe kulturave të huaja.[13]

Sistemi shumëpartiak në Turqi

Kalimi i Turqisë në një sistem politik pluralist në vitin 1946, vit në të cilin u themelua Partia Demokratike, përbënte një pikë

kthese në historinë politike të Turqisë, duke përfshirë edhe rolin e Islamit në shtetin turk. Në këtë kohë Islami ishte nën kontrollin e shtetit, por megjithatë mbetej ende një forcë efektive sociale dhe morale në Turqi. Partia Demokratike e kritikoi ashpër kontrollin total të Partisë Republikane Popullore mbi Islamin. Në mënyrë që të qetësonte PD, kryeministri filloi të zbuste politikat mbi Islamin, duke përfshirë këtu shtimin e kurseve rreth Islamit në programin shkollor. Kur PD fitoi zgjedhjet në vitin 1950, ajo mbajti një qëndrim të ngjashëm për sa i përket shekularizmit, edhe pse kjo parti lejoi një rikthim të thirrjes për namaz në gjuhën arabe, hoqi pengesat që ndalonin të mësuarit dhe praktikën fetare, si dhe ndërtoi xhami të reja. Megjithatë, ajo e kundërshtoi Islamin politik dhe u përpoq të ruante natyrën laike të shtetit.

PD mbështeti një ndryshim në kodin penal turk të miratuar nga administrata paraardhëse, konkretisht nenin e famshëm 163, sipas të cilit çdo lëvizje që synonte të ndryshonte sistemin social, ekonomik, politik dhe gjyqësor të bazuar qoftë edhe pjesërisht në parimet dhe besimet fetare, do të ndëshkohej. Ky nen e forcoi edhe më tepër kontrollin e fesë nga shteti dhe garantoi që asnjë lëvizje islamike që mund ta rrezikonte këtë kontroll, nuk do të mund të shfaqej. PD e ashpërsoi edhe më tej nenin 163 në vitin 1953, duke futur dënimet për çdo person apo grupim, i cili do ta përdorte fenë për qëllim politike apo personale. Në këtë mënyrë ky ligj e shtriu edhe më tej kontrollin e shtetit mbi fenë dhe i dha shtetit fuqinë për t'i mbyllur gojën çdo proteste të bazuar mbi doktrinën fetare.

Një grusht shteti në vitin 1960, e rrëzoi nga pushteti PD dhe pas këtij grushti, Partia e Drejtësisë u bë pasardhësja e PD në pushtet. Nexhmetin Erbakan synoi të garonte nën siglën Partisë Demokratike, por kërkesa iu refuzua nga krytari i partisë Sulejman Demirel. Erbakan, i cili u bë në ato vite një figurë lider dhe një politikan dhe intelektual mjaft me peshë, u zgjodh në parlament në vitin 1969. Shpesh thuhet se ai "ripërkufizoi rolin e Islamit në

politikën turke."[14] Ai synonte të bashkonte nën udhëheqjen e tij grupimet e ndryshme islame nëpërmjet krijimit të ndryshimeve në sistem përmes procesit elektoral. Për shkak të ideve dhe pikëpamjeve të tij islame, ai u përjashtua nga politika për pesë vjet, në bazë të nenit 163. Megjithatë, aty nga fundi i viteve '60, Turqia, si shumica e vendeve të tjera të botës islame, po kërcënohej nga idetë e socializmit. Një nga mënyrat për të parandaluar rritjen e ndikimit të socializmit, ishte fuqizimi i Islamit. Edhe në Shtetet e Bashkuara, si pjesë e strategjisë së politikës parandaluese të Luftës së Ftohtë, synohej të ndalohej përhapja e ndikimit të socializmit dhe komunizmit përmes ndihmës së një "brezi të gjelbër islam" që përfshinte Turqinë, Iranin, Pakistanin, Afganistanin, Indonezinë dhe Malajzinë, që të gjitha këto, vende islame. Islami shihej si antidoza e socializmit, dhe bota islame po zbulonte një rol të ri të Islamit në politikë. Dhe Erbakani ishte një faktor madhor në rritjen e rëndësisë së Islamit në politikën botërore.

Erbakani, në mënyrë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse argumentonte se nuk ishte kundër laicizmit, por kundër mënyrës së implementimit të laicizmit në Turqi. Ai kërkonte një ripërcaktim të rolit të tij, me qëllim lejimin e praktikimit të lirë të fesë dhe mbronte idenë e ndryshimeve në nenin 2 të kushtetutës turke, i cili përcaktonte natyrën laike të shtetit dhe i cili mund të përdorej për të sulmuar fenë, sa herë që shteti e dëshironte një gjë të tillë.

Në zgjedhjet e vitit 1965, partia AP (një pasardhëse e ish-Partisë Demokratike, erdhi në pushtet me Demirelin si kryeministër. Demireli ishte mjaft popullor në mesin e myslimanëve praktikantë, pasi edhe ai vetë falte namazin e xhumasë. Tetë vjet më vonë, AP i humbi zgjedhjet përballë CHP (Partisë Republikane të Popullit, - *partia me të cilën kishte udhëhequr Ataturku*) dhe Exhevit u zgjodh kryeministër. Exheviti mbështeste idenë se njerëzit kanë nevojë për fenë dhe se feja nxiste zhvillimin.

Grushti i shtetit i 1980, solli në pushtet partinë e re të quajtur

Partia e Mëmëdheut (PM) nën lidershipin e Turgut Ozalit, i cili e vuri theksin mbi rolin e edukimit dhe moralit islam si një forcë kundërvepruese ndaj socializmit.[15] Ozali përkrahte ideologjinë e Sintezës Turko-Islamie (STI), e cila ndërthurte vlerat islame me nacionalizmin turk. STI e përqafoi Islamin si një burim morali, por hodhi poshtë Islamin politik. Kjo filozofi gjithashtu e paraqiste Islamin si një sistem të pajtueshëm me nacionalizmin, demokracinë, kemalizmin dhe kapitalizmin. Nën udhëheqjen e Ozalit, Turqia eci përpara drejt sistemit ekonomik kapitalist dhe filloi të ndërmerrte reforma demokratike. Neni famëkeq 163 i Kodit Penal turk u shfuqizua, si pjesë e procesit demokratik. Po kështu, liberalizimi dhe rritja ekonomike gjatë qeverisjes së Ozalit, bëri të mundur krijimin e një klase dinamike sipërmarrësish, si dhe krijoi mundësinë e ekzistencës së gazetave dhe stacioneve televizive të pavarura, të cilat nuk mund të detyroheshin të heshtnin nga klasa politike.[16] Partia e Mëmëdheut e Ozalit ndërthuri një program ekonomik me orientim global, me vlerat konservatore shoqërore.

Nën drejtimin presidencial të Ozalit, ekonomia e tregut u shndërrua në një forcë udhëheqëse në politikën e jashtme turke. Ai e vuri theksin në një program ekonomik të orientuar nga eksportet, i cili i hapte rrugë investimeve të huaja dhe lejonte sipërmarrjet e reja të biznesmenëve turq të lulëzonin. Më pas, rënia e Bashkimit Sovietik hapi mundësi të reja për sipërmarrjet turke në republikat e sapokrijuara pas shpalljes së pavarësisë nga Bashkimi Sovietik, sidomos në fushën e rëndësishme të energjisë.[17]

Ozali argumentonte se kufizimet në lirinë e ndërgjegjes ushqenin fanatizmin, në vend që të bënin të kundërtën. Duke u përpjekur të luftonte komunizmin me anë të idealeve islame, ai kërkoi që në çdo shkollë të përfshihej edhe mësimi i detyrueshëm i Islamit.[18] Kishte filluar që nëpër xhami të ndesheshin shpesh anëtarë të parlamentit dhe të kabinetit qeveritar. Shamia e kokës u lejua në publik, duke u bazuar në të drejtat dhe liritë e individit, të cilat garantoheshin nga

kushtetuta. Kundërshtarët e shamisë argumentonin se Ataturku e kishte kthyer atë në simbolin e famshëm të Islamit, prandaj lejimi i saj në publik përbënte një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj shtetit laik të garantuar me kushtetutë.[19]

Qeveria e Ozalit miratoi gjithashtu një ligj, i cili u lejonte studenteve të universitetit të vishnin shaminë e kokës, mirëpo gjykata kushtetuese e hodhi poshtë këtë vendim. Megjithatë shumë studente vazhduan të mbanin shami në kokë. Shamia mbeti për shumë kohë një burim konflikti ndërmjet konservatorëve dhe laikëve radikalë në Turqi. Ndërkohë që laikët radikalë e konsideronin vendosjen e shamisë si një veprim antilaik dhe antikemalist, laikët liberalë dhe konservatorët e konsideronin atë si një të drejtë themelore të individit.

Çështja e shamisë u bë pasqyrë e një prej impakteve më të mëdha të politikave neoliberale të Ozalit, domethënë përhapjen e Islamit në hapësirat publike. Kjo rezultoi në një pluralizëm të sferës fetare dhe në zgjerimin e rrjeteve fetare në ekonomi, media dhe sipërmarrje bamirësie. Ligji i frekuencave radio-televizive për shembull, fuqizoi zërat islamë, të tillë si Lëvizja Gylen, duke u mundësuar atyre të shprehnin idetë e tyre nëpër stacione të ndryshme radiofonike dhe televizive, si dhe nëpër gazeta dhe revista. Këto hapësira të reja të krijuara nën qeverisjen e Ozalit kanë shërbyer për të fuqizuar grupimet me karakter islam në Turqi, duke përfshirë edhe ato të frymëzuara nga z. Gylen.[20]

Me liberalizimin dhe diversifikimin ekonomik të Turqisë, grupimet fetare dhe etnike kanë ardhur gradualisht duke u integruar në sferën publike dhe kanë fituar fuqi dhe ndikim informal. Një strukturë madhore me anë të së cilës ka ndodhur kjo, është *dershane-ja* (*qendra kursesh, me karakter kryesisht përgatitor për t'u pranuar në universitet*), qarqet e takimeve të njerëzve që angazhohen nëpër biseda dhe lexime, lutje dhe namaze frymëzuese dhe të cilët sigurojnë hapësira sociale për

diskutim, socializim dhe krijim lidhjesh shoqërore. Si rezultat i këtyre qarqeve janë krijuar mundësi të reja të komunikimit dhe një ndryshim i perceptimit publik, në të cilin është promovuar rëndësia e të qenit një mysliman i devotshëm. Në këtë mënyrë, është krijuar ndërtimi i një ndërgjegje të re fetare, së bashku me një sens të përgjegjësisë sociale. Prandaj një nga rezultatet më të rëndësishme të ndikimit të madh të këtyre qarqeve të leximit në jetën shoqërore dhe politike, është prania e frymës fetare derdhur nëpër sfera të tjera shoqërore duke ofruar kështu krijimin e lidhjeve mes njerëzve, rrjeteve si dhe mundësitë për të themeluar shoqata qytetare.[21]

Ndërsa Erbakanit i ishte ndaluar të merrej me politikë për dhjetë vjet, pasuesit e tij themeluan Partinë Mirëqënies (PM), të njohur në Turqi edhe si Partia Refah (PR), duke u bërë pjesë e parlamentit në vitin 1991. Pesë vjet më vonë ai u zgjodh kryeministër i Turqisë. Erbakan ishte një mysliman praktikues i deklaruar, i cili kishte mbështetur gjatë një rol më të fuqishëm të Islamit në arenën politike. Me zgjedhjen e tij, nisi një debat publik rreth zgjerimit të rolit të fesë në politikë dhe në lidhje me kuptimin e "islamit politik" në republikanizëm.[22] Ai e lavdëronte Iranin për rezistencën e tij ndaj Perëndimit dhe synonte të nxirrte Turqinë nga NATO, në mënyrë që të themelonte një NATO islamike, një OKB islamike, një version islamik të BE-së si dhe një monedhë të përbashkët islamike.[23] Përveç kësaj, Partia e Mirëqënies artikuloi një vizion të demokracisë në Turqi nëpërmjet përdorimit të një gjuhe të kuptueshme nga njerëzit, domethënë zakoneve fetare, vlerave tradicionale dhe moralit islam.[24] Kjo retorikë u vlerësua nga shumë qarqe konservatore të shoqërisë fetare turke dhe u kundërshtua fuqishëm nga shekularistët, të cilët i trembeshin formimit të një shteti islam. Erbakan gjithashtu bëri një seri vizitash nëpër vendet myslimane, një veprim që tërhoqi mjaft kritika nga ana e shekularistëve.

Në vitin 1997 një komision i nivelit të lartë ushtarak, i njohur si " Grupi perëndimor i punës," nisi një hetim ndaj Partisë së Mirëqënies. Rezultati ishte një deklaratë e lëshuar nga Këshilli i Sigurimit Kombëtar (KSK), i cili e shihte veten si një kujdestar të reformave kemaliste dhe sidomos shekularizmit, deklaratë e cila theksonte se "grupet destruktive dhe separatiste po kërkojnë të dobësojnë demokracinë tonë dhe sistemin ligjor duke zbehur dallimin mes laikes dhe antilaikes."[25] Si rezultat i raportit të grupit të punës të ngritur nga KSK, qeveria Erbakan u detyrua të japë dorëheqjen në atë që u quajt një "grusht shteti postmodern" dhe Erbakan, së bashku me udhëheqësit e tjerë politikë në parti, u ndaluan të merren me politikë për pesë vjet, duke çuar deri në deklarimin e partisë si të jashtëligjshme.

KSK përgatiti një plan 18 pikësh për të cilin do të duhej të bihej dakord paraprakisht në mënyrë që KSK të mbështeste më pas një qeveri të re. Ky plan synonte të reduktonte ndikimin e Islamit në Turqi dhe në të përfshiheshin propozimet që forconin masat ndaluese mbi komunitete dhe organizata të caktuara fetare, spastrime të personelit "reaksionar" nga postet drejtuese, kufizime të forta për "veshjet politikisht provokuese" si shamitë e kokës së femrave si dhe spastrimin e zyrtarëve ushtarakë të njohur për të ashtuquajturat aktivitete islamike, si dhe për simpatinë për Islamin.[26] Disa analistë thonë se që nga grushti ushtarak i vitit 1980, asgjë nuk ka qenë aq vendimtare në jetën politike turke sesa këto veprime të KSK-së në shkurt 1997, për shkak se në këtë rast, ushtria konfirmoi supremacinë e saj mbi jetën politike në Turqi.[27] Në vitin 1998 Gjykata Kushtetuese e nxori jashtë ligjit Partinë e Mirëqënies "për shkak të veprimtarisë së saj kundër parimeve të republikës laike." Anëtarët e partisë së rrëzuar formuan një parti pasardhëse, Partia e Virtytit (PV), e cila më pas u bë partia më e madhe në parlament.

Në vitin 1998 Mesut Jëllmaz, udhëheqësi i Partisë së Mëmëdheut,

formoi një qeveri të re dhe u bë kryeministër i Turqisë, e me të marrë pushtetin i dha një shtysë përpara «Procesit të 28 shkurtit", qëllimi i të cilit ishte që të kufizonte ndikimin e Islamit në jetën publike. Ai vuri kufizime për pranimin nëpër Shkollat Imam Hatip (*medrese*) dhe udhëzoi Ministrinë e Arsimit për të zbatuar rregulloret që ndalojnë shaminë nëpër shkolla, universitete, si dhe nëpër hapësirat publike. Policia arrestoi 20 biznesmenët kryesorë myslimanë me akuzën se kishin siguruar fonde për aktivitete islamike. Një kryeprokuror në Ankara kërkoi mbylljen e MUSIAD, "Shoqatës Industrialistëve dhe Biznesmenëve të Pavarur," pasi ishte një shoqatë me nuanca "fetare".

Në mes të hetimeve rreth korrupsionit politik dhe lidhjeve me krimin e organizuar, në vitin 1998, qeveria Jëllmaz u rrëzua. Exhevit, kreu i Partisë Demokratike të Majtë (DLP) u bë kryeministër. Qeveria ishte efektive me qëndrimin e saj përsa i përket prurjes së një sërë reformash ekonomike, me zyrtarizimin e legjislacionit që kishte të bënte me respektimin e të drejtave të njeriut dhe afrimin e Turqisë më pranë pranimit në Bashkimin Evropian. Një seri krizash ekonomike, çoi në zgjedhje të reja në vitin 2002 dhe solli në pushtet partinë fetare konservatore për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) të themeluar nga Rexhep Tajip Erdogan, me 34% të votës popullore. Në vitin 2007, AKP fitoi përsëri zgjedhjet me një shumicë votash edhe më të madhe (46%) sesa në zgjedhjet e mëparshme dhe zgjodhi Abdullah Gyl si president dhe Erdoganin si kryeministër.

AKP e portretizon vetveten si një parti konservatore të moderuar pro-perëndimore që mbështet një ekonomi liberale të tregut dhe anëtarësimin e Turqisë në BE. Revistat më me ndikim të biznesit, të tilla si *The Economist,* e konsiderojnë qeverinë e partisë AKP si më të suksesshmen në Turqi në dekadat e fundit.[28] Fuller, ish zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Zbulimit në CIA, thotë se Turqia ka prodhuar dy lëvizje dinamike islame, që

kanë një rëndësi të madhe jo vetëm për Turqinë, por edhe për Islamin bashkëkohor në përgjithësi: partinë politike AKP dhe lëvizjen e madhe komunitare apolitike të Fethullah Gylenit.[29] AKP u zotua për të respektuar besimin fetar dhe për të mbështetur vlerat morale, por brenda kontekstit të një shteti laik. Për AKP-në, laicizmi nënkuptonte mosndërhyrje shtetërore në praktikë fetare, një qëndrim i përkrahur edhe nga z. Gylen dhe mbështetësit e tij. Në vizionin e AKP-së, feja mbeti institucioni më i rëndësishëm i njeriut, duke krijuar kështu një rend moral dhe social, por institucionet fetare mund të mbahen në këmbë dhe forcohen më së miri në një klimë të lirisë fetare.[30]

Ndërsa kritikët shpesh e akuzojnë partinë se mbart një axhendë të fshehtë islamike, Erdogan pohon se AKP nuk është një parti politike me një aks fetar, por një parti që bën thirrje për reforma demokratike dhe ekonomike krahas theksit që u jep vlerave morale.[31] Erdogan kërkoi të zbuste imazhin islamik të partisë së tij duke ndërtuar një koalicion të gjerë afatgjatë me partitë e qendrës së djathtë dhe duke mbështetur aspiratën e Turqisë për t'u bashkuar me BE. Por përkundër deklaratave të partisë, AKP ka sjellë më shumë ndryshime që mund të interpretohen si joshekulare apo me rrënjë në Islam. Partia është akuzuar për vendosjen e individëve antilaikë në zyrat e qeverisë dhe për dhënien e kontratave qeveritare për kompanitë dhe individët, të cilët janë me prirje fetare. Në vitin 2007, AKP miratoi një projektligj për heqjen e ndalimit të shamive në të gjitha universitetet. Këto veprime u kritikuan nga partitë laike, gjë që do të çonte në paditë e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese të Turqisë në vitin 2008, ku bëhej thirrje për mbylljen e partisë AKP. Argumenti i paraqitur ishte se partia AKP ishte bërë një "vatër e veprimtarive antishekulare" duke shkelur kështu kushtetutën e Turqisë. Më 30 korrik 2008, Gjykata Kushtetuese e dha verdiktin e saj. Padia për shpërbërjen e AKP-së dështoi vetëm për një votë (pesë në favor dhe gjashtë kundër).[32]

Siç tregon kjo histori e shkurtër, çështjet që kanë lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Islamit dhe shtetit kanë dominuar politikën turke që nga lindja e Republikës së Turqisë në vitin 1923 e madje edhe përpara këtij viti, qysh në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane. Asnjë çështje e vetme nuk ka qenë aq e fuqishme apo e diskutueshme në skenën politike turke; çështje e cila ende vazhdon të dominojë mbi të gjitha çështjet e tjera ligjore, zgjedhore dhe gjyqësore në atë vend. Pikërisht në kontekst të kësaj historie turke, është arsimuar, dhe ka zhvilluar idetë e tij dhe trajnimin fetar mendimtari Fethullah Gylen, i cili ishte një imam dhe predikues i famshëm, që u bë promotor i lëvizjes që tani është shndërruar në ndërkombëtare dhe ka lulëzuar në nivel global, dhe ky është gjithashtu edhe konteksti i kritikave nga ata shekularistë, të cilët frikësohen se z. Gylen është duke ndërtuar një bazë të fortë në vijim, me qëllim të krijimit në të ardhmen të një shteti islam në Turqi.

---

[1] Balci (2007).

[2] Po aty.

[3] Yilmaz (2005).

[4] Fuller (2008).

[5] Balci (2007); Yavuz dhe Esposito (2003).

[6] Yavuz (2005) thotë se Turqia mishëron një paradoks të papajtueshëm të formuar gjatë themelimit të Republikës. Nga njëra anë, shteti e ka përdorur Islamin për të unifikuar grupe të ndryshme etno-gjuhësore, në anën tjetër, ajo e përcakton ideologjinë e saj si progresiste, civilizuese dhe në kundërshtim me Islamin.

[7] Kemalistët u referohet ideve dhe politikave të promovuara nga Mustafa Kemal Ataturku.

[8] Yavuz dhe Esposito (2003).

[9] Po aty.

[10] Çetin (2010).

[11] Yavuz dhe Esposito (2003).

[12] Yavuz dhe Esposito (2003).

[13] Ballxhë (2008).

[14] Balxhë (2008).

[15] Yavuz dhe Esposito (2003).

[16] Po aty.

[17] Fuller (2008).

[18] Mësimi i detyrueshëm i Islamit është përfshirë në programin mësimor nga kreu i grushtit ushtarak të shtetit të 1980, Kenan Evren, dhe Ozal thjesht ka vazhduar praktikën e nisur prej tij.

[19] Ka pasur edhe argumente në të cilat përmendej fakti se që të dyja, si nëna ashtu edhe bashkëshortja e Ataturkut mbanin veshur shami.

[20] Yavuz dhe Esposito (2003).

[21] Yavuz (2003).

[22] Çetin (2010).

[23] Mason (2000); Howard (2001).

[24] Cetin (2010).

[25] Howard (2001); Howe (2000).

[26] Çetin (2010).

[27] Aras dhe Baxhëk (2000).

[28] The Economist (05-03-20).

[29] Fuller (2008).

[30] Mecham (2004).

[31] Turkish Daily News (07-22-2007).

[32] Hurriyet (07-30-2008).

FETULLAH GYLEN: JETA, BESIMI DHE LËVIZJA E FRYMËZUAR PREJ TIJ

Në këtë kapitull do të flasim në lidhje me shkollimin fillor të Fethullah Gylenit në një fshat të vogël në juglindje të Turqisë, arsimimin e tij të hershëm dhe ekspozimin ndaj ideve të Said Nursiut; pjesëmarrjen e tij të më vonshme në leximet e qarqeve të Nursiut dhe për famën e tij në rritje si predikues në Turqi, gjë e cila ka ndodhur brenda kontekstit të historisë turke të përshkruar në kapitullin e mëparshëm. Krahas trajnimit të tij në shkencat klasike islame, ai është më shumë një produkt i ardhur të qenit një shtetas turk dhe nga ngjarjet politike që ndikuan gjashtë apo më shumë dekadat e tij si një qytetar turk. Në këtë kapitull, unë së pari dëshiroj t'u prezantoj lexuesve ato aspekte të jetës së hershme të zotit Gylen, që u bënë shkas për formimin e ideve të tij të mëvonshme dhe planet e tij të veprimit. Së dyti, unë dëshiroj të flas në lidhje me besimet kryesore, bindjet dhe prioritetet që orientuan si mësimet e tij të hershme ashtu edhe ato të mëvonshme. Së treti, unë kam studiuar ecurinë e lëvizjes Gylen që nga burimi i origjinës në Turqi, pastaj pasi u përhap nëpër vendet e ish-Bashkimit Sovjetik dhe në fund në mbarë botën.

Historia e jetës së Fetullah Gylenit

Vitet e tij të rinisë

Fethullah Gyleni u lind në vitin 1941 në një fshat të vogël bujqësor afër Erzurumit në Turqinë Lindore. Ezurumi ishte i njohur për

një jetë kulturore konservatore dhe për një popullsi shumë të devotshme. Edhe pse kanë ekzistuar pak shanse për popullin turk në ato kohë për të ndjekur një arsim të përgjithshëm laik, prindërit e zotit Gylen e dërguan atë në shkollën fillore shtetërore më të afërt për tre vjet me radhë. Në përfundim të viteve të tij të arsimit fillore, i ati i cili punonte si imam,[1] u caktua nga shteti të punonte në një xhami të një qyteti tjetër ku nuk kishte shkolla të mesme. Kështu, z. Gylen u detyrua të braktisë shkollimin e tij formal në mes të viteve të tij të shkollës fillore, duke filluar të merrte një edukim joformal, kryesisht nga babai i tij.

Babai i zotit Gylenit, prej të cilit ai mësoi elementet themelore të Islamit, si dhe pak arabisht dhe persisht, ishte një dijetar dhe imam. Z. Gylen e kujton atë si një person që gëzohej kur lexonte libra, i cili lexonte vazhdimisht Kur'anin, kalonte faza meditimesh të përditshme rreth profetit Muhamed dhe sahabëve të Tij, si dhe që recitonte vazhdimisht poezi fetare. Ai ia ushqeu këtë dashuri për të mësuar dhe dashurinë për Profetin dhe sahabët e Tij edhe të birit.[2]

Z. Gylen e përshkruan shtëpinë e tij ku kaloi fëmijërinë e hershme si një "bujtinë për të gjithë njerëzit e ditur dhe të lartësuar shpirtërisht në rajon." Babai i tij mikpriste në shtëpinë e tij veçanërisht dijetarët me të cilin ai mund të diskutonte rreth çështjeve fetare. Sipas fjalëve të zotit Gylen, "vizitat e miqve e sidomos dijetarëve, ishin të shpeshta në shtëpinë tonë. Ne i kushtonim vëmendje të madhe pritjes së tyre. Gjatë fëmijërisë dhe rinisë sime, unë kurrë nuk jam ulur me moshatarët e mi, përkundrazi unë kam ndenjur gjithmonë me njerëz të moshuar, për t'i dëgjuar ata të flisnin rreth temave të mendjes dhe të zemrës."[3] Për shkak të këtij kontakti të hershëm me dijetarët dhe mendimtarët fetarë, z. Gylen u rrit në një rreth njerëzish të cilët ishin vazhdimisht në kërkim të botës shpirtërore dhe të vendit të saj në botën moderne.

Nëna e zotit Gylen, e cila u mësonte fshehurazi Kuranin vajzave të fshatit,[4] ka qenë gjithashtu një nga udhërrëfyeset e tij, ashtu siç ka qenë edhe gjyshi i tij, i cili ishte një nga heronjtë e tij të hershëm. Një dekadë më parë, Ataturku dhe qeveria kemaliste kishte vendosur gjashtë parimet kemaliste, përfshirë edhe nacionalizmin dhe laicizmin. Megjithëse xhamitë dhe namazet u lejuan nga qeveria laike, në këtë periudhë të historisë turke, të gjitha format e tjera të mësimit dhe praktikës fetare ishin të ndaluara. Megjithatë, prindërit e zotit Gylen, ashtu si edhe shumë njerëz të tjerë në Turqi, vijuan në traditën islame turke për t'u siguruar që ai të mësonte siç duhet Kuranin dhe praktikat themelore fetare, duke përfshirë edhe namazin.

Një mësues me ndikim në vitet e tij të hershme ishte Shejh Muhamed Lutfi Efendiu, një mjeshtër sufi. Ishte për shkak të mësimeve të tij dhe mjeshtrave të tjerë sufi që zoti Gylen u njoh me shkrimet e Said Nursiut (1876-1960), një predikues islam, i cili porosiste myslimanët të mos refuzojë modernitetin, por të gjejnë frymëzim në tekstet e shenjta për të punuar krah për krah me të.[5] Nursiu kishte zhvilluar idetë e tij rreth një Islami modern dhe këmbëngulte në domosdoshmërinë e një roli të rëndësishëm të besimeve fetare në jetën publike duke përqafuar njëkohësisht edhe zhvillimet shkencore dhe teknologjike. Shkrimet e Nursiut e riinterpretojnë Kuranin nën dritën e shkencës moderne dhe racionalizmit. Qëllimet e lëvizjes Nursi që lindi nga mësimet e tij janë: sinteza e Islamit dhe shkencës, një pranim i demokracisë si forma më e mirë e qeverisjes në kuadër të sundimit të ligjit, ngritjen e nivelit të vetëdijes islame, të treguarit e lidhjes midis arsyes dhe Shpalljes Hyjnore, si dhe arritjen e shpëtimit të kësaj bote dhe botës së përtejme nëpërmjet një tregu të lirë dhe edukimit cilësor.[6] Këto ide të cilat e merrnin frymëzimin nga Nursiu, patën shumë ndikim në edukimin e hershëm të Gylenit dhe u bënë gurthemeli i predikimeve dhe shkrimeve të tij të mëvonshme.

Krahas studimeve të tij në fushën e Islamit, Gyleni u përqendrua gjithashtu edhe në edukimin e tij në fushën e shkencës, filozofisë, letërsisë dhe historisë. Ai do të qëndronte deri natën vonë duke studiuar parimet themelore të shkencave moderne si fizika, kimia, biologjia dhe astronomia. Ai ka lexuar gjithashtu filozofët ekzistencialistë si Kamynë, Sartrin dhe Markuzen, klasikët evropianë si Rusoin, Balzakun, Dostojevskin, Pushkinin, Darvinin dhe Tolstoin, si dhe burimet kryesore të filozofisë lindore e perëndimore, si ato islame ashtu edhe ato joislame.[7]

Vitet e para të predikimit

Kur ishte adoleshent, z. Gylen hyri në qarqet letrare të lëvizjes Nursi, ku, shumë shpejt, u shndërrua në një pjesëtar aktiv. Ndryshe nga tarikatet apo urdhrat sufiste, grupime të tilla rreth mësimeve të një dijetari quheshin *xhemat* (*gj. sh.* - bashkësi). Një xhemaat është një formë specifike turke e vetëorganizimit, e cila u zhvillua pas formimit të Republikës laike në vitin 1923 dhe pas daljes jashtë ligjit të urdhrave sufiste dhe mbylljes së medreseve (institucione klasike edukative islame). Fenomeni i xhemaatit lindi për shkak të motivimit të qarqeve letrare për të edukuar qytetarë të devotshëm brenda kontekstit të trysnisë që ushtrohej nga ana e qeverisë ndaj çdo organizate, e cila potencialisht mund ta sfidonte regjimin e ri nga pikëpamja politike. Në rastin e qarqeve letrare të Nursiut, problemi themelor qëndronte në gjetjen e mënyrave se si duhej t'i përgjigjeshin kërkesave të botës moderne me anë të dijes islame, në mënyrë që Islami të bëhej i përputhshëm me modernizmin. Xhemaati nuk përmbante kërkesa formale anëtarësimi; nuk nevojitej asnjë ritual fillestar; asnjë ndërtesë apo dhomë rrëfimi; kështu që ai nuk ishte një urdhër i mirëfilltë sufi, edhe pse Nursiu ishte ndikuar mjaft nga poeti Rumi dhe mjeshtra të tjerë të kësaj rryme mistike. Përkundrazi, xhemaati përbëhej nga njerëz që ndanin një diskurs të përbashkët dhe synime të njëjta brenda

individëve anëtarë.[8] Sa më shumë që këto norma janë pranuar, aq më shumë një person ka punuar për kauzën e xhemaatit, dhe aq më e fuqishme ka qenë përfshirja e tij në xhemaat.[9] Fethullah Gyleni ishte një pjesëmarrës i rregullt në xhematin e *Nur*[2]-it, një përvojë e cila në masë të madhe ndikoi në jetën e tij të mëvonshme dhe në motivimin e qarqeve të formuara nga dëgjuesit dhe lexuesit e tij. Në fakt, çelësi për të kuptuar organizimin social të lëvizjes Gylen qëndron në një kuptim të thellë të xhemaatit Nur, me të cilin Gyleni u socializua në vitet e tij të rinisë së hershme.

Lexuesit, pasuesit dhe audienca e ligjëratave të Nursiut, mundësuan krijimin e *dershane*-ve apo edhe të qarqeve të leximit, që takoheshin nëpër shtëpitë private; ato zakonisht përbëheshin nga studentë universitarë, të cilët takoheshin rregullisht së bashku për të lexuar dhe për të diskutuar çështje që lidheshin me Kuranin dhe me aspekte të tjera shpirtërore. *Dershane*-t mundësuan krijimin e "zonave të socializimit fetar brenda kornizës edukative laike."[10] Në këto *dershane* studentët studionin Kuranin dhe veprat e Nursiut duke krijuar kështu marrëdhënie të ngushta mes njëritjetrin. Këto *dershane* kanë shërbyer si hapësira për mbledhje dhe diskutime te temave filozofike, sociale dhe fetare. Ata u bënë model për konviktet dhe "shtëpitë e dritës", të cilat më vonë zoti Gylen vetë, ndihmoi për t'i hapur.

Edhe pse z. Gylen nuk ndoqi studimet në ndonjë nga shkollat e mesme shtetërore, por në sistemin joformal të ixhazit (licensës për të mësuar), ai e përfundoi arsimin e tij të mesëm laik nëpërmjet provimeve të jashtme. Në vitin 1959, ai u regjistrua gjithashtu, dhe kaloi provimin e shtetit, për t›u bërë një imam, prandaj u caktua nga shteti në një post prestigjioz pasi suksesi i tij në provim demonstronte njohuritë e tij të thella që ishin kusht për imamët.[11]

Erzurumi, qyteti ku ai mori shkollimin e tij të hershëm, ishte gjithashtu një qendër e rëndësishme për mbrojtjen e ideologjisë

[2] Emërtim i lëvizjes së frymëzuar prej ideve dhe veprimtarisë së Bediuzaman Said Nursiut.

nacionaliste turke. Ai ishte pozicionuar tradicionalisht në një rrugë karvani që kalonte nga Anadolli në Iran dhe u bë më pas një stacion i madh hekurudhor në rrugën Ankara-Iran. Për vetë pozitën e tij si qytet, meqë ai ndodhet në kufirin lindor të Turqisë dhe ka shumë emigrantë nga Kaukazi, zona mburret me një kulturë që ka qenë gjithmonë në ballë të mbrojtjes së kufirit turko-islam kundër sulmeve që mund të vinin nga Lindja, por edhe nga sulmet e jashtme aktuale dhe nga mbështetësit e vendeve lindore që jetojnë brenda Turqisë. Z. Gylen, kur ishte i ri, udhëhoqi Shoqatën Turke për Luftën Kundër Komunizmit në Erzurum dhe më vonë në rekrutimin e mbështetjen ideologjike kundër kërcënimit politik të Islamit iranian.[12] Pra vitet e tij në Erzurum, ishin vendimtare në formimin e bindjeve të thella të z. Gylen në lidhje me Islamin dhe nacionalizmin. Gjatë gjithë jetës së tij, Gyleni ka vlerësuar dhe predikuar identitetin turk.

Gjatën rinisë së tij, Fethullah Gyleni shkoi në një qytet tjetër kufitar në perëndim të Turqisë, në Edirne, ku ai shërbeu si një udhëheqës xhamie për katër vjet, duke përmbushur në të njëjtën kohë edhe detyrën e tij ushtarake, dhe pastaj kaloi një tjetër vit në një qytet tjetër në rajon. Në Edirne, dhe një vit më vonë edhe në Kërklareli, ai u bë shumë ndikues në mesin e të rinjve të arsimuar dhe njerëzve të zakonshëm. Ai organizoi ligjërata mbrëmjesh dhe seri bisedash të shumta, në të cilat ai i mëshonte fort moralit në jetën private dhe publike. Në vitin 1966, Drejtoria turke e Punëve Fetare, një zyrë shtetërore e krijuar në ditët e para të Republikës për të administruar çështjet fetare islame, emëroi z. Gylen në vendin e quajtur *Pazari i gështenjave (Kestanepazarë)* në Izmir, qyteti i tretë më i madh në Turqi, ku ai kishte vajtur për të mësuar shkencat islame dhe ishte përgjegjës për një xhami, për një trupë, një konvikt studentor si dhe një sallë dhe për të predikuar fenë islame në rajonin e Egjeut. Ai bënte një jetë asketike dhe për pesë vjet ka banuar në një kolibe të vogël, në trajtën e kasolles, duke mos pranuar asnjë pagesë për shërbimet e tij. Pikërisht gjatë këtyre

viteve idetë e zotit Gylen në lidhje me arsimin dhe shërbimin ndaj komunitetit filluan të shfaqen. Duke filluar që nga viti 1969, ai ka mbajtur rregullisht takime dhe ligjërata nëpër kafene të vogla nëpër të gjitha krahinat dhe në fshatrat e rajonit të Egjeut.

Themelimi i projekteve të para edukative

Z. Gylen, së bashku me administratorët e institucionit *Kestanepazar*ë dhe me mbështetjen e biznesmenëve vendas, ka organizuar gjithashtu kampe verore për nxënësit e shkollave të fillore dhe të mesme, si dhe të ngjashme me studentët e universitetit. Në këto kampe kryheshin kurse laike të mësimdhënies në fusha të tilla si historia dhe biologjia, por zhvilloheshin edhe diskutime fetare mbi çështje të tilla si roli i islamit në debatet publike. Z. Gylen shpesh evokonte jetën e Muhamedit dhe periudhën klasike të perandorisë Osmane si shembuj të mirë të mjeteve me të cilat promovohej madhështia prej besnikërisë ndaj parimeve thelbësore të Islamit. Ai argumenton, se nëse Turqia dëshiron të jetë sërish një komb i madh, është e nevojshme për njerëzit që të jetojnë një jetë besnike ndaj Islamit dhe të njohin Zotin e tyre nëpër institucionet publike.[14] Meqenëse shkollat shtetërore nuk e shpjegonin Islamin, z Gylen kishte frikë se të rinjtë nuk po i mësonin parimet e Islamit. Kampet verore ishin një mënyrë për t'i njohur fëmijët e moshës shkollore me besimin e tyre fetar, krahas lëndëve laike.

Krahas kampeve verore, duke filluar që nga vitet '70, pasuesit e zotit Gylen filluan të formonin një *bashkësi* të ri rreth mësimeve të tij, të ngjashëm me *bashkësinë* e frymëzuar nga Nursiu, të cilin zoti Gylen e kishte ndjekur më parë. Megjithatë, ajo që i tërhoqi më shumë njerëzit në mesazhet e z.Gylen ishin predikimet e tij të mëdha publike përpara mijëra dëgjuesve dhe ligjëratat publike, të cilat janë të regjistruara dhe të shitura gjerësisht në të gjithë

vendin. Audienca e tij përbëhej kryesisht nga biznesmenë me të ardhura të ulëta apo të mesme, nga një numër të vogël i personave nga shtresat e pasura, si dhe nga studentët e universiteteve.[15] Ai tërhoqi mjaft njerëz, të cilët kanë mbështetur idetë e tij, jo vetëm duke marrë pjesë nëpër ligjëratat e tij, por edhe me mbështetjen e tyre financiare dhe kontributet e punës së tyre. Nëpërmjet një modifikimi të *dershane*-ve të lëvizjes Nur, z. Gyleni i ka ndihmuar nxënësit, prindërit e tyre dhe donatorët për të krijuar "shtëpitë e dritës", ku edukimi islam studiohet në bazë të shkrimeve të Nursiut dhe mësimeve të vetë Gylenit. Këto "shtëpi të dritës" u bënë një burim për mijëra edukatorë, të cilët më vonë do të formonin Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të themeluar sipas filozofisë arsimore të zotit Gylen. Kjo ishtë faza në karrierën prej teologu të zotit Gylenit, në të cilën një grup njerëzish që numëroheshin diku rreth njëqind vetave, filloi të evidentohej si një grup i shërbimit, domethënë një grup që doli në pah për shkak të konceptit të tij të *shërbimit (gj. tr. hizmetit, që është edhe emërtimi popullor i lëvizjes)* ndaj komunitetit.[16]

I vetëdijshëm për faktin se të rinjtë në Turqi po tërhiqeshin nga rrymat ekstremiste dhe ideologjitë radikale, ku përfshiheshin komunizmi ateist dhe materializmi, z. Gylen, si teolog u përpoq të edukonte të rinjtë në lidhje me vlerat tradicionale morale dhe për t'i mbajtur ata larg nga ato që ai i konsideronte si ide destruktive dhe degraduese. Kjo ishte periudha në të cilën Erbakani, një figurë e madhe e Partinë së Drejtësisë, argumentonte se Islami ishte një alternativë për t'iu kundërvënë rrezikut të socializmit dhe promovonte një rol më të madh për Islamin në politikën globale. Përkundër këtij sfondi politik, Fethullah Gyleni gjithashtu promovonte idealet islame si një antidozë për marksizëm-leninizmin dhe maoizmin radikal, rryma të cilat tërhoqën shumë të rinj në mbarë rajonin. Ai shpesh përdorte paratë e tij për të blerë dhe shpërndarë materiale që kundërshtonin ateizmin militant dhe komunizmin. Ai shihte tek erozioni i vlerave morale në mesin e

të rinjve, shkaktarët e krimit dhe konfliktit shoqëror, ndaj ishte i vendosur për të bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të ndikuar tek rinia në drejtim të asaj që ai e shihte si një rrugë të shëndetshme dhe produktive.

Në vitin 1970, si pasojë e një grushti shteti ushtarak, një numër i konsiderueshëm i myslimanëve të shquar në rajon që kishin mbështetur aktivitetet fetare dhe leksionet për të rinjtë e rajonit, në mesin e të cilëve ishte edhe z. Gylen, u arrestuan. Ai u mbajt për gjashtë muaj në paraburgim pa u nxjerrë në gjyq. Pastaj u lirua me kusht që ai të mos jepte më asnjë leksion publik. Pas lirimit të tij, z Gylen e la postin zyrtar që mbante në Izmir, por ruajti statusin e tij si një predikues fetar i autorizuar nga shteti. Ai vijoi t'u bënte thirrje donatorëve dhe prindërve për të ngritur salla studimi dhe konvikte studentore në të gjithë rajonin e Egjeut. Në Izmir ai organizoi kampe verore dhe konvikte, ku studentët e universitetit mund të qëndronin, të studionin dhe të zhvillonin një sens të identitetit si myslimanë turq. Në këto konvikte, jetonin së bashku nga një grup i vogël studentësh të të njëjtit seks, të cilët ndihmonin njëri-tjetrin me studime, lexonin Kuranin dhe shkrimet e Nursiut apo Gylenit, faleshin së bashku, duke zhvilluar kështu një ndjenjë të fuqishme solidariteti. Në to studentët mësonin dhe ngulisnin në karakterin e tyre vlerat islame të vetësakrificës dhe përgjegjësisë sociale. Këto konvikte shërbyen si strehëza kundër alkoolit dhe drogës, shfrytëzimit seksual paramartesor, shfrytëzimit dhe përfshirjes në lëvizjet komuniste, ultranacionaliste apo të tjera lëvizje radikale. Shumë prindër konservatorë dhe fetarë i nxisnin fëmijët e tyre për të jetuar në këto konvikte, ndërkohë që ata ndiqnin arsimin universitar në qytetet e mëdha në Turqi.

Izmir ishte një qytet ku Islami politik nuk kishte arritur kurrë të ishte i suksesshëm dhe ku klasa e mesme e profesionistëve dhe biznesmenëve nuk mund të duronte më tej kufizimet e një burokracie të ashpër shtetërore. Përkundrazi, ky grup

mbështeste politikat e orientuara drejt tregut të lirë si dhe idetë properëndimore. Angazhimi i zotit Gylen në ndihmë të tregut të lirë dhe inkurajimi i tij për biznesmenët që të rrisnin bizneset e tyre, për t'i bërë ato globale dhe konkurruese dhe pastaj të kontribuojnë një pjesë të pasurisë së tyre për të mbështetur projektet e *shërbimit*, ishte i jashtëzakonshëm dhe përkonte plotësisht me këtë frymë sipërmarrëse. Financimi për konviktet dhe shkollat private erdhi nga biznesmenët vendas, të cilët mbështetën misionin e z. Gylen në edukimin e të rinjve, si në lëndët laike ashtu edhe në mësimin e parimeve të moralit. Pikërisht në Izmir e pati zanafillën kjo lëvizje e fuqishme transnacionale e cila filloi të kristalizohej rreth z. Gylen dhe që sot përfshin mijëra rrjete të ndërlidhura individësh të të njëjtave ideale.

Midis viteve 1972 dhe 1975, z. Gylen mbajti poste të ndryshme si teolog në disa qytete në rajonet e Egjeut dhe Marmarasë, ku ai vazhdoi të predikonte dhe të promovonte idetë e tij rreth arsimit dhe shërbimit ndaj komunitetit. Në atë periudhë mundësitë për shkollim ishin të pakta për shtetasit e zakonshëm turq dhe disa qytetarë mendonin se arsimi ishte shumë i ndikuar nga elemente politike radikale nga të dy krahët, qoftë nga të majtët, ashtu edhe nga të djathtët. Prindërit, fëmijët e të cilëve kishte kaluar provimet e kërkuara për hyrjen në shkollë të mesme dhe universitet hynë në dilemë, sepse nga njëra anë dëshironin që fëmijët e tyre të arsimoheshin, ndërsa nga ana tjetër në mendjet e tyre ekzistonte frika nga një atmosferë tejet e politizuar e shkollave. Për t'u dhënë drejtim këtyre dilemave, z Gylen i inkurajoi pronarët e bizneseve të vogla për të ngritur shtëpitë konvikt, ku studentët mund të ndiqnin shkollën në një atmosferë që ai shpresonte se ishte e imunizuar nga mjedisi i politizuar. Për të mbështetur këto shtëpi dhe mundësitë për arsimim, njerëzit lokalë të cilët ndanin idetë e përbashkëta etike me zotin Gylen në lidhje me shërbimin, hapën llogari bankare «bursash", me të cilat ata mbështesnin financiarisht aktivitetet. Përsëri, falë njerëzve lokalë të cilët e kuptuan nevojën

për arsimim cilësor dhe të cilët u ndikuan nga idetë etike të zotit Gylen, shërbimi eci përpara me burimet e veta, për të vënë idetë e tij në zbatim.

Me kalimin e kohës, studentët që banonin në shtëpitë konvikt u bënë avokatët më të mëdhenj të ideve të shërbimit të zotit Gylen dhe u kthyen në fshatrat dhe qytetet e tyre për të përhapur fjalën e përvojave dhe mundësive të tyre të vyera. Të pajisur me një arsimim të mirë, ata u bënë tregtarët, biznesmenët dhe profesionistët në komunitetet e tyre dhe filluan të bashkoheshin për të siguruar mbështetje financiare për të mbajtur të hapura shtëpitë konvikt si dhe projekte të tjera në vijim të shërbimit. Në të njëjtën kohë, bisedat dhe ligjëratat e zotit Gylen regjistroheshin nëpër kaseta audio dhe shpërndaheshin në të gjithë komunitetet nëpër Turqi. Ai ishte teologu i parë ligjëratat e të cilit janë vënë në dispozicion në audio dhe videokaseta për publikun e gjerë në Turqi. Përmes aktiviteteve të nxënësve të tij nëpër komunitetet e tyre si dhe nëpërmjet kanaleve të reja teknologjike të komunikimit, idetë e zotit Gylen rreth shërbimit filluan të përhapeshin në mbarë Turqinë.

Në vitin 1974, z. Gylen u dërgua në Manisa, ku filloi kurse përgatitore parauniversitare në një përpjekje për të përgatitur fëmijët e njerëve të thjeshtë turq për shkollën e lartë. Deri në këtë kohë, ai ishte marrë pothuajse krejtësisht me fëmijët e familjeve të pasura të cilët ishin në gjendje për të shkuar në universitet. Duke ofruar nivel të lartë kursesh përgatitore, një rrjet i gjerë fëmijësh të shtresës së mesme dhe të klasës punëtore u përgatitën për të marrë provimet e detyrueshme në mënyrë që të fitonin të drejtën për t'u regjistruar nëpët universitete dhe të kishin sukses atje.

Hapja e shkollave të frymëzuara nga Gyleni

Falë politikave neo-liberale të Ozalit në fillim të viteve '80 dhe mundësisë më të madhe për krijimin e shkollave private, në vitin

1982 u hapën dy shkollat e para të arsimit të detyruar të frymëzuara nga idetë e Gylenit; njëra në Izmir dhe tjetra në Stamboll. Këto u pasuan gjatë dy dekadave në vijim nga qindra shkolla të tilla në të gjithë Turqinë, pastaj në republikat turke të ish-Bashkimit Sovjetik, duke vijuar më pas me shtetet e tjera pasardhëse të ish-Bashkimit Sovjetik, në Ballkan, Afrikë të Jugut dhe në fund në gjithë Perëndimin. Në Forumin Ekonomik Botëror në Davos në vitin 2000, Kryeministri Exhevit i njohu të pranishmit në fjalën e tij me rëndësinë e shkollave të frymëzuara nga Gyleni në mbarë botën, dhe me mënyrën se si këto shkolla kontribuojnë në ngritjen kulturore dhe në mirëqenien e Turqisë dhe vendeve të tjera.[17]

Z. Gylen i ka inkurajuar gjithmonë ndjekësit e tij për të investuar në shkolla laike të mesme private elitare, ku ai shpreson të ndërthurë moralin islam me njohuritë laike. Këto shkolla janë të bazuara në një program mësimor laik të miratuar nga shteti dhe të cilat përdorin gjuhën angleze për mësim. Të vetmet njohuri rreth Islamit që mësohen zyrtarisht në këto shkolla në Turqi, janë gjatë orëve të posaçme mësimore që janë të parashikuara nga shteti për mësimin fetar gjatë lëndës së krahasimit të feve, nëpërmjet tekstit të përzgjedhur nga shteti. Të gjitha shkollat, ashtu si edhe institucionet e tjera të frymëzuara nga Gyleni, janë njësi të pavarura të administruara dhe të financuara nga grupet lokale. Megjithatë, personeli në këto shkolla është i bashkuar në atë që Agai[18] e quan një "rrjet arsimor të virtytit," bazuar në faktin se figurat kryesore të tyre janë socializuar brenda xhematit, marrin pjesë në jetën e xhematit dhe janë të lidhur me njëri-tjetrin përmes marrëdhënieve të ngushta ndërpersonale të krijuara po në bashkësi. Shumë nga drejtorët dhe mësuesit e shkollave, si brenda ashtu edhe jashtë Turqisë, vijnë nga radhët e edukatorëve me përfshirje substanciale në bashkësi. Bashkësia sigurohet, që njerëz të kualifikuar dhe të motivuar të lëvizin brenda rrjetit ku ata janë të nevojshëm për të shërbyer. Megjithatë në këto shkolla ka edhe mësues, të cilët nuk janë pjesëmarrës në lëvizjen Gylen dhe mund

të mos kenë dëgjuar kurrë për Fethullah Gylenin. Megjithatë, pa angazhimin e mësuesve të frymëzuar nga Gyleni, të cilët e konsiderojnë punën e tyre si shërbim human, të urdhëruar prej fesë, këto shkolla cilësore nuk do të ekzistonin. Shumë prindër i dërgojnë fëmijët e tyre në këto shkolla, sepse ata i konsiderojnë ato si shkollat që ofrojnë arsimimin më të mirë të mundshëm për fëmijët e tyre. Siç vëren Agai, z. Gylen arriti të forconte ndikimin e tij në radhët e bashkësisë, duke mundësuar hapjen e këtyre shkollave dhe duke i bërë ato pjesë të një konglomerati të madh të rrjeteve arsimore. Ndërsa institucionet mbështeten në bashkësi për mësues dhe financues të motivuar, z. Gylen synon të shtrijë idetë e tij në një audiencë më të gjerë, të interesuar në fushën e arsimit dhe modernizimit.

Në vitin 1977, në moshën 36 vjecare, Fethullah Gyleni ishte i njohur gjerësisht si një nga teologët më me ndikim në Turqi. Në atë vit, në një rast, kur kryeministri dhe personalitete tjera shtetërore erdhën në namazin e xhumasë në Xhaminë Blu në Stamboll, ai u ftua për të predikuar.

Institucionet mediatike të frymëzuara nga Gyleni

Z. Gyleni gjithashtu i inkurajoi ndjekësit e tij për t'u orientuar në shtypin e shkruar, si një mënyrë për të promovuar rëndësinë e arsimit dhe të shërbimit. Madje liberalizimi i mjedisit politik dhe mundësia për media të pavarura dhe të pacensuruara, që u sendërtua nga presidenti Ozal siguroi kontekstin në të cilin institucionet private botuese u mundësuan në Turqi. Në vitin 1979 një grup mësuesish të frymëzuar nga idetë e Gylenit rreth arsimit, themeluan Fondacionin e Mësuesve për të mbështetur arsimin. Ky fondacion nisi të botonte edhe revistën e saj të përmuajshme *Sëzëntë* (gj. shq., Rrjedha*)*, e cila u bë shumë shpejt revista e përmuajshme më tirazhin më të lartë të shitjeve në Turqi.[19] Misioni

i saj ishte që të evidentonte lidhet mes shkencës dhe fesë, për të treguar ato nuk ishin të papajtueshme mes tyre dhe se njohja e të dyjave ishte thelbësore për një edukim të suksesshëm. Secili numër i revistës përmbante një editorial të shkruar nga vetë z. Gylen. Përveç kësaj, qindra predikimet e tij në audio dhe video dhe regjistrimet e një seri predikimesh mbi tema të rëndësisë kryesore, u botuan në trajtën e mbi 60 librave, shumë prej të cilëve u bënë librat më të shitur në Turqi. Shumë nga këto materiale janë në dispozicion të publikut të përkthyera në gjuhët kryesore botërore, në shtyp dhe në trajtë elektronike nëpërmjet faqeve të shumta të internetit.

Gjithashtu, zoti Gylen ka inkurajuar vazhdimisht përdorimin e risive teknologjike, si një mënyrë për të edukuar masat popullore dhe në veçanti të rinjtë. Në vitin 1982, nën drejtimin e kryeministrit Ozal, kushtetuta prezantoi reformat sociale që lejonin organizimin e aktiviteteve me karakter më social dhe fetar. Këto reforma u hapën dyert veprimtarive fetare fillimisht të kufizuara, që çuan më pas në gjallërimin fetar në të gjithë vendin. Si rezultat i kësaj, në vitin 1980 shumica e bisedave të Gylenit u regjistrua dhe u shpërnda nëpër videokaseta, duke përhapur idetë e tij të shërbimit për publikun në rreze gjithnjë më të gjerë në të gjithë Turqinë. Nga fundi i viteve ’80 predikimet e tij tërhoqën pas vetes turma të mëdha prej dhjetëra mijëra njerëzish, një shifër kjo e paparë në Turqi. Këto predikime janë filmuar edhe dhe shpërndarë gjerësisht nëpër të gjithë vendin.

Pjesëmarrësit në lëvizjen Gylen kanë themeluar edhe një stacion televiziv kombëtar Samanyolu TV – STV (*gj. shq.* TV Rruga e Qumështit), një agjenci të madhe lajmesh Agjencia e Cihan Haber Ajansi – CHA, *gj. shq.,* Agjencia e Lajmeve Bota), gazetën “Zaman”, një gazetë e përditshme e pavarur që ka tirazhin më të madh ditor në Turqi, dhe e cila botohet në dhjetë gjuhë të huaja si dhe në gjuhët lokale turke në të gjithë botën turke, revista

të tjera të ndryshme elitare, si dhe një shtëpi botuese me emrin The Light, Inc. (*gj. shq.*, Drita).

Suksesi është reklamuesi më i mirë i shanseve dhe në këtë rast, për shkak se ishte përhapur fjala për të gjitha ato që ky mendimtar dhe njerëzit e frymëzuar nga mesazhi i tij kishin arritur, ai u ftua të fliste nëpër të gjithë Turqinë. Grupet lokale ishin gjithashtu të etura për të hapur shkollat e frymëzuara nga Gyleni nëpër zonat e tyre. Krahas mësimit të artit dhe shkencave humane, shkollat e frymëzuara nga Gyleni kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshme në përgatitjen e studentëve për testet e pranimit në universitet si dhe nëpër konkurset dhe olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore në matematikë, kimi, biologji dhe shkenca kompjuterike. Suksesi i shkollave private të themeluara nga lëvizja, ishte për shumë njerëz një konfirmim i asaj që z. Gylen kishte argumentuar gjithmonë në fjalimet dhe shkrimet e tij, domethënë, që është e mundur që të ekzistojë një mysliman i devotshëm, i cili të jetë në të njëjtën kohë edhe një qytetar modern në bashkëkohësi me botën.

Zoti Gylen si rrufepritëse e kritikave

Duke pasur parasysh historinë moderne të Turqisë si një republikë laike, që daton nga themelimi i Republikës së Turqisë nga ana e Mustafa Kemal Ataturkut në vitin 1923 dhe vendosjen e shekularizmit si një prej gjashtë parimeve kemaliste, ishte pothuajse e pashmangshme që fama dhe rritja e lëvizjes të mos tërhiqnin vëmendjen dhe të mos ngjallnin frikë në arenën politike laike.

Duke filluar që në vitin 1971, me arrestimin dhe burgimin gjashtë mujor të tij, ai u akuzua në mënyrë sistematike nga autoritetet shtetërore se kërcënonte laicizmin e regjimit zyrtar. Në fund të viteve ’90, rreth tij shpërthyen shumë polemika, kur një kanal privat turk transmetoi videokaseta në të cilat ai shihej të

predikonte luftën kundër republikanizmit laike dhe nevojën për ta rrëzuar atë dhe për ta zëvendësuar me një shtet islam. Disa nga përkrahësit e tij kanë argumentuar se këto videokaseta janë bërë nga një kombinim imazhesh dhe regjistrimesh zanore të montuara në mënyrë të sofistikuar, me qëllimin e vetëm, sulmimin e figurës së tij.[21] Në vitin 2000, kryeprokurori Jyksel, paraqiti kërkesën për arrestimin e Gylenit me akuzën se ai dhe simpatizuesit e tij kanë organizuar një grup njerëzish me qëllimin për të ndryshuar qeverinë laike dhe për ta kthyer Turqinë në një shtet teokratik. Pas vitesh të tëra paraqitjesh në gjykatë dhe apelimesh, në maj të vitit 2006 çështja kundër z. Gylen më në fund u mbyll nga Gjykata e Lartë Penale në Ankara.

Në vitin 1999, Gyleni u transferua në Shtetet e Bashkuara për të kërkuar trajtim mjekësor për sëmundjet e tij të shumta, duke përfshirë edhe problemet serioze të zemrës dhe diabetit. Edhe në Shtetet e Bashkuara, prania e tij nuk ka kaluar pa polemika. Në nëntor 2006, z. Gylen paraqiti zyrtarisht një kërkesë për qëndrim të përhershëm (të njohur si Green Card) e cila do ta lejonte atë që të jetonte dhe punonte në mënyrë të ligjshme në këtë vend. Zyra e Sherbimit për Emigracionin dhe Shtetësinë Amerikane (USCIS) e refuzoi kërkesën e tij, duke argumentuar se rregullorja kishte baza të përcaktuara, që do të thotë se statusi i tij si "një dijetar i njohur botërisht ", ishte kriter i pamjaftueshëm dhe i pabazuar. Apeli i paraqitur prej zotit Gylen u shqyrtua në një gjykatë federale në rajonin lindor të Pensilvanisë, (ku ai banon edhe sot e kësaj dite), gjykatë e cila e shfuqizoi vendimin e mëparshëm dhe përcaktoi se mohimi i lejes së qëndrimit nga ana e USCIS ishte i padrejtë. Në tetor të vitit 2008, kërkesa e tij për qëndrim të përhershëm, më në fund u pranua nga qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Si tregon historia e mësipërme jetësore, Gyleni ka qenë një frymëzim për miliona njerëz në mbarë botën turkfolëse, të cilët pajtohen me idetë e tij, që janë të angazhuar për të qenë pjesë e

sohbeteve (qarqeve lokale) të njerëzve të cilët zhvillojnë biseda rreth temave të trajtuara në predikimet dhe shkrimet e tij, të cilët japin kohën dhe të hollat e tyre për të përkrahur projektet e *shërbimit* që ai frymëzon. Nga ana tjetër, ekzistojnë megjithatë mjaft turq, të cilët janë të bindur se Gylen dhe pasuesit e tij janë të vendosur për krijimin e një shteti teokratik në Turqi, duke e çuar Turqinë mbrapa në lidhje me aspiratat e saj drejt modernizimit, duke turbulluar mendjet e të rinjve me qëllim që të ndjekin idetë e tyre dhe të krijojnë një shoqëri të fshehtë, të përkushtuar ndaj z. Gylen dhe axhendës së tij. Po cilat janë idetë, besimi dhe botëkuptimi i Gylenit që kanë frymëzuar disa njerëz dhe disa të tjerëve u kanë ngjallur frikën për të ardhmen e Turqisë?

Idetë kryesore të z. Gylen

Ndërtimi i urave lidhëse mes Islamit dhe Perëndimit

Një theks i rëndësishëm i mësimeve të zotit Gylen është vënë tek nevoja për të krijuar ura lidhëse ndërmjet botës myslimane dhe Perëndimit, së bashku me rëndësinë e sintetizimit të përparimeve shkencore dhe teknologjike në shoqërinë bashkëkohore myslimane. Ai beson se ashtu siç turqit kanë luajtur një rol të rëndësishëm fetar dhe kulturor nën Perandorinë Osmane për shekuj me radhë, Turqia edhe tani në shekullin XXI është gati për të udhëhequr botën myslimane me theks në dialog, tolerancë, shkencë dhe arsim. Ndërsa Gyleni beson se ekziston vetëm një Islam autentik i bazuar në Kuran dhe në traditën e Profetit Muhamed, ai i njeh mjaft mirë interpretimet e ndryshme historike, kulturore dhe sociale të Islamit në botën moderne.[22]

Ai mbron një nocion progresist të Islamit, sipas të cilit myslimanët dhe kombet myslimane janë në gjendje të angazhohen në botë me më të mirën në fushat e shkencës, arsimit, filozofisë, shkencave sociale dhe teknologjisë. Ai argumenton se që prej

lindjes së Islamit në shekullin e gjashtë, ai ka ndërvepruar me kushtet e veçanta historike dhe kulturore, dhe se myslimanët kanë mbetur prapa kur dështuan për të konkurruar në një botë gjithnjë e më globale në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Në mënyrë që të rifitojnë përsëri një rol të respektuar në botën moderne, z. Gylen shpesh u kujton pasuesve të tij trashëgiminë osmane në Turqinë bashkëkohore. Ai nuk mbështet idenë e një rikthimi të kalifatit, por më tepër përqëndrohet në vlerat e mëdha kulturore dhe praktikat e osmanëve si: (l) fryma e dialogut, (2) fakti që shteti osman ishte shumëgjuhësh, multietnik dhe multifetar, (3) respekti për gratë dhe (4) afrimi intelektual dhe kulturor në mes të shoqërisë osmane dhe Perëndimit që pat filluar në shekullin e nëntëmbëdhjetë.[23] Z. Gylen mbron idenë e përdorimit të modelit osman si një bazë për rikthimin e botës myslimane në qendër të qytetërimit botëror dhe për krijimin e lidhjeve produktive me Perëndimin. Për shkak të vendndodhjes së saj strategjike gjeografike midis Lindjes dhe Perëndimit dhe sistemit të saj demokratik të qeverisjes, ai gjithashtu e sheh Turqinë si lider në botën myslimane për sa i takon kapërcimit të hendekut Lindje-Perëndim.

Gylen beson se bota bashkëkohore myslimane përballet me një numër sfidash serioze, njëra prej të cilave është mungesa e një mentaliteti të vërtetë shkencor, siç dëshmohet në shumë vende myslimane, dhe së dyti është mungesa e dialogut të vërtetë mes botës myslimane dhe Perëndimit.[24] Ai pranon se bota myslimane ka qenë e dominuar dhe e nënshtruar nga bota perëndimore në pjsën më të madhe të historisë moderne. Megjithatë, ai mendon se është koha për botën myslimane për të treguar anën pozitive të Islamit në Perëndim.

Një mënyrë që myslimanët të fillojnë të tregojnë anën pozitive të Islamit është që të angazhohen në globalizimin, në bashkëpunimin dhe në bashkëveprimin me njerëzit në të gjithë botën. Ai

mbështet formimin e një "brezi të artë", domethënë me njerëz të rinj të shkolluar dhe të përgjegjshëm, të cilët mendojnë në mënyrë globale. Ky brez i ri është nxitur për të udhëtuar gjerësisht, për të mësuar disa gjuhë të huaja, për të studiuar shkencat natyrore dhe humane në mjedise të ndryshme arsimore dhe për t'u angazhuar aktivisht në dialogun ndërfetar kudo që ata janë.

Arsimi

Problemi më i madh në botë sot, sipas Gylenit, është mungesa e dijeve, e cila përfshin prodhimin dhe kontrollin e dijeve të reja, si dhe marrjen e dijeve ekzistuese. Prodhimi, ruajtja dhe përhapja e dijeve mund të arrihet vetëm përmes arsimimit cilësor, jo të detyruar nga politika apo me forcë. Arsimi, për z. Gylen, është përgjegjës për shndërrimin e një individi në produktiv dhe kontribues në çdo shoqëri. Asnjë individ ose shoqëri, - thotë ai, nuk mund të arrijë potencialin e vet të plotë, pa pasur arsimim. Ai e sheh arsimin si mjetin me anë të të cilit njerëzit bëhen një qenie e vërtetë, ashtu siç Zoti i krijoi për të qenë, kështu që të bëhen të shkolluar është detyra më e rëndësishme e jetës së tyre. Ai thotë:

*Detyra dhe qëllimi kryesor i jetës njerëzore është të kërkojë kuptimin e ekzistencës. Përpjekja për të bërë këtë, e njohur si edukim, është një proces përsosjeje përmes të cilit ne fitojmë dimensionet shpirtërore, intelektuale dhe fizike të qenieve tona, si dhe gradën e përcaktuar për ne, si modeli i p*ërkryer *i krijimit.*[26]

Ai i sheh tri format e edukimit (domethënë shkencën, humanizmin dhe fenë) si aspekte që zhvillojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin, dhe të cilët duhet të veprojnë së bashku për të formuar qenien e plotë njerëzore si tërësi (Aslandogan dhe Çetin 2006). Z. Gyleni përkrah injektimin e vlerave etike, së bashku me një trajnim të shëndoshë në shkencat laike.

Ai e sheh arsimin si parakusht për modernizimin social,

ekonomik dhe politik, ndaj përkrah idenë që individët do të respektojnë ligjin demokratik dhe të drejtat e njeriut vetëm nëse marrin një edukim të shëndoshë. Drejtësia dhe paqja sociale, - argumenton ai, janë arritur nga njerëzit e ndriçuar intelektualisht, me vlera të forta morale dhe me ndjenjën e altruizmit. Z. Gylen dhe personat e frymëzuar nga fjalët e tij shpresojnë që të edukojnë një brez të trajnuar me njohuri moderne, si dhe me ato të moralit islam. Kjo filozofi është baza e sistemit arsimor në të gjitha shkollat fillore, të mesme dhe të nivelit universitar, që janë të frymëzuara nga idealet e zotit Gylen.

Ndërsa mbron angazhimin arsimor, shkencor dhe ndërfetar në nivel global, z. Gylen këmbëngul se kjo nuk do të thotë pranim total i perëndimorizimit në tërësinë e tij. Ai argumenton se megjithëse qytetërimi perëndimor e ka dominuar botën gjatë disa shekujve të fundit, dhe ka siguruar rolin udhëheqës në shkencë dhe teknologji, botëkuptimi i Perëndimit modern është materialist dhe ka nevojë për t'u përqendruar në dimensione të tjera të qenies njerëzore, sidomos ato shpirtërore.[27] Në veçanti, që nga periudha e Iluminizmit, shumë njerëz e kanë ndarë fenë nga qëllimet e shkencës dhe e konsiderojnë fenë të vjetëruar dhe një kërcënim për kërkimin shkencor. Z. Gylen insiston se feja dhe shkenca ecin dorë për dore dhe se feja mund dhe duhet të luajë një rol kyç në sferat etike, intelektuale dhe shoqërore.

Në pikëpamjen e Gylenit, shkenca dhe besimi janë vetëm të përputhshme, por madje edhe komplementare. Ai shpreh vizionin e një besimi të bazuar në botëkuptim, duke siguruar një rrëfim të plotë dhe të shëndoshë të fenomeneve shkencore, gjë që mund të mbështesë dhe t'i japë kuptim arsimit laik. Sipas fjalëve të tij, dija e shëndoshë u mundëson nxënësve të lidhin ngjarjet në botën e jashtme me përvojat e tyre të brendshme.[28] Ai gjithashtu e kundërshton fenë kur ajo merr kuptimin e besimit të verbër dhe i kritikon ata që nuk arrijnë të përdorin arsyen e tyre dhe për të shqyrtuar dhe analizuar universin e dukshëm. Prandaj, ai e sheh

të nevojshëm procesin e pajtimit mes besimit dhe arsyes dhe jo përçmimin e ndonjërës prej tyre.

Kritikat e tij rreth medreseve tradicionale dhe teqeve (institucioneve tradicionale islame të arsimit), është se ato nuk plotësojnë kërkesat e jetës moderne meqënëse atyre u mungojnë metodat dhe mjetet për përgatitjen e studentëve për të dhënë kontribute pozitive në botën moderne, për shkak të dështimit të tyre për të integruar shkencën dhe teknologjinë në kurrikulat e tyre tradicionale. Ai gjithashtu kritikon shkollat laike për dështimin në përcjelljen e vlerave shpirtërore dhe etike tek studentët, edhe nëse ato janë të pajisura mirë me bazë materiale për të mësuar shkencën dhe teknologjinë. Për të zgjidhur këtë ngërç, Gyleni propozon një sistem arsimor që integron njohuritë shkencore me vlerat etike.[29]

Fethullah Gylen e sheh arsimin shkencor dhe atë islam si të pajtueshëm dhe komplementarë me njëri-tjetrin. Edhe pse ai është shkolluar në institucionet tradicionale islame, ai u kërkon ndjekësve të tij për të hapur më mirë shkolla moderne, sesa medrese tradicionale. Ai ka këshilluar gjithashtu edhe hapjen e shkollave në vend të xhamive. Ai mbështet edukimin e brezit të ri me dije islame përmes botimeve informale, predikimeve dhe bisedave brenda familjes në vend të marrjes së detyruar të tyre nëpërmjet kurrikulave formale nëpër shkolla.[30]

Z. Gylen këmbëngul që shkollat e frymëzuara nga lëvizja t'i shmangen politizimit. Pavarësisht se ka qenë kontaktuar vazhdimisht nga liderë të ndryshëm të partive politike për angazhim në politikë, ai ka mbajtur gjithmonë një qëndrim jopartizan dhe i ka inkurajuar pasuesit e tij që të mbeten jashtë përfshirjes së drejtpërdrejtë në politikë. Ai argumenton se Turqia është tashmë duke vuajtur pasojat nga format e ndryshme të ndarjes dhe se arsimi duhet të mbetet një ishull i unitetit dhe të mos njolloset nga ambiciet politike.[31]

Financimi i projekteve të Hizmetit në aspektin shpirtëror të bamirësisë dhe shërbimit ndaj njerëzve

Për të përmbushur me sukses projektet arsimore që z. Gylen ka parashikuar, duhet të sigurohen burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare. Që në krye të herës nevojiteshin mësuesit dhe drejtorët, të cilët ishin të përkushtuar dhe të angazhuar për një arsim cilësor dhe që ishin të gatshëm të bënin sakrifica për të rritur nivelin arsimor të nxënësve të tyre. Prindërit duhej të ishin të gatshëm për të punuar me mësuesit dhe administratorët e shkollave për qëllimet e përbashkëta arsimore. Dhe për të arritur këto qëllime filantropike ishte i nevojshëm dhurimi nëpërmjet krijimit të trusteve bamirëse. Prandaj, që në ditët e para të lëvizjes, z. Gylen filloi bisedat me njerëz nga të gjitha shtresat e shoqërisë në Turqi. Ai vizitonte grupet e njerëzve kudo ku mund t'i gjente; në kafene, në xhami, në shtëpitë e të gjitha fshatrave të vogla, qytezave dhe qyteteve të mëdha në të gjithë Turqinë. Pavarësisht se kush ishte ai që kishte përballë, mesazhi i tij ishte i njëjtë: arsimim të shëndoshë dhe cilësi të lartë nëpër shkolla dhe për të arritur këtë, ai theksonte domosdoshmërinë e shërbimit altruist dhe kontributeve financiare.[32]

Ai vazhdimisht e ka inkurajuar elitën sociale dhe udhëheqësit e komunitetit, e poashtu industrialistët dhe biznesmenët e pasur, por edhe tregtarët e vegjël, për të mbështetur arsimin cilësor. Me donacione nga këta individë, janë themeluar truste arsimore për të mbështetur qindra shkolla, si në Turqi ashtu edhe jashtë vendit.

Në predikimet dhe apelet e tij, ai u rikthehej vazhdimisht ideve dhe vlerave të përbashkëta në shumë tradita fetare si: ndjenja e detyrës, detyrimi moral, kontributet pa pritur gjë në këmbim si dhe shërbimet altruiste.[33] Siç tregon Sevindi, Gylen vërtetë beson në këto ide dhe ka inkurajuar përherë sipërmarrjet e lira.[34] Ai shprehet se besimtarët duhet të jenë të pasur dhe të rrisin bizneset e tyre sa më shumë të jetë e mundur, sidomos në nivel

global, gjë të cilën ai e sheh si të ardhmen ekonomike të botës. Atëherë një pjesë e pasurisë së grumbulluar, duhet të përdoret për të mbështetur shumë projekte edukative, të cilat do të shërbejnë kundër varfërisë, injorancës dhe imoralitetit. Ai është përpjekur të argumentojë vazhdimisht, se një treg i lirë dhe i fortë është i nevojshëm për të prodhuar pasuri ekonomike, që nga ana tjetër mund të mbështesë një sistem modern arsimor, i cili do të fuqizojë përfundimisht myslimanët dhe shtetin turk.[35]

Në vitet '80, nën udhëheqjen e Kryeministrit Ozal, liberalizimi ekonomik i Turqisë i dha shansin të rritej një klasë e re sipërmarrësish, e cila grumbulloi pasuri duke investuar në biznese dhe sipërmarrje kapitale, si në Turqi ashtu edhe jashtë vendit. Shumë prej këtyre biznesmenëve u tërhoqën nga idetë e zotit Gylen në lidhje me sipërmarrjen dhe akumulimin e pasurisë, dhe të pajisur me një përgjegjësi sociale dhe fetare, filluan të kontribuonin në të holla për të mbështetur projektet e shërbimit, sidomos në aspektin e arsimit cilësor, projekte që do të kontribuonin në përmirësimin e arsimit në mesin e rinisë turke. Dhe së bashku me edukimin në lëndët laike në shkollat e frymëzuara nga Gyleni, do të vinte edhe edukimin moral dhe zhvillimi i një identiteti të fortë turko-mysliman.

Gyleni fillimisht inkurajoi klasën e re të pronarëve të bizneseve të sponsorizonin konviktet, ku nxënësit mund të qëndronin dhe të studionin së bashku nën tutelën e mësuesve të përkushtuar. Hapi i dytë që ai ndërmori ishte objektivi për të financuar kurse përgatitore parauniversitare, me qëllim përgatitjen e studentëve për provimin e detyrueshëm të pranimit në universitet. Së fundi, ai inkurajoi financimin e shkollave laike private, të themeluara brenda kornizës së sistemit arsimor shtetëror.

Z. Gylen theksonte se të gjithë kishin një rol për të luajtur në qëndrimin në lidhje me shkollat e nivelit të lartë në Turqi. Atyre të cilët ishin të aftë dhe të motivuar për ta bërë këtë, u

bëri thirrje të bëheshin administratorët dhe mësuesit e këtyre shkollave. Pronarët e bizneseve dhe personat e angazhuar në punët profesionale duhet të rrisnin pasurinë e tyre sa më shumë të ishte e mundur, në mënyrë që të mbështesnin financiarisht sa më fuqishëm projekte të ndryshme arsimore. Besimtarët në Turqi dhe jashtë vendit duhet të jenë të pasur, jo vetëm për të mirën e tyre, por në mënyrë që të mbështesin projektet e vlefshme të shërbimit.[36] Ai u bëri thirrje biznesmenëve për të kombinuar me burimet dhe energjitë e tyre në krijiminn e trusteve bamirëse, në të cilat askush nuk përfiton dot nga ajo që institucionet fitojnë përveçse vetë nxënësit. Për shumë biznesmenë ndërtimi i një shkolle është ekuivalenti modern i ndërtimit të një xhamie.[37]

Ndërsa ai vetë, mbeti gjithmonë i varfër materialisht, asketizmi i tij dhe qëllimet e tij altruiste motivuan mësuesit, prindërit dhe sponsorët për të kontribuar në të mirën e përbashkët në çfarëdo lloj mënyre që të mundeshin. Përveç motivimit të njerëzve që të dhurojnë të holla, z. Gylen ka ndenjur gjithmonë larg nga menaxhimi financiar i të gjitha institucioneve që lidhen me lëvizjen. Përkundrazi, ai i ka nxitur sponsorët e këtyre institucioneve që të mbikëqyrin në mënyrë aktive përdorimin e parave të tyre. Kjo ka ndërtuar besimin e madh në ndershmërinë dhe integritetin moral të zotit Gylen.[38]

Gylen shpesh i referohet një thënieje të Aliut, kalifit të katërt pas Muhammedit, i cili është shprehur se "të gjitha qeniet njerëzore janë vëllezërit dhe motrat e dikujt. Myslimanët janë vëllezërit dhe motrat e dikujt në fe, ndërsa jomuslimanët janë vëllezërit dhe motrat e dikujt në njerëzim... Qeniet njerëzore janë më të nderuarat e krijesave. Ata që duan të rrisin nderin e tyre duhet t'u shërbejnë këtyre krijesave të nderuara."[39] Dhe, për z. Gylen, ofrimi i një edukimi të mirë përmes shërbimeve altruiste dhe veprave bamirëse është një nga mënyrat më fisnike për të treguar respekt dhe nderim për qeniet njerëzore. Kështu, çdo vepër shndërrohet

në një akt të shërbimit ndaj Zotit edhe në qoftë se vetëm një pjesë e vogël e të ardhurave të dikujt jepet për idealet e shërbimit. Puna në arsim dhe mbështetja e arsimit mbartin posaçërisht një vlerë të lartë në Islam.

Siç do ta theksojmë edhe në kapitullin 5 të titulluar *"Kultura turko-islame e bamirësisë"*, idetë e shërbimit të zotit Gylenit kanë ringjallur dinamikën filantropike të altruizmit, dhe dashamirësisë, virtyte që janë të ngulitura thellë në kulturën turke dhe kanë mbushur hendekun e krijuar nga politikat qeveritare. Ai i ka transformuar mendjet e njerëzve duke sjellë një kuptim të ri të fesë, shkencës, laicizmit, shërbimeve sociale dhe arsimore. Ai ka deklaruar se Turqia, ashtu si edhe mbarë njerëzimi, ka nevojë për individë më tolerantë dhe dashamirës, me zemra dhe mendje të hapura, shpirtmëdhenj, të cilët respektojnë mendimin e lirë, që janë të hapur ndaj shkencës dhe kërkimit shkencor, dhe të cilët arrijnë të perceptojnë harmoninë midis ligjeve hyjnore të universit dhe jetës.

Dialogu ndërfetar dhe ndërkulturor

Z. Gylen, në theksin e tij mbi dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor, shpesh i referohet marrëdhënieve harmonike ndërfetare që ekzistonin në Perandorinë Osmane. Perandoria ishte e përbërë jo vetëm nga myslimanët, por edhe nga shumë të krishterë dhe hebrenj, si dhe nga një numër i vogël zoroastrianësh. Deri në shfaqjen e shteteve kombëtare moderne, këto grupe fetare kanë jetuar së bashku në paqe dhe harmoni në të gjitha periudhat osmane. Kjo bashkëjetesë paqësore u promovua nga shumë mjeshtra sufistë turq, të cilët mbështetën idetë e tolerancës ndërfetare.[40] Z. Gylen ka studiuar shumë prej këtyre mjeshtrave sufi dhe është pa dyshim i ndikuar nga ata në këmbënguljen e tij për rëndësinë e dialogut midis këtyre komuniteteve fetare.

Konceptet e dhembshurisë dhe dashurisë janë koncepte qendrore në mësimet e z. Gylen. Ai vazhdimisht përkrah tolerancën dhe faljen si vlera bazë islame, të cilat janë të rrënjosura në përulësi. Ai na mëson se njerëzit që besojnë në superioritetin e tyre, kurrë nuk do të angazhohen në dialog të vërtetë. Përkundrazi, ai që është i përulur, do të jetë më shumë i prirur për dialog me të tjerët në një mënyrë të hapur dhe kuptimplotë. Z. Gylen e shfaqi përulësinë e tij, kur ai u takua me Papa Gjon Palin II, në shkurt të vitit 1998. Pas takimit ai u kritikua nga një grup përfaqësuesish myslimanë të rinj, të cilët argumentuan se ai nuk duhej ta kishte ulur veten duke shkuar në Vatikan për të takuar Papën. Z. Gylen reagoi duke thënë se përulësia është një cilësi e myslimanëve dhe se dialogu me njerëz të traditave të tjera fetare është një pjesë integrale e Islamit. Ai përsëriti se përulësia është thelbësore për një dialog të vërtetë dhe se njerëzit nuk duhet të mendojnë për superioritetin e tyre, por përkundrazi duhet të përulen përpara vlerave të traditave të tjera fetare.[41] Përkundrazi, ai i percepton të gjithë njerëzit si shërbëtorë të Zotit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, kombëtare apo fetare. Ai citon Profetin Muhamed, i cili ka thënë se nuk ka superioritet të arabëve ndaj joarabëve, dhe të joarabëve ndaj arabëve. Përkundrazi, feja Islame u jep vlerë të njëjtë të gjithë njerëzve dhe i quan ata shërbëtorë të të Gjithmëshirshmit.

Ai gjithashtu u kërkon myslimanëve që të mos e shndërrojnë Islamin në një ideologji që mbart rrezikun e çuarjes së tij në arenën politike, një veprim ky që pengon myslimanët të hyjnë në dialog me njerëzit e besimeve të tjera. Ideologjitë, thotë ai, janë përçarëse dhe jo bashkuese. Ai e sheh Islamin si fe dhe si i tillë ai nuk duhet të jetë një mjet urrejtjeje partiake, nacionale apo të nxisë ndjenjat e armiqësisë ndërmjet njerëzve.[42] Ai i ka ilustruar me vepra bindjet e tij, duke krijuar marrëdhënie të mira me udhëheqësit e pakicave në Turqi. Në fund të viteve '80, ai nisi një dialog me Bartolomeun, patriarkun ortodoks grek në një përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet me grekët në Turqi, hapa të cilët

janë kritikuar shpesh nga radhët e politikanëve turq.[43Z.] Gyleni, pavarësisht shumë kundërshtive, ka punuar gjithashtu për të ngritur një shkollë të mesme në Erevan, kryeqytetin e Armenisë.[44]

Veprimet e mësipërme të z. Gylen, gjithashtu tregojnë për këmbënguljen e tij për dialog mes qytetërimeve dhe për progres arsimor, krahas përpjekjeve për dialogun ndërfetar. Sipas tij: "Aktivitetet tona të vazhdueshme janë për të mirën e të gjithë njerëzimit. Ato nuk duhet të kufizohen vetëm në vendin tonë, në Turqi.»[45] Duke ndjekur këtë këshillë të z. Gylen, biznesmenët dhe edukatorët turq e kanë zgjeruar rrjetin e shkollave dhe spitaleve përtej kufijve të Turqisë.

Z. Gylen përsërit shpesh faktin, se dialogu ndërfetar nuk është një luks, por është shndërruar në një domosdoshmëri në botën e sotme të globalizuar. Ai pranon se shumëllojshmëria e ideve do të vazhdojë të ekzistojë në botën moderne dhe do të paraqesë një sfidë përherë e më të madhe në një botë e cila po shndërrohet në një fshat global. Sipas tij:

"Besimet, racat, zakonet dhe traditat e ndryshme do të vazhdojnë të bashkëjetojnë në këtë fshat. Çdo individ është si një botë e veçantë vetjake, prandaj dëshira që të gjithë njerëzit të jenë të ngjashëm me njëri-tjetrin, nuk është asgjë më shumë se sa një dëshirë e pamundur, pra një utopi. Për këtë arsye, paqja e këtij fshati (global) varet në respektimin e këtyre dallimeve, duke pasur parasysh se ato janë pjesë e natyrës sonë, si dhe në të siguruarit që njerëzit t'i vlerësojnë drejt këto dallime. Përndryshe, është e pashmangshme që bota ta gllabërojë vetveten në një rrjet të konflikteve, mosmarrëveshjeve, luftërash dhe betejash të përgjakshme, duke përgatitur kështu *terrenin* për fundin *e vet."*[46]

Në të njëjtën trajtesë ai thotë:

"Islami, Krishtërimi dhe Judaizmi, që të gjitha vijnë nga e njëjta rrënjë, kanë pothuajse të njëjtat shtylla dhe janë ushqyer nga i njëjti

burim. Edhe pse ato kanë ekzistuar si fe rivale për shekuj me radhë, pikat e përbashkëta mes tyre dhe përgjegjësinë e tyre të përbashkëta për të ndërtuar një botë të lumtur për të gjithë krijesat e Zotit, e bëjnë dialogun ndërfetar në mes tyre të domosdoshëm. Ky dialog tashmë është zgjeruar duke përfshirë edhe fetë e Azisë apo të zonave të tjera."[47]

Që nga koha kur doli zyrtarisht në pension si teolog, shumica e përpjekjeve të z. Gylen janë përqendruar në krijimin e dialogut ndërmjet kulturave, feve dhe grupeve të ndryshme etnike në Turqi dhe në mbarë botën. Ai e bën këtë nëpërmjet vizitave të tij të përhershme me njerëz me prejardhje të ndryshme që vijnë për ta vizituar atë në shtëpinë e tij në Pensilvani, nëpërmjet lidhjeve në internet dhe me anë të artikujve të tij frymëzues që botohen në mënyrë të rregullt në gazetën Zaman dhe në shumë media të tjera informative. Ai vazhdon të quhet, me mjaft respekt dhe me dashuri të madhe *hoxhaefendi*, (domethënë mësues i famshëm) nga dëgjuesit dhe lexuesit e tij.

Islami nuk mund të mbështesë apo tolerojë terrorizmin

Më 12 shtator 2001, z. Gylen iu dha një faqe e tërë në *New York Times* për të shprehur dënimin ndaj sulmeve terroriste të një dite më parë dhe për të theksuar se terrorizmi është i papajtueshëm me mësimet e Profetit dhe fenë islame. Përsëri, më 21 shtator 2001, ai shprehu qëndrimin e tij në Washington Post me fjalët e mëposhtme:

"Ne dënojmë me vendosmërinë më të madhe sulmet e fundit terroriste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe ndajmë dhimbjen me popullit amerikan në thellësi të zemrave tona. Islami urren aktet e terrorit. Një fe e cila thotë se: "Ai që vret padrejtësisht një njeri është njësoj si të ketë vrarë gjithë njerëzimin", nuk mund të justifikojë vrasjen e pakuptimtë e mijëra personave të pafajshëm. Mendimet dhe lutjet tona shkojnë për viktimat dhe të dashurit e tyre."

Në një ese të mëvonshme, ai shkoi edhe më tej duke deklaruar qartë se Islami nuk e pranon terrorizmin në asnjë lloj forme dhe se Islami nuk mund të përdoret për të arritur ndonjë objektiv vetjak. Ai përdori një frazë e cila është dëgjuar të artikulohet në mënyrë të përsëritur nga ndjekësit e tij në vitet në vijim të sulmeve të 11 shtatorit: *"Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman i vërtetë nuk mund të jetë kurrsesi terrorist."*

Z. Gylen gjithashtu deklaroi se Shtetet e Bashkuara nuk duhet të hakmerreshin nëpërmjet përdorimit të forcës, gjë që do të sillte lëndimin e njerëzve të pafajshëm, me qëllim ndëshkimin e disa personave fajtorë. Ai paralajmëroi se veprime të tilla vetëm sa do të forconin dhe më tej terroristët, duke ushqyer ndonjë pakënaqësi ekzistuese dhe do të çonin në lindjen e më shumë terroristëve dhe më shumë akteve të dhunës.[48]

Z. Gylen gjithashtu kritikon udhëheqësit myslimanë, të cilët e përdorin Islamin për interesat e tyre të pushtetit. Ai thotë se disa udhëheqës fetarë dhe "myslimanë të papjekur" nëpërmjet interpretimeve fundamentaliste e kanë përdorur Islamin për të angazhuar njerëzit në betejat që u shërbejnë qëllimeve të tyre. Në Islam, - thotë ai, ashtu siç një objektiv duhet të jetë legjitim, po kështu duhet të jenë edhe të gjitha mjetet e përdorura për t'ia arritur atij qëllimi. Kështu, një person nuk mund të arrijë parajsën duke vrarë një person tjetër. Një individ, i cili e pranon Islamin me vetëdije, kurrë nuk do të merrte pjesë nëpër akte terroriste.

Z. Gylen këmbëngul në idenë se shumë të rinj kanë humbur spiritualitetin e tyre dhe se disa liderë përfitojnë nga kjo duke i rekrutuar këta të rinj të pakënaqur nëpër aktivitetet terroriste dhe i shfrytëzojnë ata. Ai shkon aq larg sa thotë se këta liderë i kanë «droguar ata» duke i manipuluar idetë dhe angazhimet e tyre.[49] Mënyra më efikase për t›iu kundërvënë këtyre aktiviteteve sipas z.

Gylen, është që të sigurohet arsim cilësor që do të shërbejë si një alternativë për rekrutët e rinj potencialë.

Arsimi është antidoza më e drejtpërdrejtë dhe më e fuqishme kundër terrorizmit sipas mendimit të zotit Gylen. Ai pohon se parimet themelore të fesë janë krejtësisht kundër akteve politike dhe ideologjike, si dhe interpretimeve që formojnë shtresën bazë dhe motivojnë aktet brutale të terrorizmit. Këto parime themelore duhet t'u mësohen si muslimanëve ashtu edhe njerëzve të tjerë nëpërmjet sistemit arsimor. Sigurimi i një arsimi cilësor për të rinjtë do t'i mundësojë atyre ta shohin terrorizmin si shkatërrues, imoral dhe një akt të shëmtuar kundër njerëzimit.[50]

Marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë

Ndërsa ai nuk mbron krijimin e një sistemi politik islam dhe i këshillon vazhdimisht lexuesit e tij të mos përzihen në politikë, ai beson fort se feja nuk duhet të kufizohet vetëm në sferën private të individit, por që ajo duhet të jetë pjesë e jetës publike. Ai mbështet një ndarje totale mes fesë dhe politikës në shoqëritë bashkëkohore myslimane. Sipas mendimit të tij, dominimi i çështjeve fetare nga ana e shtetit e dëmton Islamin dhe prandaj feja duhet të çlirohet nga kontrolli shtetëror.

Lëvizja Gylen ishte bashkësia e parë islame në Turqi, e cila pranoi hapur legjitimitetin e shtetit laik, ndërsa synonte të mundësonte lirinë e fesë brenda tij.[51] Në vitin 1998, u themelua Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, një organizatë jofitimprurëse dialogu ndërkulturor, e lidhur me lëvizjen Gylen, e cila inicioi një takim me disa prej teologëve më të respektuar dhe studiuesve islamë në Turqi. Deklarata që rezultoi nga ky tubim pohonte pranimin e shtetit laik, i cili do të qëndrojë në të njëjtën distancë nga të gjitha besimet dhe filozofitë."[52]

Pa dyshim, z. Gylen ruan ndjenja të forta simpatie rreth

trashëgimisë së kombit të tij dhe është krenar për Turqinë e tij. Ai vazhdimisht i referohet rrënjëve të tij turke, historisë osmane të Turqisë si dhe botës turqishtfolëse. Kështu që nocioni i tij i identitetit është formuar nga trashëgimia osmane-islame. Për shkak të karakteristikave të tij nacionaliste, komuniteti i z. Gylen ka zhvilluar orientimin e vet duke u diferencuar edhe nga vetë Nursiu dhe grupimet e tjera islame, nëpërmjet vënies së theksit tek nacionalizmi, tregu i lirë dhe të arsimi. Ai është motori për ndërtimin e një Islami "të ri" në Turqi që është shenjuar me logjikën e ekonomisë së tregut dhe trashëgimisë osmane.[53] Nacionalizmi i tij është gjithëpërfshirës dhe jo në bazë të gjakut apo racës, por përkundrazi, në bazë të përvojave historike dhe realiteteve politike të përbashkëta. Prandaj, komuniteti i zotit Gylen argumenton se Islami është feja e kombit dhe nuk duhet të reduktohet duke u shndërruar në identitetin e ndonjë partie politike. Për Fethullah Gylenin, Islami nuk është një projekt politik për t›u zbatuar, por përkundrazi, një rezervuar dijesh dhe praktikash për zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe etike.[54]

Z. Gylen shmang çdo formë të konfrontimit me shtetin. Përkundrazi, qëllimi i tij kryesor nuk është për të riorientuar shtetin në drejtim të normave islame, por më tepër për të potencuar një shtet që nuk ndërhyn në ushtrimin e lirë së fesë, ndërsa përfiton nga fuqia e besimit në luftimin e sëmundjeve të tilla sociale si dhuna dhe droga. Ai pohon se: "Unë jam gjithmonë në anën e shtetit dhe ushtrisë. Pa shtet, ka anarki dhe kaos."[55] Ai vazhdimisht ka inkurajuar audiencën e tij për të respektuar shtetin, por jo të ngatërrohet në politikë partiake. Z. Gylen është një avokat i shtetit demokratik dhe argumenton se demokracia është forma më e përshtatshme dhe efektive të qeverisjes në një botë të globalizuar. Ai thotë shprehimisht:

"Demokracia dhe Islami janë të përputhshme. Nëntëdhjetë e pesë për qind e rregullave të islamit kanë të bëjnë me jetën private dhe

familjare. Vetëm pesë për qind ka të bëjë me çështjet e shtetit, dhe kjo gjë mund të zgjidhet vetëm nën kontekstin e demokracisë. Nëse disa njerëz janë duke menduar për diçka tjetër, të tillë si një shtet islamik, kushtet e historisë dhe sociale të këtij vendit nuk lejojnë atë. Demokratizimi është një proces i pakthyeshëm në Turqi."[3]

Ai mbron idenë që pasuesit e tij të respektojnë qeverinë dhe të shprehin kundërshtinë apo objeksionet e tyre, siç bëjnë kolegët tyre në vendet më të zhvilluara, në vendet demokratike perëndimore, pra me anë të votës.

Zhvillimi i Lëvizjes Gylen

Dijetarët që studiojnë lëvizjet sociale janë dakord për faktin se elementet e një lëvizjeje duhet të "ngrohen" për pak kohë përpara se ata të shfaqen në publik si një lëvizje e njohur sociale.[57] Për shkak të predikimeve dhe këshillave të tij të regjistruara nëpër kaseta, idetë dhe fryma e z. Gylen vijon të promovohet në Turqi që nga fillimi i viteve '80. Për këtë fakt dëshmon rritja e numrit të njerëzve që i janë bashkuar sohbeteve të frymëzuara nga Gyleni, qarqet lokale të njerëzve të cilët takohen rregullisht për të diskutuar idetë e tij, hapja e konvikteve dhe kurseve përgatitore të sugjeruara nga ai, financimi i këtyre projekteve dhe projekteve të tjera të shërbimit si dhe krijimi një rrjeti të marrëdhënieve joformale komunitare midis qytetarëve, të cilët ndajnë të njëjtat mendime me të. Këto rrjete individësh, duke përfshirë edhe biznesmenë që me burimet e tyre financiare kontribuonin për të mbështetur projektet e shërbimit, kishte filluar të formohej dalngadalë në fshatrat dhe qytetet ku z. Gylen predikonte. Që nga vitet '80, pronarët e bizneseve dhe edukatorët e frymëzuar nga Fethullah Gylen i ishin kundërpërgjigjur krizës arsimore në Turqi duke krijuar institucione të tilla si konviktet e studentëve, kurset përgatitore

[3] Ibid.

për provimin pranues në universitet, shoqatat e mësuesve, shtëpitë botuese, si dhe një gazetë. Nga mesi i viteve '80, lëvizja ka pasur burime të mjaftueshme, duke përfshirë rrjetet informale të njerëzve të motivuar dhe kontribute të konsiderueshme financiare, për të përshpejtuar projektet e shërbimit tashmë të sjella në jetë, si dhe për të filluar ndërtimin e shkollave dhe spitaleve në Turqi. Në këtë pikë, media u bë e vetëdijshme rreth lëvizjes, ndaj mjaft artikuj gazetash në lidhje me lëvizjen dhe aktivitetet e saj e katapultuan atë edhe më shumë në ndërgjegjen e publikut. Pikërisht në këtë moment, faza e "fshehtë" e aktiviteteve të rrjetit i hapi udhë një faze më të dukshme dhe të zhvilluar prandaj në mendjet e anëtarëve të saj filloi të formësohej ideja e një lëvizjeje shoqërore. Publiku gjithashtu nisi t'iu referohej atyre me termat "shkollat Gylen" dhe "pasuesit e Gylenit." Z. Gyleni vetë, megjithatë, kurrë nuk i referohet lëvizjes si lëvizja Gylen apo komuniteti Gylen, e as nuk i ka pranuar këto emërtime. Në vend të tyre ai preferon që lëvizja të quhet "shërbim vullnetar" apo *hizmet*, që do të thotë shërbim për të tjerët ose lëvizje e njerëzve të bashkuar rreth vlerave të larta njerëzore.[59]

Që nga mesi i viteve '80 shkollat e frymëzuara nga Gyleni, janë bërë të njohura në të gjithë Turqinë, duke siguruar një arsim cilësor për të rinjtë turq. Nxënësit e këtyre shkollave ishin dhënës së provimit të pranimit nëpër universitetet kombëtare me rezultate shumë më të larta se sa pjesa tjetër e të rinjve, të cilët edhe ata kishin ndjekur gjithashtu kurse të tjera përgatitore. Gjithashtu, shumë studentë të shkollave të mesme në shkollat e hapura sipas orientimit të Gylenit kanë dalë fitues në garat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Shkollat Gylen dhe lëvizja Gylen që qëndronte pas tyre, nisën të fitonin famë gjithmonë e më të gjerë në publik dhe të tërhiqte përherë e më shumë pjesëmarrës, të cilët gjithnjë e më shumë shihnin vlera të jashtëzakonshme në idetë e shprehura nga lëvizja. Pikërisht në kulmin e suksesit të shkollave që vepronin të motivuara nga idetë e zotit Gylenit rreth

arsimit, shërbimet jopolitike filluan të rriten së bashku në atë që u bë e njohur më vonë si Lëvizja Gylen.

Kolapsi i Bashkimit Sovjetik në vitin 1991 dhe pavarësia e republikave turke në Azinë Qendrore krijuan kushtet që lëvizja Gylen të shndërrohej në një lëvizje ndërkombëtare. Në predikimet e tij në fund të viteve '80, z. Gylen e këshillonte gjithnjë audiencën e tij për t'u përgatitur për të ndihmuar ato vende të cilat së shpejti do të fitonin pavarësinë e tyre, shumica e të cilave ishin me origjinë dhe gjuhë të përbashkët me turqit. Në vitin 1992, shumë shpejt pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, një grup biznesmenësh dhe me shkolla mësuesish të frymëzuar nga Gyleni hapën shkollën e parë në Azerbajxhan. Në po të njëjtin vit, një shkollë e tillë, e frymëzuar nga Gyleni, u hap edhe në Kazakistan dhe në dy vitet në vijim, në atë vend u hapën plot 28 shkolla të tjera. Ndërmjet viteve 1992 dhe 1994, pjesëmarrësit në lëvizje hapën mjaft shkolla në Kirgizistan, ku sot numërohen 12 shkolla të mesme dhe një universitet. Në të njëjtën kohë, 20 shkolla janë hapur në Turkmenistan.[60]

Ndërsa disa pjesëmarrës në lëvizje ishin të zënë me hapjen e shkollave në republikat turke, të tjerët u morën me hapjen e shkollave të ngjashme në vende jomyslimane në Evropën Lindore dhe ish-Bashkimin Sovjetik, të tilla si Bullgaria, Rumania, Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Vullnetarë të tjerë u morën me themelimin e shkollave në vendet e Azisë së Paqësorit si Filipinet, Kamboxhia, Australia, Indonezia, Tajlanda, Vietnami, Malajzia, Koreja e Jugut dhe Japonia.[61] Një aspekt i mahnitshëm i lëvizjes Gylen, është se ajo ndihet aktive jo vetëm në vendet me një trashëgimi turke dhe myslimane, por edhe ato vende me tradita të krishtera, budiste dhe hindu. Kalyoncu argumenton se një arsye për këtë është fakti, se lëvizja vërtet në Turqi e nisi ekzistencën e saj duke përdorur diskursin islam, por me kalimin e kohës ajo në diskursin e saj filloi të vinte theksin në elementet laike dhe humaniste, të tilla si arsimin cilësor, pranimin me dëshirë të të

tjerëve si dhe vlerat etike universale. Ai e përfundon argumentin e tij me fjalët: "megjithëse kjo lëvizje në nivel individual ka mbetur një lëvizje islame, në nivelin e përgjithshëm, ajo është një lëvizje sociale laike."[62]

Gjatë viteve '80, anëtarët e borgjezisë së re të Anadollit, të cilët ishin frymëzuar nga mësimet e z. Gylen, filluan të investojnë në ndërtimin e institucioneve arsimore në të gjithë Turqinë. Në vitet '90, zhvillimi politik dhe ekonomik në Turqi nën politikat e Presidentit Ozal, si dhe ngjarjet politike në mbarë botën, krijuan kushtet dhe hapën rrugën për hapjen dhe zgjerimin e shumë bizneseve me përmasa globale. Rënia e Bashkimit Sovjetik dhe dobësimi i kontrollit shtetëror turk mbi informacionin dhe flukset e kapitalit, rriti migrimin turk në Evropë, dhe zhvillimet globale kontribuan në transformimin e lëvizjes Gylen nga një komunitet i vogël në Turqi në një lëvizje ndërkombëtare aktivistësh të mbështetur nga një klasë në rritje e sipër e sipërmarrësve të pasur, të cilët ishin përkushtuar ndaj idealeve të lëvizjes Gylen.[63]

Që nga vitet '90, nuk ka asnjë dyshim se miliona qytetarë, të cilët u mblodhën rreth ideve të mendimtarit Fethullah Gylen, së bashku me qindra projekte të shërbimit që ata mbështesin, përbëjnë një lëvizje shoqërore. Ajo përbën lëvizjen më të madhe me bazë besimin fetar në Turqi.[64] Megjithatë për t'u habitur është fakti se lëvizja, megjithëse e rrënjosur në një identitet turko-islam, ka qenë dhe vazhdon të jetë aktive si në vende myslimane, ashtu edhe në shumë vende jomyslimane. Shpjegimi ndoshta qëndron në faktin se infrastruktura e lëvizjes, për sa i takon udhëheqjes organizative, vullnetarëve, donatorëve dhe frymëzimi prapa lëvizjes, është mbartur tek diaspora turke në vendet në të gjithë botën nëpërmjet studentëve, biznesmenëve dhe profesionistëve të sferave të ndryshme. Disa prej tyre emigrojnë me dëshirë, për të themeluar në vende të tjera institucionet e frymëzuara nga Gyleni, të tjerë që emigrojnë për arsye edukative dhe/ose biznesi,

qëndrojnë të përfshirë në lëvizje dhe projektet e saj të shërbimit edhe pasi vendosen në një shtet të ri. Meqenëse mbështetësit dhe pjesëmarrësit e lëvizjes vendosen në të gjithë botën për të vënë në jetë projektet e lidhura me lëvizjen Gylen kudo në botë, njerëzit me prejardhje joturke janë informuar në lidhje me lëvizjen dhe janë përfshirë në të në mënyra të ndryshme. Rezultati është se lëvizja Gylen është tashmë një lëvizje globale me arritjet dhe ndikimin e saj jashtë vendit.

Një trajtim përmbledhës i aspekteve të Lëvizjes Gylen

Lëvizja Gylen është një nismë qytetare, një lëvizje e shoqërisë civile, e cila nuk është e sponsorizuar nga ndonjë organizatë qeveritare ose shtetërore. Ajo nuk ka lindur si rezultat i ndonjë politike qeveritare apo ndonjë ideologjie shtetërore. Ajo filloi si një lëvizjes fetare, jo-politike, kulturore dhe edukative, e cila i është përkushtuar ofrimit të mundësive të reja për brezin e ri në Turqi. Ajo fokusohet në ndryshimin individual nëpërmjet edukimit. Lëvizja përqendrohet në vetëdijen shpirtërore dhe intelektuale të individit, duke kërkuar për të formuar një vetëdije të brendshme, e cila do t'i fuqizojë njerëzit për të kryer ndryshime në shoqëri. Ajo thekson rolin që teknologjia dhe rrjetet e reja globale mund të luajnë në artikulimin e një vetëdijeje myslimane. Lëvizja Gylen, pra dallohet nga grupimet e tjera islame, përmes theksit të saj në një formë jopërjashtuese të nacionalizmit turk, tregun e lirë, hapjen ndaj globalizimit, ecjen drejt Evropës, si dhe në integrimin e traditës me modernen e po kështu edhe pamjen e saj humane.

Si një individ me rrënjë të thella si në traditën islame osmane, ashtu edhe në aspektet e dobishme të modernitetit, z. Gylen është një besimtar modernist dhe një risues social. Pasuesit e tij synojnë të promovojnë idenë se Islami nuk është në kundërshtim me

modernizimin, por që arsimi, shkenca dhe teknologjia mund të përdoren krah për krah me Islamin për të promovuar një shoqëri më etike dhe të drejtë. Si rezultat i kësaj, lëvizja është më moderne dhe më me ndikim sesa çdo lëvizje tjetër islame në Turqinë e sotme.[65]

Lëvizja Gylen përbën një shembull në botën myslimane, jo vetëm për aktivitetet e saj, por edhe për mënyrën se si ajo gjeneron mbështetje financiare për këto aktivitete. Promovimi i idealeve themelore islame dhe shembujve nga jeta e sahabëve të Profetit, ashtu si edhe vlerat tradicionale turke të bujarisë dhe mikpritjes, e forcojnë edhe më tepër pozitën e lëvizjes Gylen dhe impaktin e saj brenda botës myslimane. Edhe pse lëvizja e pati zanafillën në Turqi, në një kohë të shkurtër ajo është zmadhuar edhe në rajonet e tjera të botës në kuadër të popullsisë joturke, jo vetëm me anë të projekteve arsimore, por edhe në aspektin e aktiviteteve të dialogut ndërfetar.

Lëvizja nuk i ka toleruar kurrë, prozelitizmin, përdorimin e forcës, terrorizmin apo dhunën, por është përqendruar gjithnjë në ndryshimin e mendësisë së individëve përmes arsimit, shkencës, dialogut dhe demokracisë. Ajo nxit mirëkuptimin dhe respektin reciprok dhe inkurajon angazhimin vullnetar të individëve me vlera të shëndosha në kontribute arsimore dhe altruizëm në shërbim.[66]

Rrjetet informale të njerëzve të frymëzuar nga Gyleni, së bashku me shumë projekte të shërbimit të cilat ata mbështesin, krijon një ndjenjë uniteti në një kauzë të përbashkët. Ekziston një solidaritet i pashprehur në mesin e njerëzve të tillë, si dhe një ndjenjë krenarie në institucionet e lidhura me lëvizjen Gylen. Rezultati është një njohje reciproke dhe publike e identitetit të lëvizjes Gylen. Lëvizja nuk mbart ndonjë ceremonial ritualesh formale, simbole, parulla apo veshje uniforme që ta identifikojnë atë. Përkundrazi, pjesëmarrja në lëvizje ka

trajtën e miqësisë së bazuar në qarqet që inkurajojnë një rol aktiv në veprimtarinë kolektive. Ndryshe nga marrëdhëniet e bazuara në lidhjet familjare ose farefisnore, në këtë lëvizje pjesëmarrja ka karakter vullnetar dhe bazohet në angazhimin aktiv të individëve relativisht të pavarur. Këto rrjete miqësish lehtësojnë dhe rrisin vullnetin e individit për t'u përfshirë në projekte të shërbimit nëpërmjet marrëdhënieve të tij/saj me njerëz qëllimmirë, që bartin ideale të ngjashme. Rezultati i kësaj janë rrjete të shumta njerëzish të lirë, të cilët janë të frymëzuar nga idealet e z. Gylen dhe të cilët janë të motivuar për të mbështetur, në çfarëdo lloj mënyrash që ata të munden, projektet e mëdha dhe të shumëllojshme të shërbimit në Turqi dhe në mbarë botën.

Rrjetet e shërbimit operojnë më vete dhe nuk varen nga një organizatë e centralizuar, edhe pse ata mbajnë lidhje me njerëz të tjerë pjesëmarrës në lëvizje përmes shkëmbimit të informacionit dhe njerëzve profesionistë. Informacioni, ekspertiza dhe projektet qarkullojnë përmes rrjeteve dhe për të mundësuar një nivel të kënaqshëm të identitetit kolektiv në tërësi. Duke qenë një bashkësi rrjetesh në vend të organizatave formale, lëvizja Gylen i tërheq më shumë përkrahësit apo mbështetësit e saj. Ajo nuk përmban një procedurë anëtarësimi apo një regjistër të anëtarëve. Kjo shpjegon faktin pse është e pamundur të llogariten përmasat numerike të lëvizjes Gylen.

Lëvizja është një agregat i rrjeteve, e përqendruar rreth katër aktiviteteve kryesore: sipërmarrjet ekonomike, institucionet arsimore, botimet apo veprimtaritë e tjera mediatike, si dhe tubimet fetare. Individët e përfshirë në këto projekte specifike shkojnë e vijnë duke zëvendësuar njëri-tjetrin, megjithatë projektet e shërbimit vazhdojë pa ndërprerje. Prandaj vazhdimësia në lëvizjen Gylen qëndron në ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të projekteve të shërbimit. Pjesëmarrja në projekte të

shërbimit rreth një qëllimi të veçantë dhe rezultatet e prekshme të projekteve forcojnë kohezionin social, besimin dhe solidaritetin.

---

[1] Një imam është një udhëheqës islam, shpesh lideri i një ose disa xhamive të komunitetit islam, i cili udhëheq namazin gjatë tubimeve të myslimanëve. Imamët caktohen të shërbejnë nëpër xhami të ndryshme nga shteti.

[2] Fethullah Gylen. Küçük Dünyam (Bota ime e vogël). Intervistuar nga Latif Erdoğan, Zaman.

[3] Po aty.

[4] Megjithëse xhamitë dhe namazet me xhemaat vijonin të ishin formalisht të lejuara në Turqinë "laike" asokohe, të gjitha format e tjera të mësimit dhe praktikës fetare ishin të ndaluara, përfshirë edhe shkollat kuranore.

[5] Gjatë gjysmës së parë të jetës së tij, Nursiu ka marrë pjesë në jetën politike në forma të ndryshme. Gjatë gjysmës së dytë të jetës së tij, pas vitit 1920, të cilën ai e quan periudha e "Saidit të ri", ai u tërhoq në një cep të largët në provincën e Vanit dhe ia përkushtoi veten të shkruarit të asaj që më vonë do të shndërrohej në një "Traktat të Dritës", një përmbledhje prej më shumë se 6.000 faqesh me komente tematike rreth Kur'anit dhe jetës së Profetit. Deri në vitet '50 ai refuzoi vazhdimisht përfshirjen në politikë. Gjatë dhjetë viteve të fundit të jetës së tij ai e mbështeti Partinë Demokratike dhe anëtarësimin në NATO të Turqisë, kundër asaj që ai e shihte si një kërcënim i madh nga ana e ateizmit dhe materializmit filozofik me ideator Bashkimin Sovjetik dhe me zbatues përfaqësuesin ideologjik të tij në Turqi, CHP.

[6]Yavuz (2005).

[7]Eyup Can, "Fethullah Gülen ile Ufuk Turu" (Në turne në horizont me Fethullah Gylenin) Zaman. Gusht, 1995.

[8]Agai (2002).

[9]Mardin (1989).

[10]Agai (2005).

[11]Çetin (2010).

[12]Aktay (2003).

[13]*Kestanepazar*ë ishte një konvikt dhe shkollë kuranore, ku merrnin pjesë nxënës të rregullt të shkollave publike, të cilët merrnin trajnim shtesë në

recitimin kuranor dhe në shkencat islame.

[14]Yavuz (2003).

[15]Kalyoncu (2008).

[16]Çetin (2010).

[17] Bacık dhe Aras (2002).

[18] Agai (2005).

[19] Çetin (2010).

[20] Po aty.

[21]Weller (2006).

[22] Pjesa më e madhe e materialit në këtë seksion është bazuar në intervistat që Nevval Sevindi ka kryer me z. Gylen në vitin 1997 dhe përsëri në vitin 2001, pas sulmeve të 11 shtatorit në Nju Jork dhe Uashington. Ato janë botuar në Sevendi (2008).

[23] Abu-Rabi (2008).

[24] Po aty.

[25] Sevendi (2008).

[26] Gylen, *Drejt një Qytetërimi me Dashuri dhe Tolerancë*, f. 202.

[27] Carroll (2007).

[28] Gylen (1998), f. 99–100.

[29] Michel (2005).

[30] Kuru (2003).

[31] Aslandogan dhe Çetin (2006).

[32] Çetin (2010).

[33] Gylen (2005).

[34] Sevendi (2008).

[35] Yavuz (2003).

[36] Sevendi (2008).

[37] Cetin (2010).

[38] Woodhall (2005).

[39] Unal dhe Williams (2000).

[40] Saritoprak dhe Griffith (2005).

[41] Saritoprak dhe Griffith (2005).

[42] Po aty, f. 337.

[43] Lufta Greko-Turke e viteve 1919-1922 filloi për shkak se aleatët perëndimorë i kishin premtuar Greqisë përfitime territoriale në dëm të Perandorinë Osmane. Ajo u zhvillua midis Greqisë dhe forcave revolucionare turke, të cilat më vonë do të krijonin Republikën e Turqisë. Kjo luftë përfundoi me rikthimin e Greqinë në kufijtë e paraluftës dhe të dyja palët u angazhuan në një proces shkëmbimi të popullsisë me njëra-tjetrën sipas dispozitave të Traktatit të Lozanës.

[44] Marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe vendin të saj fqinj, Armenisë, kanë qenë të tendosura që prej përfundimit të Luftës së Parë Botërore (1915), kur janë zhvilluar luftime intensive midis dy vendeve. Armenët pretendojnë se Turqia ka bërë një "genocid" mbi një milion njerëz; Turqit thonë se numri i turqve, të cilët vdiqën në konfliktet dypalëshe gjatë luftës ishte i përafërt dhe se vdekjet nga të dyja palët gjatë viteve të konfliktit ishin si pasojë e luftërave.

[45] Fethullah Gylen (1993).

[46] Gylen (2004) f. 249–250.

[47] Gylen (2004) f. 23.

[48] Po aty, f. 262.

[49] Intervistë me Gylen, Saritoprak (2005) f. 466.

[50] Gylen (2005).

[51] Akyol (2008).

[52] Po aty.

[53] Yavuz (1999).

[54] Po aty.

[55] Intervistë me Gylen në *Sabah*, 27 Janar, 1995.

[56] Po aty.

[57] Komecoglu (1997); Della Porta dhe Diani (1999); Melucci (1999).

[58] Komecoglu (1997).

[59] Çetin (2010).

[60] Kalyoncu (2008).

[61] Po aty.

[62] Po aty.

[63] Kuru (2005).

[64] Fuller (2008).

[65] Fuller (2008).

[66] Komecoglu (1997); Yilmaz (2005); Weller (2005).

ORGANIZIMI SHOQËROR I LËVIZJES: RRJETI I QARQEVE LOKALE

Suksesi i projekteve të frymëzuara nga Gyleni, mbështetet në qarqet e shumta lokale të biznesmenëve, profesionistëve dhe punëtorëve nëpër qytetet, qytezat dhe zonat rurale në Turqi. Modeli i qarqeve lokale lindi brenda *xhemaateve*, një lloj grupimi shoqëror që doli në pah në Turqi pas formimit të Republikës dhe nxjerrjes jashtë ligjit të urdhrave sufiste dhe mbylljes së medreseve. Mylimanët praktikues, të cilët dëshironin të ruanin trashëgiminë islame, ndërsa synonin përshtatjen me modernizmin, formuan qarqet e tyre rreth dijetarëve dhe intelektualëve të cilët promovuan qasje të ndryshme, të tilla si fokusimin në studimet kuranore, ndërthurjen e përkushtimit fetar me një formë të butë të nacionalizmit, apo përsosjen e praktikave individuale shpirtërore. Këto grupe lexuesish dhe dëgjuesish të mbledhur rreth figurave nismëtare, u quajtën më vonë xhemaate, një lëvizje myslimanësh praktikantë turq, të cilët nuk dëshironin të braktisin traditën dhe besimin e tyre, ndërsa përqafonin epokën moderne. Brenda xhemaateve u krijuan sohbete apo grupe të vogla, të cilat nuk kishin nevojë për ndonjë procdurë formal anëtarësimi, nuk kishin rituale pranimi, nuk kishin ndonjë emertim apo dallim të veçante brenda grupit si dhe nuk kishin ndonjë shenjë apo simbol publik që mund të shërbente për dallimin apo njohjen e anëtarëve. Përkundrazi, ato përbëheshin nga njerëz të cilët takoheshin rregullisht për të lexuar apo komentuar ajetet kuranore, traditën profetike dhe dijetarët myslimanë, për të ndarë idetë dhe nevojat e

njerëzve në grup, si dhe për të përcaktuar projektet e shërbimit që grupi përzgjedh për të mbështetur financiarisht.

Midis dijetarëve më të rëndësishëm të epokës, ishte edhe Said Nursiu, i cili tërhoqi vëmendjen e një numri të madh të qytetarëve. Ky dijetar promovoi një harmoni mes shkencës dhe arsyes nga njëra anë, si dhe revelacionit dhe besimit nga ana tjetër. Ndërsa Nursiu u ndikua fuqishëm nga traditat shpirtërore të Islamit, fokusi i tij ishte në edukimin e besimtarëve kundër batërdisë së natyralizmit dhe materializmit filozofik. Siç e kemi diskutuar edhe në kapitullin e mëparshëm, z. Gylen në vitet e tij të rinisë së hershme ishte pjesë aktive e mësimeve të një xhemaati Nursi, dhe e ka përjetuar vetë dobinë dhe efektivitetin e kësaj forme të organizimit.

Ndërkohë që idetë e zotit Gylen merrnin formë dhe përhapeshin nëpër Turqi në fund të viteve ’60 dhe në fillim të viteve ’70, si rezultat i predikimeve dhe shkrimeve të tij, ai nxiste promovimin e strukturën e *sohbetit*, si një mënyrë për ata të cilët frymëzoheshin nga idetë e tij për t’u mbledhur së bashku dhe për të diskutuar rëndësinë e këtyre ideve për shoqërinë bashkëkohore turke. Njerëzit në Turqi ishin tashmë të njohur me qarqet lokale dhe shumë prej tyre i përkisnin ndonjërit prej qarqeve të tilla, të themeluara në qendrën e tyre të punës, apo të bazuar mbi zonat apo interesat e veçanta. Ishte e natyrshme pra, që këto qarqe të përqendroheshin në idetë e predikuara nga ky imam, i cili po tërhiqte pas vetes turma të mëdha njerëzish, duke u shndërruar në një frymëzues të ri shprese për të ardhmen e Turqisë dhe në veçanti të rinisë turke.

Të dhënat në këtë kapitull vijnë nga intervista me pjesëmarrësit e lëvizjes të cilët janë pjesë e qarqeve lokale. Në pranverën e vitit 2007, Doğan Koç ka intervistuar një rreth prej 12 biznesmenësh lokal në Ankara, si dhe me një tjetër biznesmen në Stamboll, i cili operon në biznesin e tekstilit dhe jep një kontribut thelbësor për

çdo vit lidhur me projekte rreth ideve të Gylenit. Ai gjithashtu ka intervistuar një grup mbështetësish të lëvizjes në Hjuston, Teksas, që përbëhej kryesisht nga studentë të diplomuar. Në pranverë të vitit 2008, unë kam studiuar vetë nëntë target-grupe me qarqet lokale të mbështetësve të Gylenit në Turqi. Në Stamboll unë kam intervistuar një grup të përbërë nga tetë biznesmenë të pasur; një tjetër rreth lokal prej 16 profesionistësh të rinj, kryesisht inxhinierë; një grup prej 4 mjekësh dhe një administrator në spitalin SEMA; një rreth lokal të përbërë nga 12 punëtorë me "jakë blu"; si dhe një grup grash që i përkasin një rrethi lokal. Përveç kësaj, në Bursa unë u takova me një grup prej tre biznesmenësh të cilët janë donatorët kryesorë të shkollave të frymëzuara nga Gyleni atje, një grup prej tetë mjekësh në Spitalin "Bahar" dhe një rreth prej 13 punëtorësh me jakë blu të cilët i takova në qarqet vendore rreth qytetit të Bursës. Së fundi, në Mudanya, një fshat i vogël në periferi të Bursës, kam intervistuar një grup prej dhjetë njerëzish me prejardhje të ndryshme profesionale, duke përfshirë një shitës, një mësues të shkollës fillore publike, një punonjës civil në pension dhe pronarin e një restoranti modern.

Përveç këtyre target-grupeve, unë kam kryer gjithashtu intervista tek për tek me pesë persona që i përkasin qarqeve lokale dhe të cilët japin kontribute të konsiderueshme monetare në projekte të frymëzuara nga Gyleni si në Turqi ashtu edhe jashtë vendit. Këta të intervistuar përfshinin: dy gazetarë, një sipërmarrës të pasur të industrisë ushqimore, i cili zotëron një kompani të madhe në Turqi, pronarin e një kompanie të madhe tekstili dhe drejtorin e njërës prej shkollave të frymëzuara nga Gylen.

Target-grupet dhe individët e intervistuar ishin përfaqësues të pjesëmarrësve të lëvizjes për sa i përket klasës shoqërore, profesioneve, qyteteve të mëdha dhe të vogla, gjinisë, moshës dhe kohëzgjatjes brenda lëvizjes. Si rezultat, të dhënat reflektojnë diversitetin që ekziston në qarqet vendore, si dhe në mesin e shumë

individëve të cilët janë pjesë e këtyre qarqeve. Analiza në këtë kapitull, është përshtatur nga pikëpamja sociologjike në drejtim të teorive organizative të angazhimit, për të cilat kemi diskutuar në kapitullin l, në të cilin unë kam paraqitur të dhëna për të treguar se kontributet e dhëna nga anëtarët e lëvizjes, duke përfshirë edhe sponsorët më të pasur, demonstrojnë si angazhim për idealet e lëvizjes e njëkohësisht gjenerojnë angazhim brenda lëvizjes.

Struktura e qarqeve lokale

Qarqet lokale, zakonisht janë të organizuara sipas dy mënyrave: (l) sipas vendndodhjes dhe lagjeve; dhe (2) sipas arsimit dhe profesionit. Për shembull, mjekët në të njëjtën zonë takohen së bashku, ashtu siç bëjnë edhe dentistët, avokatët, ekonomistët, mësuesit, punëtorët e fabrikave etj. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit e lëvizjes Gylen, mund t'i përkasin gjithashtu organizatave më të mëdha profesionale të lidhura me lëvizjen, të cilat zhvillojnë tubime periodike; ata takohen çdo javë, ose dy herë në javë në grupe të vogla prej rreth 10-12 personash. Në këto takime të vogla, pjesëmarrësit flasin për një shumëllojshmëri temash, përfshirë fenë, çështjet teknike, familjen dhe çdo problem tjetër të jetës që ngrihet për diskutim nga anëtarët. Nganjëherë grupi lexon pjesë nga Kurani ose nga tradita profetike, në të tjera raste, grupi mund të mikpresë një predikues. Më shpesh, anëtarët e një grupi të caktuar, thjesht mblidhen së bashku për të ndarë përvojat e jetës së tyre, dhe çfarëdo tjetër që mund të ketë qenë e rëndësishme në javën në fjalë. Siç ka thënë një anëtar: "Ajo çfarë është më e rëndësishme, është të mbledhurit së bashku dhe takimet me njëri-tjetrin. Çdo javë e mbyll telefonin të premten mbrëma dhe i porosis miqtë e mi të mos më thërrasin fare apo të mos planifikojnë asgjë në lidhje me mua. Takimi "në qarkun tim lokal" është ngjarja më e rëndësishme e javës sime."

Grupi i punëtorëve që takova në Bursa takoheshin nëpër qarqet lokale prej 20-25 vetash, një herë në javë me të sapoardhurit në lëvizjen Gylen dhe një herë tjetër me njerëz të cilët kanë qenë në lëvizje që prej një kohë të gjatë. Siç m'u shpreh një punëtor: "Në kulturën tonë ne kemi vlera të cilat kanë qenë të mbuluara nga harresa, kështu që ne konsultojmë materiale motivuese të tilla si librat apo videot e Gylenit ose veprat e Nursiut apo diçka nga tradita profetike." Për shkak se nuk janë aq të pasur sa biznesmenët, ata nuk mund të mbështesin një shkollë të tërë ose dhjetë bursa siç bëjnë disa biznesmenë, por ndoshta tre prej tyre së bashku mund të mbështesin një student me bursë. Përveç kësaj, grupi në Bursa ka krijuar *Kor-Der*, një shoqatë që organizon aktivitete në 120 fshatra rreth Bursas për të përhapur mesazhin e shërbimit të lëvizjes, për të grumbulluar donacione dhe për të përcaktuar nevojat në fshatrat lokale. Prandaj, ndërsa grupi i punëtorëve nuk është në gjendje për të bërë donacione në shuma të mëdha parash, anëtarët e tij dhurojnë shumë orë të kohës së tyre si ndihmës, për të nxitur të tjerët të mbështesin projekte të shërbimit.

Siç shpjegonte një biznesmen:

"Të qenët në të njëjtin lloj biznesi, do të thotë se ne kemi një arsye të fortë për t'u mbledhur së bashku dhe për të kuptuar njëri-tjetrin. Ne gjithashtu diskutojmë midis nesh në lidhje me rrjetin dhe klientët tanë. Pastaj ne kemi një çështje bazë, diskutimin e projekteve që duhen *realizuar në komunitetin tonë dhe se si ne mund të ndihmojmë në këto projekte. Ne gjithashtu vërejmë rezultatet e përpjekjeve tona të cilat na inkurajojnë që të jemi edhe më bujarë."*

Në fakt, ideja e të ndihmuarit të njëri-tjetrit për të qenë të suksesshëm në bizneset e tyre, është hedhur fillimisht nga z. Gylen. Në vitin 2007, TUSKON, një shoqatë biznesi me 1.500 anëtarë, e frymëzuar nga Gyleni, ka sponsorizuar një konferencë në Stamboll për një mijë pronarë biznesesh nga vendet në zhvillim nga Afrika dhe Azia Qendrore në të cilën ata u trajnuan, në mënyrë që të

rrisin bizneset e tyre. Të ndihmuarit e njëri-tjetrit në një industri të caktuar dhe efikasiteti i rrjeteve të biznesmenëve, është një nga arsyet që komuniteti i biznesit të pasuesve të Gylenit në Turqi, është i njohur si një nga komunitetet më të pasura në vend.[2]

Organizimi në bazë të grupimeve të natyrshme, të tilla si ato mbi bazë zanati apo vendi pune, gjithashtu e lehtëson rekrutimin. Grupe që ndajnë identitete të mprehta dalluese dhe rrjete të dendura ndërpersonale, janë më të organizuara dhe për rrjedhojë, mobilizohen lehtësisht. "Rekrutimi në bllok" i grupeve parapërgatitore të solidaritetit, përfaqëson formën më efikase të rekrutimit.[3] Lëvizjet të cilat përqëndrohen në grupimet parapërgatitore ose «natyrore» dhe të cilët e lidhin vizionin e tyre me ndryshimin e kësaj kulture parapërgatitore, janë më efektive sesa grupimet që i përqendrojnë përpjekjet e tyre për të rekrutuar individë të veçantë. Rekrutimi individual kërkon investime më të mëdha të burimeve dhe është shumë më i ngadaltë se rekrutimi në bllok.

Të gjitha qarqet lokale që kam vizituar ishin të ndara mbi baza gjinore. Kur kam pyetur për gratë anëtare në secilin qark, m'u tha se qarqet janë të hapura për gratë, por se gratë parapëlqejnë të takohen më vete dhe ndjeheshin shumë më rehat me gratë e tjera. Në rastin e inxhinierëve, për shembull, rreth 10% e grave inxhiniere takohen nëpër qarqe të përziera. Ekzistojnë edhe qarqe lokale paralele për gratë inxhiniere, ku takohen pjesa e mbetur prej 90%. E njëjta gjë vlen edhe për mjekët, infermieret, dentistët, ekonomistët, punonjësit me jakë blu, etj. Një arsye për ndarjen, m'u tha se ishte e karakterit logjistik. Gratë preferojnë të takohen gjatë paraditeve, përpara se fëmijët e tyre të kthehen në shtëpi nga aktivitetet shkollore, të cilët kërkojnë vëmendjen e tyre të plotë. Gjithashtu, për arsye sigurie, gratë nuk kanë dëshirë të qëndrojnë jashtë pasi të erret, kohë kur shumica e meshkujve të qarqeve takohen me njëri-tjetrin.

Çështja e rolit të grave në lëvizjen "Gylen" është ngritur në mënyrë të përsëritur gjatë intervistave të mia. Kritikët e lëvizjes, si në Turqi ashtu edhe në Hjuston, Teksas, thonë se gratë në lëvizje shihen dhe trajtohen si individë të dorës së dytë, të prirura për të përmbushur rolet tradicionale të rritjes së fëmijëve dhe të përkujdesjes për shtëpinë; ato nxiten për të veshur shami, i shmangen ndërveprimeve sociale me meshkujt dhe qëndrojnë të tërhequra nga rolet e lidershipit publik.[4] Në intervistat e mia me femrat pjesëmarrëse në lëvizje, si në Turqi ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara, kam zbuluar një shkallë të gjerë të dallimeve midis grave për sa i takon gjykimit të tyre rreth mënyrës se si ato trajtohen në kuadër të lëvizjes si dhe në lidhje me respektimin e roleve të luajtura nga gratë në aktivitetet e lëvizjes. Për shembull, në San Antonio, Texas, një grua e mbuluar ka qenë organizatorja dhe hapësja e ceremonive në darkën vjetore të Ramazanit, në të cilën morën pjesë qindra njerëz nga komuniteti lokal. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë në Hjuston, Texas, ku ka qenë gjithmonë një burrë ai i cili ka qenë oranizatori dhe i cili ka shërbyer si president i grupit lokal. Në Turqi shumica e të intervistuarave të mia femra, e kanë vlerësuar faktin që atyre u lejohet të studiojnë dhe të punojnë nëpër shkollat dhe spitalet e lëvizjes, ndërsa mbanin veshur shaminë, diçka kjo e ndaluar nëpër institucionet publike në Turqi. Shumë nga këto gra e gjejnë fuqinë e tyre në faktin e të qenit në gjendje të vendosin për veten e tyre se çfarë duhet të veshin, si dhe në hapësirën që kanë në institucionet e lidhura me Gylenin, për të ushtruar individualitetin dhe aftësitë e tyre.[5]

Unë zhvillova intervista në njërin nga qarqet lokale të grave në pjesën aziatike të Stambollit. Grupi përbëhej nga një përzierje grash me prejardhje të ndryshme profesionale, duke përfshirë një ish-mësuese dhe një mësuese aktuale në një shkollë të frymëzuar nga Gyleni, një avokate, një ekonomiste, një sekretare, një shitëse dhe një nënë shtëpiake. Kur i pyeta se çfarë mendonin ato rreth përjashtimit të tyre nga qarqet e meshkujve, unë u korrigjova nga

ato me këto fjalë: "Ne nuk jemi të përjashtuara. Ne thjesht nuk dëshirojmë të takohemi me burrat. Ne zhvillojmë takime në mes njëra-tjetrës ku e ndiejmë veten më rehat. Në këtë rast, ne mund të flasim për atë që na intereson dhe shqetëson, gjë cila është mjaft e ndryshme nga ajo e burrave."

Unë mësova se qarqet e grave veprojë në mënyrë të ngjashme me ato të burrave. Grupet takohen çdo javë, lexojnë pjesë nga Kurani, nga tradita profetike, prej shkrimeve të z. Gylen dhe nga libra të tjerë frymëzues. Gratë pastaj diskutojnë rreth temave të ndryshme, sidomos për ato që kanë lidhje me jetën e tyre. Ato gjithashtu diskutojnë rreth familjeve të tyre, rreth problemeve në shtëpi sidomos ato që kanë të bëjnë me fëmijët, si dhe rreth projekteve të shërbimeve për të cilat nevojitet ndihma e tyre. Ato gra të cilat punojnë jashtë shtëpisë, japin kontribute financiare për projektet e Gylenit. Gratë gjithashtu angazhohen në *kermes*, praktikën turke për të bërë punime me dorë (psh, qëndisje, gatime, vepra arti, etj) të cilat ato pastaj i shesin dhe fitimet i japin për projektet që kanë nevojë për mbështetje.

Një element thelbësor i çdo rrethi vendor është se ai mbështet disa projekte që kanë nevojë për financim, qoftë në Turqi apo në ndonjë vend tjetër. Kur pyet se në ç'mënyrë grupi informohet në lidhje me nevojat në komunitet, m'u tha në mënyrë të përsëritur se komuniteti i frymëzuar nga Gyleni është mjaft i lidhur dhe njerëzit e dinë se cilat projekte kanë nevojë për ndihmë. Disa prej njerëzve brenda lëvizjes kanë qenë në kontakt dhe janë marrë me mbështetjen e projekteve arsimore për vite me radhë, ndaj e dinë mirë se çfarë ndodh në fushën e arsimit. Të tjerët kanë lidhje me spitalet dhe e dinë se çfarë nevojitet atje. Të tjerë akoma, udhëtojnë jashtë Turqisë dhe janë të vetëdijshëm për nevojat që ekzistojnë në vende të tjera. Qarkullon fjala se cilat projekte kanë nevojë të financohen, veçanërisht ato të cilat kanë një afat kohor, prandaj personat anëtarë të qarqeve vendore, mblidhen së bashku dhe

vendosin se çfarë mund të bëjnë në këtë aspekt.

Përveç ndihmës financiare që japin gjatë gjithë vitit, myslimanët dy herë në vit festojnë Bajramin, festë e cila stimulon ndjenjën e ndihmës për nevojtarët. Gjatë muajit të Ramazanit kur çdo mysliman praktikon agjërimin që nga lindja deri në perëndim të diellit dhe bën përpjekje të mëdha për të jetuar një jetë të virtytshme dhe të disiplinuar, ekziston edhe kërkesa për ndarjen e bollëkut të atyre që kanë pasur, me njerëzit në nevojë. Pothuajse pa përjashtim, myslimanët në mbarë botën janë veçanërisht bujarë gjatë Ramazanit, me kontributet e tyre bamirëse.

Bajrami i dytë është Eid-ul-Adha, Kurban Bajrami, që vjen menjëherë pas Haxhit, pelegrinazhit vjetor në Mekë që është i nevojshëm të kryhet një herë në jetë për të gjithë myslimanët e aftë për punë të cilët mund të përballojë udhëtimin. Në këtë ditë pra në Ditën e Sakrificës, myslimanët sakrifikojnë kafshë të cilat konsiderohen hallall apo të përshtatshme për t'u therur, në kujtim të sakrificës që Abrahami bëri ndaj Zotit. Ata jo vetëm që hanë për vete nga ai mish, por e shpërndajnë atë në mesin e të afërmve fqinjë dhe miqve të tyre, dhe në fund, një të tretën e mishit e japin për të varfërit dhe të uriturit. Qëllimi i këtij veprimi në shumë komunitete myslimane është që të bashkohen zemrat, duke u kujdesur që asnjë fqinj i varfër të mos lihet pa mish kurbani gjatë kësaj dite.

Në kohën e Kurban Bajramit, disa muaj para intervistave të mia, një grup biznesmenësh nga Bursa udhëtoi për në Darfur, Sudan, ku ata blenë tre dema të vegjël për therje dhe ua ndanë si ushqim njerëzve të varfër atje. Ata takuan gjithashtu edhe biznesmenë të tjerë atje, të cilët i bindën që të jepnin kontribut në ndërtimin e një shkolle në një nga qytetet e Darfurit, në mënyrë që të rinjtë e asaj zone të arsimoheshin.

Donacione në rritje për projektet e frymëzuara nga Gylen

Një fokus i madh, nëse jo më i madhi i vizionit të Gylenit për Turqinë dhe për njerëzimin, është rëndësia e edukimit cilësor për zhvillimin e personalitetit të njeriut dhe në të njëjtën kohë, për ta sjellë Turqinë në epokën moderne të shekullit të njëzetenjëtë. Për të arritur këtë qëllim, ai mbrojti me forcë idenë e hapjes së shkollave së pari në Turqi dhe më pas në fund në të gjithë botën. Për ta bërë këtë ai do të kërkonte angazhimin e të gjithë personave të përfshirë në lëvizje, duke përfshirë administratorët, mësuesit, kujdestarët, studentët si dhe mbështetjen financiare të të gjithë personave që ishin në gjendje t'a bënin këtë. Si rezultat, çdo person i çdo rrethi në të cilin kam kryer intervistat theksoi në mënyrë të vecantë mënyrat me të cilat anëtarët e rrethit i kanë mbështetur disa nga projektet arsimore, duke përfshirë konviktet, klasat përgatitore, ndërtimin e shkollave dhe sigurimin e bursave për studentët në nevojë, në mënyrë që edhe ata të ishin pjesë e këtyre shkollave.

Çdo shkollë ka sistemin e saj të pavarur të kontabilitetit dhe kontabilistët, të cilët bëjnë menaxhimin e buxhetit dhe faturave financiare. Ata janë të gjithë të përgjegjshëm ndaj autoriteteve lokale dhe shtetërore, si dhe njerëz të besuar të sponsorëve. Sponsorët lokale kanë dijeni në çdo kohë në lidhje me gjendjen e projekteve në proces, sepse ata janë personalisht përgjegjës për shumë prej tyre, qoftë si kontraktorë ndërtimi, kontabilistë, duke shërbyer në bordin drejtues, si mësues, drejtorë, etj. Pra, është mjaft e lehtë, për ata që të monitorojnë mënyrën se si janë përdorur donacionet, duke mundësuar një transparencë totale në çështjet financiare. Për më tepër, siç shpjegon një biznesmen:

"Para së gjithash, unë dëshiroj që ju të dini se njerëzit në lëvizjen Gylen kanë fituar besimin e njerëzve në çdo fushë të jetës. Njerëzit që përkrahin financiarisht aktivitetet e kësaj lëvizjeje nuk shqetësohen nëse fondet kanë arritur ose jo në destinacion, ata nuk e ndjekin

këtë çështje. Megjithatë, në qoftë se ne duam të shikojmë nëse paratë tona janë përdorur siç *duhet, të gjitha tipet e informacionit janë në dispozicion në çdo veprimtari; ne mund të sigurohemi për efektshmërinë e tyre duke i kontrolluar vetë ato.*"

Po kështu, një biznesmen lokal në Hjuston që financon projektet e lidhura me Gylenin u shpreh, "Edhe në qoftë se unë nuk i di detajet e aktiviteteve të tyre, unë e di se këta janë njerëz shumë të mirë dhe besoj tek ata. Prandaj unë bëj donacione i bindur se ato fonde mirëpërdoren."

Në Mardin, për shembull, një qytet në jug-lindje të Turqisë, një grup biznesmenësh lokalë u takuan gjatë një periudhe tre vjeçare (1988-1991) dhe arritën në konkluzionin se shteti nuk ishte në gjendje për të siguruar edukimin e nevojshëm për studentët jo vetëm në qytetin e tyre, por në të gjithë Turqinë Jug-Lindore, në mënyrë që ata të konkurronin në kushte të barabarta me të tjerët në provimet e pranimit në universitet. Shumica e biznesmenëve kishin ndjekur më parë predikimet publike të zotit Gylen, në të cilën ai theksonte rëndësinë e edukimit dhe bënte thirrje për ndërtimin e shkollave moderne. Këto biznesmenët ishin frymëzuar nga suksesi i shkollave të Gylenit në Izmir, Stamboll dhe Gaziantep, të cilat ishin dalluar nga homologet e tyre në drejtim të mënyrës së tyre të punës të bazuar në progresin shkencor, dhe ishin të impresionuar nga suksesi i tyre i paparë në konkurset ndërkombëtare shkencore. Gjatë vizitave nëpër këto shkolla, personat e intervistuar dëshmuan se lista e njerëzve të cilët dhuronin para për këto shkolla përfshin jo vetëm biznesmenë, por edhe punëtorë, mësues dhe nëpunës civilë.

Në Mardin, këta biznesmenë arritën të ndikonin në shumë më tepër njerëz me të cilët ata kishin një vizion të përbashkët arsimor dhe arritën të përfitonin shumë më tepër ndihmë sesa kishin parashikuar kur kërkonin para për sponsorizimin e shkollave. Disa

premtuan para, disa të tjerë premtuan të kërkonin individë që do të zotohshin për të kontribuar në të holla, të tjerët u vetëofruaran për të blerë materialet e ndërtimit dhe pajisjet si donacione nga furnizuesit e tyre, dhe shumë të tjerë kryen një sasi orësh pune fizike gjatë procesit të ndërtimit. Aktualisht në shkollat e lëvizjes Gylen në Mardin, çdo mësues mbështet financiarisht shpenzimet mujore të të paktën një nxënësi të shkollës nëntëvjecare apo të mesme.[6]

Në një intervistë të zhvilluar me një duzinë biznesmenësh që merren me industrinë e tekstilit në Ankara, kemi dëgjuar shumë histori se si biznesmenët e parë u përfshinë në financimin e projekteve të frymëzuar nga Gyleni. Për shembull, në vitin 1985 një imam erdhi në një xhami lokale dhe u kërkoi biznesmenëve atje të ndihmonin për të hapur një shkollë për fëmijët e qytetit. Pasi ai u largua, njerëzit u mblodhën dy herë në javë për të diskutuar çështjen. Grupi mori angazhim për të ndihmuar në ndërtimin e shkollës. Disa dhanë paratë, të tjerë morën premtime për mbështetje financiare nga biznesmenë të tjerë në qytet dhe të tjerët ofruan mallra dhe shërbime të tilla si beton, tavolina, dhe madje edhe punë krahu vullnetare. Brenda një kohe të shkurtër, Kolegji "Samanjolu" hapi dyert e tij për nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme.

Grupet e biznesmenëve vazhduan të takoheshin rregullisht, për të monitoruar nevojat nëpër shkolla dhe për të nismuar projekte shtesë që ata mbështesnin. Për shembull, në vitin 1991, pas rënies së Bashkimit Sovjetik, në Azerbajxhan ndodhi një masakër. Njerëzit atje kishin nevojë për ndihmë. Komuniteti Gylen në Ankara u përgjigj menjëherë; 18 biznesmenë nga zona të ndryshme të Ankarasë shkuan në Azerbajxhan për të ofruar paratë dhe mallrat që ata kishin mbledhur nga njerëzit e frymëzuar prej Gylenit nëpër Ankara. Siç deklaronte njëri nga biznesmenët: "Ky ishte një udhëtim i rëndësishëm për mua. Kam mësuar shumë nga njerëzit

në grupin tonë. Ata ishin njerëz nga më të ndryshmit, shumica e tyre nuk ishin të shkolluar si unë, por të gjithë më prekën thellë nëpërmjet konceptit të tyre për mësimet e z.Gylen dhe nëpërmjet ngjarjeve rreth jetës së tyre. Që nga ai udhëtim unë jam përfshirë shumë në lëvizjen Gylen."

Një tjetër biznesmen brenda grupit në fjalë, rrëfeu një histori e cila ravijëzon mënyrën në të cilën shumë njerëz janë përfshirë në lëvizje. Një ditë në vitin 1988 ai u takua me një student juridiku që merrte bursë nga njëri prej biznesmenëve të cilin ai e njihte dinte dhe që jetonte brenda kompleksit të tij të banimit. Ai i kërkoi biznesmenit në fjalë për ta njohur me ndonjë prej këtyre studentëve të juridikut që ishin në vështirësi financiare dhe të cilët nuk mund ta përballonin dot tarifën e Fakultetit Juridik. Disa ditë më vonë një grup studentësh të këtij fakulteti u shfaqën në dyqanin e tij. Megjithatë, ata nuk kërkuan para, por biseduan rreth problemeve që shqetësonin vendin dhe botën. Disa javë më pas ata e ftuan personin në fjalë në shtëpinë e tyre, ku ishin të pranishëm dhjetë studentë të Drejtësisë të ardhur nga e gjithë Turqia, shumica e të cilëve nga familje të varfëra. Përsëri askush nuk i zuri me gojë paratë. Disa nga studentët e vizituan përsëri dyqanin e tij dhe u takuan me të birin, i cili kishte vështirësi në shkollë. Ata i ofruan ndihmë të birit, notat e të cilit u përmirësuan në mënyrë dramatike për shkak të ndihmës së ofruar. Prapë askush nuk diskutoi rreth parave. Biznesmeni, një vit pasi i kishte njohur këta studentë personalisht, filloi t'u jepte bursa që t'i ndihmonte financiarisht të përballonin shpenzimet e universitetit. Ai, që nga viti 1988, vazhdon të ofrojë bursa për studentët në nevojë të Fakultetit Juridik.

Historia e mësipërme tipizon veprimet e vetë z. Gylen gjatë viteve '70 dhe '80, kur ai jetonte brenda ose në afërsi të kampuseve universitare përgjatë Turqisë. Ai shërbeu si mësues për njëfarë kohe dhe kaloi shumë vite në mbikëqyrjen e nxënësve të shkollës

së mesme dhe në kurset përgatitore për pranimin në universitet. Në Bursa kam intervistuar një zotëri, i cili së bashku me vëllain e tij, kishin banuar në të njëjtën shtëpi me z. Gylen, ndërsa ai ishte student universiteti në vitet '60. Ai sjell ndër mend faktin se shumë studentë universitarë e vizitonin zotin Gylen në katin e dytë të banesës e tij për ndihmë dhe përkrahje. Ai komenton se sipas mendimit të tij, kjo tabllo studentësh që u mblodhën përreth Fethullah Gylenit gjatë atyre viteve, ishin fillimet e vërteta të lëvizjes Gylen në Turqi.

Kontributet financiare

Kontributet financiare përbëjnë një karakteristikë të pandarë të pjesëmarrësve në lëvizjen Gylen. Të intervistuarit në mënyrë të përsëritur, komentuan se të gjithë personat e përfshirë në lëvizje japin një lloj kontributi financiar në varësi të rrethanave. Ekziston një marrëveshje e gjerë në mesin e njerëzve pjesëtarë të qarqeve të ndryshme lokale që shuma e donacioneve të variojë nga 5% deri në 20% të të ardhurave vjetore, me një mesatare prej 10%; po ashtu ekziston një grup i vogël individësh të cilët japin kontribute mbi 20%.

Teoricienët e mjeteve organizative argumentojnë se suksesi i një lëvizjeje është shumë i varur nga kontributet e "aktorëve të shkathët" ose elitave. Pavarësisht nëse ata janë politikanë me ndikim, "profetë", biznesmenë të suksesshëm, apo kompani biznesi, këta individë janë "aktorë të shkathët", sepse ata kanë aftësinë për të kontribuar me një pjesë të konsiderueshme të asaj që fitojnë, për të shpënë përpara objektivat e lëvizjes. Mobilizimi i një grupi të madh ndodh vetëm kur kjo gjë lehtësohet nga kontributet e fuqishme të elitave të tilla, sepse ato ofrojnë dy lloje të burimeve: Së pari, elitat kanë qasje dhe kontroll në oaze të mëdha burimesh, dhe së dyti, përfshirja e elitave mund t'i japë legjitimitetin dhe

vëmendjen e duhur një lëvizjeje sociale, një burim tjetër thelbësor ky për suksesin e një lëvizjeje.[7]

Të gjithë industrialistët e pasur që kam intervistuar në Stamboll, duke përfshirë pronarin e një kompanie të madhe elektronike, pronarin e një biznesi të njohur mobiliesh, si dhe një person familja e të cilit zotëron një kompani anijesh, dhurojnë çdo vit rreth 1 milion dollarë për projektet e frymëzuara nga Gylen, shumë kjo e cila përfaqëson rreth 10-15% të të ardhurave të tyre. Dy nga këta persona janë në mesin e pesë mbështetësve që kanë financuarar ndërtimin e spitalit më të fundit të ndërtuar nga mbështetësit e Gylenit në Stamboll. Në Bursa, një biznesmen jep afërsisht 3.500.000 $ në vit, shumë kjo e cila është sa një e treta e të ardhurave të tij. Një tjetër biznesmen jep 3-4.000.000$ në vit për njëmbëdhjetë shkolla në Shqipëri. Një person i tretë jep para për shkollat në dhjetë vende të ndryshme, dhe thoshte se ai tani kishte vëllezër në të gjitha këto vende dhe jo vetëm në nivel lokal, në Turqi.

Ne pyetëm një grup prej dymbëdhjetë biznesmenësh në Ankara, nëse ndonjëri prej tyre kontribuon financiarisht për projektet e frymëzuara nga Gylen dhe nëse po, afërsisht nga sa japin në vit. Secili prej 12 personave të intervistuar tha se jepte rregullisht kontribut me sa kishte mundësi për projektet e lëvizjes. Shumat e kontributeve varionin nga 10-70% të të ardhurave të tyre vjetore, duke filluar nga 20,000 deri në 300,000 $ në vit. Në veçanti, njëri nga këta biznesmenë tha se ai jepte 40% të të ardhurave të tij vjetore, shumë e cila është rreth 100.000 $, megjithatë, ai tha se do të dëshironte të dhuronte 95%, por nuk ishte në gjendje ta bënte këtë sepse nuk mund ta mbante dot veten dhe familjen e tij. Një njeri tjetër tha, "Ne dëshirojmë që t'u ngjajmë sahabëve të Profetit dhe të dhurojmë gjithçka që kemi. Por kjo nuk është e lehtë." Ky grup biznesmenësh përbëhej nga burra të moshuar, të cilët kanë qenë së bashku në një grup për shumë vite dhe kanë arritur të

financojnë projekte të shumta të frymëzuara nga Gyleni, si në Ankara, ashtu edhe në vende të tjera. Aktualisht, secili prej tyre ka punësuar menaxherë në dyqanet e tyre, të cilët kryejnë punët ditore të biznesit. Pronarët e bizneseve kalojnë 2-3 orë çdo ditë nëpër dyqanet e tyre dhe pastaj mblidhen së bashku pothuajse çdo ditë për të diskutuar mbi çështjet që lidhen me projektet që ata mbështesin financiarisht. Grupi pra, ofron një komunitet të ngushtë individësh të të njëjtit mendim, të cilët punojnë për kauzën e përbashkët. Çetin pohon se «solidariteti i grupit është i pandashëm nga synimet personale dhe nga nevojat e përditshme emocionale dhe komunikuese të pjesëmarrësve në rrjet... Megjithatë, kjo përbën dicka epi-fenomenale, dhe nuk është qëllimi përfundimtar ose final në vetvete, megjithatë e shoqëron të vepruarin natyrshëm, si rezultat i realizimit të projekteve të shërbimit."[8]

Një tjetër biznesmen tepër i suksesshëm në Stamboll, të cilin ne intervistuam, na ofroi një pasqyrë të shumave të parave të dhuruara nga mbështetësit e lëvizjes Gylen nëpër projektet lokale. Ai është 48 vjeç dhe merret me biznesin e tekstileve. Ai kontribuonte me 20% të të ardhurave të tij vjetore prej 4-5 milionë $ në projektet që kanë të bëjnë me lëvizjen. Tetëdhjetë për qind e shokëve e tij më të mirë ishin gjithashtu pjesëmarrës në lëvizje dhe kontribuojnë sa munden për financimin e projekteve. Ai thoshte se kishte krijuar miqësi të sinqerta dhe shumë fat nëpërmjet pjesëmarrjes nëpër aktivitetet e lëvizjes. Ai u njoh me lëvizjen, kur një mik i tij e ftoi në një mbledhje bashkëbisedimi në vitin 1986, ku njerëzit mblidheshin së bashku dhe diskutonin, qoftë rreth shkrimeve të z. Gylen qoftë në lidhje me projektet lokale që kishin nevojë për mbështetje. I pyetur se çfarë përfiton një person i cili merr pjesë në mbështetjen e projekteve të frymëzuara nga Gyleni, ai u përgjigj:

"Unë nuk marr ndonjë përfitim të kësibotshëm me mbështetjen e lëvizjes Gylen. Nëse unë do të përfitoj ndonjë gjë në jetën e përtejme,

do ta shohim kur të shkojmë atje. Unë shpresoj të jem në gjendje për të kënaqur Zotin nëpërmjet këtyre aktiviteteve dhe kohës që kam shpenzuar me këta njerëz të mrekullueshëm. Përveç kësaj, as unë as vullnetarët e tjerë nuk presim ndonjë gjë tjetër. Pastaj duke dhënë zemrën për këto aktivitete bamirëse, Zoti nuk të lë në telashe. *Ne dhurojmë dhe Ai na dhuron neve edhe më shumë. Ai e shumëfishon pasurinë* që kemi në duart tona. Unë nuk mendoj se kontributet e mia janë aq të mëdha, megjithatë, në sytë e Zotit, nuk ka asgjë të vogël dhe të pavlerë, nëse ju e bëni për Atë dhe për njerëzimin."

Disa prej biznesmenëve dhe profesionistëve dhurojnë një të tretën e të ardhurave të tyre vjetore përvec taksave, për projektet e lëvizjes. Për shembull, një biznesmen në Stamboll e shpërndau një të tretën e fitimit për biznesin e tij, një të tretën për mbështetjen e familjes dhe një të tretën e mbetur për projektet e lidhura me lëvizjen Gylen. Ndërsa unë qeshë në gjendje për të përcaktuar saktësisht të ardhurat e tij vjetore, më thanë se biznesi i tij është me vlerë mbi 1 miliard dollarë dhe është ndër ndërmarrjet më të suksesshme të biznesit të sektorit ekonomik në Turqi. Unë munda ta marr me mend pra, se shuma e të ardhura vjetore të tij të ishte shumë miliona dollarëshe. Disa njerëz brenda lëvizjes e identifikojnë atë si një nga kontribuesit më të mëdhenj në projektet e shërbimit, veçanërisht në shkolla.

Kontributet substanciale të bëra nga biznesmenë të pasur dhe sipërmarrës në projektet e lidhura me lëvizjen janë të rëndësishme jo vetëm për impaktin e tyre financiar për sa i përket asaj që mund të realizohet në aspektin e ndërtimit dhe mbarëvajtjes së projekteve të shtrenjta, por edhe për shkak se një mbështetje e tillë i jep legjitimitet dhe peshë lëvizjes. Gjatë intervistave janë përmendur më shpesh "biznesmenë" të cilët janë në gjendje për të mundësuar realizimin e objektivave të shërbimit të lëvizjes.

Megjithatë nuk janë vetëm pronarët e pasur të biznesit, ata të

cilët kontribuojnë financiarisht për projektet e lëvizjes, por çdo qark lokal kontribuon me aq sa ka mundësi për mbështetjen e projekteve arsimore. Grupimi i sipërmarrësve të rinj në Stamboll, shumica prej tyre inxhinierë, i përkasin një organizate profesionale prej rreth 1.000 anëtarësh, që të gjithë pjesëmarrës në lëvizjen Gylen. Ky grup dhuron rreth 2.000.000 $ në vit për projekte të frymëzuara nga Gylen. Rreth gjysma e parave buron nga të ardhurat e vetë anëtarëve dhe gjysma tjetër e parave sigurohen nga pjesëtarët e familjeve të tyre si dhe nga bashkëpunëtorët e biznesit.

Mesatarja prej 10% e dhurimit të të ardhurave vlen jo vetëm për biznesmenët dhe profesionistët brenda qarqeve lokale, por edhe për punëtorët me jakë blu, në Stamboll, Bursa dhe në Mudanya. Shumë e këtyre pjesëmarrësve të lëvizjes së frymëzuar nga Gyleni, punojnë si shitës, punonjës biblioteke, administratorë lokalë, punëtorë të mirëmbajtjes dhe punonjës fabrikash. Paga mesatare vjetore e këtyre punëtorëve varion, por afërsisht shkon diku rreth 15,000-30,000 $ në vit. Megjithatë, ka ekzistuar një marrëveshje e përgjithshme që donacioni mesatar për anëtarët e qarqeve të ishte 10% për mjaft vite me rradhë. Nëse një individ nuk arrin të bëjë shumën monetare të kontributit prej 10%, ai premton se do të kërkojë kontribute nga të njohurit e tij për të plotësuar shumën e kërkuar. Një punëtor në Bursa na tregoi lidhur me ngjarjen e rregullimit të një vizite për shefin e tij, i cili nuk dinte asgjë rreth lëvizjes Gylen. Ai u dërgua për të vizituar Shqipërinë dhe për të parë nga afër një shkollë të frymëzuar nga Gyleni atje. Ai mbeti aq i impresionuar, sa që tani ai jep çdo vit një kontribut të rëndësishëm financiar për lëvizjen. Shumë prej njerëzve, të cilëve u është të kërkuar të kontribuojnë në projekte të veçanta, nuk janë nga rradhët e anëtarëve të lëvizjes të cilën financojnë rregullisht atë. Përkundrazi, ata vijnë nga rrethi familjar, miqtë dhe të njohurit jashtë lëvizjes të cilët janë të gatshëm për të mbështetur financiarisht studentët në nevojë apo projekte të vlefshme të shërbimit, sidomos gjatë muajit të Ramazanit, kur çdo mysliman

praktikues priret të forcojë vetëdijen e tij në fushën e bamirësisë.

Qarqet e punëtorëve janë të prirur më shumë të mbështesin nxënës nëpërmjet bursave, sesa të kontribuojnë në ndërtimin e shkollave pasi kjo e fundit përbën një "sipërmarrje madhore" në drejtim të burimeve financiare. Zakonisht kushton rreth 1.800 $ në vit për të qëndruar në një nga konviktet e lëvizjes Gylen, ndaj punëtorët mendojnë se mund ta përballojnë këtë lloj burse, qoftë vetëm apo me ndonjë anëtar tjetër të qarkut. Punëtorët ndihmojnë gjithashtu edhe anëtarët në nevojë që janë mes tyre. Nëpër lagjet e tyre ka edhe konvikte dhe anëtarët e qarqeve shpesh i njohin personalisht studentët në nevojë që banojnë nëpër këto konvikte. Gjithashtu, studentët i vizitojnë anëtarët dhe ua bëjnë me dije se kush ka nevojë për ndihmë. Shpesh fëmijët e anëtarëve të rrethit mund të qëndrojnë falas nëpër konvikte lokale dhe një mënyrë e tillë jetese është përkrahur shpesh dhe ka përparësi të mëdha, sepse klima që krijohet aty është më e favorshme për studim dhe për krijimin e miqësive të reja të cilat preferohen mjaft nga prindërit e tyre.

Një praktikë interesante në të gjitha qarqet lokale në të cilat kemi kryer intervista, ka qenë ai i premtimit vjetor të shpallur publikisht nga ana e një anëtari të lëvizjes për mbështetjen e projekteve të frymëzuara nga Gyleni. Ndërsa vihej një theks i madh në faktin se kontributet janë plotësisht vullnetare dhe se respekti tregohet në rrethana të veçanta, të intervistuarit pranuan se ekziston një konkurrencë midis anëtarëve të një qarku të caktuar në lidhje me sasinë e parave që secili mund të dhurojë. Kjo dukuri ishte veçanërisht e dukshme ndër donatorët më të pasur, të cilët shpesh sfidonin njëri-tjetrin për të rritur zotimet e tyre. Megjithatë, krahas ndjenjës së konkurrencës, disa prej pjesëmarrësve thanë se të dëgjuarit se një koleg i cili ka afërsisht të njëjtat të ardhura, është duke u zotuar të dhurojë një sasi të dhënë parash, shërben si motivim për të bërë të njëjtën gjë edhe vetë. Një inxhinier tha:

"Ekziston një ndjenjë konkurrence. Ne në përgjithësi e dimë se me çfarë merret secili nga ne dhe mund të bëjmë krahasime. Kur unë shoh se ai tjetri dhuron 10% të të ardhurave të tij, kjo më inkurajon edhe mua të bëj të njëjtën gjë.

Ndodhen rreth 50 grupe lokale dialogu ndërfetar në Shtetet e Bashkuara, të cilat përbëhen nga individë që janë të frymëzuar nga mësimet dhe jeta e mendimtarit turk.[9] Këto grupe janë të pavarura nga pikëpamja organizative, edhe pse anëtarët e të gjithë grupeve të mund ta njohin njëri- tjetrin dhe të ndajnë së bashku idetë dhe projektet në mënyrë jozyrtare. Instituti i Dialogut Ndërfetar për Paqe Botërore (IID) është themeluar në gusht 2002 në Austin, Texas. Një vit më vonë selia e tij u zhvendos në Houston. IID organizon aktivitete në më shumë se 16 qytete në shtetet jugore, duke përfshirë Teksasin, Luizianën, Oklahoman, Kansasin, Arkansasin dhe Misisipin. Qëllimi i këtij institucioni jofitimprurës, ashtu si dhe të tjerët në të gjithë Shtetet e Bashkuara, është që të promovojë dialogun dhe mirëkuptimin ndërfetar.

Për të arritur këtë qëllim, instituti organizon dhe mbështet aktivitete të shumta në të gjitha qytetet në të cilat ajo ka anëtarë. Këto aktivitete përfshijnë një darkë vjetore ndërkomunitare në Ramazan, një darkë vjetore ndarjeje çmimesh për të nderuar njerëzit në komunitetet lokale të cilët japin kontribute të mëdha për dialogun ndërfetar, seminare gjatë gjithë vitit, një analizë vjetore dhe udhëtime të shumta në emër të dialogut ndërfetar në Turqi. Këto aktivitete mbështeten financiarisht nga kontributet e vullnetarëve të angazhuar në punët e institutit, nga myslimanë shumica e të cilëve turq, të cilët janë frymëzuar nga mësimet e z. Gylen. Shumë prej tyre janë studentë turq të cilët ndjekin universitetet në shtetet jugore në SHBA, edhe pse ekziston një pjesë e vogël biznesmenësh dhe profesionistësh që janë të përfshirë gjithashtu në projektet e lëvizjes.

Bazuar në modelin turk të qarqeve lokale që mbështesin projekte

të frymëzuara nga Gyleni, një përqindje e madhe e buxhetit të IID-së sigurohet nga kontributet relativisht të vogla nga ana e mbi 500 turqve dhe turko-amerikanëve që jetojnë në shtetet jugore të SHBA-ve dhe të cilët mbështesin projektet e IID-së. Rreth gjysma e këtyre mbështetësve janë studentë vendas. Në vitet e para të funksionimit të IID-së, buxheti i saj vjetor ka qenë nën 25,000 $. Deri në vitin 2006 ai u rrit në $ 500.000 dhe në vitin 2008 IID grumbulloi gati 1.000.000 $ në vit nëpërmjet donacioneve. Rreth 80% e tyre vjen nga komuniteti lokal turko-amerikan dhe pjesa e mbetur prej 20% nga komuniteti lokal jomysliman.

Një numër i madh studentësh universitarë, shumica prej të cilëve që jetojnë me anë të bursave të vogla që vijnë nga Turqia ose nga universitetet e tyre amerikane, zotohen të dhurojnë nga 2,000-5,000 $ çdo vit, edhe pse një premtim i tillë do të thotë një sakrificë e madhe nga ana e këtyre studentëve. Nuk është diçka e pazakontë për një student me një bursë prej 1500$ në muaj që të dhurojë 100-150$ në muaj për IID-në, që përbën afërsisht 10% të të ardhurave të tij apo të saj. Disa prej studentëve bëjnë edhe një punë të dytë, në mënyrë që të kontribuojnë me ca para më tepër për aktivitetet e IID-së. Dhe shumë prej tyre shohim përpara drejt periudhës së pasdiplomimit, duke shpresuar për punë të mira dhe për të qenë në gjendje, kështu për të kontribuar me më shumë të ardhura në këtë aspekt. Siç m'u shpreh një student: "Të jesh një student universiteti, krijon vështirësi për të dhuruar shuma të mëdha, por shpresojmë se pasi të jem diplomuar, unë do të jem në gjendje për të bërë donacione më të mëdha dhe më të efektshme."

Afërsisht 50% e anëtarëve IID janë profesionistë dhe biznesmenë në komunitet, shumë prej të cilëve kanë përfunduar shkollimin në Shtetet e Bashkuara dhe kanë zgjedhur për të punuar atje për momentin. Janë kontributet e këtyre individëve ato që përbëjnë përqindjen më të madhe të të ardhurave IID-së. Një biznesmen lokal, për shembull, i cili është me profesion inxhinier dhe ka bërë

disa investime në fushën e pasurive të patundshme, dhuron 50,000-70,000$ çdo vit për projektet e IID, shumë e cila përbën rreth 40% të të ardhurave të tij. Ai i vetëm financon çdo vit një darkë iftari. Në vitin 2006 ai gjithashtu ka paguar biletat për 12 amerikanëve të cilët shkuan të vizitonin Turqinë në një udhëtim me karakter dialogu ndërfetar të sponsorizuar nga IID. Ai shpreh keqardhje që agjenda e tij tepër e ngarkuar e pengon atë të përfshihet plotësisht në aktivitetet e IID-së, megjithatë, ai mendon se ai mund të japë një kontribut në projektet e IID-së duke ofruar një ndihmë të konsiderueshme financiare. Përveç kësaj, ai bashkohet me shokët çdo javë në *sohbet* (kështu quhen mbledhjet e grupit) për të diskutuar idetë e z. Gylen si dhe për t'i vënë në zbatim ato nëpër projekte lokale.

Ndërsa në literaturën organizative është vënë theksi në rëndësinë e parave dhe legjitimitetin si burimet bazë për një punë të suksesshme, disa teoricienë thonë se punës vullnetare nuk i është kushtuar e njëjta vëmendje. Shumëçka, që nga nga nxitja për veprim e deri tek puna për mbarëvajtjen e aktiviteteve ditë pas dite, veprime të cilat e shtyjnë një lëvizje drejt qëllimeve të saja, varen nga puna e anëtarëve të lëvizjes. Decentralizimi i autoritetit dhe një strukturë ku detyrat merren përsipër nga komitetet e vullnetarëve, rrit gjallërinë e lëvizjes.[10] Ky fakt është i dallueshëm si në IID, ashtu edhe në grupet e tjera lokale të Gylenit. Kontributet e drejtpërdrejta financiare nuk pasqyrojnë një tablo të plotë të donacioneve për projektet e Gylenit. Pjesëmarrësit dhurojnë kohë, mund dhe ushqim për aktivitete të ndryshme të sponsorizuara nga IID. Për shembull, shpeshherë organizohen mjaft darka dhe kokteje nga ana e IID-së. Grave të organizatës u kërkohet vazhdimisht që të përgatisin ushqime turke për këto tubime, si për të voglat ashtu edhe të mëdhatë, dhe as kostoja e ushqimit, e as ajo punës së kryer në përgatitjen e tyre nuk kompensohet financiarisht. Projektimi dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, hartimi i fletëpalosjeve dhe broshurave, krijimi i videove që lidhen me aktivitetet e IID-së, organizimi i eventeve, organizimi

i udhëtimeve me karakter ndërfetar në Turqi, pritja e njerëzve nga komunitetet e tjera fetare nëpër shtëpitë e tyre gjatë muajit të Ramazanit dhe krijimi i rrjeteve ndërfetare brenda komuniteteve, të gjitha këto mundësohen nga veprimtaritë mbi baza vullnetare të anëtarëve të lëvizjes. Nuk është diçka e pazakontë për shumë anëtarë të IID-së që të shpenzojnë 20-30 orë në javë në aktivitetet e lëvizjes Gylen, dhe shumë prej këtyre pjesëmarrësve të lëvizjes janë studentë me kohë të plotë nëpër universitetet lokale. Nëse këto aktivitete do të konvertoheshin në para ose nëse ato do t'i llogarisnim në aspektin e kostove, donacionet nga anëtarët e IID-së do të rezultonin të konsiderueshme.

Disa teoricienë lëvizjesh sociale argumentojnë se një strukturë e formalizuar me një ndarje të qartë të punës çon në një lëvizje më të suksesshme dhe se një strukturë vendimmarrjeje e centralizuar rrit efektivitetin në detyrë dhe mobilizimin e burimeve.[11] Megjithatë, studimet e tjera tregojnë se marrëveshjet burokratike janë më pak të efektshme në terren, dhe se mobilizimi i pjesëmarrjes dhe strukturat e decentralizuara janë më të suksesshme në motivimin dhe përfshirjen e anëtarëve pjesëmarrës në lëvizje.[12] Në rastin e lëvizjes Gylen, autoriteti i decentralizuar dhe struktura administrative promovon përfshirjen e anëtarëve dhe ndjenjën e përgjegjësisë nga ana e miliona pjesëmarrësve, të cilët e identifikojnë interesin personal në arritjet e lëvizjes.

Motivet që shpien në ofrimin e kontributeve financiare

Kur u pyetën se përse ata dhurojnë çdo vit nga 1.000.000 $ apo më shumë për projektet e lëvizjes, grupi i biznesmenëve në Stamboll dha arsyet e mëposhtme: për t'i kontribuar në përmirësimin e humanes brenda qenieve njerëzore siç na inkurajon z. Gylen, për të edukuar të rinjtë tanë, për të kënaqur Zotin, për të fituar një shpërblim në jetën tjetër, për të qenë pjesë e një lëvizje të madhe që

do t'a bëjë botën më të mirë, për të siguruar shpresë për popullin tonë në Turqi si dhe në mbarë botën. Dy prej biznesmenëve që kishin qenë në mesin e anëtarëve të parë të lëvizjes, kishin dëgjuar predikimet e z. Gylen qysh në vitet '70 dhe kishin mbetur shumë të impresionuar nga idetë e tij; pastaj ata ishin bërë së bashku me biznesmenë të tjerë lokalë për të parë se çfarë mund të bënin për të përmbushur vizionin e atij mendimtari.

Presidenti i një kompanie të madhe prodhuese të tekstilit tha se ai është i motivuar nga idetë e zotit Gylen rreth shërbimit.

"Ne kemi krijuar lidhje me njerëzit e lëvizjes dhe kjo na motivon që të angazhohemi me projekte të ndryshme. *Cilat janë projektet e mia të preferuara? Ajo që e* kënaq më së shumti zemrën time është se unë mund të konstatoj me bindje*, se këta studentë,* të cilët përfundojnë shkollën, dhe zënë poste drejtuese, do të bëhen njerëzit e drejtë të së nesërmes në qeveri dhe në *dikastere të tjera. Kur shoh këta ish-studentë në këto pozicione, unë ndihem mjaft i kënaqur. Unë po konstatoj se shoqëria dhe qeveria ime* është duke u përmirësuar në aspektin e drejtësisë dhe të *çlirimit nga korrupsioni."*

Një biznesmen i pasur në Stamboll, i cili është një kontribues i rëndësishëm i lëvizjes, rrëfeu historinë e fondit të parë të ngritur të ndërtimin e shkollës së parë të frymëzuar nga Gyleni, një ngjarje kjo në të cilën z. Gylen mbajti një fjalim mbresëlënës. Ai tha se ishte e rëndësishme për të ndihmuar studentët në nevojë dhe pastaj dha shembuj historikë nga jeta e Profetit dhe shokëve të Tij. Në ato momente unë pashë njerëz që nënshkruanin çeqe, që jepnin të holla dhe ofronin unaza dhe byzylykë prej ari në vend të parave. "Unë u ndikova thellë nga ajo skenë që pashë, kështu që e ndieva veten mjaft këndshëm që të dhuroja menjëherë dhe bujarisht. Nga ky impakt i parë, mendova se kjo ishte diçka, pjesë e së cilës kisha kërkuar me kohë që të isha. Unë pastaj vërejta

sukseset e projekteve dhe u bëra më pas edhe pjesë e lëvizjes." Ai vijoi ta artikulonte me shembuj të tjerë mendimin e tij duke paraqitur raste të tjera në lidhje me procesin e dhurimit që ndikuan mbi atë vetë. Ai kishte parë punëtorët me jakë blu së bashku me familjet e tyre, të cilët megjithëse fitonin shumë pak, ia dedikonin çdo muaj 20% të të ardhurave të tyre lëvizjes, me qëllim për të financuar ndoshta gjysmën apo një të katërtën e një burse për një student në nevojë. Ai e kuptoi se këta njerëz ndoshta mund të përdornin transportit publik për të udhëtuar, por megjithatë jepnin para për të ndihmuar studentët. Më vonë ai u përfshi në takimet për gjenerimin e fondeve dhe e pa me sytë e tij atë çfarë njerëzit ishin duke bërë për të mbledhur para për disa projekte të frymëzuara nga Gyleni; ata dhuronin çelësat e makinave të tyre, orët e tyre të arta të dorës dhe gratë e tyre ofronin bizhuteri për të mbështetur financiarisht studentët. Një person në Izmir gatuante pite dhe i shiste ato me një makinë dore, për të mbledhur para për të ndërtuar një konvikt në një qytet të vogël fqinj. Sa më shumë bëhej dëshmitar i të tillë shembujve të bujarisë, aq më i fortë ishte motivimi i tij për të bërë pjesën që i takonte, për të mbështetur projektet e vyera. Ai mori një angazhim për të përdorur një të tretën e të ardhurave të tij për të çuar më tej biznesin, një të tretën për të mbajtur familjen, dhe një të tretën e mbetur për të sponsorizuar projektet e Gylenit.

Një inxhinier, kur u pyet përse ai dhuronte 10% të të ardhurave të tij vjetore për lëvizjen, tha: "Nuk ka asnjë arsye tjetër përveç kënaqësisë së Zotit. E kundërta e saj do të ishte të punuarit vetëm për vete, pra lakmia. Dhe ne pjesëtarët e lëvizjes Gylen, - vazhdoi ai, jemi të përkushtuar në frymën e shërbimit ndaj njerëzimit të cilin na e mësoi mësuesi ynë.

Punëtorët me jakë blu ishin të frymëzuar nga fakti që Gyleni u dukej mjaft origjinal, dhe siç u shpreh një punëtor: "Unë kam mbetur i impresionuar kur kam dëgjuar që ai nuk predikon kurrë

një gjë të cilën ai nuk e ka bërë vetë." Një tjetër punëtor tha se ai vërente luftën për para dhe gabime të mëdha nga ana e grupeve të tjera në shoqëri, por në Gylenin ai vërente vetëm dashuri dhe gjëra pozitive. Ai gjithashtu pëlqente faktin se z. Gylen nuk kishte mjekër të madhe si disa prej imamëve dhe se ai u mëson se Turqia dhe gjeografia islame duhet të përqafojnë shkencën, modernitetin dhe globalizimin. Një tjetër punëtor shprehu faktin se ai kishte pasur dëshirë të shkollohej, por nuk kishte patur mundësi. Ai mendonte se tani është duke bërë diçka për të ndihmuar dikë tjetër të shkollohej.

Në disa prej qarqeve lokale, kam dëgjuar njerëzit të shprehin faktin se çdo gjë që Zoti u ka dhënë është mirë të ndahet dhe se Zoti dëshiron që njerëzit të jenë bartës të ndarjes së pasurive. Siç u shpreh një punëtor: "Ne kemi parë edhe të tjerë në të kaluarën, të cilët kanë qenë altruistë dhe kanë ndarë me të tjerët ato që u ka dhuruar Zoti, kështu që ne vetëm ndjehemi të përulur në lidhje me ato ç'kemi mundësi të bëjmë.

Ekziston një traditë turke, e cila nxit veçimin e donatorëve nga marrësit në mënyrë që të mos lindë një ndjenjë detyrimi ndaj bamirësit nga ana e përfituesit të ndihmës. Gjithashtu, dhënësi është parë gjithmonë thjesht si një transferues i pasurisë së dhuruar nga Zoti dhe jo si një garantues mëshire. Një biznesmen në Bursa, i cili dhuroi tokën për një ndërtesë shkolle nuk i dërgoi fëmijët e tij në atë shkollë, në mënyrë që ai të mos e përziente interesin personal me të bërët e veprave të mira. Një person tjetër komentoi: "Ne nuk duam të dimë shumë detaje në lidhje me ata nxënës që ne mbështesim, të cilët përfitojnë bursa, për shkak se kjo gjë do të merrte ngjyrime personale. Përkundrazi, ne të dhurojmë për një "rezervuar", i cili ndihmon nxënësit në nevojë, por askush nuk e di se kush po e mbush atë. Megjithatë, disa prej nesh janë në kontakt me studentët që marrin ndihmë, kështu që ne në përgjithësi e dimë se si janë duke u përdorur paratë tona."

Biznesmeni 48 vjeçar nga Stambolli kishte për të thënë këtë: "Njerëzit në lëvizjen Gylen i kanë kthyer idetë e tyre në projekte, ata tregojnë se si mund të kthehen përpjekjet në sukses. Njerëzit besojnë tek ata, nëse ata kërkojnë sukses në një projekt, e presin atë nga Krijuesi, dhe jo nga krijesat, dhe kjo është arsyeja pse unë besoj se ata do të arrijnë gjithmonë suksese. Nëse dikush nga lëvizja vjen në qytetin tim dhe kërkon ndihmë, unë bëj përpjekjet e mia më të mëdha për ta ndihmuar atë dhe i inkurajoj edhe miqtë e mi përreth meje për të bërë të njëjtën gjë." Ai vijoi duke thënë, se një bujari e tillë bërë nën frymën e shërbimit ndaj Krijuesit, duke u shërbyer kështu njerëzve në nevojë, dhe se shpeshherë rezultati i një akti të tillë është zhvillimi dhe forcimi i mëtejshëm i lidhjeve shpirtërore midis dhuruesve. Siç pohon Çetin:

"Pjesëmarrja në shërbim merr forma relativisht permanente të rrjeteve. Individët shkojnë e vijnë dhe zëvendësojnë njëri-tjetrin, por projektet janë gjithmonë atje dhe vijojnë pa ndërprerje. Nevojat individuale dhe qëllimet kolektive nuk janë reciprokisht përjashtuese; ato janë një dhe e njëjta gjë. Këto dy karakteristika të Lëvizjes Gylen përputhen dhe ndërthuren ngushtë me njëra-tjetrën në jetën e përditshme... Pjesëmarrja në shërbimet rreth një qëllimi të veçantë dhe prekshmëria e produkteve, ushqen dhe forcon solidaritetin."[13]

Një inxhinier tha se njerëzit bëjnë një investim të parave të tyre në këtë botë dhe pastaj marrin një shpërblim në jetën e përtejme në qoftë se ato para janë investuar siç duhet. Ai mendon se studentët, bëjnë një investim të madh për jetën e tyre dhe ai dëshiron t'i ndihmojë ata ta bëjnë këtë investim në mënyrë të tillën që ata të mund ta jetojnë jetën në mënyrë produktive, të fitojnë shpërblime dhe pasi të jenë shkolluar, të ndihmojnë të tjerët për të bërë një investim të tillë në mënyrë që të fitojnë parajsën e përjetshme.

Ndërsa suksesi personal monetar nuk përbën një motivim edhe aq stimulues për të dhuruar, një numër i madh i të intervistuarve

të të gjitha niveleve socio-ekonomike, mbështesnin idenë se donacionet për projekte të vlefshme sjellin shpërblime materiale edhe më të mëdha për dhuruesit; bizneset nxjerrin fitime edhe më të mëdha dhe punëtorët përfitojnë rritje pagash apo ngritje profesionale. Këto suksese shihen si bekime të Zotit mbi ata që dhurojnë. Siç tha një punëtor: "Kur dikush jep për bamirësi, ai njeri përjeton bollëk në të ardhurat e veta; Zoti i garanton atij begati."

Konfidenca dhe besimi në projektet e frymëzuara nga Gyleni

Në çdo qark lokal në të cilin kam kryer intervista, anëtarët kanë shprehur besimin e tyre në lidhje me mënyrën se si përdoren donacionet e tyre. Në mënyrë të përsëritur, të intervistuarit thoshin se ata kurrë nuk shqetësoheshin se si ishin duke u përdorur paratë e tyre, sepse ata e dinin se ky proces kryhej me korrektësi. Një koment mjaft i shpeshtë në lidhje me këtë çështje ishte: «Ne shohim rezultatet.» Me këto fjalë ata donin të thoshin se shihnin studentët të cilët ishin duke marrë një trajnim të kualifikuar akademik nëpër shkollat dhe kurset përgatitore. Ata i shihnin rezultatet e projekteve tek nxënësit e dalë nga shkollat e frymëzuara nga Gyleni, të cilët kanë qenë përherë në krye të vlerësimeve nga ana e universiteteve, si në Turqi ashtu edhe jashtë vendit. Shumë prej tyre bëhen anëtarë të lëvizjes; shpeshherë kjo ndodh kur ata janë në universitet. Gjithashtu është diçka e zakonshme për disa njerëz të qarqeve vendore për të udhëtuar në vendet e Azisë Qendrore dhe në vende të tjera ku ka shkolla të frymëzuara nga Gyleni, dhe të shohin me sytë e tyre kontributin që këto shkolla janë duke dhënë. Mbështetësit e lëvizjes dëgjojnë gjithashtu edhe historitë e pacientëve, të cilët janë trajtuar në spitalet e frymëzuara nga Gylen, të cilët kanë mbetur shumë të kënaqur me trajtimin e tyre human nga ana e mjekëve dhe personelit. Rrëfimet e shumë njerëzve në nevojë, të cilët janë ndihmuar nga shoqata bamirëse *Kimse Yok Mu?*, (*gj. shq.* A nuk ka njeri?) rishprehen nëpër qarqet

vendore dhe promovohen nëpër media. Në mënyrë që komunitetet e frymëzuara nga Gyleni të mbajnë një shkallë më të lartë të komunikimit përmes *sohbeteve* dhe qarqeve mediatike, historitë e suksesit të projekteve të frymëzuara nga Gyleni, janë thënë dhe rithënë në mënyrë të përsëritur, duke siguruar njëkohësisht se të hollat e dhuruara nga kontribuesit e tyre, janë duke u shpenzuar në mënyrë efikase, dhe sigurojnë një rezultat të prekshëm.

Pjesëmarrja e anëtarëve në lëvizje

Shumë pjesëmarrës në lëvizje së pari dëgjojnë rreth saj kur qëndrojnë nëpër konvikte, kur ndjekin universitetin së bashku me njerëzit pjesëmarrës në lëvizje ose shkojnë tek ndonjëri prej kurseve përgatitore. Të tjerët kanë dëgjuar rreth saj nëpërmjet familjes ose miqve. Për shembull, një biznesmen në Stamboll kishte një vëlla që studionte Mjekësi, i cili kur ishte në shkollë të mesme, e ftoi atë në Ankara. Ai ndenji për disa ditë së bashku me 20 nxënës të shkollave mjekësore në një nga konviktet e lidhura me lëvizjen Gylen. Ai menjëherë e vuri re se këta studentë ishin ndryshe nga studentët e universiteteve të tjera në aspektin e vlerave të tyre, aspiratave dhe qëndrimeve ndaj njëri-tjetrit. Ai dha si shembull një rast kur kishte fjetur deri vonë në mëngjesin e parë dhe njëri nga studentët qëndroi me të për t'i përgatitur një mëngjes mjaft të shijshëm përpara se të shkonte për në shkollë. Ai u ndikua mjaft nga ky grup dhe kërkoi të dijë se çfarë i kishte frymëzuar ata që të jetonin së bashku në konvikt. Ai mësoi se shumë prej tyre përfitonin bursa për të qëndruar atje, të financuara nga biznesmenë lokalë. Kur u bëra biznesmen, - thotë ai, m'u kujtua kjo përvojë e imja dhe dëshiroja të isha pjesë e lëvizjes duke u bërë një sponsor për studentët në nevojë.

Ashtu si shumë të tjerë nga ata që kam intervistuar, një inxhinier kishte dëgjuar për herë të parë rreth lëvizjes Gylen në universitet.

Ai ishte duke reflektuar mbi jetën e tij dhe duke u përpjekur për të gjetur kuptimin e saj. Kushëriri i tij e futi atë në një ambient me njerëz të frymëzuar nga Gyleni, të cilët ishin studentë në universitet dhe jetonin së bashku në një fjetore. Ai u bashkua me ta dhe u bë pjesë e komunitetit të tyre.

Të tjerë inxhinierë brenda grupit, ashtu si edhe një numër mjekësh të cilët i intervistova, ishin njohur së pari me lëvizjen Gylen në kohën kur kishin ndjekur kurse përgatitore nëpër qytete të ndryshme në Turqi. Një inxhinier për shembull, ishte në kërkim të shoqërisë intelektuale në jetën tij dhe këtë nuk kishte mundur ta gjente në grupet rinore nacionaliste të cilëve u përkiste. Ai u shpreh: "Kur u njoha me njerëzit e frymëzuar nga Gyleni në kurset përgatitore, unë gjeta tek ata gjithçka që po kërkoja. Unë gjeta fenë, nacionalizmin, shkencën, intelektualizmin dhe një këndvështrim të cilin unë e mbështes." Ai pastaj kishte dëgjuar të fliste z. Gylen. Ai u bërë thirrje të gjithëve për të mos luftuar, por për të kuptuar njëri-tjetrin. Ai tha se ne jemi që të gjithë qenie njerëzore në të njëjtën anije. Po të bëheni nacionalistë, - thoshte ai, të gjithë do të bëhen armiqtë tuaj. Kur dëgjoni z Gylen, ju e kuptoni se të gjithë njerëzit janë me të vërtetë vëllezër, në të njëjtën gjatësi vale. Ai na tregoi se si të krishterët, hebrenjtë dhe myslimanët, që të gjithë vijnë nga rrënjë të njëjta. "Z. Gylen na i hapi sytë për të parë se ne jemi miq me njerëz të tjerë. Përpara se t'i shohim ata si njerëz të ndryshëm nga ne, ai na ka mësuar që t'i shohim si të ngjashëm me ne." Ai vijoi duke thënë se ne mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin, madje edhe në karrierën dhe bizneset tona, dhe se ne duhet të mendojmë në mënyrë globale dhe t'i nxisim miqtë tanë të shkojnë edhe jashtë vendit dhe jo të përqendrohemi vetëm në Turqi.

Një punëtor fabrike ishte regjistruar në Stamboll në një kurs përgatitor për në universitet të sponsorizuar nga shteti, por pa se studentët të cilët kanë përfunduar kursin nuk ishin shumë të suksesshëm dhe me rezultate mjaftueshëm të larta të për të hyrë

në universitet. Një ditë ai u takua me disa studentë të cilët ishin regjistruar në një kurs një prej qendrave të kurseve përgatitore, që i përkiste lëvizjes Gylen, dhe të cilët ishin shumë më seriozë në lidhje me objektivat e studimit dhe marrjes së një arsimi cilësor, kështu që ai u transferua në atë kurs. Atje ai nisi t'i njihte dhe të respektonte anëtarët e lëvizjes Gylen, veçanërisht mësuesit e kursit, të cilët ishin shumë të përkushtuar dhe kalonin kohë me nxënësit përtej orarit formal të mësimdhënies nëpër klasat ku jepnin mësim. Ai dëshironte të dinte se çfarë i motivonte aq shumë ata për të punuar dhe filloi të bisedonte me ta në lidhje me Fethullah Gylenin dhe idetë e tij. Ai mbeti shumë i impresionuar dhe dëshironte të bëhej si ata.

Përpjekjet e përgjithshme

Një gjetje e madhe empirike e studimit të Kanter-it rreth utopive amerikane, që ka ndikuar më pas në literaturën e botuar rreth kësaj çështjje, është se për t'i mundësuar një komuniteti për të mbijetuar, tri janë sfidat themelore të angazhimit të cilave duhet t'u jepet zgjidhje.[14] Së pari, individët shohin se sa mbështeten interesat e tyre nga pjesëmarrja në grup.[15] Së dyti, individët ndiejnë një solidaritet emocional me pjesën tjetër të grupit[16] dhe së treti, individi përjeton një autoritet moral, transhendent brenda grupit.[17] Këto mekanizma mund të përmblidhen si strategji me anë të së cilës grupi bën përpjekje për të zvogëluar vlerën e angazhimeve të tjera të mundshme dhe rrit vlerën e angazhimit brenda tij, me fjalë të tjera, kryen shkëputjen e personave nga opsionet e tjera duke ia bashkëngjitur atë komunitetit. Në veçanti, studimi i Kanter-it paraqet një korrelacion pozitiv midis sakrificës dhe investimit në drejtim të gjenerimit të angazhimit. Sa më të kushtueshme sakrificat, aq më e madhe është vlera që i jep individi qëllimeve të grupit. Të dhënat paraqitura në këtë libër mbështesin tezën e Kanterit duke treguar se kontributet financiare të projekteve

të frymëzuara nga Gyleni, tregojnë jo vetëm besimin e shfaqur në qëllimet e lëvizjes, por fakti i donacioneve personale, shërben edhe si një mekanizëm angazhimi për përfshirjen në grup.

Në konceptin e Kanterit, objektivat e grupit ndërthuren me ndjenja vetjake të qëllimit dhe kuptimit të jetës. Objektivat e grupit ushqejnë ndjenjën e egos vetjake dhe grupi shndërrohet kështu në një zgjatim të vetvetes, pra duke lidhur në mënyrë të pazgjidhshme personin dhe grupin, duke plotësuar kështu sfidën e pari themelore të Kanterit për mbijetesë dhe sukses brenda grupit. Intervistat me mbështetësit brenba lëvizjes Gylen, demonstrojnë se ata i identifikojnë qëllimet e lëvizjes si qëllimet e tyre personale. Të qenët pjesë e lëvizjes Gylen, pjesëmarrja në qarqet vendore, si dhe dhënia e kontributeve në realizimin e projekteve të mbështetura nga lëvizja, është thelbësor për identitetin e tyre.

Lidhjet afektive që zhvillohen në grupin gjatë rrjedhës së punës së përbashkët në projekte të rëndësishme, plotëson sfidën e dytë organizative të Kanterit. Fakti që shumë qarqe lokale janë bazuar në individë të cilët ndajnë interesa profesionale ose të biznesit, e shton edhe më tej ndjenjën e solidaritetit të krijuar në grup. Sa më tepër një individ të jetë i integruar brenda një grupi, aq më e madhe do të jetë shkalla e pjesëmarrjes së tij apo të saj.[18] Pjesëmarrja është një shprehje e përkatësisë brenda një grupi të caktuar shoqëror dhe e marrjes së shpërblimeve individuale nga të qenët pjesë e kolektivit të madh. Gjithashtu, sa më intensive të jetë pjesëmarrja kolektive në një rrjet të marrëdhënieve, aq më i shpejtë dhe i qëndrueshëm do të jetë mobilizimi i radhëve të një lëvizjeje.[19] Lëvizja Gylen lehtëson dhe rrit kështu gatishmërinë e individit që të përfshihet në projekte të shërbimit nëpërmjet marrëdhënieve të tij apo të saj me njerëz të tjerë me ide të përbashkëta apo të ngjashme.

Sfida e tretë, ajo e përjetimit të një autoriteti moral dhe transhendent në grup, sigurohet nga diskutimet e vazhdueshme

rreth mësimeve të zotit Gylen, si dhe përmes seancave të bërbashkëta të leximt të pjesëve nga Kurani dhe haditheve të Profetit Muhamed. Kështu, qëllimet dhe motivet prapa projekteve të shërbimit kanë një kuptim shumë më të gjerë sesa vetëm të ndihmuarët e njerëzve të tjerë. Përkundrazi, ato janë të rrënjosura në nocionin se ato janë pjesë e krijimit të vazhdueshëm të Zotit dhe kujdesit për robtë e tij.

Kanter argumenton se një mekanizëm tjetër për angazhimin individual në jetën në grup dhe qëllimet e grupit është ai i sakrificës. Dhurimi i kohës dhe burimeve të një individi ndaj objektivave të grupit, tregon jo vetëm angazhimin në grup, por gjithashtu rrit edhe më shumë shkallën e angazhimit të tij. Meqenëse njerëzit në lëvizjen Gylen dhurojnë nga burimet e tyre personale për ekzistencën e grupit dhe projekteve të tij, akti i dhurimit sjell për pasojë intensifikimin e angazhimit ndaj grupit dhe idealeve të tij.

Janë idealet themelore islame ato të cilat i motivojnë anëtarët e lëvizjes Gylen të kontribuojnë me kohë, energji dhe donacione financiare në mënyrë që projektet e frymëzuara nga Gyleni të vihen në jetë, e në të njëjtën kohë, për të mundësuar një angazhim më të fuqishëm nga ana e individëve të lëvizjes. Një burim madhor i fuqisë së qarqeve lokale janë diskutimet e vazhdueshme të këtyre koncepteve duke u bazuar në Kuran, traditat profetike dhe veprat e z. Gylen. Qarqet, pra, bëjnë të mundur motivimin shpirtëror për aktin e dhurimit dhe janë shumë më tepër sesa thjesht institucione për sigurimin e të hollave për të ngritur këto objekte. Me vetëdije apo jo, struktura që ka evoluar në kuadër të lëvizjes Gylen, i ka rrënjët në parimet e shëndosha organizative, gjë që është reflektuar në rritjen e lëvizjes në mbarë botën.

[1] Të dhënat e këtyre intervistave janë përshkruar fillimisht në Ebaugh dhe Koç (2007).

[2] Başkan (2004).

[3] Tilly (1978); Oberschall (1973); Snow, Zurcher dhe Eckland-Olson (1980); McCarthy dhe Wolfson (1996); Melucci (1999).

[4] Shih kapitullin *Konkluzione* për një përshkrim të intervistave të zhvilluara nga ana ime me kritikët e lëvizjes Gylen.

[5] Çështja e grave në lëvizjen Gylen është studiuar në mënyrë më të hollësishme nga akademikë të tjerë jashtë lëvizjes, e sidomos nga studiues të mirëpërgatitur në fushën e kulturës turke, të cilët mund të sjellin një këndvështrim sistematik dhe joideologjik rreth temës në fjalë.

[6] Kalyoncu (2008).

[7] Fireman dhe Gamson (1979); Olson (1965); McCarthy dhe Zald (1977); Garner (1996); Melucci (1999); Della Porta dhe Diani (1999); Morris dhe Staggenborg (2004).

[8] Cetin (2010).

[9] Michels (2008).

[10] McCarthy dhe Wolfson (1996); Morris dhe Staggenborg (2004); Bryne (1997).

[11] Gamson (1975); McCarthy dhe Zald (1977); McCarthy dhe Wolfson (1996); Melucci (1999); Morris dhe Staggenborg (2004).

[12] Gerlach dhe Hines (1970); Curtis dhe Zurcher (1974); Jenkins (1983); Bryne (1996).

[13] Çetin (2010).

[14] Kanter (1968).

[15] Konovsky dhe Pugh (1994); Rioux dhe Penner (2001).

[16] Van Vugt dhe De Cremer (1999); Fine (1986); Jacobsen (1988).

[17] Hales (1993); Çetin (2008).

[18] Klandermans (1989).

[19] Melucci (1999).

KULTURA TURKO-ISLAME E BAMIRËSISË[4]

Në mënyrë që të kuptojmë siç duhet arsyet e shtysës dhe motivimit që qëndron pas angazhimit në projektet e shërbimit si dhe të mbështetjes financiare nga ana e miliona turqve për lëvizjen Gylen, është e nevojshme të kuptojmë fillimisht disa praktika kulturore-fetare në historinë turke që kanë lidhje me filantropinë dhe bamirësinë. Është e qartë se lëvizja e ka pasur zanafillën në Turqi dhe se aktivitetet e saj janë organizuar kryesisht nga qytetarët turq dhe nga turqit e diasporës në mbarë botën. Dijetarë të shumtë kanë nxjerrë si konkluzion, për mirë apo për keq, se lëvizja është e lidhur në mënyrë të pandashme me kulturën turke dhe me një kuptim specifik turk të Islamit.[1] Dijetarë të tjerë e kanë përshkruar gjerësisht këtë lëvizje si "dëshmitare e traditës në epokën moderne", dhe se është Islami turk ai që qëndron në zemër të traditës.[2] Prandaj është e pamundur, për të analizuar se çfarë i motivon turqit për t'u angazhuar aq bujarisht me aktivitetet e lëvizjes pa kuptuar më parë konceptet e bujarisë dhe mikpritjes të cilat janë virtyte të qenësishme në kulturën turke.

Një nga aspektet e lëvizjes Gylen që është diskutuar në media kohëve të fundit pa i kushtuar vëmendje të mjaftueshme kontekstit të tij kulturor-historik, ka qenë mënyra se si lëvizja e financon kapitalin e saj nëpër institucione dhe aktivitete. Krahas disa hulumtimeve shkencore të kufizuara rreth kësaj çështjeje, në disa gazeta dhe revista turke apo ndërkombëtare, stacione televizive dhe blogje thashethemesh, janë botuar ose transmetuar

[4] bashkëautore me Profesor Zekeria Baskal.

një numër akuzash rreth burimeve financiare të lëvizjes. Në themel të akuzave se lëvizja ka marrë ndihmë nga burime të tilla kontradiktore të huaja si CIA, Mosadi, Vatikani, Arabia Saudite, Irani, dhe Federata Ruse, qëndrojnë supozimet e kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë, se "shumë individë të cilët mbështesin institucionet dhe aktivitetet e lëvizjes, si financiarisht ashtu edhe nëpërmjet shoqatave vullnetare ose zyrtare, janë të motivuar nga qëllimi për të fituar pushtetin politik dhe për ta kthyer gjithë kombin turk apo botën në Islam radikal apo Katolicizëm. Megjithatë, të dhënat tona të nxjerra nga intervistat tregojnë se pothuajse të gjithë përkrahësit e lëvizjes, qofshin ato anëtarë myslimanë turq apo simpatizantë joturq, apo dhe jomyslimanë, janë të motivuar nga një thirrje mbi baza me të vërtetë filantropike për të dhuruar për bamirësi. Graham Fuller, ish-zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Zbulimit në CIA, shkencëtar politik për Korporatën RAND, dhe ekspert si për Lindjen e Mesme ashtu edhe për krejt botën myslimane, shpjegon për shembull se numri i shkollave të frymëzuara nga Gyleni është gjithnjë në rritje, në sajë të bujarisë së biznesmenëve të pasur që e shohin një akt të tillë jo vetëm si një formë e *zekatit* (dhënia e lëmoshës, si një mjet për të ndihmuar të varfrit dhe të ngratët), por edhe si realizimin e *ihsanit*, motivimit të thellë shpirtëror për të kthyer besimin e dikujt në vepra që kanë për qëllim përsosjen shpirtërore nëpërmjet "të bërit të gjërave të bukura." Ai më tej shton:

"...Lëvizja Gylen ka iniciuar një program pararojë përmes të cilit ka ndërtuar një rrjet prej qindra shkollash. Financimi vjen nga brenda komunitetit dhe nga biznesmenët e pasur, për të cilët ndërtimi i një shkolle është shndërruar në ekuivalentin modern të devocionit dhe angazhimit për të ndërtuar një xhami."[4]

Shpjegimi që Fuller i jep faktit se përse biznesmenët myslimanë turq janë kaq të etur për të financuar nismat edukative të lëvizjes,

mbështetet në koncepte specifike islame. Për këtë arsye, një eksplorim i shkurtër rreth kulturës së bujarisë dhe mikpritjes në Turqi, në veçanti, dhe në Islam në përgjithësi, do të hedhë dritë mbi çështje që lidhen me aktivitetet e lëvizjes së Gylenit, burimet e saj financiare, dhe motivimin e shumë njerëz të cilët kontribuojnë në këtë lëvizje në mënyra të ndryshme. Përbërësi më i rëndësishëm në çdo lëvizje altruiste sociale, duke përfshirë edhe lëvizjen Gylen, është dëshira e anëtarëve të saj për të dhënë nga koha, paratë, dhe energjitë e tyre, pa pritur në këmbim kurrfarë përfitimi material. Në këtë kapitull, ne kemi treguar se disa prej elementeve kryesore që përcaktojnë dhe ravijëzojnë karakteristikat e lëvizjes Gylen, të tilla si besimi dhe praktikimi i virtyteve si vetësakrifica, bamirësia dhe filantropia, janë të rrënjosura thellë në sfondin kulturor turko-islamik.

Virtyte si bujaria dhe mikpritja kanë rrënjë të thella historike në kulturën turke. Këto lloj traditash që lidhen me mikpritjen, bujarinë dhe bamirësinë mund t'i gjejmë në qytetërimet e Azisë Qendrore, andej nga e kanë prejardhjen turqit. Turqit nomadë që jetonin në Azinë Qendrore, e kanë pranuar Islamin që në shekullin e nëntë dhe të dhjetë. Ndër arsyet kryesore të pranimit të menjëhershëm të Islamit nga ana e këtyre turqve, ishte ekzistenca e shumë ngjashmërive midis mënyrës së tyre paraislame të jetesës, me vlerat, etikën dhe virtytet e tjera që përmban Islami. Me siguri, Islami e forcoi, e institucionalizoi dhe i shtoi një dimension shpirtëror kulturës turke paraislame, krahas ndërprerjes së disa praktikave të padëshiruara, ashtu siç ka ndodhur edhe gjatë ndërveprimit të feve të tjera të mëdha me kulturat lokale.

Disa zakone, praktika dhe tradita që i janë atribuar zakonisht Islamit, shumë mirë mund të jenë trashëguar nga kultura turke paraislame. Megjithatë, meqë Islami përmban zakone dhe tradita shumë të ngjashme, është e vështirë për të dalluar ato me prejardhje nga Islami dhe ato që rrjedhin nga kultura turke. Duke

pasur parasysh probabilitetin e lartë që traditat islame dhe ato të kulturës turke paraislame që janë të lidhura me bujarinë dhe mikpritjen të kenë pësuar mbivendosje, ne do t'i trajtojmë ato si një pjesë e pandarë e "kulturës turke" për gjithë pjesën e mbetur të kapitullit. Duhet gjithashtu të theksohet fakti se pikëpamjet dhe praktikat e urdhrave të caktuara fetare (për shembull, Urdhri Sufi *Mevlevije* i Konya-s) dhe produktet kulturore-fetare të tyre (për shembull, poema gjashtë-vëllimëshe e Mevlānā Xhalāl ad-Din Muhamed Rumiut, *Mesnevīje Ma'navī*) kanë qenë kristalizuar dhe janë identifikuar me normat kulturore të rajonit në një mënyrë të tillë saqë është e pamundur për t'i dalluar nga njëri-tjetri.

Një nga burimet më të rëndësishme të historisë së hershme turke është një tekst i quajtur *Rrëfimet e Dede Korkut*-it, i cili mendohet se është shkruar gjatë epokës heroike të turqve Oguzë në shekullin e tetë. Këto legjenda epike dokumentojnë tranzicionin e klaneve turke nga një shoqëri shamaniste në një shoqëri myslimane, si dhe vazhdimësinë e një kulture të shquar të mikpritjes dhe bujarisë. Për shembull, së bashku me traditat turqve Oguzë të konsumimit të alkoolit dhe mishit të kalit, zakone të cilat nuk janë të përhapura në mesin e myslimanëve të sotëm turq, ne gjejmë në fjalët e rrëfyesit përshkrimin një e një njeriu i cili bën thirrje për në namaz (ezanin) - "kur Persiani mjekërgjatë reciton thirrjen për në namaz," një akt ky i cili fuqimisht tregon se feja e re nuk ishte pranuar ende plotësisht si një element i qenësishëm i shoqërisë turke. Po kështu, nga të njëjtat rrëfime gjejmë të përshkruara në mënyrë të detajuar tubime sociale dhe ftesa për tubime, në të cilat kreu i klanit ose kryetari i familjes organizonte një gosti të madhe dhe shpërndante dhurata të shumta për të ftuarit. Në të vërtetë, turqit paraislamë kishin përcaktuar raste të shumta për festa, të tilla si lindjet, dasmat, ceremonitë e vendosjes së emrit, kthimi i anëtarëve të klanit nga një vend i huaj, ritualet e urimeve, si dhe ceremonitë e vdekjeve. Ndër praktikat e lashta turke të mbetura ende gjallë në Turqinë moderne janë ceremonitë e dasmave, vizitat

familjare për të kërkuar dorën e një vajze për martesë, si dhe therja e një kafshe (d.m.th. shtrimi i një gostie) për mysafirët. Shoqëria turke sot është e njohur për mikpritjen e saj (*misafirperverlik*). Në mënyrë të përsëritur, njerëzit që vizitojnë vendin dëshmojnë për ngrohtësinë e mikpritjes turke. Autori i librit *Tradita dhe Ndryshimi në një Qytet Turk,* e shpjegon këtë fenomen si më poshtë:

"Rëndësia e mikpritjes dhe bujarisë në mesin e turqve dhe popujve të tjerë të Lindjes së Mesme është e vështirë të mos theksohet. Çdo banor i lindjes së Mesme, i cili gëzon një reputacion për këto dy virtyte, është i respektuar dhe admiruar nga anëtarët e komunitetit të tij. Mysafirët në një shtëpi turke duhet të trajtohen si mbretër. Atyre u ofrohen vendet më të mira, ushqim dhe pije, dhe e gjithë familja e kthen vëmendjen e saj të plotë në përpjekjet për rehatinë e tyre... Nga ana tjetër, të ftuarit duhet të jenë jashtëzakonisht të sjellshëm dhe mirënjohës. Një nga format më të vlerësuara të falënderimit ndaj të zotëve të shtëpisë është fraza: "Allahu jua pranoftë [përpjekjet]," duke e vënë kështu theksin në faktin se bujaria dhe mikpritja janë virtytet e njerëzve të devotshëm."[5]

Në veprat e shumta antropologjike, mikpritja turke është marrë si e mirëqenë, dhe është interesante të theksohet se pak vëmendje i është kushtuar arsyeve të sjelljeve të mira të pjesës dërrmuese të anëtarëve të shoqërisë ndaj miqve si dhe detyrimeve të mikpritjes.[6] Edhe pse format e mikpritjes turke po ndryshojnë në zonat e industrializuara urbane, kjo edhe për shkak të ndryshimit të shprehive të punës dhe shpërndarjes demografike, mikpritja është ende një virtyt i cili mund të vërehet lehtë. Shumë nga shprehitë dhe besimet që ruajnë dhe nxisin kulturën e mikpritjes në Turqinë bashkëkohore, i kanë rrënjët e tyre në Islam, por edhe në kulturën nomade paraislame.

Në veprën *Rrëfimet e Dede Korkuitit* për shembull jepen shumë shembuj të mikpritjes turke. Kur një anëtar i klanit vdes, të afërmit

therin kuajt e tij dhe shtrojnë me mishin e tyre një drekë varrimi. Kur liderët e një grupi ishin gati për të marrë një vendim ose për të shpallur një njoftim që ndikonte në jetën e të gjithëve, ata i ftonin anëtarët fiseve të tyre për një darkë bujare dhe përgatisnin për ta flitë dhe duke ua shtruar në tryezë, nëpër pjata. Disa tregime përmbajnë referenca ku dënohen ose të paktën nënçmohen shtëpitë apo çadrat të cilat nuk i marrin mysafirët. Dede Korkuti, një njeri i urtë dhe i shenjtë i shoqërisë në atë kohë, thotë: «Çadrat e zeza në të cilat nuk vjen asnjë mysafir është më mirë të shkatërrohen.» Në këto histori, besohet se nëse një person ushqen të varfrit, kënaq mysafirët, ose shtron një gosti të madhe, dëshirat e tij do të plotësohen. Më poshtë jepet këshilla e një gruaje, burri i së cilës dëshiron një fëmijë, por nuk ka qenë në gjendje për të patur një të tillë prej shumë vitesh:

Rrite dhe lartësoje vetveten, hap çadrat shumëngjyrëshe
Ule fytyrën tënde në tokë. Theri të gjithë meshkujt tuaj
Hamshorët e kuajve, meshkujt e deveve, deshtë e deleve
Mblidhi rreth teje fisnikët Oghuz, të brendshëm dhe të jashtëm
Kur të shikosh të uriturin, ushqeje atë
Kur t'shikosh të zhveshurin, vishe atë
Çliroje borxhliun nga borxhi
Mblidhemishinderinëmajëtëkodrës,lëriliqenetequmështittërrjedhin
Bëj një festë të madhe, luti njerëzit çfarë të dëshirojnë
Pra, me gojën plot lutje, duke thurur lavde
Që Zoti të mund të na dhurojë një fëmijë të bukur. [7]

Të tjera shprehi dhe praktika të mikpritjes, mund të jenë gjithashtu mbetje të kulturës paraislame, edhe pse Islami mbështet një qëndrim të ngjashëm. Për shembull, nëse një i huaj troket në derë, ai ose ajo duhet të ftohen brenda, t'u kërkohet që t'u jepet

ushqim i mjaftueshëm dhe strehim për tri ditë, dhe vetëm në përfundim të tri ditëve duhet t'i kërkohet shkaku i vizitës. Ky hark kohor prej tri ditësh është përcaktuar si nga folklori gojor turk, nga fjalët e urta të përbashkëta, ashtu edhe nga traditat e ndryshme gojore rreth jetës, zakoneve dhe praktikave (haditheve) të Profetit Muhamed. Për më tepër, turqit e quajnë një mysafir të panjohur paraprakisht si një «mik dërguar nga Zoti" (*Tanrı misafiri*).

Përdorimi i fjalës specifike turke *Tanrı*, ndryshe nga e barazvlerëshmja e saj në arabisht apo persisht, tregon mundësinë që fjala e përdorur për emërtimin e një mysafiri të papritur, është trashëguar që nga periudha paraislame. Në të vërtetë, kur në *Rrëfimet e Dede Korkutit* femrat klasifikohen në tri kategori, duke iu përshkrua karakteristikat e tyre përkatëse, aty vlerësohet më së shumti tipi i gruas e cila strehon dhe ushqen mysafirë, edhe nëse burri i saj nuk ndodhet në shtëpi. Kjo praktikë u aprovua më vonë edhe nga feja - megjithëse me disa kufizime në lidhje me ndarjet fizike të hapësirës në shtëpi, veshjet e burrave dhe grave, të folurit dhe sjellja në shoqërinë e përzier - dhe ka vazhduar të ekzistojë si pjesë e kulturës turke deri në ditët tona. Megjithatë, është gjithashtu e mundur që ajo të rrjedhë nga një referencë kuranore për rastin e Profetit mikpritës Ibrahim me tre mysafirët "e panjohur", të cilët më pas doli të ishin kryeëngjëlli Xhebrail dhe dy engjëj të tjerë, të cilët i sollën atij sihariqin për lindjen e një djali nga gruaja e tij, Sara, dhe e paralajmëruan atë për shkatërrimin e Sodomës dhe të Gomorës, përveç Lutit nipit të tij dhe një pjesë të vogël të besimtarëve. Motivimi fetar për pranimin me mirësjellje të miqve të papritur, udhëtarët, apo edhe të huajve të cilët trokasin në derën e dikujt, është shprehur edhe në një proverb, i cili thotë se "çdo person duhet t'a konsiderojë çdo natë si Nata e Kadrit, dhe çdo person që i vjen në derë si Hizrin" *("Her geceyi Kadir, her geleni de Hızır bil")*. Kjo fjalë e urtë i referohet figurës së Hizrit, një shenjti apo profeti mysliman, i cili besohet se shfaqet në rast nevoje, dhe të cilit i janë dhënë njohuri të veçanta për të fshehtën, dhe shpirti

i të cilit ka qenë i njohur për shkak të shfaqjes së tij individëve të devotshëm në tokë, pra turqit janë të inkurajuar për t'i trajtuar të huajt që trokasin në dyert e tyre, ashtu siç do të trajtonin një shenjt po t'i vizitonte. Proverbi gjithashtu sugjeron se mikpritja në jetën e përditshme është po aq e rëndësishme sa gatishmëria shpirtërore për Natën e Kadrit, një natë e papërcaktuar në gjysmën e dytë të muajit të Ramazanit, e cila është konsideruar si "më e vlefshme se një mijë muaj", siç theksohet në Kur'an (97/3).

Ekzistojnë edhe koncepte të tjera specifike islame dhe praktika bamirësie, të cilat u rrënjosën shpejt në kulturën e lashtë turke, migruan së bashku me turqit nomadë nëpër stepat e Azisë Qendrore në Anadoll, dhe më vonë hynë në Afrikën Veriore dhe Ballkan nën kujdesin e Perandorisë Osmane. Akte të caktuara të bamirësisë, të përshkruara nga Kurani dhe të inkurajuara nga Profeti Muhamed (570-632) kanë gjetur zbatim pothuajse të vazhdueshëm në kulturën paraosmane, osmane dhe të shoqërisë moderne turke. Konceptet kryesore që do të diskutohen këtu, janë: **sadakaja, zekati, kurbani, vakëfi, ahiliku, bereketi, fqinjësia** dhe ***karz-i hasen***. Në këtë kontekst, ne gjithashtu do të shqyrtojmë domethënien e shprehjeve të zakonshme sociolinguistike turke dhe fjalëve të urta që lidhen me bujarinë, mikpritjen, dhe fqinjësinë. Së fundmi, shkurtimisht do të prezantojmë mënyrat me të cilat idealet, aktivitetet dhe diskursi i lëvizjes Gylen kanë siguruar një dimension të ri për shprehitë individuale dhe ato kolektive të lidhura me traditat turko-islame të bujarisë.

Konceptet mëkryesore të traditës turke në lidhje me bamirësinë

Sadakaja

Një nga praktikat më të rëndësishme profetike e cila i inkurajon turqit për të dhuruar është *sadakaja*, një term që mund të përkthehet si "lëmoshë", "ndihmë" ose "një dhuratë bamirëse e cila jepet me

qëllimin e vetëm të fitimit të kënaqësisë së Zotit, në pritje të një shpërblimi në botën tjetër (d.m.th. pa llogaritur ndonjë përfitim të kësaj bote, të tillë si, pushtet, famë apo avantazh shoqëror)."[9] Përfituesit e sadakasë nuk janë të detyruar të jenë pjesëtarë të ndonjë feje të caktuar. Çdokush që ka nevojë për lëmoshë mund ta marrë një të tillë. Edhe pse *sadakaja* interpretohet zakonisht si diçka materiale ose monetare, nëpër hadithe, si e tillë konsiderohet çdo favor që i bëhet dikujt, edhe veprimi i buzëqeshjes së një myslimani ndaj shokëve të tij, mund të konsiderohet si një *sadaka*, dhe dhuruesit të saj i është premtuar një shpërblim shpirtëror. Për këtë arsye, njerëzit mund të ofrojnë para, ushqim, ujë, rroba, libra, ekspertizë profesionale apo kohën e tyre si sadaka. Referencat në lidhje me sadakanë nëpër hadithe të ndryshme, në veçanti e vënë theksin në dobinë e të dhënit lëmoshë në një apo në një tjetër rrethanë: për shembull, sadakaja e dhënë për fqinjët dhe të afërmit, sadakaja e dhënë gjatë të premteve apo gjatë Ramazanit, sadakaja e dhënë në Mekë, Medinë apo Jeruzalem, sadakaja e dhënë në fshehtësi, dhe sadakaja që ka të bëjë me vetësakrifikimin thuhet se janë veçanërisht të pëlqyeshme.[10]

Dhënia e sadakasë ende mbetet një praktikë e përhapur në kulturën moderne turke, pavarësisht nëse individët e përcaktojnë veten si fetarë apo jo. Në epokën osmane, sadakaja jepej në shumë raste dhe vendosej në mënyrë anonime ose në kutinë e mbledhjes së parave të xhamisë, ose në një "gur sadakaje" jashtë xhamisë apo në rrugë, ose në duart e një përfaqësuesi të një vakëfi (trusti bamirëse) ose i dërgohej funksionarëve të pushtetit lokal, të cilët kishin hapur *kuzhina supe (şi evleri)* të hapura për publikun. Këto praktika siguronin që individët në nevojë të mund të përfitonin me lehtësi donacione bamirësie, duke marrë kështu atë të cilën e kishin të nevojshme, pa cenuar nderin e familjes së tyre apo dinjitetin personal.[11] Turqit osmane skalitën në besimin islam idenë se një sadaka e dhënë sinqerisht ndihmon një mysliman për të shmangur probleme në këtë botë, e bën më të lehtë pyetjen e

tij apo të saj në varr, dhe shërben për të ngritur statusin e tij apo të saj në botën e përtejme.[12] Edhe pse lëvizja perëndimorizuese, e cila filloi në Periudhën e Tanzimatit dhe fitoi një forcë pothuajse të papërmbajtshme gjatë viteve të para të Republikës Turke, futi vlerat laike dhe nacionaliste në çdo fushë të jetës në një mënyrë vertikale " nga lart poshtë", mund të thuhet se ajo që u prezantua nuk paraqiste asnjë alternativë reale ndaj Islamit, i cili u kishte siguruar banorëve të Anadollit identitetin dhe parimet organizative të jetës për kaq shumë kohë. Richard Tapper[13] thotë: "Në nivel publik, nuk mund të kishte zëvendësues për ligjet hyjnore të Islamit;. Në nivel individual, asnjë sistem nuk mund të përmbushë si ai nevojat intelektuale për etikë dhe eskatologji." Për këtë arsye, shumë praktika islame, si sadakaja, kanë mbijetuar në periudhën moderne.

Në shoqërinë moderne turke, sadakaja jepet në shumë raste, megjithëse në një mënyrë ndoshta me më pak vetëdije fetare nga ana e disa individëve. Rastet më të zakonshme të dhënies së sadakasë (përmes kutisë së grumbullimit në xhamitë lokale, sakrifikimit të një dashi apo lope (Kurban) dhe shpërndarjen e mishit të tij ndaj të varfërve, ose edhe transferimin elektronik të fondeve për një organizatë bamirëse) janë: përpara se një çift i ri të bëhet me fëmijë apo pasi fëmija ka lindur; para se të ndërmerret një udhëtim apo pas përfundimit të udhëtimit; para se të fillojë një projekt dhe pas përfundimit të projektit; pas një ëndrre të keqe dhe për të parandaluar interpretimin keqdashës të ëndrrës; përpara se familjet të martojnë fëmijët e tyre dhe pas një ceremonie martese: kur prindërit dëgjojnë lajmin se bijtë e tyre janë në pritje të një fëmije dhe pasi fëmija ka lindur; përpara se ata të dërgojnë djemtë e tyre për të kryer shërbimin ushtarak dhe pas lirimit të fëmijëve nga ky shërbim. Turqit me prirje fetare mund të mbajnë një kuti sadakaje pranë hyrjes së shtëpisë së tyre dhe depozitojnë sasi të hollash në të sa herë që dalin jashtë. Ata gjithashtu mund të japin sadaka për të shlyer mëkatet apo për të

shprehur falënderimet ndaj Zotit kur shohin se Ai i kursyer nga një fatkeqësi e madhe. Sadaka jepet nga njerëzit që janë gjallë, si dhe në emër të atyre që kanë vdekur. Një traditë profetike për të cilën do të flasim gjerësisht në seksionin mbi vakëfet inkurajon pasardhësit e një personi të vdekur për të dhënë sadaka. Për këtë arsye, fëmijët e të ndjerit shpesh shikojnë për ndonjë rast për të dhënë sadaka për të kënaqur jo vetëm Zotin, por edhe shpirtrat e etërve, nënave apo të dashurve të tyre.

Zekati

Edhe pse sadakaja është një pagesë ose kontribut vullnetar, turqit më fetarë njohin një formë të institucionalizuar dhe të detyrueshme të bamirësisë të quajtur *zekat*. Zekati është pagesa e detyrueshme e një pjese të caktuar, 1/40 e pasurisë së përgjithshme të dikujt - nëse posedon kapital ose prona më shumë se çfarë është absolutisht e nevojshme për të siguruar jetesën e familjes - të varfërve, një herë në vit. Ky dhurim i pasurisë së fituar në mënyrë të ligjshme për nevojtarët, është konsideruar si pastrim dhe shtim i saj, për faktin se bamirësia është krahasuar në Kuran me mbjelljen e farës që sjell shpërblimin më të madh:

"Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut, është si i një kokrre që i mbin shtatë kallinj, në secilin kalli njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është bujar i madh, i njeh të gjitha qëllimet *tuaja (2/261)."*

Koncepti turk i Islamit në përgjithësi korrespondon me interpretimin e Islamit suni, i cili përcakton se çdo mysliman që është i aftë për të përmbushur pesë parimet e Islamit, duhet t'i përmbushë ato. Krahas të dëshmuarit me gojë: "Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij", faljeve pesë herë në ditë, të agjërimit, dhe kryerjes

së haxhit në Mekë, zekati përbën një parim të rëndësishëm për ata besimtarë të cilët janë të aftë ekonomikisht. Referencat në Kuran e bëjnë zekatin një akt të detyrueshëm për myslimanët. Zekat nuk mund të konsiderohet si një akt vullnetar dhurimi, sepse ai është pjesë e parimeve themelore të Islamit, dhe një person nuk ka të drejtë të mos japë nëse ai ose ajo janë të aftë ekonomikisht. Sipas Kuranit dhe shumë hadithe, pranuesit e zekatit, domethënë njerëzit në nevojë, kanë të drejtën natyrore dhe ligjore për ta përfituar atë, ndaj në procesin e dhënies së zekatit, paguesi thjesht përmbush detyrimin fetar të tij apo të saj, dhe nuk është duke bërë diçka ekstra. Në literaturën islame, zekati njihet gjerësisht si një mjet i rëndësishëm në rishpërndarjen e pasurisë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, si dhe për rolin që luan në parandalimin e sëmundjeve të caktuara sociale të nxitura nga varfëria, si vjedhjet dhe prostitucioni. Në të vërtetë, lëmosha, dhurimi në mënyrë të rregullt për të mirën e të varfërve është i njohur për kontributin e tij në harmoninë dhe prosperitetin e shoqërive. Zekati, nëse flasim nga pikëpamja ideale, duhet të çimentojë marrëdhëniet midis sektorëve të ndryshëm të komunitetit dhe të sigurojë stabilitet. Ai duhet të kultivojë një frymë qytetarie, të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve sociale, dhe të nxisë lidhjet e dashurisë dhe miqësisë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë.[14] Ajetet kuranore të cilat e përmendin zekatin si një akt të detyrueshëm, i kërcënojnë me zjarr ata myslimanë që nuk janë të gatshëm ta paguajnë atë.[15]

Dy ajetet kuranore (2/117 dhe 9/60) paraqesin një listë të detajuar të tipit të njerëzve, të cilët mund të jenë përfituesit e zekatit: të afërmit dhe fqinjët nevojtarë, jetimët, të varfrit dhe të vobektët, ata që janë të ngarkuar me borxhe, udhëtarët që kanë përjetuar vështirësi, skllevërit apo robërit që kanë nevojë të emancipohen, mbledhësit e zekatit (ata të cilët janë vetë në mesin e nevojtarëve), si dhe ata persona "zemrat e të cilëve duhen fituar" për kauzën e Allahut. Më vonë, juristët myslimanë zhvilluan grupe ose nëngrupe sipas këtyre kategorive dhe e zgjeruan numrin e

njerëzve që mund të marrin ndihmë përmes zekatit. Si rezultat, rregulli i përgjithshëm për të dhënë zekat është që të fillohet nga qendra (domethënë, me njerëzit e afërt) dhe të shtrihet më pas në periferi. Me fjalë të tjera, një mysliman duhet t'ua japë zekatin e detyrueshëm së pari të afërmve dhe fqinjëve në nevojë, dhe pastaj vetëm nëse nuk ka përfitues legjitimë në këto dy kategori, t'ua japë njerëzve të tjerë nevojtarë. Gjithashtu, shpërndarja lokale e zekatit është më e parapëlqyer sesa shpërndarja kombëtare apo rajonale.

Një formë tjetër e detyrueshme e zekatit apo sadakasë është *Sadaka-i Fitri*, duke pasur parasysh se ai jepet çdo vit në fund të Ramazanit. *Sadaka-i Fitri* zakonisht është një shumë të hollash e cila varion ndërmjet 10$ dhe 25$, ose shuma e parave të nevojshme për të ushqyer një të varfër për një ditë.[16] Ndryshe nga zekati, i cili është një obligim për muslimanët e një moshe dhe statusi ekonomik të caktuar, *Sadaka-i Fitri* duhet të paguhet nga çdo anëtar i vecantë i familjes i cili është ekonomikisht i aftë. *Sadaka-i Fitri* është parë si një "gomë shpëtimi," në mënyrë që anëtarët e varfër të shoqërisë të mund të festojnë Eid-ul-Fitrit (Fitër Bajramin), një festë e madhe në fund të muajit të Ramazanit.

Në historinë e hershme islame, zekati ka qenë mbledhur nga shteti në formën e një takse. Në shekujt e mëvonshëm, në disa raste zekati është mbledhur në mënyrë rigoroze në kohën e përcaktuar, ndërsa në raste të tjera njerëzit e paguanin atë, nëse e shikonin të arsyeshme. Edhe nën administratën osmane, e cila ishte mjaft burokratike (si ato të mesit të shekullit të trembëdhjetë apo fillimit të shekullit të njëzetë), nuk duket të ketë ekzistuar ndonjë metodë formale e vlerësimit të pasurisë për zekat, kështu që shuma e paguar, me siguri do të ketë qenë më shumë një çështje e ndërgjegjes personale.[17] Në fillim të shekullit të njëzetë, kur kalifati islam i hapi rrugë shteteve-kombe të kolonizuara apo gjysëm të kolonizuara, dhe shumë qeveri hoqën dorë nga mbledhja e zekatit në favor të sistemeve tatimore me natyrë perëndimore,

vendimi nëse qytetarët duhej apo jo të paguanin zekat iu la zyrtarisht ndërgjegjes së tyre individuale. Në Turqi, në vitin 1930, në kohën kur iniciativa nacionaliste-laike i detyroi shumë institucione islame të shpërbëheshin, Shoqata Turke Aeronautike ishte përcaktuar si një organizatë jofitimprurëse për të cilën qytetarët mund të paguanin zekat. Për shkak të shqetësimit se kjo organizatë nuk mund t'i përmbahej plotësisht përcaktimeve fetare, organizata të tjera civile nisën gjithashtu të lulëzojnë, dhe filluan të marrin përsipër detyrën e mbledhjes dhe shpërndarjes së zekatit. Në të vërtetë, në Turqinë moderne, zekati është shndërruar në një burim shumë të rëndësishëm financiar për organizatat bamirëse joqeveritare dhe ato të shoqërisë civile në përgjithësi.

Një përbërës i rëndësishëm i dhënies së sadakasë, zekatit ose *sadakanë së fitrit* është parimi i fshehtësisë. Po citojmë këtu një thënie profetike sipas së cilës "dora e majtë nuk duhet ta shohë atë që jep dora e djathtë ", që do të thotë se sadakaja apo zekati duhet të jepet në fshehtësi të plotë. Duke marrë parasysh atë shoqëri të vogël dhe të ngushtë, në të cilën ka jetuar Profeti Muhamed, si dhe natyrën e jetës së shumë shoqërive në qytete të vogla dhe në fshatra, krenarinë dhe dinjitetin e njerëzve të cilët marrin sadaka nga shumë njerëz me të cilët jetojnë, punojnë dhe bisedojnë, ky parim bëhet shumë i rëndësishmëm. Një proverb i njohur turk pasqyron gjithashtu motivimin fetar për të bërë vepra të mira në fshehtësi: "Bëje një të mirë dhe hidhe në det. Nëse peshqit nuk e vlerësojnë atë, me siguri e vlerëson Krijuesi." Ka raste megjithatë, në të cilat sadakaja ose mbledhja e fondeve për të mirën e të varfërve bëhet haptazi, dhe njerëzit e pasur inkurajohen për të dhënë edhe më shumë. Një shembull i njohur në historinë islame është mbledhja e fondeve nga ana e Profetit Muhamed në Medinë. Kur komuniteti i sapokrijuar i myslimanëve e pati ndierë nevojën në rritje për të holla, Profeti Muhamed u kërkoi shokëve të Tij të shkonin në shtëpitë e tyre dhe të sillnin ca para. Omer ibni Hatabit, i cili më vonë do të bëhej kalifi i dytë i Shtetit Islam, solli

gjysmën e pasurisë që kishte, dhe Ebu Bekr Sidiku, i cili më vonë u bë kalifi i parë, solli të gjithë pasurinë e tij. Kur Ebu Bekri u pyet se çfarë i kishte lënë familjes së tij, ai u përgjigj, "Unë u lashë atyre Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Edhe pse 'Omer ibni Hatabi ka thënë se që prej asaj dite ai pat kuptuar se kurrë nuk mund ta arrinte dot Ebu Bekr Sidikun në aspektin e besnikërisë ndaj çështjes islame, të dy këta persona vazhdojnë të shërbejnë si shembuj myslimanë të bujarisë edhe sot e kësaj dite.

Të tjera tradita turko-islame që lidhen me dhënien dhe aktet e bamirësisë, të praktikuara gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit dhe gjatë dy festave të mëdha, Bajramit të Ramazanit dhe Eid-ul Adha, Kurban Bajramit, gjithashtu mund të diskutohen brenda kontekstit të sadakasë dhe zekatit. Gjatë Ramazanit, një nga shumë mënyrat me të cilat një besimtar mund të fitojë shpërblime prej Allahut është që të ftojë mysafirë në shtëpinë e vet për iftar (vaktin e prishjes së agjërimit në muzg), ose për syfyr (vakti që mbyllet në mëngjes herët përpara se të fillohet agjërimi i ditës). Në epokën osmane, kjo porosi pati zhvilluar dinamika të reja, si mikpritja bujare e kërkuar për të kënaqur mysafirët e tyre, e cila realizohej jo vetëm duke shtruar atyre përpara një koleksion pjatash të shijshme, por edhe duke iu ofruar dhurata të vogla, të njohura si *qiraja e dhëmbëve*, në një përpjekje për të fituar zemrat dhe duatë e tyre. Përtej familjes, *vakëfet osmane* dhe agjencitë e qeverisjes vendore, kanë shtruar iftare publike përjashta, duke siguruar që të dyja palët, si të varfrit ashtu edhe të pasurit të mund të prishin agjërimin e tyre. Sot, tradita e "çadrave të iftarit», të lira dhe të hapura për publikun, është ringjallur nga qeveritarët vendorë të Turqisë, të cilët i shohin të tilla akte bamirësie, si evente demokratike reciprokisht të dobishme, për të pasurit dhe të varfrit. Gjatë Bajramit të Ramanzanit, madje edhe turqit që nuk paguajnë zekat, sadaka ose fitrin, bëjnë një përpjekje për të bërë dhurata të vogla si karamele dhe të holla për të gjithë fëmijët që ata njohin ose shikojnë, gjatë vizitave tek të afërmit, miqtë dhe fqinjët.

Kurbani

Gjatë Kurban Bajramit, ose "Festa e Sakrificës," myslimanët turq, ashtu si edhe të gjithë myslimanët në mbarë botën, bëjnë flijime në formën e therjes së kafshëve bujqësore të tilla si dele ose bagëti të tjera të imëta, në përkujtim të gatishmërisë së Profetit Abraham tek sakrifikonte djalin e tij si një veprim të bindjes ndaj Zotit, dhe në përkujtim të bujarisë me të cilën Zoti e pranoi sakrificën e tij të sinqertë, duke e udhëzuar për të sakrifikuar një dash në vend të të birit (Kuran: 37/102–107). Kjo festë e dytë e madhe islame, përkon me ditën pasi pelegrinët kryejë haxhin, pelegrinazhin e tyre vjetor në Mekë. Kjo ditë është burim i një numri traditash të forta kulturore që lidhen me dhënien dhe bamirësinë. Për shembull turqit, shumicën e mishit të atyre kafshëve që sakrifikojnë, në përputhje me Kuranin (22/28, 34-37) dhe traditën profetike, e ndajnë në tri pjesë: një pjesë për të varfërit (domethënë si sadaka), një pjesë për të afërmit dhe fqinjët, dhe pjesën e mbetur e mbajnë për vete. Me idenë se një pjesë e madhe e mishit duhet t'u jepet njerëzve të varfër dhe të uritur në mënyrë që të gjithë ata të mund të bashkohen në festë, shumë turq ua dhurojnë të gjithin ose shumicën e mishit, si dhe lëkurën apo kockat e kafshëve të tyre organizatave civile përgjegjëse për shpërndarjen. Pjesa tjetër gatuar për vaktet e festës familjare gjatë të cilave të afërmit dhe miqtë, ftohen për të ngrënë së bashku. Praktikat e rregullta bamirëse të myslimanëve turq demonstrohen gjatë Bajramit të Kurbanit nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta për t'u siguruar se asnjë person i varfër të mos mbetet pa ushqim kurbani, dhe se asnjë i afërm, sidomos të moshuarit dhe miqtë, të mos lihen pa u vizituar gjatë këtyre ditëve.

Tendenca e turqve për të sakrifikuar një kafshë fermash në emër të Zotit (Bismil'lah) dhe për shpërndarjen e mishit të varfërve (domethënë të japin sadaka), pasi një fëmijë lind si dhe pas prerjes së flokëve të tij të parë, është vazhdim i një tradite paraislame në

gadishullin Arabik. Kjo traditë, e quajtur *akide*, u pat miratuar dhe institucionalizuar nga Profeti Muhamed gjatë viteve të hershme të Islamit. Është gjithashtu diçka e zakonshme për turqit që të japin një sadaka prej mishit të sakrifikuar pas hapjes së një biznesi të ri ose në ndonjërin nga rastet e listuara më sipër, në të cilat jepet edhe sadakaja monetare.

Vakëfi

Një tjetër institucion i rëndësishëm, i cili pasqyron kulturën e të dhuruarit në traditën turke, është *vakëfi* (trustet bamirëse). Trustet bamirëse e kishin periudhën e tyre të artë në kulturën turke gjatë epokës osmane (1299-1920) dhe mund të quhen shembulli *par excellence* e dhurimit. Termi arab *vakf* mund të përkthehet si "trusti i ligjit të përbashkët" ose " blatimi i pajisjes me vullnet të lirë." Në mënyrë që të krijojë një lidhje të patjetërsueshme fetare me Zotin, një i rritur, që është i shëndoshë mendërisht, i cili ishte në gjendje të trajtojë çështjet financiare, i cili nuk rrezikohet nga falimentimi, dhe i cili ka për qëllim të kryejë një vepër të devotshme, mund ta deklarojë një pjesë ose të gjithë pronën në pronësi të tij për ta kthyer në mënyrë tipike në një ndërtesë ose një ngastër toke, si *vakëf*, domethënë të dedikuar për qëllime bamirësie apo për qëllime që përputhen me traditat myslimane. Në përgjithësi, ky vendim ishte i pakthyeshëm. Në mënyrë që të sigurohej *vakëfi*, individi i cili deklaronte se do ta jepte pronën për vakëf dhe pastaj shkonte në gjykatë në përpjekje për të rifituar pronën, në rast të tillë gjykata do t'i nxirrte atij përpara një deklaratë ku ai vetë kishte firmosur se prona është *vakëf* dhe nuk mund të rikthehet, shitet apo dhurohet. Krijimi i një vakëfi përfshinte edhe përcaktimin formal të përfituesve (p.sh. anëtarët e familjes, një segment i veçantë i publikut, dhe/ose shërbimeve publike) dhe emërimin e një administratori të besuar ose një Bordi të Besuarish *(mutevelli)*, i cili do të menaxhonte vakëfin

sipas qëllimit fillestar dhe ligjeve mbi të cilat është themeluar si institucion. Këta njerëz të besuar zotëronin të drejtën për të bërë ndryshime për sa kohë që ato ishin në përputhje me ligjin islam dhe në dobi të fondacionit, në raste të tjera, duhej kërkuar leje nga gjykatësi. Menaxhimi i papërshtatshëm i një vakëfi, sidomos përdorimi i pavend i fondeve të saj, konsiderohej si një mëkat. Edhe pse disa studiues besojnë se dhurimet e hershme islame ishin modeluar sipas atyre të të krishterëve dhe zoroastrianëve, me të cilët myslimanët arabë ranë në kontakt që në shekullin e shtatë, pothuajse të gjithë turqit ia atribuojnë një origjine islame themelimin e këtij institucioni bamirësie.

Edhe pse vakëfet nuk janë përmendur në mënyrë specifike në Kuran, transmetimet e shumta nga tradita profetike e kanë nxitur krijimin e tyre. Në pikëpamjen ligjore islame, ky institucion e ka origjinën qysh prej kohës kur Omer ibni Hatabi pati fituar ca toka në oazet e Hajberitit pranë Mekës. Ai e pyeti Profetin nëse ai duhet ta jepte tokën si donacion vullnetar (sadaka) dhe Profeti raportohet të jetë përgjigjur: "peshoje vetë këtë gjë dhe dedikoji frytet e saj për qëllime të devotshme." Omeri thuhet se e bëri këtë me kushtin që toka nuk duhej të shitej e as të trashëgohej, dhe ai ia dedikoi të ardhurat e saj një shumëllojshmëri qëllimesh bamirëse - për çlirimin e robërve nga skllavëria, për të ndihmuar udhëtarët, si dhe për të ftuar njerëzit "në rrugën e Zotit."[19] Një tjetër hadith i famshëm thotë: "I Dërguari i Zotit ka thënë: Kur një njeri vdes, vetëm tri lloje veprash të tij do të mbijetojnë: lëmosha e vazhdueshme, dijet e dobishme dhe një fëmijë që lutet për të."[20] Ndërsa elementi i dytë i këtyre veprave, "dijet e dobishme" u interpretua si shkrimi i një libri apo nxjerrja e një zinxhiri të pandërprerë nxënësish, pika e parë, "lëmosha e vazhdueshme", u interpretua si vazhdimi i një linje bamirësie.

Trustet bamirëse arritën kulmin e tyre në shoqërinë osmane. Mjaft burra dhe gra të pasur dhe të devotshëm dhuruan copa të

mëdha toke dhe ndërtesa të tëra, por edhe sipërfaqe të vogla shtëpish, tokash, madje edhe dhoma teke si vakëfe. Ka pasur raste në të cilat edhe një qilim apo shtroje e vetme është shpallur vakëf në ndonjë shkollë ose xhami të caktuar, apo në të cilat biblioteka apo libra të veçantë ishin deklaruar si vakëf dhe ishin vënë në dispozicion të publikut për përdorim të përbashkët. Trustet bamirëse ishin përhapura jo vetëm në mesin e myslimanëve, por edhe në mesin e të krishterëve dhe hebrenjve që jetonin nën sundimin osman. Në qytetet e mëdha, në qendrat qeveritare, dhe madje edhe në qytetet provinciale, qindra truste bamirëse ishin themeluar për qëllime të ndryshme. Disa vakëfe trajtonin nevojat e kafshëve: duke ndihmuar zogjtë e dobët, të pamundur për të emigruar në tokat e ngrohta, duke ngrohur vezët për pulat, duke u kujdesur për macet dhe qentë endacakë, dhe duke ofruar shërbime veterinare. Të tjera vakëfe ishin përcaktuar për nevojat e individëve apo grupeve të njerëzve. Të dy palët, si njerëzit ashtu edhe shërbimet publike, mund të ishin përfituesit e një trusti bamirësie; dhurimet ishin llogaritur për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, shkollave, xhamive, shërbimeve të kanalizimeve, banjove publike, urave, varrezave dhe burimeve të ujit të pijshëm, si dhe për mbështetjen financiare të nxënësve, vejushave, jetimëve dhe të të varfërve në lagje të caktuara. Si myslimanët, ashtu edhe të krishterët apo hebrenjtë, mund të krijonin të tilla truste dhe të përfitonin nga të mirat e tyre. Sidomos në Ballkan, ku popullsia ishte kryesisht e krishterë, në vitet e para të sundimit osman, trustet bamirëse kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksioneve civile, duke ndihmuar të dobëtit dhe nevojtarët në rajon, duke siguruar kështu admirimin dhe simpatinë e popullatës lokale.

Në thelb, trustet bamirëse kanë ofruar shërbime shumë më cilësore sesa ofrojnë shërbimet shtetërore dhe qeverisjet lokale moderne, të tilla si sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe arsimit fillor, mirëmbajtja e rrugëve, dhe shpërndarja e ujit të pastër nëpër qytete dhe lokalitete. Përveç shërbimit ndaj të varfërve

dhe nevojtarëve, vakëfi rriti gjithashtu respektin e publikut për të pasurit të cilët e zotëronin një dhunti të tillë. Me pak fjalë, ekzistenca e vakëfeve ka promovuar harmoninë sociale dhe ka zvogëluar hendekun mes të pasurve dhe të varfërve.

Tradita e vakëfeve vijoi me vrull që nga shekulli i dymbëdhjetë deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë, duke shërbyer për kryerjen e funksioneve të shumta pozitive në shoqërinë osmane. Në vitin 1910, Turqit e Rinj e zëvendësuan institucionin e vakëfit me Dhomat e Tregtisë dhe në vitin 1920, ai u vendos nën juridiksionin e Ministrisë së Punëve Fetare dhe Vakëfit, e cila u ndryshua më pas në Drejtorinë e Përgjithshme të Trusteve Bamirëse në vitin 1924. Kjo Drejtori e Përgjithshme vazhdon të administrojë rreth 41.000 truste bamirëse të mbetura që nga koha osmane dhe zotëron një nga bankat më të mëdha në vend, *Vak*ıf Bank, e cila punëson më shumë se 38.000 njerëz.[21] Sot në Turqi, ekzistojnë shumë lloje të trusteve bamirëse. Disa sigurojnë fonde për restaurimin dhe ruajtjen e zonave të panumërta historike të vendit, ndërsa të tjerat ofrojnë shërbime financiare, arsimore, kulturore dhe/ose shëndetësore për publikun. Vakëfet e sotme janë plotësuar edhe nga një numër i madh i organizatave dhe shoqatave bamirëse, aktivitetet e të cilëve shpesh janë të ngjashme, edhe pse struktura e tyre financiare dhe ligjore ndryshon.

Nga pikëpamja krahasuese, format e institucionalizuara të filantropisë, të tilla si vakëfi, janë më të lehta për t'u gjetur sesa format informale të filantropisë, të tilla si sadakaja, për shkak të praktikave dhe kontributet e institucionit të vakëfit, të cilat zakonisht lënë një dëshmi ligjore të dokumentuar.

Organizatat *Ahi*

Përveç vakëfeve, edhe organizatat *Ahi* janë shembuj të dhurimit për bamirësi. Organizatat *Ahi* janë grupime sociale, profesionale

dhe fetare, të cilat u shfaqën fillimisht në Anadoll në shekullin e trembëdhjetë dhe luajtën një rol të rëndësishëm në themelimin e Perandorisë Osmane. Organizatat Ahi janë të lidhura me *futuvva* apo *fitjan* të cilat janë lëvizjet dhe organizatat e ndryshme, të cilat deri në fillim të epokës moderne, ishin përhapur në të gjitha komunitetet urbane të Lindjes myslimane.[22] Ato ishin një formë e kalorësisë, nëpërmjet dy elementeve të rëndësishme, lidhjes së tyre me sufizmin dhe dimensioneve të tyre profesionale. Si një grupim profesional, ato ishin të lidhura me Ahi Evran (vd.1262), i cili konsiderohet të jetë shenjtori mbrojtës i regjësve të lëkurave. Ka pasur edhe organizata të tjera tregtare në Turqi, por regjësit e lëkurave u shndërruan në simbolin e organizimit shoqëror për shkak të vendndodhjes së tyre të centralizuar dhe strukturës strikte organizative. Përfaqësuesit e Ahi Evran jetonin në Kërshehir në Turqinë qendrore dhe bënin pranimin e njerëzve në këtë profesion. Ceremonia simbolike e pranimit përfshinte veshjen e kandidatit, duke miratuar kështu kualifikimin e tij, që ai të ishte një anëtar i këtij profesioni. Më vonë, kreu i regjësve të lëkurave në Kërshehir u bë kreu i të gjitha profesioneve me mbështetjen e sulltanit, i cili përfitoi nga kontributet e organizatave *Ahi* si gjatë luftës ashtu edhe në kohë paqeje. Gjatë kohës së luftës disa organizata Ahi siguronin armë dhe fuqi punëtore për ushtrinë. Gjatë kohës së paqes, organizatat Ahi kontribuan në përmirësimin material dhe social të shoqërisë.

Edhe pse organizatat Ahi nuk kishin pushtet të pavarur politik, atë kanë luajtur role të cilat normalisht duhet të ishin marrë përsipër nga shteti, siç ishte mbrojtja e qyteteve dhe fshatrave kundër pushtimit mongol. Në disa raste, ato kanë luajtur një rol ndërmjetësues në mes të shtetit dhe të masave popullore.[23] Këto organizata kanë qenë në njëfarë kuptimi ekuivalenti i shoqatave tregtare moderne, por me një dimension moral dhe shpirtëror. Ato nuk e konsideronin veten thjesht si shoqatë prodhuesish artizanalë, por si udhëheqësit përgjegjës për mirëqenien e

komunitetit, si materialisht ashtu edhe nga pikëpamja shoqërore. Anëtarët e këtyre organizatave priteshin të shfaqnin cilësitë e mëposhtme: besnikëri, besueshmëri, bujari, drejtësi, modesti, altruizëm për kolegët e tyre profesionistë dhe gatishmëri për të falur.

Begatia

Një tjetër koncept i rëndësishëm i cili është pjesë e filantropisë turko-islame është koncepti i *bereqetit,* pra begatisë. Kjo fjalë ka kuptimin "forcë e dobishme, me origjinë hyjnore, e cila sjell bollëk në aspektin fizik si dhe prosperitet e lumturi në aspektin psikologjik."[24] Fjala *"Bereket"* është bërë një pjesë integrale e kulturës turke dhe përdoret dendur në turqisht e përditshme. Në të vërtetë, shumica e turqve besojnë se kur bëhet diçka me qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut, pa pritur ndonjë shpërblim të kësaj bote, kjo do të sjellë bollëk. Për shembull, nëse një individ jep një pjesë të parave të tij ose të saj për të varfërit apo nevojtarët, ai/ajo pret që pjesa tjetër e parave që zotëron, të bëhet të bollshme (domethënë më shumë se e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e individit). Kjo ide e bollëkut që rezulton nga bujaria, është zbatuar jo vetëm për paratë, por edhe për jetën, kohën dhe objekte të tjera të prekshme, të tilla si ushqimet, të lashtat, e kështu me radhë. Besohet se nëse një individ shpenzon një pjesë të kohës së tij për një vepër të mirë, ai do të jetë më efikas dhe produktiv në përdorimin e kohës së mbetur të tij.

Ky konceptim i begatisë i ka rrënjë e veta në Kuran, ku thuhet:

"S'ka dyshim se ata që japin lëmoshë (sadaka) dhe që sinqerisht japin për hir të Allahut, atyre u shumëfishohet dhe ata kanë shpërblim të madh (57:18)."[25]

Bereqeti është një fjalë e përdorur rëndom në jetën e përditshme të turqve, qofshin apo jo mbartës të një botëkuptimi fetar të veçantë. Për shembull, pas përfundimit të një transaksioni biznesi, pronarët e dyqaneve apo shitësit thonë: "Allahu të dhëntë bereqet!" *("Allahu Bereket versin!")*, ndërsa fusin paratë në xhepat e tyre ose në arkë. Në zonat rurale, kur një person viziton një fqinj gjatë procesit të korrjeve, ai apo ajo thotë, "Qoftë e begatë!" *("Bereketli olsun!")*.[26]

Përveç kësaj, Profeti Ibrahim është konsideruar të jetë një model i rëndësishëm i bujarisë dhe mikpritjes. Legjendat popullore thonë se ai kishte një shtëpi me katër porta. Të gjitha portat mbaheshin të hapura dhe njerëzit mund të vinin nga çdo drejtim që të merrnin pjesë në tryezën e tij. Ai gjithmonë kishte të ftuar dhe tryeza e tij ishte gjithmonë plot. Turqit besojnë, në përputhje me rrethanat, që pritja e të ftuarve i sjell bollëk dhe begati të zotit të shtëpisë. Shprehjet e shumta gjuhësore e tregojnë qartë këtë besim. Për shembull, pas ngrënies në shtëpinë e dikujt tjetër, turqit thonë, "Ju qoftë tryeza si tryezë e Ibrahimit!", që do të thotë u shpërbleftë i zoti i shtëpisë me pasuri dhe bekime. Si gjatë udhëtimeve nëpër qytete të mëdha të Turqisë, ashtu edhe nëpër qyteza, mund të vëresh shumë restorante të quajtura "Tryeza e Ibrahimit" ("Halil İbrahim Sofrası").

Fqinjësia

Bujaria dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët janë gjithashtu me rëndësi të madhe në gjuhën e kulturës turko-islame. Shumë turq janë të vetëdijshëm se profeti Muhamed e pat theksuar në mënyrë të vecantë rëndësinë e të pasurit të marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe për këtë mund të citojmë thënie të tilla profetike si: "Profeti ka thënë: '*Xhibrili vazhdonte të më porosiste që unë t'i trajtoj fqinjët e mi me mirësi dhe edukatë aq shpesh, saqë unë mendoja se ai do të urdhëronte mua për t'i bërë ata trashëgimtarët e mi.*'"[27] , si dhe:

I Dërguari i Allahut tha: "Kushdo që beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, nuk duhet të dëmtojë fqinjin e tij, dhe kushdo që beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, duhet ta kënaqë mikun e tij me bujari dhe kushdo që beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, duhet të flasë atë që është e mirë ose të heshtë." (d.m.th., të përmbahet nga të gjitha llojet e fjalëve të këqija dhe të pista).

Dijetarët myslimanë pajtohen njëzëri me mendimin se fqinjët jomyslimanë kanë të njëjtat të drejta si fqinjët myslimanë, pasi nuk ekziston ndonjë thënie profetike e cila përmend në mënyrë specifike fqinjët myslimanë, dhe për më tepër disa hadithe rrëfejnë raste të bujarisë nga ana e Profetit Muhamed apo familjarëve të tij ndaj fqinjëve hebrenj.[29]

Në gjuhën e sotme turke, proverba të ndryshme tregojnë vlerën e lartë të fqinjëve të mirë. Ndër këto proverba mund të përmendim: " Mos bli një shtëpi të mirë, por një fqinj të mirë!" *("Ev alma, komşu al!")* dhe "Një fqinj mund të ketë nevojë edhe për hirin e fqinjit të tij." *("Komşu komşunun külüne muhtaçtı")*. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e turqve, bëjnë përpjekje për të mbajtur marrëdhënie të mira me fqinjët e tyre, duke i përshëndetur ata me një buzëqeshje dhe duke u angazhuar në biseda të shkurtra, duke i ftuar ata për çaj ose kafe, duke i vizituar në raste festash dhe/ose në raste fatkeqësish, duke u servirur biskota, japrak me gjethe rrushi ose çdo gjë tjetër që është gatuar në shtëpi atë ditë, si dhe duke e mbajtur nivelin e zhurmës në shtëpi në minimumin e mundshëm enkas për të mos i shqetësuar ata. Amvisat turke, në veçanti, kanë tendencën të kenë marrëdhënie të ngushta me amvisat fqinje, dhe shpesh ndajnë detyrat e gatimit, pjekjes dhe kujdesit për fëmijët mes njëra-tjetrës. Ato gjithashtu mund të kontribuojnë në të holla duke ndihmuar kështu një familje fqinje në nevojë, ose të mblidhen së bashku të premteve për të lexuar Kuranin.

Karz-i-hasen

Karz-i hasen është një aspekt i rëndësishëm i kulturës së bujarisë në Turqi. Kuptimi i shprehjes është "një kredi e mirë." *Karz-i hasen* tregon një kredi e cila shlyhet pa interes, në fund të një periudhe të përcaktuar me marrëveshje nga të dyja palët. Në shoqërinë turke, ashtu si edhe në shoqëritë e tjera myslimane, dhënia e *karzi-i hasen*-it për të ndihmuar dikë për të përmbushur nevojat e tij apo të saj është konsideruar si një vepër e mirë, e shpërblyer nga Zoti. Ajete të ndryshme kuranore dhe traditat profetike e lavdërojnë huadhënien pa interes të parave ndaj njerëzve në nevojë. Një ajet kuranor thotë: "*Nëse Allahut i huazoni diçka të mirë, Ai juve ua shumëfishon atë dhe ju fal; Allahu është shumë Mirënjohës, dhe i Butë.*"[30] Prandaj, paratë e krediturara për një arsye të mirë dhe pa kërkuar interes konsiderohen si burim përfitimi të kësaj bote për huamarrësit dhe burim përfitimi shpirtëror për huadhënësit. *Karz-i hasen*, e cila thuhet se forcon harmoninë sociale dhe bashkëpunimin, është një praktikë e cila ende praktikohet shumë nga turqit, edhe pse sistemi bankar perëndimor është predominues në vend. Për shembull, shumica e turqve preferojnë të paguajnë faturat e tyre mujore ose të blejnë makinat dhe shtëpitë e tyre nëpërmjet *karzi-i hasen*-it prej të afërmve, fqinjëve apo miqve, në vend që të marrin një kredi nga një bankë apo kreditor.

Ringjallja e filantropisë turko-islame nga Levizja Gylen

Siç edhe u pa qartë në shembujt e mësipërm, kultura islame dhe ajo turke janë shkrirë së bashku për të krijuar një traditë të gjatë dhe të pasur të traditës së dhurimit në Turqi. Në këtë kontekst, tani bëhet e lehtë për të parë se një arsye për suksesin e lëvizjes Gylen është aftësia e tij për të fituar besimin e njerëzve përmes depërtimit në rrjetin e filantropisë, një traditë kjo tashmë e pranishme në shoqërinë turke. Për shembull, kur z. Gylen përvijoi

vizionin e tij për të siguruar arsimim cilësor për të gjithë të rinjtë turq përmes krijimit të konvikteve, kurseve përgatitore dhe në fund, shkollave të mesme dhe universiteteve, ai u bëri thirrje të gjithë personave të frymëzuar nga vizioni i tij, për të marrë pjesë në ofrimin e këtyre mundësive për të rinjtë në Turqi. Ai i sfidoi meshkujt dhe femrat për t›u bërë mësues dhe për t'ia kushtuar jetën e tyre të mësuarit të të rinjve, drejtorët të jenë të përkushtuar për të krijuar parakushtet kurrikulare dhe mjediset e përshtatshme për të mësuar, dhe biznesmenët të zgjerojnë bizneset e tyre duke i bërë ato më fitimprurëse, në mënyrë që, pikë së pari, ata të mund të mbështesin financiarisht aktivitetet e lëvizjes. Për më tepër, ai bëri thirrje për referencë në aspektin e vlerave themelore turko-islame, të tilla si mikpritja, bujaria, bamirësia dhe detyrimi për të ndihmuar të varfërit në shoqëri. Këto ide dhe sakrifica për të cilat u bëhej thirrje, ishin të njohura për ata që i dëgjuan, ndaj dhe iu përgjigjën menjëherë thirrjes së Gylenit, sepse ato ishin të ngulitura në kulturën në të cilën ata janë rritur. Gyleni thjesht siguroi mënyrat me anë të të cilave turqit mund të shprehnin bujarinë dhe altruizmin e tyre të rrënjosur në parimet e kulturës dhe fesë së tyre. Me pak fjalë, pjesëmarrësit në lëvizje, të cilët japin sadaka për studentët e varfër, të cilët dërgojnë mishin e tyre të kurbanit për familjet e varfëra në juglindje të Turqisë apo në zemër të Afrikës, të cilët ia dedikojnë karrierën e tyre të biznesit orientimit drejt *veprave të mira* ose që ndihmojnë viktimat e fatkeqësive natyrore, janë të motivuar nga traditat e lashta të bamirësisë dhe filantropisë, të rrënjosura thellë në gjirin e shoqërisë turke.

---

[1] Yavuz dhe Esposito (2003); Park (2007); Fuller (2008).

[2] Ozdalga (2000); Michel (2005); Ergene (2007).

[3] Ebaugh dhe Koç (2007); Kalyoncu (2008).

[4] Fuller (2008).

[5] Magnarella (1974).

[6] Shih për shembull Piece (1964), Magnarella (1974), dhe Delaney (1991). Këta autorë shprehen me tone vlerësuese për mikpritjen turke, por ata ofrojnë shumë pak shpjegim në lidhje me të.

[7] Dede Korkut, f. 29.

[8] Shih për shembull proverbin turk, "Një mysafir është i tillë për tri ditë", i njohur edhe si "Bujtja zgjat tri ditë." Kjo fjalë e urtë tregon se një periudhë qëndrimi triditore është e pranueshme për të dyja palët, dhe se të qëndruarët më gjatë se kaq mund të përbëjë një barrë për të zotët e shtëpisë, përveçse në rastet kur mysafiri fillon të ndihmojë në punët e shtëpisë, si një anëtar i familjes.

[9] Është interesant fakti se fjala arabe e përdorur për të shprehur bamirësinë, *sadaka*, rrjedh nga *sidk*, do të thotë "e vërteta."

[10] Për informacion më të detajuar mbi hadithet që i referohen sadakasë, shih kapitullin "*Sadakaja*" në *Enciklopedia e Islamit*, Vol 26.

[11] Për më shumë informacion në lidhje me praktikën e sadakasë gjatë periudhës osmane, shih *Leksione Historike* nga Dr. Talha Uğurluel (transmetuar rregullisht nga Samanyolu TV) ose *Ligjërata/Vepra* nga historiani i njohur, dr. Ilber Ortaylı.

[12] Këto ide janë shpjeguar nga dijetarët si Ibrahim Hakkı, punimet e të cilit kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të ndihmuar turqit e sotëm të kuptojnë dhe praktikojnë fenë e tyre. *Ibrahim Hakkı, Ruhul Beyan, Istanbul: 1928.*

[13] Tapper (1991).

[14] Karakaş (2002).

[15] Shih, për shembull, këtë ajet kuranor: *"Ata të cilët bëjnë kopraci me atë që nga të mirat e veta u dha Allahu, të mos mendojnë kurrsesi se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. Ajo e mirë me çfarë bëjnë koprraci, në ditën e Kijametit do t'u mbështillet në qafën e tyre. Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka, Allahu është i njohur mirë me ato* që *ju veproni." (3/180*).

[16] Në të kaluarën, thasët e drithrave apo kokrrat e rrushit dhe të hurmave, janë konsideruar gjithashtu të vlefshme për sadakanë e fitrit.

[17] McChesney (1995).

[18] McChesney (1995).

[19] Ibn Had̲ j̲ ar al-Askalānī, Bulūg̲ h̲ al-marām, Kairo n.d., nr. 784. Në: *"Vaḳfi", Enciklopedia e*

Islamit (EI-2).

[20] Po aty, nr. 783.

[21]Për më shumë informacion, shih: www.tr.wikipedia.org/vakiflargenel mudurlugu (11.05.2008), http://www.vakifbank.com.tr/vakifbank-tarihcesi. aspx ose http://www.diyanet-sen.org.tr/article. php?article_id=8. (aksesuar më 11.05.2008).

[22] Cahen C. "Futuvva." *Enciklopedia e Isla*mit (EI-2).

[23] Ergün (1922).

[24] Collin (1960).

[25] Shih gjithashtu: Kurani 64/17 ku thuhet: *"Nëse Allahut i huazoni dicka të mirë, Ai juve ua shumëfishon atë dhe ju fal; Allahu është shumë mirënjohës, i butë."*

[26] Fraza të tjera në gjuhën turke përshkruajnë rastet kur bollëku ose bekimet janë ndërprerë: ("Bet bereket kesildi") apo kanë marrë fund ("Bereket kalktı") për shkak të mungesës së bujarisë së një personi. Shumëllojshmëria e frazave të zakonshme ku përdoret fjala "Bereqet" tregon se ky koncept është bërë një pjesë integrale e kulturës turke.

[27] Al-Bukhârî, Adab, 28. Rijâd-us-Sâlihin(1991).

[28] Sahih Bukhari, Vëllimi 8, Libri 73, Nr. 47.

[29] Diyanet İslam Ansiklopedisi, "Komşu," f. 157.

[30] Kur'an, 64:17.

UJI I NEVOJSHËM PËR TA VËNË NË LËVIZJE MULLIRIN: FINANCIMI I PROJEKTEVE TË SHËRBIMIT TË FRYMËZUARA NGA GYLENI

Për të ndërtuar dhe mbështetur projektet të shumta që lidhen me lëvizjen Gylen, burimet financiare janë thelbësore. Të dhënat e paraqitura në Kapitullin 4, "Rrjeti i Qarqeve Lokale" përshkruan mekanizmat e krijuar brenda qarqeve lokale për të gjeneruar burime të konsiderueshme financiare. Kapitulli 5 "Kultura Turko-Islame e Dhurimit" paraqet konceptet turko-islame të bujarisë dhe mikpritjes, virtyte këto që janë të rrënjosura thellë në kulturën turke. Ky kapitull përqendrohet mbi rregullimet financiare në marrëdhënie me institucionet që janë të lidhura me lëvizjen Gylen.

Në nëntor 2004, z. Gylen u pyet nga një gazetar: "Nga vjen uji që duhet për të vënë në lëvizje këtë mulli?", një aludim figurativ turk i pyetjes "cili është burimi i gjithë këtyre parave që financojnë projektet e frymëzuara nga ju?" Z. Gyleni ka pranuar se atij i është bërë kjo pyetje shumë herë nga ana e politikanëve dhe gazetarëve turq, të cilët pretendojnë se ekzistojnë interesa vetjake apo plane të fshehta, të cilat qëndrojnë në prapaskenë të projekteve të lëvizjes. Ai thotë se ekzistojnë shumë njerëz që nuk do t'ju jepnin as edhe një gotë çaj pa u siguruar se do të marrin nga ju dy gota çaj në këmbim. Megjithatë, këta njerëz z.Gylen i vendos në kontrast me ata të cilët janë të përkushtuar për të mbështetur veprat e mira të frymëzuara nga mësimet e tij. Në lidhje me këta njerëz ai thotë: "Ata janë njerëzit tanë të cilët japin dhe japin vazhdimisht. Ju mund të thoni se ata kanë krijuar varësi ndaj dhurimit. Në qoftë se

atyre u thonë 'mos jepni' ata do ta ndienin veten të pikëlluar dhe të pakënaqur." Ai vijon të tregojë historinë e një pensionisti me të cilin ai pat folur gjatë një fushate për mbledhje fondesh. Burri nuk mund të jepte asgjë, pasi ai vetë zotëronte shumë pak. Kur z. Gylen po largohej nga ndërtesa, burri e arriti nëpër shkallë, i dorëzoi atij një sërë çelësash dhe i tha: "Këto janë çelësat e shtëpisë sime. Unë nuk kam asgjë tjetër për të dhënë përveç kësaj shtëpie, ju lutem merrini këto çelësa.» Z. Gylen ia ktheu çelësat dhe i tha atij të mos shqetësohej, por të dhuronte kur të kishte diçka për të dhuruar. Z. Gylen vijoi bisedën duke lavdëruar njerëzit e Anadollit, si njerëz të mrekullueshëm, të cilët i përkrahin pa hezitim projektet që ata i shohin si të vlefshme, dhe të cilët ndihmojë për të zgjidhur problemet botërore dhe të ardhmen e kombit të tyre. Ai komentoi se liderët e Turqisë nuk kanë qenë në gjendje ta përdorin këtë potencial në popullin e tyre.

Z. Gyleni vetë, kurrë nuk ka pasur pasuri personale në mënyrë që të jetë në gjendje për të sponsorizuar projekte. Ai ka zgjedhur të jetojë një jetë asketike, të përkushtuar ndaj adhurimit dhe leximit. Për vite me rradhë ai ka jetuar në një cep të xhamisë lokale, me aq pak hapësirë, sa mezi mjaftonte për t'u shtrirë. Përveç faktit se kurrë nuk ka patur ndonjë pasuri personale, ai lutet për të afërmit e tij që të mbeten të varfër aq sa për të mos ngritur ndonjë hije dyshimi për fitime të nxjerra nga ndikimi i tij.[1] Ai shfaqej në darkat e mbledhjes së fondeve dhe vizitonte shumë individë të pasur, në përpjekje për t'i bindur ata për të mbështetur një arsim cilësor dhe modern. Megjithatë, përveç inkurajimit të njerëzve që të dhurojnë të mira materiale, z. Gyleni ka qëndruar i distancuar nga të gjitha përfshirjet financiare dhe për më tepër i ka inkurajuar ata që sponsorizojnë projektet, të mbikëqyrin përdorimin e kontributeve të tyre. Ky qëndrim ka ndërtuar besimin në ndershmërinë dhe integritetin e zotit Gylen.

Institucionet e frymëzuara nga Gyleni

Banka "Asya"

Banka "Asya" sot është më e madhja e katër "bankave të pranishme" në Turqi.[2] Banka u themelua në vitin 1996, kur 346 biznesmenë nga e gjithë Turqia blerë aksione në bankë dhe morën një licencë nga Departamenti turk i Thesarit për të hapur një bankë pa interesa (të quajtur fillimisht shtëpia e financave). Në kohën kur u themelua, Bank "Asya" ishte një nga gjashtë bankat e tilla dhe ishte e njohur si Asya Finans. Qysh atëherë njëra nga bankat ka falimentuar dhe dy të tjera janë bashkuar, duke e lënë aktualisht tregun me katër bankat prezente në Turqi, ku Bank "Asya" zotëron pjesën më të madhe të tregut prej 30%.

Në ç'mënyre Bank Asya arriti të quhej një bankë e frymëzuar nga Gyleni? Në fillim të viteve '90 z. Gylen ra dakort me disa biznesmenëve në lidhje me faktin se hapja e një banke pa interesa, ndoshta mund të ishte një ide e mirë. Më parë, në vitin 1983, presidenti i atëhershëm Ozal, nënshkroi një dekret që lejonte themelimin e shtëpive të veçanta financiare të bazuara në bankat pa interes, në mënyrë që t'i shërbenin myslimanëve turq, të cilët nuk dëshironin të vinin paratë e tyre në llogaritë që mbartnin interes. Z. Gylen, një mik i Presidenti Ozal, e pat mbështetur dekretin dhe i pat inkurajuar biznesmenët e fillimit që të vinin në jetë planet e tyre për të hapur një bankë të tillë. Disa prej këtyre biznesmenëve të parë, ishin të frymëzuar nga predikimet dhe shkrimet e z. Gylen. Megjithatë, kjo nuk ishte e vërtetë për të 346 biznesmenët, disa prej të cilëve ishin indiferentë ndaj ideve të z. Gylen, por gjithsesi ata panë një mundësi të mirë fitimi në themelimin e një banke të tillë. Z. Gylen ka marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së bankës dhe u fotografua me disa nga aksionerët nismëtarë, të cilët morën pjesë gjithashtu. Mediat pra, ndihmuan në krijimin e imazhit që kjo bankë është e afërt me lëvizjen Gylen. Versioni më i saktë megjithatë, është se disa nga aksionerët individualë ishin

pjesë e lëvizjes dhe shumica e tyre nuk ishin të tillë.

Disa nga shkollat dhe spitalet e frymëzuara nga idetë e Gylenit, e përdorin Bank "Asya" për disa nga nevojat e tyre bankare. Megjithatë, kjo zgjedhje është e bazuar mbi tenderat konkurrues midis bankave në Turqi. Presidenti i bankës, z. Unal Kabaca këmbëngul vazhdimisht se banka ka punuar shumë për të konkurruar me të gjitha bizneset që ka. Banka nuk ka asnjë avantazh konkurrues me projektet e frymëzuara nga Gyleni dhe duhet të punojë shumë për ta fituar të drejtën e kryerjes së punimeve, siç bën me bizneset e tjera në Turqi. Për shembull, Universiteti "Fatih", një institucion i frymëzuar nga Gyleni, ka punuar për shumë vite me një bankë shtetërore, derisa Bank "Asya" fitoi të drejtën e financimit të tij, duke zhvilluar një sistem grumbullimi që apelon në bordin drejtues të universitetit. Banka ka emetuar një kartë krediti për familjet e studentëve të cilën ata mund ta përdorin për të bërë pagesat mujore të shkollimit, si në shkollat fillore, shkollat e mesme apo universitete. Kjo kartë krediti shkollore ka rezultuar shumë e suksesshme dhe tërheqëse për familjet turke për të bërë pagesat e shkollimit. Megjithatë, Banka "Asya" ofron të njëjtin shërbim të kartës së kreditit për të gjitha shkollat private që janë të interesuara, jo vetëm për shkollat e frymëzuara nga Gylen. Për shkak të suksesit të saj me kartat e kreditit për shkollim, Banka "Asya" tani kryen një numër të shërbimeve të institucioneve arsimore, duke përfshirë edhe disa universiteteve lokale.

Një numër i aksionerëve themelues i kanë shitur aksionet e tyre që zotëronin në bankë, kështu që sot vetëm 30% e aksioneve janë në pronësi të grupit themelues. Sot banka është publike dhe është në pronësi të individëve dhe kompanive të shumta, të cilat kanë blerë aksionet e bankës. Nuk ekziston asnjë mënyrë për të ditur se sa prej këtyre individëve janë të frymëzuar nga z. Gylen, meqënëse lëvizja nuk zotëron një listë anëtarësimi dhe përkatësia

në grup është krejtësisht një çështje individuale. Kryetari aktual i bordit të Bankës Asya, i cili njëkohësisht është edhe një biznesmen i pasur që zotëron disa kompani në industrinë e anijeve, është një mbështetës i projekteve të ndryshme të frymëzuara nga Gyleni, dhe për njëfarë kohe ka qenë në Bordin e Besuar të Universitetit "Fatih". Megjithatë, të qenët një mbështetës i ideve të Gylenit nuk është në asnjë mënyrë një kusht për të zënë një post të tillë. Nuk ekziston asnjë lidhje zyrtare mes z. Gylen dhe bordit drejtues të bankës, oficerëve bankarë, apo klientëve të bankës. Një herë në çdo tre vjet asambleja e përgjithshme e aksionarëve, duke përfshirë edhe investitorët e huaj, zgjedh kryetarin dhe bordin drejtues të saj. Shumica e këtyre aksionerëve nuk kanë dëgjuar kurrë për Fethullah Gylenin apo lëvizjen e tij. Z. Kabaca pretendon se sot për sot, fryma dhe idetë e zotit Gylenit, nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm në bankë.

Z. Kabaca e përshkruan Bank "Asya" si një "bankë islame", aq sa interesi në të holla nuk praktikohet në këtë bankë, por përkundrazi, banka investon në transaksionet e vërteta, që përfshijnë produkte aktuale, në vend të interesit të përbërë vetëm në të holla. Përveç kësaj, banka nuk e financon kumarin apo alkoolin. Disa jomyslimanë, duke përfshirë edhe të krishterë dhe hebrenj, të cilët kanë vërejtje në lidhje me mekanizmin e interesit bankar për arsye të tjera përveç arsyeve që janë të lidhuar me fenë, i depozitojnë paratë e tyre në Asya Bank, veçanërisht në qoftë se vlerat e tyre sociale përputhen me ato të bankës. Është gjithashtu e vërtetë se banka ka pasur një performancë shumë të mirë, duke e rritur kapitalin e saj shtatë deri në tetë herë që nga themelimi i saj 17 vjet më parë. Në vitin 2007, Banka "Asya" ka deklaruar fitime neto prej 51% dhe ka raportuar se fondet në llogaritë e saj janë rritur me 47%, me depozitat e tanishme që shkojnë në mbi 5 miliardë dollarë. Si rezultat i suksesit të saj financiar, banka ka tërhequr investitorët globalë, nga të dyja kategoritë, si individët ashtu edhe kompanitë.

Gjatë krizës financiare të vitit 2002 në Turqi, shumica e bankave nuk do të investonin në kompanitë e ndërtimit, qoftë në nivel lokal apo ndërkombëtar. Banka "Asya" pa në këtë rast një mundësi për rritje, ndaj përkrahu shumë kompani ndërtimore si në rajonin e Gjirit, ashtu edhe në Afrikë. Ky investim ka rezultuar në fitime të konsiderueshme për bankën dhe ka rritur ndjeshëm peshën e saj në komunitetin ekonomik botëror. Sot në të janë institucionalizuar shumë aksionerë, sidomos nga Shtetet e Bashkuara dhe Evropa. Prej shumës 5 miliardë $ që ndodhen në depozitat e saj, rreth 2 miliardë $ vijnë nga individët dhe 3 miliardë dollarët e mbetur nga kompanitë. Bankat e tjera në Turqi, ndërkohë që zotërojnë vetëm 3.2% të biznesit bankar, kanë pasur një rritje prej 1.1% që nga viti 2001 me një projeksion prej 10% të tregut bankar turk në tre vjet.

Si konkluzion, ndërsa z. Gylen fillimisht e ka mbështetur idenë e krijimit të një banke pa interes dhe i ka inkurajuar biznesmenët nismëtarë për të realizuar planet e tyre për të hapur një bankë të tillë, kurrë nuk ka ekzistuar ndonjë lidhje zyrtare midis tij dhe Asya Bank. Ndërsa disa nga aksionerët themelues ishin të frymëzuar nga z. Gylen dhe idetë e tij, ky nuk ishte sigurisht rasti për të gjithë 346 aksionarët nismëtarë dhe kjo gjë nuk ka ndikuar fare në suksesin që ka bërë të mundur që banka të rritej, të bëhej më konkurruese dhe e suksesshme në treg dhe të tërheqë gjithnjë e më shumë investitorët e huaj.

Stacioni televiziv "Samanyolu"

Gjatë viteve '80, z. Gylen filloi të mbronte idenë e mediave të përgjegjshme, duke përfshirë edhe gazetat dhe televizionet. Në vitin 1989 ai u takua me rreth njëzet biznesmenë në Stamboll për të shqyrtuar mundësinë e hapjes së një stacioni televiziv, që do të ishte i angazhuar për të raportuar të rejat e fundit në mënyrë

të balancuar, objektive dhe me përgjegjësi shoqërore, krahas programeve të tjera që do të vinin theksin mbi një orientim familjar pa seksualitet eksplicit apo skena të dhunshme krimi. Disa anëtarë të grupit nismëtar të biznesmenëve vlerësuan se kostoja për hapjen e një stacioni të tillë do të ishte rreth $ 250,000. Biznesmenët ranë dakord për të vënë kapitalin fillestar dhe Samanyolu TV, apo siç quhet ndryshe prej teleshikuesve, STV, nisi punën më 13 janar 1993. Megjithatë, kostoja për hapjen e një stacioni të ri ishte afërsisht katër herë më e lartë nga sa ishte parashikuar. Në gjashtë apo shtatë vitet e para pra, stacioni nuk qe në gjendje për të mbajtur vetveten me të ardhurat e krijuara dhe u subvencionua nga biznesmenët vendas, të cilët ishin pjesë e lëvizjes së frymëzuar nga Gyleni. Megjithatë, pasi kaluan 4-5 vjet, ky stacion u bë gjithnjë e më tepër i pavarur financiarisht, kryesisht nëpërmjet reklamave të paguara, dhe që nga viti 2004 ai ka pasur nevojë për asnjë ndihmë nga mbështetësit lokalë.

Aktualisht, të ardhurat nga reklamat janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e veprimtarisë. Në fakt, stacioni tani ka një marzh fitimi që e lejon atë të zgjerojë programin e tij dhe studiot e transmetimit. Programi i tij aktualisht përfshin drama, sport, komedi, reality show, një program për përgatitjen e ushqimit, programe për fëmijë dhe një program lajmesh 24 orësh. Çfarë e dallon Samanyolu TV nga stacionet e tjera televizive turke, sipas z. Karakas, Drejtori i Marrëdhënieve me Publikun, është se ai e vë theksin mbi një orientim familjar në të gjitha programet e tij. Stacioni përfshin gjithashtu programe që nxisin qëllimet e lëvizjes që kanë të bëjnë me dialogun ndërkulturor dhe ndërfetar. Një nga programet e saj më të njohura në të kaluarën e afërt ka qenë *"Kimse Yok Mu?",* ose "A nuk ka njeri?", një program i cili shpaloste realitetin, i transmetuar që pas tërmetit të vitit 2004 në rrethinat e Stambollit. Punëtorët e shpëtimit që kishin hyrë në zonën e shkatërruar patën shpëtuar një vajzë të vogël, e cila thërriste "A nuk ka njeri aty?" Programi ballafaqonte dy familje,

njërën të varfër dhe tjetrën me burime të mjaftueshme ekonomike. Familja e pasur pastaj vendoste për të ndihmuar familjen e varfër për të rindërtuar jetën e saj pas tërmetit. Si rezultat i këtij programi, donacionet vërshuan nga të gjitha anët në këtë stacion, për të ndihmuar viktimat e tërmetit. Si rezultat i kësaj, u themelua organizata jofitimprurëse e ndihmave *Kimse Yok Mu*?, e cila merret me shpërndarjen e parave për viktimat e tërmetit, si dhe në fatkqësitë e tjera në mbarë vendin dhe globin.

Programi i gatimit të Samanyolu TV, *Yeşil Elma* apo Molla e Gjelbër, renditet në top listën e programe të tilla në Turqi dhe *Tek Türkiye*, një seria televiziv, u bë top-show më i ndjekur në vend gjatë vitit 2008. Duke filluar që nga viti 1998, AGB, një kompani qendrore e cila bën renditjen e stacioneve në bazë të 2,500 matjeve të ndryshme, filloi ta rekomandonte Samanyolu TV për reklamuesit. Fakti që stacioni transmeton programe në shumë gjuhë të ndryshme dhe mund të shihet në shumë rajone të ndryshme të botës me anë të satelitit, ka tërhequr shumë biznese ndërkombëtare dhe ka rezultuar në reklama të fuqishme për stacionin televiziv, duke bërë që Samanyolu TV të kthehet në një biznes fitimprurës.

Gazeta "Zaman"

Në mes të viteve '80, z. Gylen dhe disa prej atyre që qëndronin përreth tij dhe të cilët e mbështesnin ideologjinë e tij, menduan se do të ishte një ide e mirë botimi i një gazete që do të ishte gjithëpërfshirëse në aspektin e raportimit të pikëpamjeve dhe opinioneve të ndryshme ideologjike, do të raportonte lajmet më të fundit në mënyrë objektive, do të promovonte dialogun dhe tolerancën dhe jo urrejtjen midis grupeve dhe do të shmangte alkoolin dhe lakuriqësinë në reklamat e saj. Në vitin 1986, një grup biznesmenësh turq të cilët ishin frymëzuar nga z. Gylen

dhe që mendonin se një gazetë me qëllime të tilla do të ishte një ndërmarrje e mirë biznesi, blenë aksione në letër dhe kështu Zaman nisi punën. Ata ishin biznesmenë të interesuar në fushën mediatike, të cilët e kishin në pronësi dhe e kontrollonin gazetën nga fillimet e saj. Edhe pse disa nga aksionerët themelues ishin të ndikuar dhe të frymëzuar nga z. Gylen, ai vetë nuk kishte asnjë lloj përfshirjeje financiare dhe as administrative në këtë gazetë. Ai kurrë nuk ka shërbyer në bordin drejtues të gazetës ose në strukturën e saj organizative, edhe pse ai çdo të premte shkruan nga një editorial për *Zaman.*

Kryeredaktori i Zaman, z. Ekrem Dumanlı, e shprehu qëllimin e kësaj gazete si vijon: "Ne jemi po përpiqemi për të botuar një gazetë sipas standardeve ndërkombëtare. Ky është standardi ynë, jo ai i prodhimit ti një vandaku letrash propagandistike për të tërhequr ca anëtarë të rinj të komunitetit. Ne duam të kemi një gazetë, e cila të mund të konkurrojë denjësisht me gazetat e tjera, kështu që ne do të dëshironim që "Zaman" të lexohet si gazeta më e mirë, në mënyrë që të inkurajojmë stafin tonë për të na sjellë lajmet më të freskëta.» Sot, 27 vjet nga themelimi i saj, gazeta "Zaman" ka tirazhin më të lartë se çdo gazetë tjetër në Turqi me një mesatare prej 760,000 abonime ditore të parapaguara dhe me një numër total lexuesish që vlerësohet rreth dy deri në dy milion e gjysmë njerëz në ditë (këtu përfshihen edhe ata të cilët e ndajnë abonimin dhe të cilët e blejnë gazetën nga qendrat e shpërndarjes së shtypit.

Krahas versionit në turqisht të saj, ekziston edhe versioni në gjuhën angleze i titulluar "*Today Zaman*", gazetë e cila është pjesë e konsorciumit mediatik *Media Group,* në të cilat gazetat përbëjnë vetëm një pjesë të tij. Përveç kësaj, Media Group përfshin një revistë javore dhe një agjenci lajmesh. Në vitin 2007 të ardhurat për Media Group ishin rreth 250.000.000 $, me mbi gjysmën e tyre që vinin nga abonimet. Megjithatë, për sa i takon gazetave, mbi

50% e të ardhurave vjen nga reklamat dhe më pak nga abonimet. Reklamat vijnë kryesisht nga bizneset kryesore që duan të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të cilat nuk janë të lidhura në asnjë formë me lëvizjen Gylen. Siç shpjegon z. Dumanlı, "Këto biznese vetëm duan biznes të mirë dhe e shohin gazetën tonë si një mënyrë për të arritur nivelin e tregut të tyre të dëshiruar."

Today Zaman është jo vetëm e pavarur financiarisht, por edhe një sipërmarrje fitimprurëse biznesi për aksionerët e saj. Aktualisht, aksioneri më i madh në Zaman është një sipërmarrës i fuqishëm në fushën e tekstilit në Turqi. Z. Dumanlı nuk ishte i sigurt në lidhje me numrin e personave të bordit aktual drejtues janë të lidhur me lëvizjen Gylen. Ai tha se bordi është zgjedhur nga krerët e mediave dhe komuniteti i biznesit të Turqisë, pa ekzistuar asnjë kusht paraprak për sa i takon lidhjeve me lëvizjen.

Kur u pyet se në ç'shkallë gazeta aktuale pasqyron idetë e Gylenit, z. Dumanli u shpreh, se pa ndikimin e zotit Gylen në drejtim të ideve të përbashkëta, "ne nuk do të ishim në gjendje për të nxjerrë këtë gazetë, sepse ne ndajmë së bashku idetë e Gylenit rreth dialogut mes kulturave dhe feve, në atë mënyrë saqë gazeta reflekton një shumëllojshmëri të opinioneve, gjë e cila është e vështirë për t'u vërejtur nëpër gazeta të tjera. Shumica janë ideologjike. Ne përpiqemi për të pasqyruar mendime të ndryshme, sidomos në rang editorialesh. Faqet e rubrikës së opinionit janë të hapura për të gjithë, vetëm se në to nuk mund të gjejë kurrsesi vend urrejtja apo mendimet përçarëse." Ai vijoi të thoshte se editorialistët vijnë si nga e djathta, ashtu edhe nga e majta, çka bën që pikëpamjet rreth çështjeve të ndryshme të mund vijnë nga të gjitha anët e spektrit. Shprehjen e lirë të mendimit, pavarësisht nga feja apo grupi etnik, e mbrojnë me kujdes në politikat e gazetës. Sipas mendimit të zotit Dumanlı, këto politika të mbrojtjes së lirisë së fjalës, janë ato që e bëjnë gazetën "Zaman" të suksesshme. Ndërsa nuk ka ndonjë "klasë Gylen" ose ndonjë mekanizëm zyrtar për

socializimin e stafit të "Zaman"-it me idetë e z. Gylen, ekziston një atmosferë e përgjithshme që përfshin parimet bazë të Gylenit, pra parimet e dialogut, tolerancës, lirisë së shprehjes, angazhimit për demokraci dhe gjithpërfshirje.

Transparenca financiare është një prej kushteve për të qëndruar në biznes për një kohë të gjatë për "Zaman". Çdo vit qeveria heton financat e çdo gazete dhe nëse ka ndonjë shkelje në lidhje me veprimet financiare apo transparencën, gazetat mund të mbyllen apo të gjobiten. Në gjithë historinë e saj 22 vjeçare, Zaman nuk ka pasur asnjë shkelje pavarësisht nga kontrollet rigoroze prej auditeve financiare.

Për të përmbledhur sa thamë më lart, "Zaman" është një gazetë e frymëzuar nga Gyleni, përkundrejt faktit se disa prej aksionerëve nismëtarë ishin të frymëzuar nga idetë e zotit Gylen dhe se ai e pati nxitur botimin e saj. Përveç kësaj, gazeta është e angazhuar për të pasqyruar nocionet e Gylenit rreth dialogut, përfaqësimit të ideve të ndryshme dhe shmangien e urrejtjes. Gjithashtu, kjo gazetë është e kufizuar në reklamat, duke reklamuar vetëm aktivitete të cilat nuk nxisin lakuriqësinë, alkoolin apo aktivitetet e lidhura me krimin. Megjithatë, nuk ka asnjë lidhje financiare midis gazetës dhe lëvizjes Gylen. Ajo është thjesht një sipërmarrje biznesi fitimprurës për aksionerët e saj.

Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve

Gjatë një vizite në Stamboll në vitin 1994, z. Gylen u takua me një grup shkrimtarësh dhe gazetarësh dhe u shpreh se ata kishin një rol të rëndësishëm edukativ për të luajtur në formësimin e ideve të publikut, veçanërisht në lidhje me dialogun në mes kulturave, etnive dhe feve të ndryshme. Vërejtjet e tij erdhën një dekadë apo më shumë pas polarizimit të fortë mes intelektualëve në Turqi, duke rezultuar në disa raste edhe në konflikt të armatosur.

Polarizimet në rritje në mes komunistëve, nacionalistëve dhe grupeve radikale fetare në Turqi dhe lufta brutale në Bosnje-Hercegovinë, shërbenin si sfond për këmbënguljen e zotit Gylen, se dialogu midis kulturave, qytetërimeve dhe feve ishte më i nevojshëm se kurrë në Turqi dhe në botë. Ai u bëri thirrje grupit të shkrimtarëve dhe gazetarëve për të sjellë në të njëjtën tryezë, njerëzit me ideologji të ndryshme me qëllim nxitjen e dialogut dhe i inkurajoi ata për të krijuar një fondacion që do t'i përkushtohej këtij qëllimi.

Në qershor 1994, një grup nga shkrimtarët dhe gazetarët më të rëndësishëm të cilët ishin takuar me z. Gylen dhe ishin frymëzuar nga vizioni i tij i krijimit të bazave të dialogut, themeluan Fondacionin e Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, me seli në Stamboll. Z. Gylen pati rënë dakord për të shërbyer si president nderi i fondacionit, një rol të cilin ai e ka kryer për 10 vitet e para të fondacionit ose më tepër. Në thelbin e Fondacionit qëndrojnë takimet e Platformës së Abantit, një arenë për debat, e cila nxjerr në pah këndvështrime të ndryshme mbi zgjidhjet për sfidat e përbashkëta dhe gjithashtu për vlerat themelore të njeriut, ide të cilat pjesëmarrësit i ndajnë me njëri-tjetrin. Për shembull, këto takime kanë sjellë së bashku turqit me prejardhje të ndryshme intelektuale dhe fetare, duke përfshirë myslimanët, laikët, tradicionalistët, modernistët, ateistët, të krishterët, të majtët dhe konservatorët, për të diskutuar dhe debatuar qëndrimet e përbashkëta mbi çështjet kyçe bashkëkohore. Deklaratat e Platformës së Abantit që rezultojnë nga pikat e diskutuara në këto takime, hedhin dritë mbi marrëveshjet e përbashkëta.

Pjesa më e madhe e financimit për Fondacionin vjen nga botimet e librave të tyre, të cilat u adresohen kryesisht intelektualëve. Ndërsa shumë botues raportojnë shitjet e 2000 apo më shumë kopjeve të një libri, Fondacioni ka shitur mbi 50.000 kopje të disa librave, veçanërisht ato të shkruara nga z. Gylen.

Nga botimet e veta, Fondacioni fiton rreth 300,000-500,000 $ në vit. Shitja e CD-ve muzikore në pjesën më të madhe të viteve, ka qenë gjithashtu një mjet për mbledhjen e disa të ardhurave, edhe pse minimale. Kur Platforma Abant merr përsipër organizimin e një ngjarjeje specifike, të tillë si ndonjë takim apo konferencë mbi një temë të veçantë, Fondacioni i bën thirrje biznesmenëve lokalë për mbështetje. Vetëm në tri raste, Fondacioni ka marrë grante qeveritare për të mbuluar shpenzimet e sjelljes së dijetarëve nga vendet e tjera, vlerë kjo që arrin në më pak se 50,000$. Përveç kësaj, Fondacioni ka iniciuar disa projekte të reja, si një mënyrë për të gjeneruar të holla. I fundit ishte prodhimi i një CD-je nga një këngëtar i famshëm, i cili kishte rënë dakord për t'i dhuruar të ardhurat për qendrat e kujdesit në zonat e varfra, si brenda Turqisë ashtu edhe në botë. Përveç kësaj, Fondacioni arriti të bindte dhjetë këngëtarë të njohur në Turqi, asnjëri prej tyre i përfshirë thellësisht në lëvizje, për të dhuruar performancat e këngëve të tyre për një CD, e cila tashmë është shitur në mbi 200.000 kopje në një periudhë kohore të shkurtër. Të ardhurat e këtyre përpjekjeve ndihmojnë në mbështetjen e punës së Fondacionit. Një tjetër projekt që kishte për qëllim krijimin e fondeve për Fondacionin, është sponsorizimi i mundësuar nga një ndeshje futbolli në mes atletëve të kombëtares turke dhe atletëve të tjerë të famshëm në botë. Paratë e fituara nga ky aktivitet janë përdorur për të hapur shkolla në Bosnjë për nxënësit serbë dhe ata boshnjakë. Konflikti i zakonshëm serbo-boshnjak u ndal në dyert e shkollës për hir të faktit se shkollën e ndjekin fëmijët nga të dy grupet etnike, me qëllim përfitimin e një arsimi cilësor.

Për shkak të statusit të tij si fondacion legal, Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve ka të drejtë të përfitojë nga avantazhet e tatimit mbi pronën, për pronat që zotëron për përdorim biznesi. Megjithatë, fondacioni aktualisht i ka marrë me qera hapësirat, prandaj nuk mund të përfitojë nga ky benefic tatimor. Për shumë vite, Fondacioni e ka mbyllur vitin me borxhe. Megjithatë, falë

botimit të librit më të fundit të zotit Gylenit të publikuar vetëm pak kohë më parë dhe i cili ka qenë shumë i suksesshëm në aspektin e shitjes, Fondacioni planifikon të blejë ca prona së shpejti, të cilat do t'i përdorë për të ndërtuar zyrat e veta.

Universiteti "Fatih"

Universiteti *Fatih* hapi dyert e tij në vitin 1994, një vit pasi Kongresi miratoi kërkesën për të ndërtuar një universitet privat në periferi të Stambollit. Në Turqi vetëm fondacionet bamirëse mund të krijojnë universitetet jopublike, jo individët apo bizneset me qëllim fitimi. "Fondacioni themelues" që pat financuar fillimisht Universitetin "Fatih" ndodhej në Ankara dhe përbëhej nga përkrahës të cilët ishin të lidhur me lëvizjen Gylen. Financimet erdhën nga përkrahësit e Gylenit në dy qytete: biznesmenët nga Ankaraja, të cilët premtuan të holla për të ndërtuar dhe mbështetur nevojat e universitetit dhe biznesmenët nga Stambolli. Një biznesmen i pasur nga Stambolli dhuroi pronën piktoreske në të cilën ndodhet universiteti, e vlerësuar në atë kohë në rreth 5 milion $. Sot prona ka një vlerë prej rreth100 milion $. Pasi u dhurua toka, biznesmenët e tjerë kanë kontribuar në ndërtimin e godinave dhe në hapjen fillestare të universitetit.

Aktualisht, tarifat e shkollimit janë të mjaftueshme për të mbajtur në këmbë universitetin në aspektin e shpenzimeve operative, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e ndërtesave, pagat e stafit të fakulteteve, etj. Megjithatë, ligji turk thotë se ndërtesa nuk mund të ndërtohet me paratë e shkollimit, por që fondacioni themelues duhet t'i sigurojë paratë për shpenzime të tilla. Prandaj secila prej ndërtesave universitare dhe laboratoreve, u ndërtua falë donacioneve të mbledhura nga fondacioni. Disa vite më parë fondacioni ka ndërtuar një laborator që ka kushtuar rreth 7 milion $, në vitin 2007 ka përfunduar së ndërtuari godina e

kursve përgatitore për pranimin në këtë universitet, e cila me siguri duhet të ketë pasur një kosto prej rreth 4 milion dollarësh. Në vitin 2008, universiteti kishte nevojë për 15 milion $ për të ndërtuar laboratore, por ligji turk thotë se nuk mund të investohen aq shumë para brenda një viti, kështu që kjo sasi parash u investua përgjatë dy viteve me radhë.

Shumë njerëz, kryesisht mbështetësit e Gylenit, japin kontribute për fondacionin. Ekziston një numër i vogël individësh shumë të pasur, të cilët japin kontribute të mëdha dhe universiteti shpesh ua vendos emrin e tyre një ndërtese ose laboratori, për nder të donatorëve të tillë. Megjithatë, fondacioni dhe universiteti janë jashtëzakonisht të kujdesshëm në drejtim të pranimit të donacioneve, me synimin për të mos pranuar para nga grupet radikale politike. Kohët e fundit universiteti kishte nevojë urgjente për ndërtimin e disa ndërtesave të reja shkencore dhe pati mundësi për të aplikuar për një grant të zhvillimit nga një bankë islame që ofron para pa interes për universitetet në vendet myslimane, në mënyrë që të promovojë edukimin. Banka ndodhet në Arabinë Saudite dhe paratë mund të merreshin nëpërmjet qeverisë turke. Titullarët e universitetit ia parashtruan propozimin z. Gylen dhe ai u kërkoi atyre me forcë që të mos aplikonin për një kredi të tillë. Siç tha ai, duke pasur parasysh faktin se banka ndodhet në Arabinë Saudite, njerëzit do të akuzojnë lëvizjen se ka pranuar paratë e sauditëve, prandaj ai me këmbëngulje argumentonte se kjo nuk ishte një ide e mirë. Ai i këshilloi titullarët e universitetit të prisnin pak dhe të ishin të durueshëm, sepse paratë do të mund t'i siguronin nga komuniteti i lëvizjes në Turqi.

Në bazë të ligjit të arsimit të lartë në Turqi, në qoftë se një universitet i plotëson kriteret e përcaktuara, qeveria i rimburson atij 15% të buxhetit, çdo vit. Kjo shumë alokohet për secilin nga universitetet e kualifikuara në Turqi. Në vitin 2006 dhe 2007, Universiteti "Fatih" u kualifikua dhe e ka marrë pjesën që i takonte

nga shteti; në vitin 2008 ai nuk arriti të kualifikohej vetëm për një kriter prandaj kjo ndihmë iu mohua.

Marrëdhënia në mes të fondacionit dhe universitetit është rreptësisht monetare. Në fakt, zyrtarët e universitetit nuk e dinë se cili prej tyre shërben në bordin e fondacionit. Zëvendës rektori të cilin unë e intervistova, më rrëfeu një histori për të ilustruar këtë fakt. Kohët e fundit ai ishte në një takim në Stamboll dhe në një rast u shpreh se universitetit i nevojitet më shumë tokë për zgjerim. Një zotëri nga grupi të cilit ai nuk e njihte u shpreh: "Ju doni të thoni se toka të cilën unë ju pata dhuruar fillimisht nuk është e mjaftueshme?" Ishte vetëm rastësisht që ai u takua me donatorin fillestar. Gjithashtu, administratorët e universiteteve nuk janë të vetëdijshëm për faktin se cili shërben në bordin e fondacionit apo kontribuon në fondacion. Paratë i jepen fondacionit i cili e mbështet edhe universitetin në mesin e shumë projekte të tjera. Kur njerëzit i dhurojnë para fondacionit në mënyrë rutinore, ata nuk e dinë me saktësi se pikërisht cili nga projektet do të financohet nëpërmjet donacioneve të tyre.

Fondacioni nuk ka ndonjë kontroll tjetër mbi universitetin përveç sigurimit të fondeve për projekte të veçanta, kur kjo kërkohet nga administrata e universitetit. Askush nga anëtarët e fondacionit nuk bën pjesë në bordin e të besuarve të universitetit ose jep kontribut në punët akademike të Universitetit. Kjo është gjithashtu e vërtetë edhe për donatorët individualë që i dhurojnë para universitetit. Për shembull, pronari i një kompanie të madhe bizhuterish, i cili kishte dhuruar paratë për një ndërtesë në kampus, erdhi për ceremoninë e hapjes së ndërtesës dhe që atë ditë ai nuk është parë kurrë më nga administratorët në ambientet e Universitetit "Fatih".

Kur u pyetën se sa është përqindja e studentëve të Universitetit Fatih që janë pjesëmarrës në lëvizjen Gylen, Dr. Acikgenc, zv-rektori i universitetit, u shpreh që kjo shifër vlerësohet të jetë diku rreth 50%, të cilët janë simpatizantë, që do të thotë se ata janë

të përfshirë në nivele të ndryshme në lëvizje. Universiteti "Fatih" është i njohur edhe si një universitet që lidhet me idetë e Gylenit, kështu që zgjedhja për të studiuar në Universitetin "Fatih" tregon së paku që studenti nuk është armiqësor ndaj lëvizjes Gylen. Nuk ka ndonjë departament studimesh fetare në këtë universitet, e madje asnjë kurs në lidhje me z. Gylen apo idetë të tij; nuk ka asnjë fotografi apo statujë të tij, ose ndonjë qark organizativ apo ndonjë diskutim që të përqendrohet në mësimet e tij. Çdo qark lokal i studentëve që mblidhen së bashku për të diskutuar mbi veprat e zotit Gylen është krejtësisht informal dhe vullnetar. Ekziston një preferencë nga ana e administratorëve për të punësuar persona të cilët janë frymëzuar nga z. Gylen në mënyrë që ata të mund të ruajnë misionin e universitetit nën frymën e z.Gylen. Ndër fakultete, megjithatë, më pak se 50% e stafit vijnë nga radhët e lëvizjes. Universiteti "Fatih" përpiqet të punësojë persona të cilët ndajnë vlerat e përkrahura nga z. Gylen, si ajo e gjithëpërfshirjes, dialogut, respektit për arsimin dhe shkencën, dhe pajisjen e studentëve me një frymë humane, në mënyrë që të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë qytetarë të mirë, asisoj që të jenë të vlefshëm për vendin e tyre.

Në Universitetin "Fatih", ligji turk i ndalimit të alkoolit në kampuse zbatohet në mënyrë rigoroze, gjë që nuk ndodh në shumicën e kampuseve. Për këtë arsye, shumë familje turke shprehen në favor të dërgimit të vajzave të tyre për të studiuar në këtë universitet. Mendohet që vajzat këtu janë më të sigurta dhe nën mbikëqyrje më të rreptë se në shumë universitete të tjera turke. Si rezultat, Universiteti "Fatih" ka më shumë studente vajza në gjirin e tij sesa shumë universitete të tjera.

Spitalet e frymëzuara nga idetë e Fethullah Gylen

Ekzistojnë gjashtë spitale të frymëzuar nga Gyleni në Turqi. Ne kemi vizituar vetëm dy prej tyre, Spitali "Sema" në Stamboll dhe

Spitali "Bahar" në Bursa. Spitali "Sema" është financuar fillimisht nga pesë biznesmenë nga lëvizja Gylen, të cilët dëshironin të nismonin një projekt në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ata e diskutuan këtë ide me z. Gylen duke marrë shembull prej modelit tepër të suksesshëm arsimor të shkollave të frymëzuara nga idetë e Gylenit, duke e zbatuar atë për të hapur një spital privat. Z. Gylen e mbështeti idenë dhe i inkurajoi ata që të vazhdonin më tutje me planet e tyre. Pesë biznesmenët nismëtarë, i siguruan fondet fillestare për Spitalin "SEMA" nga të ardhurat personale dhe paratë që ata ishin në gjendje të merrnin hua për shkak të levave të tyre financiare nga bankat në Stamboll. Të pesë këta biznesmenë nismëtarë janë ende në bordin e të besuarve të spitalit dhe ata mbeten ende të përfshirë ngushtë në veprimtarinë e tij.

Edhe pse Turqia e aplikon shërbimin e kujdesit shëndetësor universal, kjo nuk i mbulon të gjitha shpenzimet në spitalet private. Për disa situata mjekësore, të tilla si probleme të zemrës, kujdesin intensiv dhe trajtimin e syrit, spitali nuk i ka tarifat përtej shumës së parashikuar nga shërbimi i kujdesit shëndetësor universal. Për shërbimet e tjera të cilat nuk mbulohen nga kjo paketë, disa njerëz janë në gjendje të paguajnë privatisht dhe të tjerët jo. Për këta të fundit, shpesh faturat e tyre mjekësore merren përsipër nga sponsorët e lëvizjes Gylen. Ndonjëherë një sponsor e shoqëron një pacient dhe i siguron shërbimet e mësipërme edhe përtej tarifës së rimbursueshme nga ana e shoqërive të sigurimit shëndetësor, duke marrë përsipër shpenzimet ekstra të kurave. Në raste të tjera, sponsorët dërgojnë para anonime për të ndihmuar pacientët në nevojë dhe personeli i spitalit nuk e di se kush janë ata. Në raste të tjera përsëri, pacientët të cilët vijnë në spital, kanë nevojë për trajtim, por pranojnë që në fillim se ata nuk janë në gjendje të paguajnë përtej shumës së rimbursueshme të kujdesit shëndetësor të planifikuar për ta nga ana e qeverisë. Në këto raste, personeli i spitalit përpiqet të gjejë një sponsor, i cili është i gatshëm për të ndihmuar atë pacient të veçantë. Kristin, Administratori i

Shëndetit Publik të spitalit, një i diplomuar në Harvard, komentoi:

"Ne kemi një rrjet të mahnitshëm të njerëzve që sponsorizojnë pacientët që vijnë tek ne për përkujdesje. Ata sponsorizojnë pacientët tanë. Sistemi është shumë informal, por ai gjithsesi funksionon. Lëvizja Gylen është shumë efektive në të qenët e vetëdijshme për faktin se ne jemi një spital i ri dhe kemi nevojë për të mbetur me këmbë në tokë. Sponsorët nuk duan që ne të kemi von*esa në arritjet tona, kështu që ata tregohen shumë bujarë me mbështetjen e tyre."*

Në planin strategjik të spitalit "Sema", nuk ka qëllime financiare. Përkundrazi, theksi është vënë në kënaqësinë e punonjësve dhe pacientëve. Për shkak se ai është një biznes privat, spitali "Sema" është një spital mjaft fitimprurës, megjithatë, fitimet nuk shkojnë në xhepat e biznesmenëve themelues për të rritur të ardhurat e tyre financiare. Përkundrazi, fitimi shkon në përmirësimin dhe zgjerimin e spitalit, duke siguruar më shumë kujdes për të varfërit apo për të ndihmuar spitalet e tjera për të fituar emër, famë dhe sukses. Disa herë gjatë rrjedhës së intervistës me Kristen dhe një grup mjekësh, u theksua fakti se nëse spitali "Sema" ka arritur të zhvillojë një model që funksionon, edhe shumë spitale të tjera si ai do të ndërtohen nga mbështetësit e Gylenit dhe kështu, shumë njerëzve në nevojë do t'u shërbehet nën një atmosferë të trajtimit njerëzor dhe të kujdesshëm.

Spitali "Sema" ndryshon nga spitalet e tjera publike dhe private, në tri aspekte themelore: (l) mënyra sipas të cilës janë të punësuar dhe të paguar mjekët dhe stafi; (2) strategjia e tij e çmimeve, dhe (3) mënyra e trajtimit të pacientëve. Në shumë spitale publike, mjekët janë nëpunës civilë dhe janë shumë të zënë. Siç komentoi një mjek, "Shpesh në spitalet publike, mjekët i trajtojnë pacientët si një telash." Mjeku vazhdoi: "Çdo gjë është ndryshe në këtë spital. Njerëzit nuk punojnë për paratë, por për pacientët." Procesi i punësimit në spitalin "Sema" është mjaft strikt. Ndërsa

kredencialet dhe përvoja janë të rëndësishme për personelin, si mjekësor ashtu edhe jo mjekësor, rekrutuesit dhe personeli i punësimit shikojnë edhe në aspektin e "asaj se çfarë njerëzish janë sesa në atë që kanë bërë." Një infermiere, e cila kënaqet duke ndihmuar njerëzit, mund të jetë shumë më e dobishme për pacientët sesa një infermiere shumë e kualifikuar së cilës nuk i pëlqejnë njerëzit. Një nga mjekët komentoi se shumica prej 80 mjekëve që punojnë në spitalin "Sema" u përkasin qarqeve lokale Gylen që përpara se ata të jenë punësuar dhe të tjerët, të cilët nuk janë të përfshirë në lëvizje, dëshirojnë të punojnë në një vend që është burim humanizmi, duke u bazuar në modelin e shkollës Gylen. Shpesh, mjekët pranojnë një reduktim page kur punojnë në spitalin "Sema", por dëshira e tyre për të qenë pjesë e një stafi që i jep prioritet kujdesit ndaj pacientit në një atmosferë pozitive, i eklipson shqetësimet financiare. Gjithashtu, edhe pjesa tjetër e stafit mjekësor dhe jo mjekësor, e dinë se "Sema" është një spital i frymëzuar nga Gyleni, kështu që nuk do të përzgjidheshin për të punuar atje, nëse ai ose ajo nuk do të ishin në përputhje me kulturën dhe atmosferën e spitalit.

Nga rreth 20.000 mjekët e punësuar në Stamboll, rreth 2.000 janë të lidhur me lëvizjen Gylen dhe janë pjesë e qarqeve lokale të mjekëve. Me shpenzimet e tyre, në prill të vitit 2008, 60 mjekë të lidhur me lëvizjen Gylen, shkuan në Turqinë Jug-Lindore për të vizituar pacientë pa asnjë shpenzim për tri ditë me radhë. Rreth 130 prej këtyre pacientëve, shumica prej tyre me probleme kardiake, u transportuan në spitalin "Sema" dhe u trajtuan falas. Përveç kësaj, qarqet e mjekëve të angazhuar në lëvizjen Gylen, që të gjithë japin para për lëvizjen, ashtu siç bëjnë shumë prej të punësuarve në spital. Në fakt, punonjësit në spitalin "Sema", mbështesin financiarisht një shkollë të frymëzuar nga Gyleni në Shqipëri.

Spitali "Sema" gjithashtu kujdeset për mësuesit në të gjitha shkollat e frymëzuara nga Gyleni kudo në botë, nëpërmjet një

shkalle të faturimit të njëjtë sikurse punonjësit e spitalit, e cila është 80% më lirë se tarifat e zakonshme. Përveçse për të ndihmuar këta mësues, të cilët shpesh punojnë për paga minimale dhe nuk mund të përballojnë sigurimet shtesë të kujdesit shëndetësor, siç thekson Kristen, "Ne dëshirojmë t'i nderojmë ata për punën që po bëjnë." Për shembull, një ditë përpara intervistës sonë, një mësues nga një shkollë e frymëzuar nga Gyleni në Nigeri, erdhi për trajtim mjekësor për shkak të sëmundjeve të shumta. Në shenjë mirënjohjeje për kujdesin që Spitali "Sema" i ofroi këtij pacienti, një ministër nga Nigeria premtoi tokën për të ndërtuar një spital të frymëzuar nga idetë e Gylenit në Nigeri. Njëri nga mjekët që kemi intervistuar tha se disa mjekë në mesin e grupit të atyre që vizituan Turqinë Jug-Lindore për të siguruar kujdes mjekësor janë duke planifikuar të vizitojë gjithashtu Afrikën, për të përcaktuar nëse do të jetë e mundur për të hapur spitale atje, duke u bazuar në modelin e shkollave të Gylenit, modeli i të cilave rezultoi i suksesshëm edhe në rastin e spitalit "Sema". Në fakt, ai u shpreh se një skenar ideal do të ishte të trajnuarit e mjekëve dhe infermierëve në sistemin arsimor Gylen dhe pastaj punësimi i tyre në spitalet e lidhura me lëvizjen, në mënyrë që fryma dhe qëllimet e frymëzuara nga z. Gylen, t'i përshkojnë këto institucione të ndryshme.

Për sa i takon mënyrës se si pacientët e përjetojnë atmosferën unike në spitalin "Sema", Kristen dha shembullin e një punëtori me jakë blu, i cili u shpreh pas operacionit në zemër: "Këtu mësova se unë jam një qënie njerëzore. Unë nuk e kisha kuptuar vlerën time si një qenie njerëzore derisa erdha këtu." Ajo u shpreh se spitali mbart dëshmi të tilla të shumta për sa i takon kujdesit ndaj pacientit, i cili mjaft i ndryshëm në krahasim me shumë spitale të tjera. Disa pacientë nga brenda Turqisë, por edhe nga vende të tjera, vijnë në Spitalin Sema pikërisht sepse ata e dinë se ky është një spital i frymëzuar nga Gyleni. Të tjerët vijnë për shkak se ata kanë dëgjuar që spitali

ofron kujdes të nivelit të lartë, në një atmosferë që e respekton pacientin si një qenie njerëzore.

Spitali "Bahar", Bursa

Spitali "*Bahar*" e nisi punën si një qendër mjekësore në vitin 1998, kur një grup biznesmenësh punësuan 4-5 mjekë për të drejtuar një klinikë të vogël mjekësore. Përveç biznesmenëve, ekzistonte edhe një bazë mbështetjeje nga shumë pjesëmarrës të lëvizjes Gylen në Bursa, të cilët ishin frymëzuar nga ideja që të kishin një qendër mjekësore. Ambulanca e parë u ble me paratë e nxjerra nga shitja e disa bizhuterive të dhuruara nga gratë e mbështetësve. Në 2004, kati i parë i ndërtesës u shndërrua në spital. Në katin e sipërm të ndërtesës, në katin e tetë ndodhej një shkollë e Gylenit, e cila më pas u zhvendos në mënyrë që të mund të zgjerohej hapësira e spitalit. Sot spitali i përfshin të gjitha katet e kësaj ndërtese tetë katëshe me gjithsej 80 shtretër pacientësh. Aktualisht, në këtë spital punojnë gjithsej 53 mjekë dhe 400 veta personel.

Mes pajisjeve të spitalit ndodhen një numër i madh pajisjesh mjekësore moderne, duke përfshirë një aparat kardio-vaskular shumë të shtrenjtë, dhe një staf mjekësor shumë i aftë, i cili ka kryer gjithsej mbi 700 operacione kardiake në ambientet e këtij spitali. Nga tetë spitalet private që ndodhen në këtë qytet, spitali "Bahar" është i treti për nga madhësia, duke kryer rreth 1.000 operacione çdo muaj, me një buxhet vjetor prej rreth 40 milion $ dhe me një normë fitimi prej 10-15%.

Motoja e Spitalit Bahar është: "Besim tek mjekësia" Shpesh pacientët në Turqi dyshojnë se mjekët lëshojnë receta dhe ilaçe për motive fitimi dhe jo për interesin në të mirë të pacientit. Një objektiv madhor i spitalit "Bahar" është që të krijojë besimin tek pacientët e tyre. Për shembull, kohët e fundit një pacient i cili ishte konsultuar më parë tek një mjek okulist në Stamboll për

një opinion rreth një sëmundjeje të syrit dhe ai kishte dyshime në diagnozën që i kishte përcaktuar mjeku, kështu që ai erdhi në spitalin "Bahar" pas këshillës së një miku, i cili i kishte thënë se në këtë spital ai mund t'u besonte mjekëve.

Spitali Bahar këmbëngul që stafi i tij t'i trajtojë pacientët si anëtarë të familjes, duke i bërë ata të ndjehen si «në shtëpi» në atmosferën e spitalit. Stafi, duke përfshirë mjekët, është punësuar në bazë të kompetencës profesionale si dhe qasjeve ndaj kujdesit për pacientin. Rreth 40% e personelit të përgjithshëm janë pjesëmarrës të lëvizjes Gylen, pjesa tjetër prej 60% nuk janë pjesë e lëvizjes, por ndajnë me të vlerën e vënies së kujdesit shëndetësor ndaj pacientit mbi gjithçka tjetër.

Spitali ka një kapacitet të veçantë për pacientët që nuk mund të paguajnë. Gjatë muajve të fundit, mjekët e spitalit shkuan dy herë në juglindje të Turqisë dhe gjetën atje pacientë që kishin nevojë për ndërhyrje kirurgjikale, të cilët pastaj i sollën në spitalin "Bahar" për kurim. Këta pacientë nuk kishin sigurime shëndetësore në mënyrë që të mund të përfitonin nga shërbimi shëndetësor falas që ofron shteti. Megjithatë, nën udhëheqjen e drejtorisë së spitalit është bërë e mundur ekzistenca e një shoqatë, e cila tërheq mjekët të cilët dëshirojnë të bëjnë vepra të mira, diçka e ngjashme me shoqatën "Mjekët pa kufij". Shumica e këtyre mjekëve janë pjesë e lëvizjes Gylen. Shoqata ka dërguar 35 mjekë nga Bursa në një qytet në juglindje të Turqisë dhe 40 të tillë në një qytet tjetër.

Niveli i pagave të mjekëve të këtij spitali është në përputhje me mesataren e pagave të mjekëve në sektorin privat. Spitali këmbëngul që mjekët të paguhen në mënyrë adekuate në mënyrë që ata të mos kenë probleme me pagat e tyre dhe në këtë mënyrë të mund të përqendrohen në kujdesin e mirë ndaj pacientit. Përveç kësaj, shumica e mjekëve në spital i përkasin qarqeve lokale të mjekëve dhe përmes këtyre qarqeve premtojnë mbështetje financiare për projekte të ndryshme, duke përfshirë projektet e

kujdesit shëndetësor, por edhe shkollat dhe bursat studentore. Për shembull, një mjek të cilin e intervistuam, fiton rreth 120.000 $ në vit, ka tre fëmijë dhe personalisht dhuron 30% të të ardhurave të tij vjetore për projektet e frymëzuara nga Gyleni, një kontribut që kap një vlerë prej rreth 40.000$ në vit. Ai thotë se ka njohur mjekë të cilët dhurojnë 50% të pagës së tyre vjetore për këto projekte. Ai vlerësoi se donacionet nga mjekët në Bursa mbështesin rreth 600 bursa studentësh në vit, secila me një vlerë prej 1.500 $ në muaj, me një donacion totale prej 900.000 $ në vit. Përveç kësaj, ai tha se mjekët gjithashtu mbështesin ndërtimin e objekteve të veçanta shkollore dhe projekteve të tjera që mund të lindin.

Kur e pyetën përse e jepte një kontribut të tillë, ai deklaroi:

"Unë e shoh këtë si akt mirënjohjeje ndaj Zotit. Kjo ndjenjë ka lindur tek unë që kur banoja në*për shtëpitë ku qëndronin studentët* që ishin pjesë *e lëvizjes. Mua më lindi ndjenja e mirënjohjes. Unë shikoja gjithashtu biznesmenët që dhuronin shuma të mëdha dhe kam shfrytëzuar cdo rast* për të *bërë të tilla donacione, kur kam pasur mundësi. Kështu që unë besoj se ky akt është i pëlqyshëm* për *Allahun dhe Ai i shpërblen ata të cilët veprojnë sipas dëshirës së Tij."*

Në shkollën mjekësore, ky mjek pati qëndruar në konviktet dhe shtëpitë e studentëve dhe ai vërejti se shuma e parave që ai ka paguar nuk ishte e mjaftueshme për të qëndruar në shtëpi. Ai shihte familjet që i ftonin studentët për darkë dhe ai pyeste veten se nga ku vinin paratë që nevojiteshin për aktivitete të tilla. Pastaj ai e pa se ishin biznesmenët ata të cilët siguronin mbështetjen financiare të këtyre shtëpive, financonin darka dhe projekte të tjera, ndaj dëshironte që një ditë ai të ishte në anën e dhuruesve.

Institucionet arsimore: Konviktet, kolegjet dhe qendrat e kurseve përgatitore

Në zemër të mësimeve z. Gylen qëndron theksi i tij mbi nevojën për arsim cilësor për të gjithë të rinjtë turq. Ai e sheh arsimin si zgjidhjen kryesore për tri problemet që shqetësojnë vendet në zhvillim, të cilat janë injoranca, varfëria dhe skizma e brendshme.[3] Ai vazhdon të argumentojë se, dituria, puna kapitale dhe bashkimi mund t'i luftojnë këto probleme. Ai e sheh injorancën si më seriozen e të gjitha këtyre problemeve dhe arsimin si nevojë më imediate në shoqërinë turke. Ai argumenton se çdo problem në jetën e njeriut në fund të fundit varet nga vetë qeniet njerëzore, ndaj për këtë arsye edukimi është mjeti më efektiv, pavarësisht nëse një shoqëri ka një sistem shoqëror dhe politik të paralizuar apo një të tillë që punon me precizionin e akrepave të orës. Z. Gylen i ka inkurajuar njerëzit t'i shërbejnë vendit të tyre dhe njerëzimit në përgjithësi, përmes promovimit dhe mbështetjes së arsimit.

Së bashku me promovimin e vazhdushëm të arsimit në predikimet e tij, z. Gylen i ka inkurajuar biznesmenët, industrialistët e fuqishëm së bashku me biznesmenët e vegjël, për të mbështetur financiarisht arsimin cilësor. Ai e kuptoi se përgatitja e mësuesve të shkëlqyer ishte një hap i parë kritik drejt arsimit superior në shkolla, por për t'ia arritur këtij qëllimi duhej kohë e mjaftueshme. Prandaj, si një hap i parë, ai inkurajoi pronarët e bizneseve dhe sipërmarrësit për të mbështetur konvikte, ku nxënësit mund të qëndrojnë dhe të studiojnë së bashku nën tutelën e mësuesve të përkushtuar. Ky sistem ishte veçanërisht vital për të rinjtë e zonave rurale, të cilët aplikonin për shkollat e mesme dhe universitetet në qytetet më të mëdha, por nuk mund të përballonin dhomat dhe kurset krahas tarifave shkollore dhe librave. Përveç kësaj, për të siguruar regjimin ditor të studentëve, këto konvikte kishin tutorë të cilët ndihmonin të rinjtë për t'u përshtatur me rregullat e atjeshme dhe me kurset e tyre akademike.

Vetë z. Gylen, gjatë viteve ’70, u kujdes për të rinjtë në disa nga këto konvikte si dhe në banesën e tij. Z. Yavuz, një person nga Bursa tani rreth të shtatëdhjetave, e kujton marrjen me qera të një apartamenti së bashku me vëllain e tij, dhe lëshimi i katit të lartë z. Gylen, i cili i ftonte studentët vazhdimisht në banesën e tij, në mënyrë që të kujdesej për ta. Ai gjithashtu i nxiste edhe studentët e tjerë për t’u shndërruar në mësuesit e atyre që nuk shkonin mirë me mësime.

Dyzet vjet më vonë, në prill të vitit 2008, kur unë kreva një studim rreth lëvizjes në Turqi, konviktet e frymëzuara nga idetë Gylenit vazhdojnë të shtohen në të gjithë vendin duke u bërë përherë e më të shumta në çdo qytet. Këto konvikte janë të sponsorizuara nga biznesmenë lokalë, nga profesionistët dhe punëtorët e lidhur me lëvizjen. Megjithëse tarifat e qëndrimit nëpër këto konvikte janë minimale, shumë studentë nuk mund të përballojnë pagesat dhe kërkojnë bursa. Disa nga konviktet janë krejtësisht të pavarura financiarisht dhe shumica gjejnë mbështetje nga sponsorët lokalë. Siç u vu re edhe në Kapitullin 4, “Rrjeti i Qarqeve Lokale”, shumë sponsorë studentësh nëpër qarqe lokale në konviktet e lëvizjes Gylen, po ashtu edhe shumë pjesëmarrës nëpër qarqet lokale në të cilat kam hasur përpara intervistave, ishin njohur me idetë e lëvizjes Gylenit nëpër konviket në të cilat ata jetonin gjatë shkollës së mesme, ose më shpesh, ndërsa ndiqnin universitetin apo shkollën mjekësore.

Përveç promovimit të krijimit të konvikteve, një projekt i dytë i inkurajuar nga Fethullah Gylen ishte ngritja e qendrave përgatitore pranë kolegjeve për përgatitjen e nxënësve të shkollave të mesme për provimin e detyrueshëm për të gjithë nxënësit që dëshirojnë të ndjekin studimet universitare. Për rreth dy milionë nxënësit e vitit të fundit të shkollës së mesme, të cilët marrin provimin çdo vit, rreth 25% e tyre nuk kanë ndjekur ndonjë kurs paraprak përgatitor për të hyrë në provim. Ky numër rritet në rreth 50%

për ata që regjistrohen nëpër kurset shtetërore ose ato private. Aktualisht, kurset parauniversitare, të pajisura me personel nga edukatorë që ndajnë filozofinë arsimore të Gylenit, ekzistojnë pothuajse në çdo qytet në mbarë Turqinë. Studentët që ndjekin këto kurse përgatitore, i kanë rritur rezultatet e tyre mesatarisht në shifra të tilla që variojnë në 75-80% të kalueshmërisë. Një arsye për suksesin e këtyre kurseve është cilësia dhe përkushtimi i mësuesve të stafit, shumica prej të cilëve janë pjesë e lëvizjes Gylen dhe janë të motivuar nga arsye që shkojnë përtej aspektit material.

Ndërsa kurset përgatitore të frymëzuara nga Gyleni, tani janë në pronësi dhe administrohen si ndërmarrje biznesi, të cilat paguajnë taksat, ekzistojnë shumë studentë që duan të marrin pjesë në këto kurse, por të cilët nuk mund të përballojnë tarifën e caktuar. Të gjitha qarqet lokale që kemi vizituar, sigurojnë bursa për studentët në nevojë, në mënyrë që ata të ndjekin këto kurse përgatitore. Një mbështetje e tillë ofron mundësi për studentët që nuk janë në gjendje të marrin përgatitje cilësisore për provim në ndonjë mënyrë tjetër. Shumë pjesëmarrës në qarqet lokale, përjetuan gjithashtu kontaktin e parë me lëvizjen e Gylenit, ndërsa ishin duke ndjekur një kurs përgatitor. Pra të dyja këto institucione, si konviktet ashtu edhe kurset përgatitore, ofrojnë mundësi arsimore për të rinjtë turq dhe shërbejnë, ndoshta jo qëllimisht, si një mekanizëm rekrutimi për pjesëmarrjen në lëvizje.

Institucionet arsimore: Shkollat e frymëzuara nga Gylen

Koleksionit të lëvizjes Gylen i shtohen edhe shkollat e frymëzuara nga Gyleni (vlerësohet të jenë mbi l, 000) që ekzistojnë në të gjithë Turqinë dhe në rreth 100 vende në të gjithë botën, të vendosura në 5 kontinente. Pikërisht në këto shkolla, filozofia e arsimit e zotit Gylenit është shprehur më qartë dhe ku rezultatet e ideve të tij arsimore janë më të dukshme. Qëllimi i këtyre shkollave është

krijimi i brezave shkencërisht konkurrues, të cilët do të jenë, si besimtarë, ashtu dhe qytetarë të devotshëm. Qëllimi i tyre është kapërcimi i konfliktit të supozuar në mes të besimit mysliman, mënyrës së jetesës turko-islame dhe shkencës perëndimore.[4]

Shkollat janë zakonisht të njohura si "shkollat e Gylenit," edhe pse ato nuk janë në pronësi të tij personalisht, por të kompanive dhe institucioneve private të themeluara nga biznesmenë të cilët janë frymëzuar nga idetë e z. Gylen dhe që duan t'i ndajnë ato me të tjerë. Gyleni vetë ka shumë pak, nëse ka, kontakt me shkollat dhe nuk është në dijeni të numrit të tyre të saktë apo të emrave konkretë të tyre.[5] Shembulli i tij fillestar si edukator, ashtu si edhe idetë e tij për arsimin, komunitetin global dhe përparimin njerëzor, kanë frymëzuar një brez njerëzish për të ndërtuar shkolla në të gjithë Turqinë, Azinë Qendrore, Evropë, Afrikë dhe gjetkë. Pikërisht për këto arsye shkollat janë të njohura si shkollat Gylen.

Ashtu si të gjitha institucionet e tjera të frymëzuara nga Gyleni (p.sh. organizatat e medias, spitalet, konviktet, kurset përgatitore), nuk ekziston asnjë organizatë qendrore ose strukturë formale e cila administron dhe mbikëqyr shkollën. Përkundrazi, çdo shkollë është hapur nga një grup biznesmenësh dhe pjesëmarrësit e tjerë në lëvizjen Gylen, të cilët e shohin nevojën për një shkollë të tillë në një zonë lokale dhe fillojë fushatën për mbledhjen e fondeve dhe hartojnë planet për të mundësuar ndërtimin e saj. Në intervista të shumta, kam dëgjuar në mënyrë të përsëritur se brenda Turqisë nuk ekziston ndonjë mbështetje e qeverisë për rinovimin, ndërtimin ose mirëmbajtjen e këtyre shkollave. Përkundrazi, mbështetja financiare vjen fillimisht nga sponsorët lokalë deri në çastin kur tarifat e shkollimit të paguara nga studentët mund t'i bëjnë këto shkolla të pavarura financiarisht.

Shkollat Gylen janë shkollat private me tarifa të përcaktuara dhe me standarde rigoroze akademike për pranim. Në këtë mënyrë ato janë shkolla elitare në të cilat nxënësit kanë tendencë për të

shënuar arritje të larta akademike në aspekte të tilla si hyrja në universitet dhe sukseset në konkurset shkollore kombëtare dhe ndërkombëtare. Shkollat ndjekin kurrikulat arsimore të vendit pritës, me shumicën e lëndëve, të cilat mësohen në gjuhën angleze krahas gjuhës turke si lëndë e veçantë. Megjithatë, pavarësisht strukturës së tyre tarifore me pagesë, prindërit që paguajnë për shkollim dhe pronarët e bizneseve mbështetës të këtyre shkollave, ofrojnë mundësi shkollimi për disa studentë që vijnë nga sfonde ekonomikisht të pafavorizuara. Përafërsisht 20-40% e trupit të studentëve në çdo shkollë merr bursa mbi bazë nevojash. Prindërit pra, e kuptojnë se paratë që ata paguajnë për shkollimin e fëmijëve të tyre, ndihmojnë financiarisht disa studentë në nevojë. Disa prindër dhe biznesmenë sponsorizojnë gjithashtu krijimin e bursave shtesë për studentët në nevojë.

Në Turqi, kurrikula shtetërore e arsimit është krejtësisht laike me vetëm një orë në javë edukim fetar të detyrueshëm në të gjitha shkollat. Shkollat Gylen ndjekin këtë model dhe zhvillojnë një orë të mësimi fetar të detyrueshëm, e cila nuk përqendrohet vetëm në Islam por edhe në njohjen e nxënësve me fetë e tjera.

Janë disa faktorë që i dallojnë shkollat Gylen nga shkollat e tjera private dhe shtetërore. Së pari, ato e vënë theksin mbi vlerat etike dhe morale. Islami për z. Gylen në thelb është një fe e vlerave etike dhe shkollat Gylen e shohin veten si besnike ndaj Islamit, sepse ato ofrojnë udhëzime dhe shembuj moralë për nxënësit.[6] Së dyti, mësuesit nëpër këto shkolla janë përzgjedhur dhe trajnuar posaçërisht në nocionin e *temsil-it,* apo, thënë ndryshe, përfaqësimit. Në vend që të predikojnë Islamin nëpër shkolla, mësuesit janë model për nxënësit me veprat e tyre të mira dhe sjelljet e moralshme. Për më tepër, angazhimi i mësuesve në zhvillimin arsimor dhe moral të nxënësve, shtrihet përtej orarit normal të shkollës. Nuk është diçka e pazakontë për mësuesit të qëndrojnë për shumë orë pas orarit të shkollës duke kryer

detyrën e tutorit dhe duke punuar me nxënësit. Ata gjithashtu bashkëpunojnë ngushtë me familjet e nxënësve, duke i vizituar shpesh ato në shtëpitë e tyre, për të diskutuar përparimin e një nxënësi apo problemet që mund të jenë shfaqur. Mësuesit janë zgjedhur me kujdes dhe janë rekrutuar zakonisht brenda qarqeve të xhemaateve. Shpesh, mësuesit kanë qenë shkolluar vetë në shkollat e Gylenit dhe shumë prej tyre kanë qëndruar në rezidenca studentore apo shtëpitë e dritës. Përveç kësaj, krahas të qenit kompetent në lëndën e tyre të veçantë, mësuesit duhet të jenë të njohur me to dhe të përkushtuar ndaj idealeve të lëvizjes Gylen.

Z. Gylen i ka inkurajuar vazhdimisht nxënësit e kolegjeve për të zgjedhur arsimin si profesionin e tyre duke promovuar kështu një karrierë në arsim si superiore ndaj një karriere në mjekësi, inxhinieri apo drejtësi, pavarësisht nga perspektivat e një të ardhmeje më të pasur në karrierën jashtë arsimit.[7] Ai thekson se të shërbyerit ndaj të rinjve përmes edukimit është detyrë për çdo qenie njerëzore dhe plotëson qëllimin e krijimit të njeriut. Me një motivim të tillë, z Gyleni e ngriti statusin e mësuesit nga një profesion relativisht të keqpaguar dhe të pavlerësuar në një profesion "të njohur si ndërtuesi kryesor i të ardhmes së vendit."[8] Si rezultat i vlerës që ai u ka dhënë mësuesve, shumë njerëz të rinj nga radhët e pasuesve të Gylenit, në përgjithësi, shfaqin respekt për ata që zgjedhin t'ia kushtojnë karrierën e tyre arsimit. Kjo armatë e mësuesve të përkushtuar, e cila është një pasuri e madhe e shkollave të Gylenit përbën një faktor dominant që shpjegon suksesin e tyre. Fakti që mësuesit janë të gatshëm të sakrifikojnë profesione të tjera potencialisht më fitimprurëse për të punuar në arsim, është një arsye shtesë që motivon edhe biznesmenët lokalë dhe sipërmarrësit për të bërë pjesën e tyre duke mbështetur financiarisht shkollat.

Në shumicën e rasteve, biznesmenët vendas dhurojnë të holla për të ndërtuar një shkollë. Përveç kësaj, shpesh janë dhënë

donacione në natyrë, sidomos nga ana e përkrahësve të bizneseve të ndërtimit dhe mobilieve. Për shembull, shkolla e parë e Gylenit në Bursa ishte një shkollë e mesme ndërtuar në fillim të viteve '80. Grupi i biznesmenëve që unë intervistova atje më treguan se kishin parë nevojën e madhe për një shkollë, meqë shkollat lokale shtetërore ishin të pamjaftueshme. Megjithatë, kjo gjë ishte shumë e vështirë për 20 biznesmenët e parë që u mblodhën së bashku për të ndërtuar dhe mbështetur shkollën, pasi shumica e tyre ishin duke u marrë me një biznes të cilin e kishin të panjohur më parë. Megjithatë, njëri prej tyre u zotua për të blerë hekurin e nevojshëm për ndërtimin dhe një tjetër siguroi çimenton. Ata pastaj kërkuan nga miqtë e tyre në industri të tjera për t'u siguruar çfarëdolloj materialesh që mund t'i shërbenin projektit të ndërtimit të shkollës. Në këtë mënyrë, ata ndërtuan shkollën me një të tretën apo gjysmën e kostos së saj reale. Shkolla në të cilën na u dha rasti të takoheshim me biznesmenët e Bursas, sipas llogaritjeve të tyre, kishte një vlerë prej rreth 14.000.000 $. Për këtë shkollë, ata kishin arritur me sukses të siguronin donacione në të holla. Këta biznesmenë ishin duke u marrë aktualisht me ndërtimin e një shkolle të re në periferi të Bursës. Njëri prej tyre kishte dhuruar tokën për shkollën, një tjetër kishte financuar një nga tre ndërtesat e përfshira në projekt dhe një tjetër biznesmen, i cili nuk ishte i pranishëm, ishte ai që financonte ndërtimin e një godine të dytë.

Që kur u krijuan të parat konvikte, kurse përgatitore dhe shkolla të Gylenit, janë themeluar mjaft fonacione joqeveritare në mënyrë që të sigurojnë dhe shpërndajnë fonde për projekte të ndryshme të frymëzuara nga Gyleni. Zakonisht, donatorët nuk janë në dijeni të plotë rreth projekteve apo studentëve specifikë të financuar nga kontributet e tyre. Paratë i jepen fondacioneve dhe pastaj ato u shpërndahen projekteve sipas nevojave. Megjithatë, gjatë dekadës së kaluar mekanizmi i krijimit të fondacioneve është braktisur në favor të krijimit të bizneseve për të administruar operacionet

për mbledhjen e fondeve që mbështesin projektet e ndryshme të Gylenit. Arsyeja e kalimit nga modeli i fondacioneve në modelin e biznesit ka të bëjë me faktin se fondacionet kanë rregulla më rigoroze sesa bizneset dhe fakti që grushtet ushtarake të shtetit gjatë viteve të kaluara në Turqi kanë rezultuar në krijimin e agjencive të reja qeveritare, të cilat i shpërbënin fondacionet që nga themelet dhe uzurponin burimet e tyre financiare. Gjatë periudhave të paqëndrueshme politike, bizneset janë më të sigurta ne sipërmarrje të tilla sesa fondacionet. Edhe pse këto biznese, në dallim nga fondacionet, janë të përjashtuara nga çdo lloj uljeje apo heqjeje taksash nga qeveria, liderët e biznesit pjesëtarë në lëvizje janë të bindur se faktori i sigurisë mbizotëron ndaj favoreve në taksa. Si biznese që janë, edhe kompanitë mund të nxjerrin fitime, por këto fitime përdoren zakonisht për të hapur më shumë shkolla. Në fakt, kompanitë që financojnë shkollat e Gylenit janë aq të suksesshme financiarisht, saqë kompanitë fitimprurëse të cilat nuk janë të lidhura me lëvizjen, kanë përdorur modelin e tyre për të hapur shkolla private. Megjithatë, këto shkolla nuk u bënë kurrë aq të suksesshme për shkak se shkollat e Gylenit mbështeten në edukatorët e tyre të përkushtuar, e jo në nivelin e shkollimit, për suksesin e tyre.

Herë pas here, ndonjë biznesmen i pasur, siç ishte një i tillë i intervistuar në qytetin Kajseri, dhuron para të mjaftueshme për të ndërtuar një konvikt apo një shkollë të vetme pa u mbështetur nga askush tjetër. Megjithatë, pak njerëz janë në gjendje të bëjnë këtë gjë dhe shumica e projekteve janë ndërtuar nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta nga ana e ithtarëve të shumtë, të cilët japin kontribute.

Biznesmenët në Bursa vlerësuan se atje tani ka rreth 1.000 persona të cilët marrin pjesë në takimet e qarqeve lokale dhe që janë të përfshirë vazhdimisht në projekte lokale, krahas 1.000 të tjerëve të cilët ndihmojnë në projekte specifike. Për grupin e

parë, ata të cilët janë përfshirë pjesërisht në lëvizje, kontributi mesatar vjetor për financimin e projekteve shkon diku mes 15% dhe 20%. Për ata që kanë qenë me lëvizjen prej një kohe të gjatë, si rregull është që ata të ndajnë një të tretën e të ardhurave vjetore për biznesin, një të tretën për nevojat familjare dhe një të tretën për projektet e frymëzuara nga Gyleni. Nisur nga fakti që aktualisht ka shumë pronarë të pasur të biznesit në Bursa të cilët janë pjesëmarrës të lëvizjes, kjo shumë është mjaft domethënëse. Për shembull, një nga biznesmenët në grupin e marrë si shembull ka qenë pronar dhe drejtor i një kompanie të madhe prodhuese të pëlhurës dhe një tjetër zotëron një kompani globale të ndërtimit.

Vlerësimet mbi numrin e shkollave të Gylenit në Turqi dhe gjetkë ndryshojnë në masë të madhe. Başkan vlerëson se janë rreth 2.000 shkolla në 52 shtete në 5 kontinente.[9] Balcı pretendon se lëvizja zotëron 29 shkolla në Kazakistan, 12 shkolla në Azerbajxhan, 13 në Turkmenistan dhe 12 shkolla në Kirgizıstan. I vetmi vend i Azisë Qendrore i cili ka qenë armiqësor ndaj shkollave turke të lëvizjes është Uzbekistani.[10] Ka shkolla të tilla në çdo vend mzsliman, përveç Iranit, Arabisë Saudite dhe Libisë. Gjashtë shkolla në Afganistan u mbyllën nga talebanët, por janë rihapur përsëri tani. Katër shkollat që ndodhen në Irakun verior, kanë kryesisht nxënës kurdë dhe myslimanë vendas.

Është e pamundur për të dhënë shifra të sakta në lidhje me numrin e shkollave të Gylenit si në Turqi, tani edhe të gjithë botën për disa arsye. Së pari, nuk ekziston asnjë agjenci e centralizuar apo strukturë organizative që kontrollon shkollat. Secila prej tyre është në pronësi, financohet dhe operon në nivel lokal. As brenda Turqisë, e aq më pak në nivel global, nuk ka asnjë agjenci kontrolluese apo edhe koordinuese e cila mban evidenca për shkollat. Së dyti, është e vështirë për të përcaktuar saktësisht një shkollë të Gylenit, pasi ekzistojnë forma të shumta sipas të cilave janë të strukturuara këto shkolla dhe se si ato lidhen me sistemet

shkollore në vendet ku ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Në disa vende jashtë Turqisë, shkollat e Gylenit marrin ndonjë mbështetje nga qeveritë përkatëse, sidomos në fillim të aktivitetit, në drejtim të truallit dhe ndërtesave të dhuruara nga qeveria lokale, si një mënyrë për të inkurajuar krijimin e një shkolle të tillë në vend. Shpeshherë, megjithatë, siç theksonte një numër biznesmenësh, ndërtesat përbëheshin nga strukturat e shkatërruara që kërkonin rinovim të konsiderueshëm. Në Azerbajxhan, për shembull, qeveria i dha lëvizjes një ndërtesë për ta përdorur si shkollë. Megjithatë, nevojitej një shumë prej 500.000 $ për të restauruar atë, shumë e cila u sigurua nga populli turk. Pas 3 viteve të funksionimit, shkolla u shndërrua në një institucion fitimprurës. Kur shkollat e para u hapën në vendet me prejardhje turke të ish-Bashkimit Sovjetik, z. Gylen i kërkoi presidentit Ozal, t'u shkruante letra qeverive të këtyre vendeve, ku të kërkojë leje për hapjen e shkollave atje. Z. Ozal ra dakord me kërkesën, duke ofruar mbështetje për zgjerimin e shkollave edhe jashtë Turqisë.

Brenda dy dekadave të fundit, shumë biznesmenë të frymëzuar nga Gyleni, i kanë zgjeruar bizneset e tyre në të gjithë globin, sidomos në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik dhe në Ballkan. Meqenëse ata po bëhen gjithnjë e më të përfshirë nga pikëpamja financiare në këto vende, ata gjithashtu e shohin nevojën për mundësi më të mira arsimore për të rinjtë. Kjo është arsyeja pse shpesh këta biznesmenë, të cilët iniciojnë planet për të ndërtuar një *shkollë Gylen* atje, vënë në dispozicion burimet e tyre si mbështetje financiare dhe nxisin ndihmat financiare nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e tyre të biznesit në Turqi.[11] Në vazhdën e intervistave, kam zbuluar pesë biznesmenë, të cilët kanë financuar individualisht me forcat e tyre ndërtimin dhe hapjen e shkollave të Gylenit në këto vende, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjen, Turkmenistanin, Afganistanin dhe Pakistanin.

Shkollat Gylen janë më të shumta në vendet e ish-bllokut

socialist, sidomos në ish-Bashkimin Sovjetik. Si ish-provinca osmane, Ballkani dhe vendet e Azisë qendrore ishin ndër vendet e para që mikpritën shkollat e Gylenit jashtë Turqisë. Ato janë gjithashtu të pranishme në Evropën Perëndimore, veçanërisht në komunitetet turke në Francë, Gjermani dhe Hollandë. Kohët e fundit, shkollat e frymëzuara nga Gyleni janë hapur në vendet e Azisë Jugore dhe Afrikës.

Jashtë Turqisë, shkollat kanë axhenda të pasura kulturore dhe politike. Në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara, shkollat kanë tërhequr familjet e emigrantëve turq, të cilët dëshirojnë të rrisin fëmijët e tyre sipas "mënyrës turke." Në vendet e pazhvilluara ose në ato në zhvillim të Afrikës dhe Azisë, ato janë mjaft të parapëlqyera nga nxënësit, për cilësinë e tyre të mësimdhënies, teknologjisë dhe standardeve të larta të arsimit. Përqendrimi i lartë i shkollave në Azinë Qendrore, tregon për një shumëllojshmëri të gjerë të pranisë së popullit turk, duke përfshirë turqit e diasporës dhe turqit e Turqisë, dhe do të shërbejnë si një qendër kulturore dhe biznesi duke bërë lidhjet mes biznesmenëve, politikanëve dhe shkollave lokale.[12]

Një objektiv i shkollave të Gylenit në zonat që janë aktive në rekrutimin e të rinjve nëpër grupe terroriste është që të ofrojnë një alternativë për të rinjtë atje. Një studim i kohëve të fundit në Turqinë Jug-Lindore ku PKK (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit), është shumë aktive, siguron të dhëna për disa nga shkollat e Gylenit në këtë zonë, ku rezulton që ato shërbejnë si alternativa për të rinjtë që ishin të destinuar për t'u bashkuar me PKK-në.[13]

Shoqata e ndihmës dhe solidaritetit Kimse Yok Mu*?*

Një përjashtim për modelin e decentralizuar të projekteve të iniciuara dhe drejtuara nga lëvizja Gylen është *Kimse Yok Mu?*, organizata e ndihmave e cila ka evoluar në një organizatë jo

fitimprurëse bamirëse pas tërmetit të vitit 1999 në zemër të rajonit Marmara në Turqi. Kjo agjenci e frymëzuar nga Gyleni, ka një strukturë formale hierarkike dhe mekanizma të organizuara për mbledhjen e fondeve.

Pas 3 viteve të shfaqjes së programit të Samanyolu TV, i cili fokusohej në nevojat e njerëzve të rajonit të Marmarasë dhe nxitjen e fondeve humanitare nga ana e njerëzve dashamirës, në vitin 2002 Shoqata e Ndihmës dhe Solidaritetit *Kimse Yok Mu* u themelua si një fondacion bamirësie. Brenda disa vitesh ajo e zgjeroi aktivitetin e saj me njerëz të tjerë që kishin nevojë për ndihmë, si brenda Turqisë ashtu dhe në mbarë botën. Kontributet e donacioneve si në para ashtu edhe në natyrë, janë grumbulluar nga agjencia gjatë këtyre viteve. Pas tërmetit në Pakistan në vitin 2005, në rajonet e goditura u dërguan ndihma që shkonin në një shumë prej 12 milion $. Në mënyrë të ngjashme, mjaft donacione janë dërguar në Indonezi pas katastrofës së tsunamit në vitin 2004, pas tërmetit në Peru, si dhe në Etiopi dhe Kenia në vitin 2006 për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë për shkak të luftërave fisnore atje. Aktualisht, *Kimse Yok Mu?* është angazhuar në rindërtimin e një vendbanimi të tërë në Darfur, Sudan, përgjatë një periudhe tre vjeçare me një kosto prej 50 milion $.

Kimse Yok Mu? siguron rreth 16 milion $ në vit, një pjesë nëpërmjet teknikave mjaft kreative për mbledhjen e fondeve. Në vitin 2007, donacionet e bëra direkt në një llogari bankare të agjencisë arritën në 6.6 milion $. Afërsisht rreth 558,000 $ janë dhuruar online nëpërmjet një karte krediti. Kuti të vendosura nëpër kioska donacionesh në rrugët e mbushura me njerëz dhe të tjera që ndodhen në dyqanet e bizneseve të vogla, mbledhin çdo vit afërsisht 165.000 $. Teknika më kreative përfshin dërgimin e mesazheve tekst drejt një numri telefoni celular publicitar, të vendosur në dispozicion nga ndonjëra prej tri kompanive të mëdha të telefonisë celulare, praktikë e cila e llogarit sasinë e

dhurimit mujor në faturën telefonike të konsumatorit. Kjo teknikë ka rezultuar në sigurimin e pothuajse një milion dollarëve në vitin 2007. Organizata gjithashtu ka kuti të grumbullimit në vende të ndryshme në të gjithë Stambollin dhe qytete të tjera në Turqi.[14]

Kimse Yok Mu? është një agjenci joqeveritare, së cilës, në vitin 2006, iu dha statusi "Shoqatë e Interesit Publik" nga ana e qeverisë. Ajo e ka selinë qendrore në një ndërtesë pesëkatëshe në Stamboll, administrohet nga një President dhe Kryetar i Komitetit Ekzekutiv, si dhe mbledh dhe shpërndan të holla dhe donacione në natyrë nga selia qendrore.

Ndër projektet e *Kimse Yok Mu?* janë projektet familjare simotra, të ndihmës në natyrë, ndihmës arsimore dhe ndihmës ndaj të huajve. Në projektet familjare simotra shoqata lidh një familje të pasur apo të klasës së mesme, me një familje të varfër. Familja e kamur e ndihmon këtë të fundit me nevoja ushqimore, arsimim dhe mundësi për punësim. Aktualisht, kjo lloj lidhjeje asociuese ka bashkuar rreth 1.500 familje në të gjithë Turqinë dhe shoqata planifikon për të arritur në mbi njëmijë familje gjatë një periudhe pesëvjeçare.[15]

Nëpërmjet bankës së saj ushqimore, *Kimse Yok Mu?* është në gjendje të mbledhë ushqim, rroba, materiale të higjienës, dhe karburant nga individët dhe prodhuesit e këtyre produkteve dhe punon për shpërndarjen e tyre për nevojtarët. Në vitin 2007, shoqata i ka shpërndarë këto mallra në mbi dy milionë njerëz në njëmbëdhjetë vende të ndryshme. Përveç këtyre artikujve ushqimorë, shoqata grumbullon edhe mishin e kafshëve të sakrifikuara gjatë Bajramit të Kurbanit dhe ua shpërndan atë njerëzve në nevojë. Në vitin 2007, janë mbledhur 12.500 kafshë kurbani dhe mishi i tyre është shpërndarë në 45.000 njerëz në 35 vende të ndryshme, përveç 30,000 njerëzve në Turqi.[16]

Kimse Yok Mu? gjithashtu shpërndan mjete shkollore dhe bursa

për studentët e varfër në Turqi dhe gjetkë. Shoqata ka ofruar shërbime ndihme në të mësuar për mbi 20.000 studentë, me ndihmën e vullnetarëve të saj. Ajo ka ndërtuar edhe 11 shkolla në Pakistan, 4 në Indonezi, 1 në Shqipëri dhe një në Turqi. Pas ndërtimin të shkollave, shoqata i administron ato me ndihmën e qeverive lokale.[17]

Organizata gjithashtu organizon kontrolle mjekësore falas dhe jep ilaçe për banorët në zonat rurale. Kohët e fundit, *Kimse Yok Mu?* ka organizuar grupet lokale të përkrahësve për t'u sjellë ndihmë atyre që jetojnë në juglindje të Turqisë dhe të cilët janë duke vuajtur për shkak të konfliktit me PKK atje. Një grup mjekësh lokalë vizitoi rreth 8.000 pacientë në qytete dhe fshatra të ndryshme, ndërsa ka një grup punëtorësh shpërndau ushqime dhe veshje të cilat ishin mbledhur nga donacionet në Stamboll, Bursa dhe qytete të tjera në Turqi. Më shumë se 50.000 njerëz kanë përfituar nga këto shërbime, kryesisht në Turqi, por edhe në disa vende afrikane, Pakistan dhe Bangladesh.

Modele të brendshme që kanë të bëjnë me institucionet e frymëzuara nga Gyleni

Ekzistojnë modele mjaft të qarta anembanë institucioneve të ndryshme të frymëzuara nga Gyleni të përshkruara më lart, në origjinën e tyre, strukturën e tyre organizative, financimet e tyre dhe sidomos për sa i takon frymës dhe kulturës që i përshkon ato. Për këto arsye, ekziston tendenca për t'i karakterizuar këto institucione si organizata të frymëzuara nga Gyleni.

Frymëzimi fillestar

Në çdo rast, pa përjashtim, frymëzimi dhe motivimi për themelimin e institucioneve të tilla buron nga idetë dhe mësimet

e z. Gylen. Projektet arsimore, duke përfshirë konviktet, kurset përgatitore dhe shkollat, ishin rezultate të drejtpërdrejta të këmbënguljen e tij të vazhdueshme se arsimi ishte përgjigja e duhur ndaj varfërisë dhe konflikteve të brendshme që ai vërente në Turqi dhe në mbarë botën gjithashtu. Dëshira e tij përvëluese për të edukuar të rinjtë, është reflektuar pothuajse në të gjitha predikimet dhe shkrimet e tija të shumë viteve më parë, dhe mund të konsiderohet si një nga ëndrrat më të hershme të z. Gylen. Ai ishte i bindur se edukimi i të rinjve ka qenë një përgjigje për mungesën e modernizimit dhe njohjen globale të Turqisë, si dhe një antidozë për terrorizmin dhe konfliktin, në vend dhe në mbarë botën.

Organizatat e mediave të lidhura me lëvizjen (d.m.th. gazeta "Zaman", Samanyolu TV, Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve) u themeluan nën modelin e objektivitetit, raportimit të balancuar dhe përgjegjësisë shoqërore, ide këto të mbrojtura nga z. Gylen, sidomos në vitet '90. Përveç kësaj, ai ka këmbëngulur se mënyra e vetme për të arritur paqen dhe harmoninë në mes grupimeve të ndryshme, ishte duke lejuar shprehjen e lirë të mendimeve dhe nëpërmjet krijimit të dialogut midis grupeve që synojnë mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë. Të gjitha organizatat e mediave që u themeluan nga idetë z. Gylen, i kanë këto qëllime si agjendën e tyre eksplicite.

Spitalet u themeluan nën frymën e zotit Gylen të respektit për të gjithë njerëzit, përfshirë pacientët, si dhe për t›u kujdesur për nevojat themelore të njerëzimit, njëra prej të cilave sipas vizionit të tij, ishte kujdesi adekuat mjekësor dhe humanitar. Çdo spital i frymëzuar nga Gyleni, është i përkushtuar për të siguruar nivel të lartë kujdesi mjekësor, jo vetëm për ata që mund ta përballojnë atë, por edhe për pacientët që kanë nevojë për ndihmë financiare për të marrë një trajtim mjekësor cilësor.

Banka "Asya" ndoshta është institucioni më pak i lidhur me

realizimin e ideve të zotit Gylen, edhe pse ai në mesin e viteve '90, ra dakord me disa biznesmenë turq për faktin se kishte ardhur koha për të themeluar banka pa interes për ata myslimanë të cilët refuzonin të vendosnin paratë e tyre në llogaritë me interes të ofruara nga bankat shtetërore dhe private në Turqi. Edhe pse nuk ka pasur ndonjë lidhje zyrtare midis zotit Gylen dhe Bankës "Asya", disa nga aksionerët fillestarë të bankës ishin të frymëzuar nga idetë z. Gylen.

Udhëheqja e shoqatës *Kimse Yok Mu?*, për sa i takon agjencisë së ndihmës, ecën në gjurmët e frymëzimitit për shqetësimit e zotit Gylenit për njerëzit në nevojë kudo ku ata ndodhen. Në fakt, ky është i vetmi institucion ndër ata që kam vizituar, i cili ka klasa të strukturuara dhe programe për stafin e tij, të cilat përqëndrohen tërësisht në idetë e z Gylen si një burim frymëzimi.

Ndërsa mësimet dhe frymëzimi i z. Gylen qëndron prapa të gjitha këtyre projekteve si dhe fakti që ai ishte i përfshirë fillimisht në disa prej tyre, siç ishin konviktet e para dhe kurset përgatitore, por edhe prania e tij në hapjen e Bankës "Asya", gjithsesi ai mbetet i përfshirë pak ose aspak, në shumicën prej këtyre projekteve. Përjashtimi i vetëm qëndron në faktin se ai shkruan një editorial javor për gazetën "Zaman" dhe shumë nga librat e tij janë botuar nga Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve. Ai aktualisht nuk ka asnjë lidhje me Bankën "Asya", Samanyolu TV, Universitetin "Fatih", spitalet, shkollat, apo organizatat humanitare. Tashmë është shndërruar në diçka të zakonshme për grupet e biznesmenëve për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara, ku z. Gylen jeton tani, për t'u konsultuar me të në lidhje me mënyrën se si ata planifikojnë një projekt, ose kur lind një çështje specifike për të cilën ata kërkojnë këshilla. Për shembull, ai u pyet si në rastin e planit për hapjen e Bankës "Asya", por edhe së fundi, nga administratorët e Universitetit "Fatih", kur ata ishin të ftuar të aplikonin për një grant të zhvillimit nga ana e qeverisë turke, të nënshkruar nga

Arabia Saudite, për të financuar zgjerimin e universitetit. Gyleni u pat rekomanduar që ata të mbështeteshin vetëm në burimet turke. Përveç këtyre rasteve periodike dhe shumë specifike, z. Gylen nuk është e përfshirë në funksionimin normal të institucioneve të frymëzuara nga idetë e tij.

Idetë përshkuese

Ekziston një kulturë organizative në secilin nga institucionet e Gylenit që kam vizituar, e krijuar nga idetë e frymëzuara nga Gyleni dhe idealet që i përbëjnë ato. Këto ideale janë aq të forta dhe të përhapura saqë ato i karakterizojnë organizatat me tipare të përbashkëta. Këto përfshijnë objektivat në vijim: edukimin e të rinjve në shoqëri dhe ndërthurjen e trajnimeve intelektuale me ato shpirtërore; ofrimin e arsimit modern në të gjitha fushat e jetës, duke vënë theksin në nacionalizmin turk dhe vlerësimin e së kaluarës turke, angazhimin në dialogun ndër-kulturor dhe ndërfetar; tolerancën ndaj ideve dhe mendimeve të ndryshme, dashurinë dhe respektin për gjithë njerëzimin; një vizion global, mikpritjen dhe ofrimin e shërbimit si dhe të ndihmuarit e qenieve njerëzore në nevojë.

Si në mjediset arsimore, ashtu edhe nëpër spitale, organizata humanitare ose organet e medias, cilësitë e mësipërme ishin të dukshme në mënyrat në të cilat këto organizata janë strukturuar, në qëllimet e tyre dhe në stafin e personelit të këtyre institucioneve. Si është arritur kjo? Fakti që një pjesë e konsidrueshme e grupeve kryesore në secilën prej organizatave, përbëhet nga pjesëmarrësit në lëvizjen Gylen, shumica e të cilëve janë pjesë e qarqeve lokale brenda profesioneve dhe lagjeve të tyre, do të thotë se këta njerëz kanë studiuar dhe diskutuar vazhdimisht mësimet dhe shkrimet e z. Gylen, si dhe të gjithë traditën profetike islame. Prandaj është një kuadër i personelit, i cili është i përfshirë brenda një grupi

të ideve dhe vlerave të përbashkëta. Pavarësisht se të qenët një anëtar i lëvizjes nuk përbën një kusht për punësim në shkolla, konvikte, spitale apo në organizatën bamirëse *Kimse Yok Mu?*, prapëseprapë një vëmendje e posaçme i është dhënë punësimit të vetëm atyre njerëzve, të cilët ndajnë të njëjtat vlera dhe qëllime si grupi kryesor i anëtarëve të lëvizjes. Për këtë arsye, nëpërmjet këtyre mekanizmave të socializimit dhe punësimit, është krijuar një kulturë që e dallon secilin prej institucioneve që Gyleni ka frymëzuar.

Angazhimi i personelit

Krahas ndarjes së një kulture të përbashkët të ideve dhe vlerave, dhe si pjesë e kësaj kulture, një arsye e madhe për suksesin e institucioneve të Gylenit është angazhimi dhe përkushtimi i personelit që i drejton ato. Cilindo që unë intervistova, qofshin mjekë ose administratorët e spitaleve, drejtorët apo mësuesit në shkolla, zëvendësrektori i Universitetit "Fatih", apo stafi në *Kimse Yok Mu?*, të gjithë ata u shprehën se ata ishin duke punuar jo vetëm thjesht për të fituar një pagë, por sepse ata besonin në atë që ishin duke bërë. Si rezultat, ditët e punës tentojnë të shtrihen përtej një dite normale tetëorëshe, stafi merr përgjegjësinë dhe kujdesin për pacientët dhe studentët, përtej kërkesave të zakonshme të punës dhe për habinë time, ankesat dhe pakënaqësitë ndaj punës ishin minimale. Përkundrazi, në të gjitha institucionet e lartpërmendura, njerëzit që kam takuar dhe intervistuar ishin shumë të lumtur që punonin atje, mendonin se ata ishin pjesë e aktivitetesh të vlefshme dhe ishin mirënjohës që ata mund të shërbejnë për njeriun e tyre. Përveç këtyre motiveve idealiste, është rasti të theksohet se të jesh pjesë e një shkolle apo projekti tjetër të frymëzuar nga Gyleni, kjo ofron edhe një mbështetje të fortë sociale dhe një angazhim kuptimplotë. Gjithashtu, për shembull, mësuesve nëpër shkollat u është garantuar se ata dhe familjet e tyre do të marrin kujdesin e

duhur në aspektin e sigurisë së punës, strehimit dhe shpenzimeve mjekësore. Të gjitha këto benefice kanë bërë të mundur motivimin e personelit për t'u angazhuar në punën e tyre dhe për t'u çliruar nga të gjitha llojet e shqetësimeve që ndeshin shumë punonjës.

Mbështetja financiare

Me përjashtim të Bankës "Asya", e cila që nga fillimi ishte një sipërmarrje e biznesit, të gjitha projektet e tjera të frymëzuara nga Gyleni, ishin që të gjitha të financuara fillimisht nga grupet e mbështetësve lokale, të cilët dëshironin të bënin realitet idetë e z. Gylen, duke krijuar institucione së bashku me kulturat e tyre organizative, të cilat do të shprehnin këto ideale. Karakteristikë e lëvizjes Gylen është decentralizimi i saj, organizata lokale. Në çdo rast që kam studiuar, iniciativa, planifikimi dhe financimi i shkollave, konvikteve, kurseve përgatitore, spitaleve dhe organizatave të mediave, ka ardhur kur një grup i mbështetësve të Gylenit, ku zakonisht përfshiheshin biznesmenë vendas, ishin mbledhur së bashku dhe kishin përcaktuar që në komunitetin e tyre kishte lindur nevoja për një institucion të caktuar. Ata pastaj ishin zotuar para njëri-tjetrit të kërkonin donacione në natyrë dhe asistencë financiare nga miqtë, familja dhe të njohurit. Në shumicën e rasteve ata krijuan një fondacion apo biznes në mënyrë që të grumbullonin dhe administronin projektin në fjalë ose projekte të tjera të ngjashme në zonën e tyre të banimit.

Ndërsa shkollat e Gylenit u ndërtuan në vendet jashtë Turqisë, veçanërisht në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, modeli i zakonshëm i punës për hapjen e tyre ishte, që një ose disa biznesmenë turq, të cilët kishin veprimtari në një vend të caktuar, fillonin dhe të financonin një shkollë lokale, shpesh me mbështetje financiare edhe nga të njohurit e tyre të biznesit në Turqi. Në shumë raste, një ose disa qarqe lokale të mbështetësve të Gylenit, binin dakort

për hapjen e një shkolle në një vend tjetër dhe ofronin mbështetje financiare për këtë shkollë. Në raste të tjera, një biznesmen në Turqi bie dakord për të ndërtuar dhe për të mbajtur një shkollë jashtë vendit. Kam dëgjuar shumë shembuj të mbështetësve të Gylenit në Turqi, të cilët kishin vizituar shkollat simotra dhe shpreheshin me krenari të madhe për këto shkolla.

Modelet e zakonshme në të gjitha institucionet e frymëzuara nga Gyleni është se ato mbështeten në përkrahjen e sponsorëve për ndërtimin e godinave dhe për funksionimin e institucionit. Megjithatë, në të gjitha rastet këto projekte janë të pavarura financiarisht brenda pak viteve. Shumica e shkollave që kam vizituar, ishin në gjendje për të siguruar mbështetjen e tyre përmes tarifave të shkollimit brenda 2-3 viteve të hapjes së tyre. Të gjitha shkollat ofrojnë bursa, të cilat variojnë nga 5,000-9,000 $ në vit për disa studentë në nevojë, të cilët nuk mund të përballojnë tarifën e shkollimit. Në shumicën e rasteve, përkrahësit e qarqeve lokale, vazhdojnë të ofrojnë disa nga këto bursa. Përveç kësaj, megjithatë, shkollat shndërrohen shumë shpejt në institucione të pavarura financiarisht dhe brenda pak viteve të para të funksionimit, nuk kanë më nevojë për mbështetje financiare nga jashtë. Modelet e zakonshme të punës, siç vura re në Bursa, ishin që grupi nismëtar i përkrahësve të gjente një projekt të ri sapo shkolla e hapur prej tyre të mos kishte më nevojë për mbështetjen e tyre financiare. Në Bursa tani ndodhen gjashtë shkolla të frymëzuara nga Gyleni dhe shtatë të tjera do të hapen së shpejti, çdonjëra prej të cilave e financuar nga mbështetësit lokalë të lëvizjes Gylen. Gjithashtu, të dyja institucionet shëndetësore, si Spitali "Sema" në Stamboll ashtu edhe Spitali "Bahar" në Bursa, tashmë janë kthyer në vetëfinancuese, edhe pse ato u mbështetën fillimisht nga sponsorët për të nisur aktivitetin dhe për të funksionuar gjatë viteve të para të punës së tyre.

Cilësia e institucioneve

Një karakteristikë themelore e institucioneve të Gylenit është cilësia e tyre e lartë, pavarësisht sektorit në të cilin ato operojnë. Të gjitha shkollat e frymëzuara nga Gyleni, janë të njohura si në Turqi ashtu edhe në shumë vende të tjera në të cilat ato tani veprojnë, si shkolla elitare. Fakti që një përqindje shumë e lartë e nxënësve të tyre e kalojnë me sukses provimin e pranimit në universitet dhe shkojnë nëpër shumë universitete si brenda Turqisë, ashtu edhe jashtë vendit, si dhe numri i jashtëzakonshëm i nxënësve nga shkollat e Gylenit që fitojnë çmimet e para në konkurset si brenda Turqisë, ashtu edhe nëpër olimpiadat shkencore ndërkombëtare, është dëshmi e përsosmërisë së arsimimit të ofruar në këto shkolla.

Spitalet e lidhura me lëvizjen, kanë gjithashtu një reputacion të mirë në Turqi, duke qenë ndër më cilësoret e spitaleve private. Meqenëse pagat e mjekëve janë konkurruese për nivelin e spitaleve private dhe për shkak të kujdesit ndaj pacientit që karakterizon këto institucione mjekësore, disa nga mjekët më të mirë të Turqisë shërbejnë atje. Të dy spitalet që vizitova, si "Sema", ashtu edhe "Bahar", posedonin në laboratorët e tyre pajisjet më të sofistikuara mjekësore, të tilla si makinat digjitale të rezonancës magnetike, dhe kishin aftësinë për të kryer operacione të hapura në zemër me mjetet më të fundit. Për disa prej këtyre pajisjeve, mbështetësit lokalë të lëvizjes, vazhdojnë të sigurojnë ndihmë financiare, në mënyrë që spitalet të mund të blejnë pajisjet më të fundit dhe më të avancuara në tregun mjekësor.

Banka "Asya" është tashmë më e madhja e bankave të pranishme në Turqi. Edhe pse ajo e ka marrë ndër të fundmet licensën për ushtrimin e aktivitetit bankar të ofruar nga qeveria, brenda 12 viteve ajo ka fituar një të tretën e tregut të bankave të tilla në Turqi, me depozita aktuale që shkojnë në mbi 5 miliardë $. Gjithashtu, gazeta "Zaman" tani ka tirazhin më të madh të gazetave të pranishme në tregun mediatik në Turqi. Fondacioni i

Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, edhe pse ka vetëm 19 vjet që kryen aktivitetin e tij, ka qenë në gjendje për të mbledhur së bashku liderët fetarë dhe politikë për dialog ndërfetar dhe ndërkulturor nga arena të shumta të konfliktit, si në Turqi, ashtu edhe në mbarë botën. Për shembull, në vitin 2006, udhëheqësit nga grupet më të mëdha fetare në Turqi (si p.sh. myslimanë, të krishterë ortodoksë, hebrenj) u mblodhën së bashku në Goteborg të Suedi, për të diskutuar për çështjet që ndajnë dhe bashkojnë komunitetet. Në të njëjtin vit, Fondacioni mbështeti një takim dialogu mes liderëve turq dhe francezë për të diskutuar në lidhje me pluralizmin kulturor në Evropë. Ai ka mbajtur një sërë takimesh në të cilat është diskutuar në lidhje me procesin e anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian, duke përfshirë edhe një të tillë në Egjipt në vitin 2007, takim i cili u përqendrua rreth Islamit, Perëndimit dhe Modernizmit. Fondacionit i janë njohur meritat nga shumë qeveri dhe organizata jo-qeveritare, përfshirë qeverinë e Turkmenistanit, Federatën Ruse, Seminarin e Hartfordit në Shtetet e Bashkuara, për sa i takon të qenit në mesin e organizatave më efektive në krijimin e dialogut ndërmjet grupeve në konflikt prej në kohe të gjatë me njëri-tjetrin.

Prandaj, pavarësisht nga sektori në të cilin ato veprojnë, institucionet e frymëzuara nga Gyleni, ndajnë së bashku karakteristikat e mësipërme, të cilat i shënojnë këto përpjekje si ato të institucioneve të shkallës së parë të cilësisë. Kjo ndodh në pjesën më të madhe për shkak të angazhimit të vullnetarëve dhe mbështetësve, të cilët dhurojnë kohën, talentin dhe burimet e tyre financiare për të sjellë në jetë projektet e shërbimeve të lidhura me lëvizjen, të mbrojtura fort nga Gyleni, në mënyrë që të mundësojnë krijimin e një shoqërie më të mirë, kudo ku ata janë të vendosur.

---

[1] Aslandoğan dhe Çetin (2006).

[2] Për një diskutim në lidhje me financat islame, shih Yousef (2000).

[3] Ünal dhe Williams (2003).

[4] Turam (2004).

[5] Carroll (2007).

[6] Solberg (2005).

[7] Aslandoğan dhe Çetin (2006).

[8] Po aty.

[9] Başkan (2004).

[10] Balcı (2003).

[11] Balcı (2003).

[12] Turam (2004).

[13] Kalyoncu (2008).

[14] Koç (2008).

[15] Bölükbaş (2008).

[16] Sakin dhe Albayrak (2007).

[17] Bölükbaş (2008).

[18] Po aty; Koç (2008).

PËRMBLEDHJE

Unë e nisa studimin e paraqitur në këtë libër duke ngritur tri pyetje themelore: Cilat janë mekanizmat organizativë, të cilat gjenerojnë përkushtim dhe entuziazëm nga ana e përkrahësve të lëvizjes dhe të cilat na ndihmojnë të shpjegojmë përse lëvizja Gylen është përhapur si një lëvizje ndërkombëtare? Sa është i lidhur angazhimi i anëtarëve me mekanizmat financiarë që mbështesin projektet e shërbimit, në mënyrë që të promovojë përfshirjen, entuziazmin dhe angazhimin e mbështetësve të lëvizjes? Cilat janë marrëveshjet financiare me institucionet e lidhura me lëvizjen dhe në çfarë mënyre janë mbështetësit të lidhur financiarisht me projektet e frymëzuar nga Gyleni? Në këtë kapitull përmbyllës unë kam përmbledhur përgjigjet për këto tri çështje bazuar në intervistat që kam kryer me një rrjet të gjerë të përkrahësve të lëvizjes Gylen, si në Turqi ashtu edhe në Hjuston, Teksas.

Në mënyrë që t'u jap përgjigje pyetjeve të mësipërme studimore, unë kam kryer intervista me individë dhe grupe të interesit, me pronarët e bizneseve, profesionistët dhe punëtorët me jakë blu në qytete, qyteza dhe fshatra në Turqi (p.sh. në Stamboll, Ankara, Bursa, Kajseri dhe Mudanja). Përveç këtyre, unë kam intervistuar mbështetësit e një grupi lokal në Hjuston, Teksas. Në to përfshihshin si burrat, ashtu edhe gratë me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike dhe kohëzagjatje të ndryshme të përfshirjes në lëvizje. Më tej, kam intervistuar drejtorë të shkollave dhe zyrtarë të lartë administrativë në institucionet e mëposhtme, të frymëzuar nga Gyleni dhe idetë e tij: Banka "Asya", stacioni televiziv "Samanyolu",

gazeta "Zaman", Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, Universiteti "Fatih", Spitalet "Sema" dhe "Bahar", pesë shkolla të frymëzuara nga Gyleni dhe Shoqata e Ndihmës dhe Solidaritetit *Kimse Yok Mu?*.

Si pjesë e projektit fillestar për t'iu përgjigjur pyetjeve të përshkruara më sipër, unë kam intervistuar vetëm anëtarët pjesëmarrës në lëvizje. Nga pikëpamja metodologjike, kjo ka kuptim nëse duam të studiojmë ata që janë përfshirë në këto institucione, në mënyrë që të përcaktojmë se çfarë i motivon njerëzit që të jenë të përkushtuar për një lëvizje dhe për të konstatuar mekanizmat e financimit brenda institucioneve të veçanta. Si rezultat, ky libër nuk është një vlerësim kritik i lëvizjes nga perspektiva të ndryshme. Për të arritur një qëllim të tillë do të duhej përdorur një metodologji e ndryshme, ku përfshihet intervistimi i njerëzve me këndvështrime të ndryshme rreth lëvizjes. Përkundrazi, libri është një analizë sociologjike e strukturës së lëvizjes, me theks të veçantë mbi mekanizmat e përkushtimit të anëtarësisë, dhe projekteve të shërbimit që janë rezultatet e dukshme të kësaj lëvizjeje.

Falë trajnimit tim akademik si sociologe, është pikërisht këndvështrimi sociologjik ai që më ofroi lentet me anë të të cilve unë kam formuluar formatin tim kërkimor të punës. Duke pasur parasysh natyrën vullnetare të pjesëmarrjes në lëvizjen dhe strukturën johierarkike, e cila ishte mjaft e dukshme, unë u fokusova veçanërisht në mekanizmat strukturorë dhe motivues që promovojnë dhe nxisin angazhimin ndaj qëllimeve dhe projekteve të lëvizjes. Duke pasur parasysh faktin se qindra shkolla elitare, gjashtë spitale private, një perandori mediatike, një universitet privat si dhe një agjenci ndihmash në raste fatkeqësish, ishin të lidhura në njëfarë mënyre me lëvizjen, kam kuptuar se çështja e financave duhet të trajtohet si pjesë e analizës organizative. Unë, gjithashtu duke u bazuar në teorinë tradicionale organizative, kam pasur dyshime, qysh nga fillimi, që një marrëdhënie e fortë ekziston

mes strukturave financiare dhe angazhimit për anëtarësim.

Në bisedat me kolegët, nxënësit dhe një numër botuesish potencialë, unë e kuptova se shumë pak nga lexuesit perëndimorë kishin dëgjuar sado pak për vetë Fethullah Gylenin ose për Lëvizjen Gylen. Pra, ishte e nevojshme, për të filluar me një kapitull mbi jetën dhe mësimet e z. Gylen, si dhe me një histori të shkurtër të lëvizjes që ai frymëzoi. Përveç kësaj, lëvizja është shumë me tipare turke, jo vetëm për faktin se shumica e mbështetësve janë turq, por veçanërisht në aspektin e origjinës historike dhe politike. Unë dyshoj, se lëvizja Gylen mund të kishte lindur në formën e saj të veçantë, duke arritur një përqendrim të këtillë në ndonjë vend tjetër në botë. Rrënjët e saj shtrihen në një periudhë të caktuar historike, e cila ekzistonte qysh katër dekada pas lindjes së Republikës Turke. Evolucioni i lëvizjes u ndikua shumë nga ngjarjet sociale dhe politike që ndodhën në Turqi gjatë viteve 1960 dhe të cilat pasuan këto katër dekada, si dhe ngjarjet që kanë ndodhur që atëherë e deri në shekullin XXI. Prandaj u ndieva e detyruar, që të përfshija në studim një kapitull të shkurtër mbi historinë e Turqisë, me përqendrim kryesisht në marrëdhëniet ndërmjet Islamit dhe shtetit.

Përfundimet e studimit

Unë tani po u rikthehem edhe një herë tri pyetjeve kërkimore, të cilat kanë udhëhequr grumbullimin e të dhënave dhe organizimin e këtij libri dhe po mundohem të përmbledh shkurtimisht përfundimet e mia.

1. Cilat janë mekanizmat organizativë të angazhimit që i tërheqin dhe i mbajnë anëtarët të lidhur kaq fort brenda lëvizjes? Nga këndvështrimi sociologjik i teorive organizative, veçanërisht ato teori që parashikojnë angazhimin e anëtarësimit dhe mobilizimin e burimeve, aspekti themelor strukturor i lëvizjes,

i cili gjeneron angazhimin, shtrihet brenda qarqeve lokale. Këto qarqe përbëhen nga biznesmenë, nëpunës specialistë dhe punëtorë të ndryshëm në qytetet qytezat dhe zonat rurale të Turqisë, të cilët takohen rregullisht për të lexuar interpretim të Kuranit dhe shkrimet e dijetarëve myslimanë, sidomos z. Gylen, për t'u lutur së bashku, për të ndarë idetë dhe nevojat e njerëzve në grup si dhe për të përcaktuar projektet e shërbimit (si për shembull, shkolla, spitale, konvikte studentore, ndihma në raste fatkeqësish, etj.), projekte të cilat grupi i zgjedh për të mbështetur financiarisht. Shpesh, qarqet vendore përbëhet nga njerëz, të cilët punojnë në të njëjtin profesion (si p.sh. mjekë, avokatë, biznesmenë, punëtorë fabrikash) ose që jetojnë në të njëjtin komunitet banimi. Këto grupime natyrore nxisin miqësinë, si dhe krijojnë lidhje të cilat lehtësojnë marrëdhëniet profesionale dhe të biznesit.

Qarqet lokale janë të bazuara në xhemaatet tradicionale turke, një lloj grupimi me bazë shoqërore, që pati evoluar qysh pas formimit të Republikës dhe nxjerrjes jashtë ligjit të urdhrave sufi dhe medreseve. Xhemaatet u formuan për t'i praktikuar myslimanët që dëshironin të ruanin trashëgiminë islamike, ndërsa përpiqeshin për t'iu përshtatur modernizmit. Ato ishin të organizuara rreth dijetarëve dhe intelektualëve, të cilët përkushtimin fetar e kishin të përzier me një formë të nacionalizmit apo të individualizimit të praktikave shpirtërore.

Gjatë viteve të rinisë, z. Gylen ishte pjesë e një xhemaati të organizuar rreth mësimeve të Said Nursiut, një dijetari sufi i cili promovoi harmoninë mes shkencës dhe arsyes, nga njëra anë, dhe shpalljes dhe besimit nga ana tjetër. Ndërsa idetë e zotit Gylen filluan t'i tërhiqnin përkrahësit në Turqi në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, ai i inkurajoi ata që ishin të interesuar, të mblidheshin së bashku në xhemaate për të diskutuar idetë e tij, si dhe ato të lidhura me shoqërinë moderne turke.

Intervistat e mia me anëtarë të lëvizjes Gylen, tregojnë qartë se lidhjet sociale të ofruara nga të qenët pjesë e një qarku lokal, janë një shpërblim i madh për anëtarët. Pjesa dërrmuese e mbështetësve të lëvizjes, e përshkruajnë anëtarësimin e tyre në një qark lokal si një element kryesor përcaktues në jetën e tyre dhe si diçka që përshkon identitetin, përparësitë dhe jetën e tyre të përditshme.

Lëvizja Gylen nuk ka formalisht një strukturë hierarkike të organizuar, por është më tepër një rrjet i koordinuar lirisht i qarqeve lokale, ku secili prej tyre ka autonominë e vet në aspektin e përmbajtjes dhe shpeshtësisë së takimeve, diversitetit të anëtarëve dhe projekteve që duhen mbështetur. Kjo strukturë bazë promovon përkushtimin dhe angazhimin për faktin se çdo punë që kryhet, është inicuar dhe realizuar nga vetë anëtarët. Autoriteti dhe struktura e decentralizuar administrative, promovon përfshirjen e anëtarëve dhe një ndjenjë të përgjegjësisë nga ana e miliona pjesëmarrësve, të cilët nuk kanë asnjë interes personal në arritjet e lëvizjes. Rezultati është krijimi i një grupimi mjaft koheziv, i cili ndan qëllimet dhe vizionin e prezantuar nga Fethullah Gyleni, si dhe një angazhim ndaj njëri-tjetrit, për realizimin e projekteve të planifikuara nga vetë grupi.

2. Në ç'mënyrë mekanizmat financiarë të përfshira në financimin e projekteve të shërbimeve, nxisin entuziazmin, përfshirjen dhe angazhimin e mbështetësve të lëvizjes? Si mundësohet motivimi i anëtarëve për të dhuruar? Dhurimi financiar është një element i pandarë në gjirin e përkrahësve të lëvizjes Gylen. Z. Gylen, vazhdimisht, në predikimet dhe shkrimet e tij gjatë viteve, i inkurajon mbështetësit për të dhuruar në çfarëdolloj mënyre që të jenë në gjendje, duke përfshirë edhe shërbimin në shkolla, spitale dhe shoqata humanitare, si dhe dhënien e mbështetjes financiare për projektet e shërbimit. Si rezultat, shumë mbështetës, veçanërisht në vitet e para të lëvizjes, ndoqën rrugën e sponsorizimit të shkollave, dhe u bënë

administratorët dhe mësuesit në shkollat e frymëzuara nga Gylen, duke sakrifikuar karriera më fitimprurëse, në mënyrë që të kenë një rol në krijimin e shkollave të cilësisë së lartë të cilat z. Gylen kishte parashikuar për Turqinë.

Z. Gylen predikonte, se të gjithë kishin një rol për të luajtur në realizimin e vizionit të tij për përmirësimin e edukimit për çdo të ri në Turqi. Ai inkurajon vazhdimisht sipërmarrësit dhe biznesmenët e pasur, por edhe pronarët e bizneseve të vogla, për të mbështetur arsimin cilësor dhe për të krijuar truste që mbështesin financiarisht ndërtimin e shkollave fillore dhe ato të mesme, konviktet dhe kurset verore për përgatitjen e nxënësve të shkollës së mesme për provimin e detyrueshëm të universitetit. Për të mundësuar sigurimin e donacioneve të tilla, ai i inkurajoi mbështetësit të zmadhojnë bizneset e tyre sa më shumë të jetë e mundur, sidomos në nivel global, të cilin ai e shihte si të ardhmen ekonomike të botës. Pra, një pjesë e pasurisë së akumuluar duhet të përdoret për të mbështetur projekte edukative që do të eliminojnë varfërinë, injorancën dhe imoralitetin në mesin e të rinjve. Z. Gylen argumenton se në një treg të lirë solid është e nevojshme për të prodhuar pasuri ekonomike, e cila të mund të mbështesë një sistem arsimor modern.

Për inkurajimin e një dëshire për të dhuruar, z. Gylen iu referua një tradite të gjatë në kulturën turke dhe islame. Përveç zekatit, një nga pesë shtyllat e Islamit, kusht i cili kërkon dhënien e një pjese të caktuar të pasurisë së dikujt ndaj të varfërve një herë në vit, sadakaja është një dhuratë bamirësie, e cila është dhënë me qëllimin e vetëm të fitimit të kënaqësisë së Zotit dhe të shpresuarit e një shpërblimi në botën tjetër. Nocioni i mikpritjes apo fqinjësisë së mirë, është ngulitur në kulturën turke dhe i ka gjurmët në fjalët dhe veprimet e Profetit, i cili ka theksuar me forcë rëndësinë e marrëdhënieve të mira me fqinjët. Në kërksën që njerëzit të mbështesnin shkollat cilësore dhe projektet arsimore në çfarëdo mënyre që të ishin në gjendje, z.

Gylen ka shprehur thirrjen e tij për veprim në drejtim të këtyre vlerave themelore turko-islame. Ai thjesht siguron mënyrat me të cilat ata mund të shprehin bujarinë dhe altruizmin, virtyte të cilat janë të ngulitura thellë në kulturën dhe fenë e tyre.

Në mënyrë të përsëritur, të intervistuarit deklaruan se të gjithë të përfshirët në lëvizje, japin një lloj kontributi financiar në varësi të rrethanave apo mundësive të tyre. Ishte bërë e udhës në mesin e njerëzve në qarqet e ndryshme lokale, që donacionet të varionin midis 5% dhe 20% me një mesatare prej 10% të të ardhurave vjetore. Një grup i vogël biznesmenësh dhuron një kontribut mbi 20%, duke përfshirë edhe disa të cilët i ndajnë fitimet e tyre vjetore në tri pjesë, ku një të tretën e përdorin për biznesin, një të tretën për shpenzimet e jetesës dhe një të tretën që mbetet ia dhurojnë lëvizjes për të mbështetur një ose më shumë projekte të shërbimit.

Një rrjedhojë e paparashikuar e dhurimit financiar, praktikisht nga ana e çdo përkrahësi në lëvizje, është gjenerimi i përkushtimit ndaj grupit, mësimet dhe idealet themelore të tij, dhe projektet që ai mbështet. Një forcë e madhe e qarqeve lokale është diskutimi i vazhdueshëm i koncepteve të shprehura në Kuran, traditat profetike dhe veprat e z. Gylen. Këto qarqe pra, sigurojnë motivimin shpirtëror për dhënien e donacioneve dhe e përcaktojë këtë virtyt si një pjesë integrale të jetës fetare dhe patriotike të dikujt. Përveç përcaktimit të projekteve të denja për mbështetje financiare, dhurimi i parave jo vetëm demonstron përkushtimin ndaj lëvizjes dhe veprave të saj të mira, por gjeneron një angazhim të tillë, i cili krijon një ndjenjë të pronësisë të përbashkët ndaj projekteve të shërbimit.

3. Cilat janë marrëveshjet financiare të lidhura me institucionet që bashkëpunojnë me lëvizjen Gylen dhe në çfarë mënyre mbështetësit janë të lidhur financiarisht me projektet e frymëzuara nga Gylen?Së pari dhe më kryesorja, z. Gylen asnjëherë nuk ka zotëruar pasuri personale të mjaftueshme për të

sponsorizuar projektet, pra në këtë mënyrë, është e qartë se kurrë nuk kanë qenë e as nuk janë sot paratë e tij, ato të cilat qëndrojnë prapa shumë projekteve, që ai fillimisht frymëzon dhe të cilat më pas administrohen nga mbështetësit e tij. Në vitet e tij të hershme, ai u pat shfaqur evente të shumta për mbledhjen e fondeve dhe pat vizituar individët e pasur, në përpjekje për t›i bindur ata që të mbështetnin shkollat e shkëlqyera dhe projektet e tjera arsimore në vend. Megjithatë, pavarësisht nga motivimi i njerëzve për të dhënë kontribute financiare për projektet, ai ka ruajtur distancën e tij nga të gjitha llojet e përfshirjes financiare dhe ka inkurajuar grupe lokale si për të siguruar të holla për projekte lokale, ashtu edhe për të mbikëqyrur veprimtarinë e tyre. Kjo qasje ka ndërtuar besimin në qëllimet e tij.

Me përjashtim të Bankës "Asya", e cila ishte tërësisht një sipërmarrje e biznesit që nga fillimi, projektet e tjera të frymëzuara nga Gyleni që kam studiuar, janë financuar kryesisht nga të gjitha grupet e mbështetësve lokalë. Duke pasur parasysh karakterin e decentralizuar të organizatave lokale të lëvizjes, në çdo rast inicimi, planifikimi dhe financimi i projekteve, është realizuar kur një grup i mbështetësve të Gylenit, zakonisht biznesmenë vendas, mblidheshin së bashku dhe vendosnin se kishte lindur nevoja në komunitet për një institucion të veçantë. Ata pastaj merrnin zotime për të dhënë nga paratë e tyre dhe kërkonin nga të tjerët në komunitet të merrnin iniciativën për të kontribuar, zakonisht nëpërmjet ndonjë fondacioni apo biznesi, i cili do të ngrinte dhe administronte projektet.

Modeli i zakonishëm i funksionimit të institucioneve të frymëzuara nga Gyleni, është se ato mbështeten në përkrahjen e sponsorëve për ndërtimin e godinave dhe funksionimin e institucionit. Megjithatë, brenda pak vitesh këto projekte bëhen të pavarura financiarisht nëpërmjet tarifave të shkollimit, pagesave, regjistrimeve, etj. Sapo një shkollë apo spital të bëhet

financiarisht i pavarur ndaj mbështetjes së sponsorëve, praktika i sponsorizimeve është nisja e ndërtimit të një shkollë të ose spitali të ri në një zonë ku një nevojë e tillë ekziston, brenda Turqisë, ose në një vend tjetër.

Në vitet '90, së pari në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, ishte praktikë e zakonshme për një ose disa biznesmenë turq të cilët kishin lidhje biznesi në vend të veçantë, për të mbledhur së bashku udhëheqësit e komuniteteve lokale dhe liderët e biznesit dhe për t'i inkurajuar ata të përcaktonin nevojat në zonat e tyre lokale. Biznesmenët më pas fillonin financimin e një projekti lokal, zakonisht një shkollë, shpeshherë edhe me mbështetjen e biznesmenëve të tjerë në Turqi. Me kalimin e kohës, ndërkohë që shkollat bëheshin të pavarura financiarisht, biznesmenët bëheshin më pak të përfshirë dhe ia kalonin shkollën nën mbikqyrje mbështetësve dhe administratës lokale.

Si përmbledhje, lëvizja Gylen është një rrjet i organizuar lirisht organizatash lokale në të cilat mbështetësit bashkëveprojnë nëpërmjet takimeve të tyre nëpër qarqet lokale. Brenda këtyre qarqeve, mbështetësit lexojnë dhe diskutojnë idetë e paraqitura nga Kurani dhe dijetarët islamë, sidomos nga Fethullah Gyleni. Përveç kësaj, grupet lokale mbështesin njëri-tjetrin si emocionalisht ashtu dhe nëpërmjet ndihmës materiale, kur kjo është e nevojshme. Grupi gjithashtu zgjedh projekte të tilla të frymëzuara nga Gyleni si shkolla, kurse përgatitore, konvikte, spitalet dhe organizata humanitare, të cilat ai vendos për t'i mbështetur përmes punës vullnetare dhe kontributeve financiare. Përfshirja në qarqet vendore, së bashku me donacionet financiare, gjenerojnë atë lloj të angazhimit në lëvizje, që ka rezultuar në përhapjen e saj në mbi 100 vende të ndryshme në pesë kontinente.

Në përfundim, lëvizja Gylen është një iniciativë qytetare e iniciuar së pari në Turqi në vitet '60 nga vetë Fethullah Gylen, dhe ka ardhur duke u përhapur në mbarë botën nëpërmjet diasporës

turke. Lëvizja angazhohet për një arsimim kualitativ dhe modern për të gjithë të rinjtë, për dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor, si dhe për bashkëpunimin e ndërsjellë mes grupimeve kulturore dhe fetare. Këto synime themelore të lëvizjes, së bashku me kontributet e saj të projekteve të shumta të shërbimit, kanë rezultuar në njohjen e lëvizjes Gylen si një lojtar i rëndësishëm në promovimin e bashkëjetesës paqësore dhe paqes globale.

SHTOJCË:
ZËRAT E KRITIKËVE KARSHI LËVIZJES GYLEN

Gjatë udhëtimeve në terren në Turqi dhe në bisedat e mia me emigrantë turq në Hjuston, për mua u bë e qartë se lëvizja Gylen ka edhe kritikët e saj. Në një përpjekje për të mësuar natyrën e këtyre kritikave, unë kam zhvilluar 25 intervista me një rrjet të gjerë të kritikëve më në zë, duke përfshirë profesorë universitetesh, gazetarë, biznesmenë, studentë të diplomuar, personel ushtarak në pension, juristë dhe njerëzit që punojnë në fusha të tjera, të cilët janë identifikuar si njerëz me pikëpamje të ashpra kundërshtuese ndaj lëvizjes. Këto të dhëna janë raportuar në një shtojcë në vend që të prezantohen në trupin e librit, sepse formati im origjinal i studimit nuk përfshin intervista me kritikët e lëvizjes. Vetëm gjatë rrjedhës së shkrimit të librit, kam pasur mundësi për të intervistuar disa nga kritikët. Unë nuk kam përzgjedhur një mostër të rastit të kritikëve dhe pa dyshim, kam biseduar me personat më të ashpër dhe më kundërshtues në mesin e tyre.

Qëllimi i kësaj shtojce është të tregoj se lëvizja Gylen është e diskutueshme, si në Turqi ashtu edhe në diasporën turke, dhe për të shprehur disa nga shqetësimet kryesore që kritikët kanë në lidhje me lëvizjen. Unë do të paraqes kritikat kryesore të përmendura gjatë intervistave të mia dhe pastaj do të përshkruaj të dhënat e paraqitura në këtë libër nga intervistat me anëtarët e lëvizjes, si dhe deklaratat e z. Gylen, të cilat u referohen këtyre kritikave. Kjo shtojcë, në asnjë mënyrë, nuk është konceptuar si një vlerësim

ndaj lëvizjes, përkundrazi, qëllimi im është për të treguar faktin se jo të gjithë turqit janë mbështetës të lëvizjes dhe se ekzistojnë edhe zëra të fortë kundërshtues ndaj saj.

Frika e krijimit të një shteti islam

Së pari dhe ajo që përsëritet më shpesh, është frika se z. Gylen është duke krijuar një bazë të fortë përkrahësish, me qëllim për të përmbysur "laicizmin" e themeluar në Turqi nga Ataturku. Siç është theksuar në Kapitullin 2, "Islami dhe shteti përgjatë historisë turke", më 29 tetor 1923, Ataturku pati propozuar një amendament në Parlament për ta transformuar vendin në "Republikën e Turqisë" duke shfuqizuar kështu Kalifatin. Duke formësuar Ministrinë e Çështjeve Fetare dhe duke mbyllur zyrën e autoritetit më të lartë fetar në vend. Parlamenti mbylli gjykatat e sheriatit, i bëri medresetë të heshtnin, i vendosi të gjitha organizatat fetare nën kontrollin e qeverisë, shfuqizoi Ligjin islam të sheriatit, dhe e zëvendësoi atë me një kod të ri penal. Disa vjet më vonë, në vitin 1928, Parlamenti e fshiu nga Kushtetuta frazën "feja e shtetit turk është Islami" dhe në vitin 1937, Kushtetuta u ndryshua duke deklaruar se Turqia është në të vërtetë një shtet laik. Kështu, mundësia për një shtet islamik u zvogëlua në favor të legjitimitetit republikan, të regjimit shekular.[1] Ataturku besonte se Turqia duhet të linte pas të kaluarën e saj osmane dhe të ndiqte shembullin e progresit dhe modernizimit, të përcaktuar nga Evropa dhe bota perëndimore. Për më tepër se 70 vjet, Republika e Turqisë është qeverisur si një shtet laik, me fenë të kufizuar rreptësisht në sferën private, modeluar sipas sistemit të laicizmit, të cilin Ataturku dhe turqit e rinj e patën përshtatur nga përvoja frënge. Kritikët e zotit Gylenit frikësohen se mos synimet e tij të vërteta janë përmbysja e republikës laike e frymëzuar nga Ataturku dhe krijimi i një shteti islamik në Turqi, si ai që solli Ajatullah Khomeinin në pushtet në Iran që nga viti 1979. Ata kanë frikë se lëvizja është një kërcënim

i llogaritur kundër qeverisë laike në Turqi, dhe se zoti Gylen dhe mbështetësit e tij janë duke hedhur themelet me anë të drejtimit të një numri të madh ithtarësh dhe burimet e konsiderueshme financiare, me qëllim parakalimin e qeverisë turke në një moment të caktuar në të ardhmen.

Duke lexuar me qindra faqe të fjalimeve dhe shkrimeve të zotit Gylen, si dhe duke biseduar me mbi njëqind pasues të tij, unë nuk kam vërejtur asnjë shenjë se ai synon të marrë përsipër rrëzimin e shtetit turk dhe zëvendësimin e qeverisjes laike me një shtet islamik. Në fakt, z. Gylen parapëlqen të qëndrojë larg debateve politike. Gjithashtu, pasuesit e tij shumë rrallë angazhohen në diskutime politike, nuk organizojnë grupime politike mbi bazë të veprimit dhe nuk janë të përqendruar në ndryshimin e strukturës politike, si në Turqi ashtu edhe në vendet e tjera ku ata janë të vendosur. Bazuar në të dhënat e mia, unë jam dakord me Graham Fuller, ish zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Zbulimit në CIA, se lëvizja Gylen nuk është një lëvizje politike, por një lëvizje sociale, që synon të ndryshojë zemrat dhe mendjet e individëve, në drejtim të një tolerance më gjithpërfshirëse, përgjegjësisë sociale dhe modernizimit, si dhe në drejtim të arritjeve arsimore dhe shkencore.

Gyleni dhe mbështetësit e tij nuk i sfidojnë reformat e bëra nga Ataturku në aspektin e modernizimit, për një Turqi të fortë dhe për rëndësinë e arsimit dhe aftësimit në arritjet shkencore. Përkundrazi, lëvizja është shumë nacionaliste në drejtim të përkushtimit dhe besnikërisë ndaj kombit. Argumenti i z. Gylen është se progresi dhe modernizimi shkencor mund të arrihen së bashku me angazhimin për idealet islame dhe përvijimin e identitetit si një mysliman praktikues.

Ajo që kam dëgjuar në mënyrë të përsëritur nëpër intervista me anëtarë të lëvizjes, ishte dobia e idesë së mbrojtjes së lirisë më të madhe për të praktikuar fenë në vendet publike, sesa kontrolli

i rreptë i institucioneve fetare dhe qëndrimi bllokues nga ana e shtetit. Krahasimi më i shpeshtë që bëhej gjatë intervistave ishte ai në mes të sistemit turk të *laicite* (përshkruar imtësisht në Kapitullin 2), i bazuar në kontrollin shtetëror të fesë, duke theksuar mungesën e praktikës fetare në hapësira publike, dhe sistemit të ndarjes së kishës dhe shtetit që është në fuqi në Shtetet e Bashkuara. Në sistemin amerikan, feja dhe politika janë parë gjithmonë si dy fusha të ndara. Organizatat fetare, ashtu si edhe individët kanë hapësirë të madhe për të praktikuar besimet dhe ritualet e tyre, pa ndërhyrjen e shtetit. Gjithashtu, organizatat fetare kanë kufizime në lidhje me ndikimin e tyre në punët e shtetit. Amerikanët janë të lirë, përveç në raste të rralla, të veshin rroba të dallueshme fetare në publik dhe për të ushtruar liritë e tyre fetare. Mbështetësit e Gylenit shpesh shpreheshin se ata dëshironin të kishin një liri më të madhe për të praktikuar fenë e tyre publikisht, pa ndërhyrjen e shtetit.

Në lidhje me temën delikate të "strategjisë" së pasuesve të Gylenit " të infiltruar" në nivelet e larta të qeverisjes, ushtri, politikë dhe shërbime të tjera civile, që nëpërmjet një plani të ngadaltë dhe sistematik, të marrin nën kontroll përfundimisht këto agjenci, është logjike që disa nga ndjekësit e Gylenit do të punojnë nëpër këto agjenci, duke pasur parasysh faktin se është llogaritur që rreth 8-10% e popullsisë turke është e lidhur me lëvizjen në një mënyrë apo në një tjetër. Duke u bazuar vetëm në një probabilitet statistikor të caktuar në një popullsi totale prej 70 milionë banorësh, dhe duke pasur parasysh faktin që shumë ndjekës të Gylenit janë të shkolluar mirë, është diçka krejtësisht normale që një pjesë prej 6 apo 7 milionë personash pjesëtarë të lëvizjes do të jenë të punësuar në këta sektorë. Askund në të dhënat e mia, megjithatë, nuk kam zbuluar ndonjë dëshmi të një plani sistematik për të infiltruar pasuesit e lëvizjes në këto agjenci, në mënyrë që përfundimisht të arrihet vënia e tyre nën kontroll.

Ekzistojnë dëshmi se disa parti politike në Turqi janë shumë dashamirëse ndaj z. Gylen dhe ndjekësve të tij sesa të tjerat dhe se konteksti politik i Turqisë, ndikon në rritjen dhe aktivitetet e lëvizjes, si në Turqi ashtu edhe jashtë vendit. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi se z. Gylen mbron idenë se ata të cilët janë të frymëzuar nga idealet e tij, duhet të jenë pjesë e të gjitha institucioneve në shoqëri, duke përfshirë institucionet qeveritare dhe ushtarake, dhe jo të kthehen në administratorë të shkollave kuranore dhe sektorëve të izoluar të shoqërisë. Megjithatë, unë nuk shoh asnjë provë konkrete për të mbështetur pretendimin se z. Gylen ose ata që janë të frymëzuar prej tij janë duke punuar në mënyrë të fshehtë dhe sistematike, apo se kanë për qëllim vendosjen e njerëzve në qeveri dhe në postet e larta ushtarake me synimin e një grushti shteti gradual ose të marrjes së kontrollit të pushtetit.

Gyleni si një agjent i mundshëm i SHBA-ve

Frika e dytë e madhe e shprehur nga kritikët që kemi mundur të intervistojmë, është që z. Gylen dhe shumë nga projektet e tij të shërbimit, janë duke u financuar nga Shtetet e Bashkuara, e në veçanti nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA). Një arsye e përmendur shpesh për të mbështetur këtë pretendim, është se lëvizja gjeneron miliarda dollarë dhe se shuma të tilla të mëdha duhet të vijnë nga disa burime qeveritare. Gjithashtu është e përhapur edhe ideja se Shtetet e Bashkuara po e mbështesin zotin Gylen dhe lëvizjen e tij, sepse ai përfaqëson Islamin e moderuar dhe se Perëndimi shpreson që një version i tillë i Islamit do të dominojë rajonin dhe do të jetë një antidozë ndaj terrorizmit dhe Islamit radikal.

Për sa i takon pretendimit se lëvizja është mbështetur financiarisht nga disa qeveri, përfshirë Agjencinë Qendrore Amerikane të Inteligjencës, unë sinqerisht nuk kam gjetur asnjë dëshmi empirike për të mbështetur një pretendim të tillë.

Ekzistojnë copa të ndryshme të dhënash që sfidojnë supozimin e hedhur nga kritikët. Së pari, gjatë disa dekadave të kaluara, z. Gylen dhe organizatat e lidhura me të dhe me lëvizjen e tij, janë verifikuar dhe shqyrtuar me imtësi nga institucione të shumta qeveritare, të tilla si Departamenti Turk i Thesarit dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit. Çdo vit Departamenti i Thesarit rishikon regjistrat financiarë si për bizneset fitimprurëse ashtu edhe ato jofitimprurëse. Kështu, Banka "Asya", gazeta "Zaman", Samanyolu TV dhe Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve janë të detyruar të vënë në dispozicion regjistrat e tyre të financave për t'iu nënshtruar kontrollit të inspektorëve të qeverisë. Asnjë herë, aq sa unë munda të përcaktoj, nuk ishin zbuluar fonde të dyshimta ose që të rezultonin të zhdukura shuma të caktuara parash. Gjithashtu, asnjë shkelje financiare nuk është zbuluar ndonjëherë, që të ngjallte dyshimin se qeveritë e huaja kanë marrë përsipër financimin e ndonjë veprimtarie.

Gjithashtu, për gjashtë vjet me radhë, një çështje ligjore kundër z. Gylen ishte në pritje të një gjykimi që do të jepnin për të gjykatat turke. Avokatët civilë u lëshuan mbi dokumentet e të gjitha llojeve në një përpjekje për të sjellë prova të shkeljeve të ligjit apo aktiviteteve të dyshimta kundër z. Gylen dhe lëvizjes së tij. Në qershor të vitit 2007, më në fund çështja u mbyll në bazë të mungesës së provave. Nëse do të kishte pasur ndonjë përfshirje të qeverive të huaja në financimin e lëvizjes, unë jam e bindur se lidhje të tilla do të ishin zbuluar nga avokatët apo inspektorët e shtetit.

Në rastin e kohëve të fundit të aplikimit të zotit Gylenit për një leje qëndrimi në SHBA (qershor 2008), një avokat i akuzës citoi një letër të dërguar nga ana ime dhe e Doğan Koç, *London School of Economics* në vjeshtë, 2007. Në një përpjekje për të mohuar kërkesën, avokati iu referua letrës sonë duke pretenduar se CIA mund të jetë e fshehur pas financimit të lëvizjes, kur në fakt, të themi qartë aty thuhet shprehimisht se kundërshtarët e

lëvizjes pretendojnë se CIA mund të ketë mbështetur financiarisht lëvizjen.

Argumenti se shuma të tilla të mëdha parash, janë derdhur në mbështetjen e projekteve të shërbimit dhe se kjo mund të realizohet vetëm nëse disa qeveri përfshihen në këtë proces, nuk është një argument i bazuar në fakte, po të kemi parasysh shumat e parave të dhuruara nga biznesmenët e pasur në Turqi, si dhe bazën e gjerë të donatorëve brenda lëvizjes. Siç kemi treguar në kapitujt "Rrjeti i Qarqeve Lokale" dhe "Uji i nevojshëm për të vënë në punë mullirin: Financimi i projekteve të shërbimit të frymëzuara nga Gyleni", mjaft biznesmenë të pasur kontribuojnë me 10-50% të të ardhurave të tyre vjetore për projektet e lëvizjes, ku një numër i madh i tyre dhuron një të tretën e fitimit, lëvizjes. Nëse marrim parasysh të ardhurat vjetore prej miliona dollarësh nga ana e qindra biznesmenëve të tillë, kontributet rriten shumë shpejt. Përveç kontributeve monetare, edhe donacionet e pronës dhe materialeve të ndërtimit, por edhe kohës së punës, tregojnë për një lëvizje financiarisht të suksesshme.

Përveç kontributeve të mëdha nga biznesmenë të pasur, me miliona anëtarë të lëvizjes kontribuojnë me shuma të vogla parash, materiale, shërbime dhe orë pune. Të dhënat e mia tregojnë se kontributi mesatar është rreth 10% e të ardhurave vjetore, pavarësisht nga profesioni dhe statusi. Shumëzuar me 8-10.000.000 pjesëmarrësit në lëvizje në mbarë botën, shuma e donacioneve nuk është edhe aq e vogël. Argumenti se duhet të jetë e përfshirë një njësi qeveritare në këto projekte, për shkak të miliarda dollarëve buxhet të lëvizjes, është i varfër nën dritën e këtyre të dhënave.

Shpëlarja e trurit e njerëzve të varfër dhe analfabetë

Një frikë e tretë e shprehur shpesh, ishte se z Gylen, sikurse edhe pasuesit e tij, janë duke përfituar nga njerëz me prejardhje rurale

e të paarsimuar, sidomos të rinj, duke i joshur ata për t'u futur nëpër konviktet dhe "shtëpitë e dritës" që lidhen me lëvizjen, duke u ofruar atyre bursa dhe mundësi, dhe pastaj duke ua ndryshuar pikëpamjet e tyre me ide të qenësishme të lëvizjes. Një anëtare e Bashkimit të Grave Turke tha: "Njerëzit e Gylenit i ndihmojnë financiarisht familjet e varfra dhe më pas ua marrin fëmijët që janë nxënës të suksesshëm nga shtëpitë e tyre. Ata nuk janë në dijeni se çfarë lloj arsimi marrin fëmijët e tyre nëpër këto institucione arsimore private. Ata ua ndryshojnë pikëpamjet e dikurshme këtyre fëmijëve dhe i edukojnë ata për t'i përgatitur për veten e tyre. Këta njerëz nuk janë patriotë, por fetarë."

Një menaxher hoteli, i cili është kritik ndaj lëvizjes përsëriti një ide të ngjashme: "Ata zgjedhin nxënës potencialisht të shkëlqyer dhe i edukojnë ata që të bëhen edhe më të aftë. Është edhe më mirë për ta, kur këta njerëz janë të varfër. Në këtë mënyrë ata mund t'i kontrollojnë më me lehtësi këta nxënës. Ata nuk investojnë kot. Ata kanë shpresa që ky investim do vijë një ditë që do t'u shpërblehet."

Çështja e «ndërrimit të pikëpamjeve» të njerëzve të varfër dhe analfabetë, është në thelb një çështje ideologjike. Siç ishte mjaft evidente në serinë e artikujve në vitet '80 në lidhje me çështjet e ndërrimit të pikëpamjeve në lëvizjet e reja fetare (NRM-të) ose "kultet", siç ishin të njohura zakonisht, termi "ndërrim pikëpamjesh" apo "shpëlarje e trurit," mbart në vetvete tone ideologjike.[3] Ajo çfarë përbën ndërrim pikëpamjesh për kundërshtarët e një ideje, shpesh është diçka shpirtërore apo krijim i një mundësie për mbështetësit. Siç kam dëgjuar nga dhjetëra punëtorë me jakë blu në qarqet lokale në Turqi, fjala e theksuar më shpesh ishte mirënjohja për lëvizjen për shansin që u kishte dhënë atyre vetë, por edhe vëllezërve e motrave, si dhe miqve të tyre për t›i shpëtuar varfërisë rurale dhe sistemit të varfër arsimor, në këmbim të bursave për kurset përgatitore universitare, shkollave

mjekësore dhe atyre të ligjit, si dhe për krijimin e shanseve për të jetuar në konvikte. Përveç mundësive të karrierës, këta punëtorë ishin gjithashtu mirënjohës që ishin pjesë e një grupi shoqëror, anëtarët e të cilit takohen rregullisht, ndihmojnë njëri-tjetrin dhe ofrojnë mundësi për studentët e tjerë të varfër.

Po e kthen Turqinë nga rruga e saj drejt modernizimit

Ekziston një frikë se disa nga idetë e zotit Gylen janë një kthim prapa drejt zakoneve tradicionale dhe vlerave që nuk janë në përputhje me zhvillimin shkencor, modernizimin dhe demokracinë. Në mënyrë të veçantë, siç komentoi një politikan, "Unë e kam takuar Gylenin personalisht. Ai është një person që nuk ua jep dorën grave. Ai madje nuk i shikon ato as në fytyrë. Ai bën predikime dhe qan gjatë gjithë kohën. Ai shihet qartë se është thjesht një gur shahu. Ai është i paarsimuar, por një predikues efektiv." Një gazetar u shpreh: "Nuk mund të ekzistojë ndonjë gjë pozitive nga kjo lëvizje, sepse ata duan të na rikthehejnë në periudhën e përpara krijimit të Republikës. Ne duhet të synojmë të përdorim arsyen dhe logjikën, por ata e vënë theksin mbi një dogmë e cila nuk ka bazë shkencore. Ata përpiqen të krijojnë një shtet të sunduar nga imamët dhe fanatikët. Ata dëshirojnë të jetojnë në një shoqëri të tillë."

Çështja e kufizimit të të drejtave të grave dhe inkurajimi i vendosjes së shamisë nga gratë përbënin një frikë të shprehur nga gjysma e mbi 25 të intervistuarve dhe nga të shtatë gratë që pyeta. Për shembull, një profesoreshë tha, «Ata duan të sjellin në fuqi Islamin e moderuar në Turqi... Në Islamin e moderuar burrat dhe gratë janë të ndarë. Gratë punojnë në shtëpi, si në brezin e gjyshes sime. Burrat dhe gratë duhet të jenë të barabartë në çdo aspekt të jetës, si në karrierë ashtu edhe në mundësitë e tjera të mundshme. Gratë mund të jenë edhe nëna edhe specialiste në një

profesion të preferuar në të njëjtën kohë... Nëse gratë janë më pak të arsimuara, të ekspozuara ndaj dhunës dhe nën trysni, në një vend të dominuar nga idetë mashkullore, nuk mund të ketë liri. Kultura e urdhërave fetare shmang lirinë, sepse ata janë shtypës."

Në lidhje me pretendimin se lëvizja Gylen po e kthen Turqinë prapa në drejtim të kundërt me modernizimin dhe zhvillimin shkencor, mund të them me bindje, se si fjalimet dhe shkrimet e z. Gylen, ashtu edhe arritjet që po vërehen në shkollat dhe spitalet e lëvizjes, vërtetojnë pikërisht të kundërtën. Në mënyrë të përsëritur, ai i inkurajon pasuesit e tij për të marrë arsimimin më të mirë dhe më të avancuar të mundshëm, sidomos në shkencat e natyrës, në mënyrë që të kontribuojnë në modernizimin e Turqisë. Në shkollat që kam vizituar, unë mbeta e habitur prej laboratorëve shkencorë modernë, në të cilat nxënësit zhvillonin mësimin, si dhe me trofetë e shumta që shfaqet nëpër stendat e studentëve, të cilët kishin konkurruar me sukses nëpër olimpiadat shkencore ndërkombëtare. Nuk ka asnjë dyshim se shkollat e frymëzuara nga Gyleni janë me siguri në mesin e atyre shkolla të cilat ofrojnë edukimin më të mirë dhe më modern në dispozicion sot në Turqi, dhe se shumë njerëz të cilët mund t'i përballojnë ato nga pikëpamja e tarifave, janë duke i dërguar fëmijët e tyre në këto shkolla, qofshin ata anëtarë të lëvizjes ose jo.

Gjithashtu, në të tria spitalet e lidhura me lëvizjen që unë kam vizituar, ekzistonin pajisjet dhe aparaturat më moderne laboratorike dhe në stafin e tyre punonin disa prej mjekëve më të mirë të vendit. Për shembull, në Spitalin "Bahar" në Bursa ndodhet një klinikë optomologjike ndër më të vlerësuarat, një njësi kardiake e aftë për kryerjen e operacioneve të hapura në zemër dhe një makinë lazer, e cila mund të kryejë kolonoskopi joinvazive. Në aspektin e shkencës dhe modernizimit teknologjik, institucionet e lidhura me Gylenin qëndrojnë në ballë të zhvendosjes së Turqisë drejt botën moderne dhe konkurruese të tregut.

Një fushë, e cila është problematike në aspektin e mungesës së modernizimit në këtë lëvizje, sipas mendimit tim, janë qëndrimet ndaj rolit të gruas në botë. Theksoj këtu, se vendosja e shamisë është thjesht një detaj i vogël dhe në thelb përbën një çështje preference personale.[4] Ajo që është më e rëndësishmja, në disa zona të tilla si në Hjuston, gratë rrallë janë figura publike në lëvizje, qoftë në poste kyçe, ngjarje publike ose në institucionet e financuara nga lëvizja. Gratë priren të jenë në sfond, duke kryer detyrat tradicionale të kujdesit për fëmijët, pastrimit, gatimit, mësimdhënien në shkolla dhe xhami, dhe t'ua lënë bashkëshortëve të tyre detyrat dhe shfaqjet në arenat publike. Pjesërisht, roli i grave mund të diktohet nga kultura turke dhe nga fakti se shumë gra jashtë Turqisë kanë ndjekur burrat e tyre në punë dhe universitete, si studente, dhe janë jo shumë të mësuara me gjuhët joturke. Megjithatë, meqënëse lëvizja po përhapet në të gjithë botën dhe po bëhet përherë e më pak turke, një sfidë e madhe në qëllimin e saj të modernizimit dhe përshtatjes ndaj kulturave të tjera, ka të bëjë me rolin e grave në lëvizje dhe në kulturën më të gjerë. Kjo sfidë ka mbetur pezull për shkak të vërejtjeve kontradiktore të z. Gylen, i cili thotë në mënyrë të përsëritur se gratë janë shumë të rëndësishme, sepse ato janë kujdestaret e para dhe agjentet e socializimit të fëmijëve të vegjël. Kjo është një deklaratë tepër tradicionale, që i vlerëson gratë më tepër për shkak të rolit të tyre si nëna dhe shtëpiake, sesa pranon përgjegjësinë e dyfishtë të burrave dhe grave në rritjen e fëmijëve. Për sa kohë që lëvizja të përhapet në vendet e industrializuara moderne, ajo do të përballet me sfidën e ripërcaktimit të rolit të grave.

Lëvizja Gylen mbështet vetëm njerëzit e vet

Rreth një e katërta e të intervistuarve e akuzuan lëvizjen për diskriminim, duke siguruar burime të tilla si bursa dhe mundësi arsimore vetëm për mbështetësit e saj, duke neglizhuar njerëz të tjerë në nevojë në shoqërinë turke. Një profesor turk tha: "Ata janë

duke u përpjekur që të përçajnë vendin. Nuk ka asnjë tolerancë për njerëzit që nuk janë pjesë e tyre. Ndjekësit e Fethullah Gylenit i përjashtojnë të tjerët. Ata japin bursa, themelojnë shkolla dhe japin ushqim vetëm për ndjekësit e tyre. Këto nuk bëhen për qëllime humanitare, por janë të gjitha të planifikuara.» Një biznesmen që bën biznes me ithtarët e Fethullah Gylenit komentoi, "Ata na thanë se ndihmojnë studentët që janë në nevojë. Ata mbështesin vetëm ata që janë pjesë e tyre."

Akuza se lëvizja mbështet vetëm anëtarët e vet dhe është diskriminuese ndaj njerëzve të tjerë në nevojë në shoqëri është krejtësisht e pabazë sipas të dhënave të mia. Në të gjitha shkollat që kam vizituar, më pak se gjysma e studentëve janë të lidhur me lëvizjen. Shumë prindër i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër këto shkolla për shkak të reputacionit të mirë akademik të tyre. Përveç kësaj, çdo shkollë ofron bursa për studentët në nevojë, të cilët kualifikohen në aspektin e notave, por familjet e të cilave nuk mund të përballojë tarifën për shkollim. Në shumicën e këtyre shkollave, rreth 20% e trupës së studentëve është me bursë dhe shumë prej nxënësve të futur në skemën e ndihmës financiare, nuk janë fëmijë të anëtarëve të lëvizjes. Gjithashtu, një pjesë e studentëve nëpër konvikte janë të mbështetur me bursa dhe këta përfitues nuk janë domosdoshmërisht bijtë e njerëzve pjesëmarrës në lëvizje. Shumë nga punëtorët që kam intervistuar, më thanë se do të donin që fëmijët e tyre të shkonin në shkollat e frymëzuara nga Gyleni apo të jetojnë në konviktet e lëvizjes, por që ata nuk ishin në gjendje për t'i çuar fëmijët e tyre në këto institucione. Prandaj, pohimi se lëvizja mbështet vetëm anëtarët e saj, nuk është e bazuar në të dhëna të sakta.

Gjatë viteve të fundit ka pasur qindra ndjekës të lëvizjes të cilët kanë shkuar në Turqinë Jug-Lindore për të ndihmuar njerëzit në nevojë atje, të cilët janë duke vuajtur për shkak të konfliktit të shtetit me PKK-në në këtë zonë. Mijëra paund mish dhe produkte

të tjera ushqimore, si dhe veshje e të holla, janë mbledhur dhe dërguar në këtë zonë, për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Përfituesit e këtyre dhuratave nuk ishin vetëm pjesëmarrësit në lëvizje, por të gjithë nevojtarët, kushdo qofshin. Gjithashtu, ekipet e mjekëve kanë shkuar në këtë zonë për të vlerësuar nevojat mjekësore dhe për të transportuar pacientët e sëmurë në të dyja spitalet e lëvizjes Gylen, në Stamboll dhe Bursa. Përsëri, me aq sa mund të them, askush nuk pyeti nëse ata njerëz të varfër dhe nevojtarë ishin apo jo anëtarë të lëvizjes Gylen. Viktimat që u ndihmuan pas tërmetit të vitit 2004 në rajonin Mardin, nuk ishin vetëm përkrahës të Gylenit. Pra, akuza që lëvizja ndihmon vetëm njerëzit e vet, nga të dhënat del se nuk mund të jetë e provueshme.

Lëvizja si një shoqëri apo sekt i fshehtë

Ekziston një lloj frike se z. Gylen dhe ata që e ndjekin atë, kanë plane dhe qëllime të cilat ata nuk i kanë bërë ende publike. Kritikët pretendojnë se ajo që është thënë publikisht nga anëtarët e lëvizjes nuk është e gjithë historia, por që janë duke u realizuar veprimtari klandestine në vijim e sipër, me qëllim të marrjes së kontrollit të qeverisë dhe të shoqërisë turke. Për shembull, një profesor tha: "Unë nuk jam armik i ndjekësve të Fethullah Gylenit. Ata janë njerëz të mirë. Ajo çfarë më frikëson mua janë qëllimet e tyre, sepse ato janë të fshehta. Unë nuk mund t'i vërej qëllimet e tyre. Unë jam i sigurt se ata janë duke zbatuar një plan sistematik."

Fakti se njerëzit e lidhur me lëvizjen Gylen, duke përfshirë edhe përfaqësues të lartë të Asya Bank, punonjës të gazetës "Zaman", të Samanyolu TV, të Fondacionit të Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, biznesmenë të njohur në Stamboll dhe Bursa, si dhe grupet e nëpunësve të uniformave blu, të gjithë ishin gatshëm dhe të etur për të biseduar me mua në lidhje me financat e lëvizjes, për mendimin tim tregon se lëvizja nuk është edhe aq "e fshehtë"

sa pretendojnë kritikët. Vetë z. Gylen është shprehur disa herë kohët e fundit se është shumë e rëndësishme për lëvizjen që të jetë transparente nga pikëpamja financiare. Në fakt, në rastin e bankës, gazetave dhe stacionit televiziv, pasqyrat financiare janë publike dhe në dispozicion të të gjithëve në internet. Fjalimet dhe artikujt e z. Gylen janë të aksesueshme nëpërmjet një website-i zyrtar që boton në shumë gjuhë të botës. Akuza e "fshehtësisë" për mendimin tim bëhen duke u bazuar më shumë në të imagjinuarin e aktiviteteve klandestine, sesa në të dhëna empirike që tregojnë dhe evidentojnë qëllime dhe aktivitete që nuk janë bërë publike.

Në përmbledhje, pra, unë e respektoj frikën e shprehur nga Kemalistët se historia e shekularizmit të Turqisë mund të jetë e kërcënuar për t'u rrëzuar nga ndonjë udhëheqës autoritar me një mbështetje të fuqishme nga pas, për t'u zëvendësuar me atë lloj sistemi shtetëror islamik që ekziston sot në Iran. Megjithatë, kritikët nuk paraqesin ndonjë të dhënë empirike në lidhje me frikën e tyre për ngjarjet dhe qëndrimet aktuale që kanë të bëjnë me z. Gylen apo anëtarët e lëvizjes së tij. Gjithashtu, të dhënat empirike (p.sh. intervistat, vizitat në terren, shqyrtimi i të dhënave dhe dokumenteve) që kam mbledhur gjatë 12 muajve të fundit në lidhje me lëvizjen Gylen, nuk mbështesin akuzat dhe frikën e shprehur nga kritikët e lëvizjes.

Dëshmi të mëtejshme

Përveç të dhënave të paraqitura në seksionin e mëparshëm të cilat sfidojnë kufizimet dhe kritikat në drejtim të lëvizjes Gylen, është e udhës të përmendet fakti se karakteristikat kryesore të grupit nuk i përshtaten modelit që përshkruan grupet sektare, qëllimi i të cilave është për të sfiduar *status quo*-në në shoqëri dhe për të promovuar agjendën e vet. Këto karakteristika janë: mungesa e kontrollit dhe transparencës, izolimi, kontrolli

autoritar, tradicionalizmi në raport me modernizimin dhe përdorimi i dhunës për të arritur qëllimet e grupit.[5] Lëvizja Gylen nuk manifeston asnjërën nga cilësitë e mësipërme, që do ta bënin atë me shumë të ngjarë të zhvillohej në një grupim politik, qëllimi i të cilit është që të depërtojë dhe të përmbysë rendin ekzistues në shoqëri. Përshkrimet e mëposhtme të lëvizjes e demonstrojnë këtë pikë.

Integrimi në shoqëri (përkundër izolimit)

Grupimet sektare, qëllimi i të cilëve është ose për të sfiduar strukturat ekzistuese sociale të shoqërisë (p.sh., Branch Davidians;[6] Lëvizja e Identitetit Kristian;[7] Aum Shinrikyo[8]) ose për të krijuar vetë një shoqëri alternative (p.sh., Amish;[9] Shenjtët Fondamentalistë të Ditës së Gjykimit;[10] Kisha e Unifikimit) priren të jenë të izoluara, që do të thotë, për t'u tërhequr nga pikëpamja e vendbanimit, ajo shoqërore dhe politike nga shoqëria. Lëvizja Gylen nuk ka pasur ndonjëherë si qëllim të saj të krijojë një sekt ose njësi unike brenda Islamit apo Turqisë. Ajo nuk është një fraksion kundërshtues i mbledhur rreth një besimi, interesi të përbashkët ose utopie. Nuk është e nevojshme që anëtarët ose përkrahësit e lëvizjes të jetojnë larg nga të tjerët në shoqëri. Përkundrazi, anëtarët e lëvizjes janë të inkurajuar të zhvillojnë dialogun dhe të ndërveprojnë me bashkëqytetarët e tyre të të gjitha besimeve, racave dhe prejardhjeve social-ekonomike.

Vazhdimisht, z. Gylen u kujton njerëzve ndërvarësitë aktuale të komuniteteve dhe se çdo ndryshim domethënës në një vend, nuk do të mund të përcaktohet nga ky vend i vetëm, sepse kjo është një epokë e marrëdhënieve ndëraktive, një situatë që shkakton aferësi në mes të popujve dhe kombeve. Ai argumenton se dallimet në mes besimeve, racave, zakoneve dhe traditave ka krijuar një pasuri botërore, dhe duhet të vlerësohet për të mirën e përbashkët,

nëpërmjet marrëdhënieve paqësore dhe respektit reciprok.[12] Kjo nuk do të thotë shmangie nga besimi dhe praktikat, por respektim i atyre të të tjerëve, ndërsa kryen angazhimet vetjake. Sipas vetë fjalëve të Gylenit:

"Ne duhet të dimë se si të jemi vetvetja dhe të mbetemi vetvetja. Kjo nuk do të thotë izolim nga të tjerët. Kjo do të thotë ruajtje e identitetit tonë të qenësishëm në gjirin e së ndryshmes, duke ndjekur rrugën tonë në mesin e rrugëve të tjera. *Ndërsa identiteti vetjak është i nevojshëm, ne duhet gjithashtu të gjejnë mënyrat për një integrim universal. Izolimi nga bota, përfundimisht, do të rezultojë në asgjësimin tonë."*[13]

Ndryshe nga sektet apo kultet që tentojnë t'i izolojnë anëtarët e tyre nga përfshirja shoqërore, duke e vënë theksin tek disiplina e rreptë, udhëheqja autoritare dhe ritet e anëtarësimit, lëvizja nuk ka lidership apo hierarki formale. Ajo nuk ka procedura, ose ritet ceremoniale fillestare për t'u bërë një anëtar. Gjithashtu, lëvizja nuk është konsideruar ndonjëherë si heretike apo ekstreme nga publiku, mediat apo gjykatat, qoftë në Turqi, qoftë jashtë saj.[14]

Ndërsa janë zhvilluar afërsisht njëqind seanca gjyqësore në gjykatat e shkallëve të ulëta për shkak të padive që janë bërë kundër z. Gylen dhe lëvizjes, duke u bazuar kryesisht në pretendimin se ai dhe pasuesit e tij përbëjnë një kërcënim për republikën laike, konkluzionet kryesore të gjykatave ishin se akuzat janë të pavërteta, të pabaza dhe të paargumentuara.[15] Përkundrazi, lëvizja e thekson fort respektin ndaj qeverisë dhe pjesëmarrjen në jetën qytetare të Turqisë apo të vendeve në të cilat ndjekësit banojnë.

Me pjesëmarrjen e saj në arsim, çështjet ndërfetare dhe ndërkulturore, si dhe në projektet transnacionale, lëvizja Gylen është e përfshirë në institucionet dhe veprimtaritë e shoqëritë në të cilat anëtarët e saj janë të vendosur. Shkollat e saj nëpër botë ndjekin programet shtetërore të arsimit dhe i përmbahen kriteresh

arsimore të përcaktuara nga shteti. Aktivitetet ndërfetare dhe ndërkulturore të sponsorizuara nga lëvizja, tërheqin njerëz nga të gjitha sferat e jetës dhe të të gjitha besimeve. Në antagonizëm me izolimin nga shoqëria, z. Gylen dhe mbështetësit e tij theksojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen nëpër institucionet e shoqërisë.

Kontrolli autoritar

Tipike për lëvijet sektare ose ato të kultit, është kontrolli autoritar nga një udhëheqës "karizmatik", i cili i jep të drejtën vetes për të urdhëruar pasuesit se çfarë duhet të bëjnë ata në të gjitha aspektet e jetës së tyre, qoftë private, ashtu edhe publike. Në të cilat, ndjekësit i detyrohen bindje dhe respekt absolut liderit karizmatik. Udhëheqësi është paraqitur si një person me njohuri dhe virtyte të pazakonta, si një njeri që flet me autoritet dhe meriton të drejtën të jetë i pagjykueshëm dhe i pakritikueshëm nga ana e pasuesve të tij.[16]

E ndërsa pjesëmarrësit në lëvizjen e z. Gylen shfaqin respekt, studiojnë shkrimet dhe predikimet e tij, konsultohen me të për çështje dhe projekte madhore dhe përpiqen të jetojnë sipas parimeve që ai u mëson, ai kurrë nuk e ka pranuar të përshkruarit e vetes si një lider karizmatik i lëvizjes.[17] Ai rregullisht i këshillon pasuesit e tij që të mos i referohen lëvizjes si "lëvizja Gylen", por përkundrazi si lëvizja e "shërbimit". Në gjuhën turke, ajo quhet ndryshe me këtë emër, si *Hizmet*-i. Gjithashtu, ai refuzon etiketimin "shkollat e Gylenit." Përkundrazi, ai është në favor të këshillimeve kolektive dhe konsensusit, dhe argumenton se merita e suksesit të projekteve të lëvizjes është e miliona pjesëmarrësve në lëvizje, të cilët meritojnë respekt për projektet e suksesshme që janë rezultatet i ndarjes së të njëjtit botëkuptim dhe të njëjtës frymë angazhimi. Z. Gylen fillimisht e pati refuzuar titullin doktor honoris kauza nga Universiteti i Lidsit në Londër, duke argumentuar se ky titull

u takonte miliona njerëzve të përkushtuar në lëvizje, të cilët kanë bërë të mundur realizimin e projekteve të çmuara arsimore dhe sociale të shërbimit. Vetëm kur ky titull nderi u dha në emër të lëvizjes, ai përfundimisht e pranoi çmimin.[18]

Nuk ekziston asnjë organ qeverisës i grupit apo hierarki administrative që urdhëron për çështjet ose ushtron kontroll mbi anëtarët apo aktivitetet e lëvizjes. Përkundrazi, vendimet merren nga grupet lokale përmes diskutimit dhe konsensusit. Sapo plotësohen nevojat në pjesë të ndryshme të një vendi apo edhe në rang ndërkombëtar, mbështetësve u kërkohet që të zhvendosen për të ndihmuar në një zonë të caktuar, ku përvoja dhe aftësitë e tyre mund të jenë të nevojshme. Për shembull, mësuesve u kërkohet për të lëvizur në një zonë ku janë hapur shkolla të reja. Individët të cilët kanë përvojë në planifikimin e eventeve apo në organizimin e aktiviteteve, u kërkohet shpesh që të lëvizin në një qytet ku një grup lokal ka nevojë për aftësi të tilla. Kjo zhvendosje e shpeshtë e mbështetësve të Gylenit, e zvogëlon mundësisë që një person i caktuar të shfaqet si një figurë e fuqishme me autoritet të spikatur.

Dukshmëria/Transparenca

Duke pasur parasysh miliona njerëz, të cilët i përkasin lëvizjes dhe që mund të gjenden në çdo sektor të shoqërisë, lëvizja sigurisht nuk përbën një sekret të ruajtur mirë. Në fakt, predikimet dhe shkrimet e zotit Gylen mund të aksesohen në internet, dhe po ashtu mund të gjenden të hedhura në libra nëpër libraritë e mbarë botës. Prandaj, kushdo që është i interesuar në lidhje me idealet z. Gylen dhe rreth lëvizjes që ai frymëzon, ka qasje të lehtë në veprat e tij dhe me aktivitetet dhe eventet e sponsorizuara nga qindra pasues të Gylenit, të lidhur me organizatat që ekzistojnë në nivel lokal në vende të shumta. Për shembull, në Hjuston,

Teksas, mbështetësit e Gylenit kanë themeluar Institutin e Dialogut Ndërfetar (IID) qëllimet e të cilit janë për të bashkuar komunitetet fetare në mënyrë që të "promovojnë bashkëpunimin, dhembshurinë, partneritetin dhe shërbimin ndaj komunitetit nëpërmjet dialogut dhe bashkëbisedimeve me karakter ndërfetar. IID është një institucion i përkushtuar për të inkurajuar studimin e traditave shpirtërore të komuniteteve globale nga pozita e favorshme e vërtetësisë, respektit dhe vlerësimit."[19] Organizata lokale të ngjashme ekzistojnë në shumë qytete në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Këto grupe lokale sponsorizojë evente të tilla si darka dialogu ndërfetar, konferenca për çështje që lidhen me çështjet arsimore dhe komunikimin ndërfetar, udhëtime me spektër të dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor në Turqi, dhe koktejle me udhëheqës politikë dhe qytetarë vendas. Këto ngjarje janë publike dhe shërbejnë si një mjet për të angazhuar komunitetet në të cilat pasuesit e Gylenit jetojnë, punojnë dhe studiojnë.

Kohët e fundit Instituti Gylen është themeluar si një iniciativë e përbashkët e Universitetit të Hjuston në Hjuston të Teksasit dhe Institutit të Dialogut Ndërfetar. Qëllimi i Institutit është që të promovojë "kërkimet akademike, si dhe rrënjët e aktiviteteve që shpen në drejtim të sjelljes së ndryshimeve pozitive shoqërore, domethënë në vendosjen e paqes të qëndrueshme, drejtësisë dhe harmonisë sociale, duke u përqendruar në temat e arsimit, vullnetarizmit dhe iniciativave qytetare." Instituti organizon takime pune mujore me ndonjë figurë të shquar publike si kumtues kyç. Ndër emrat më të shquar të cilët kanë mbajtur fjalim në këto takime kanë qenë James Baker dhe Madeleine Albright, të dy ish-Sekretarë të Shtetit të SHBA-ve, shefi aktual i Policisë për qytetin e Hjuston dhe disa nga figurat më të shquara të kanaleve televizive lokale. Asnjë nga këta individë nuk është i lidhur me lëvizjen. Në bisedat me disa prej këtyre figurave të profilit të lartë publik, mësova se ata kishin angazhuar tërësisht shtabet e tyre për të hetuar rreth lëvizjes Gylen, përpara se të pranonin ftesën

për të folur në cilësinë e funksionarit publik. Secili prej këtyre referuesve të ftuar nga Instituti Gylen, e përgëzuan atë për punën e bërë në drejtim të paqes botërore dhe dialogut. Për më tepër, në shtator të vitit 2008, ish-presidenti amerikan Bill Klinton paraqiti një video mesazh në Darkën e Ramazanit të mbajtur në New York City në Qendrën Kulturore Turke, të sponsorizuar nga një shoqatë lokale e lëvizjes Gylen. Ai e vlerësoi lëvizjen Gylen për përpjekjet e shquara të anëtarëve të saj për të promovuar paqen në mbarë botën.

Përfshirja e liderëve të tillë të fushave publike, politike dhe qytetare tregon dy gjëra: (l) dukshmërinë dhe transparencën e lëvizjes, dhe (2) faktin që lëvizja është hetuar me kujdes nga këta udhëheqës publikë të cilët nuk mund të përballen me rrezikun e shfrytëzimit të figurës së tyre nga një grup që është "i rrezikshëm" ose "një kërcënim" për interesat publike.

Gjithashtu, gjatë investigimeve të mia në lidhje financat e përfshira në projekte të mëdha dhe me kompanitë e lidhura me lëvizjen, kam gjetur një shkallë të lartë të transparencës. Administratorët kryesorë, jo vetëm që ishin të gatshëm të shpenzonin kohë me mua dhe t'u përgjigjeshin një morie pyetjesh të bëra nga ana ime, por ata hapën edhe regjistrat e tyre financiarë dhe m'i ofruan për shqyrtim në do të ishte e nevojshme. Pjesëmarrësit ishin të hapur dhe bashkëpunues në drejtim të kontributit të tyre në projektet e shërbimeve të sponsorizuara nga lëvizja.

Modernizmi (kundrejt refuzimit të shkencave në favor të vlerave tradicionale)

Shembulli kryesor i qëndrimit të zotit Gylenit kundrejt vlerave të shkencës moderne, teknologjisë, racionalitetit, dhe vlerave individuale, është demonstruar më së miri në llojet e shkollave që ai mbështeti që në vitet '80, kur në Turqi u hap e para shkollë

e frymëzuar nga Gyleni. Ai kritikoi medresetë (shkollat fetare, në të cilën mësohet Islami) dhe teqetë (shkolla jozyrtare të themeluara nga urdhrat tradicionale sufiste), sepse ato theksonin vlerat shpirtërore, metafizike të njeriut dhe përjashtonin rolin e trajnimit dhe progresit shkencor. Nga ana tjetër, ai argumenton se shkollat laike turke dhe akademitë ushtarake u japin rëndësi njohurive shkencore moderne dhe aftësive teknike, por dështojnë në përcjelljen e vlerave shpirtërore dhe etike të transmetuara nga tradita islame. Ai i sheh rrënjët e problemeve tek mungesa e ndërthurjes mes të resë dhe të vjetrës, mes modernitetit dhe traditës, mes njohurive shkencore dhe fetare dhe mes aftësive teknike dhe formimit të karakterit.[20] Z. Gylen propozon themelimin e shkollave që ofrojnë arsim cilësor në shkencë dhe ekspertizë teknologjike, së bashku me vlerat etike dhe shpirtërore të cilat e zhvillojnë personin në tërësi. Qëllimi i tij është krijimi i shkollave elitare të cilat sjellin bashkë me përparimet e fundit teknologjike, edhe formimin e karakterit dhe idealeve të larta.

Z. Gyleni e kundërshton idenë se modernizmi është i barabartë me perëndimorizimin, siç pretendojnë disa intelektualë në Turqi dhe në të gjithë botën myslimane. Ai kundërshton idenë se Islami është një fe e"prapambetur", dhe se feja është një pengesë për progresin. Përkundrazi, ai e sheh Islamin si "rrugën e mesme", domethënë, ndërsa nuk e refuzon ose dënon qasjen drejt shkencës moderne, as nuk e adhuron atë.[21] Me qëllim angazhimin në mënyrë kritike me modernizmin, z. Gylen promovon njohuritë dhe trajnimin në teknikat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë, dhe në të njëjtën kohë, vetë transformimin në aspektin e vlerave të larta etike, dashurisë për njerëzimin, tiparet e karakterit pozitiv dhe guximin për të punuar për përmirësimin e shoqërisë. Kjo është përmbledhur në fjalët e z. Gylen:

"Nëse intelektualët, institucionet arsimore dhe mass-mediat kanë një detyrë jetike për të ndërmarrë për të mirën e njerëzimit, ajo është

për të ofruar studime moderne shkencore nga atmosfera e ndotur në mënyrë vdekjeprurëse për shkak të aspiratave materialiste dhe fanatizmit ideologjik, si dhe për t'i orientuar shkencëtarët drejt vlerave të vërteta njerëzore."

Shkollat e frymëzuara nga Gyleni në mbarë botën, ofrojnë një arsim cilësor në shkencat dhe teknologjinë moderne së bashku me mësimin e vlerave, kryesisht përmes shembullit të mësuesve dhe drejtuesve, shumë prej të cilëve janë pjesëmarrës të lëvizjes dhe të mirë-përgatitur nën dritën e idealeve të nxitura nga z. Gylen.

Jo dhunës

Gjatë karrierës së tij si predikues dhe mësues, z. Gylen ka denoncuar vazhdimisht përdorimin e dhunës si mjet drejt një objektivi politik. Sipas tij, kushtet ekonomike, korrupsioni në shtet, ose arsyet ideologjike nuk mund të justifikojnë dot dhunën. Ai i inkurajon dëgjuesit dhe lexuesit e tij për të respektuar sundimin e ligjit dhe për të gjetur një zgjidhje paqësore të konflikteve mes individëve, mes individit dhe shtetit, ose midis grupeve të individëve dhe parimeve shtetërore.[22] Një ide kryesore gjatë fjalimeve dhe shkrimeve të zotit Gylen, është shmangia e konflikteve politike dhe ideologjike.

Vazhdimisht z. Gylen e përsërit mesazhin që ai pati shprehur në shkrimin e tij, që zuri një faqe të tërë në Nju Jork Times, të nesërmen pas ngjarjeve të 11 Shtatorit: "Një terrorist nuk mund të jetë mysliman, e as mund një mysliman i vërtetë nuk mund të jetë një terrorist." Ai thotë në mënyrë të përsëritur se "Islami urdhëron për paqen dhe një mysliman i vërtetë mund të jetë vetëm një simbol i paqes dhe i respektimit të të drejtave themelore të njeriut... Kurani, libri i shenjtë i Islamit, deklaron se ai i cili merr një jetë padrejtësisht, është njëlloj sikur të kishte marrë jetën e të

gjithë njerëzimit, dhe se ai që shpëton një jetë është njëlloj sikur të kishte shpëtuar jetën e të gjithëve. Në fjalët e Profetit tonë, një mysliman është një njeri prej të cilit nuk vjen asnjë dëm, as nga gjuha e as nga dora e tij apo e saj."[23] Ai vijon më tej duke refuzuar filozofinë sipas së cilës dhuna është një mjet i justifikueshëm për të arritur një objektiv legjitim. Në një fjalim pas shpërthimeve në metronë e Londës dhe pas sulmeve vetëvrasëse në Izrael, ai i kritikoi ata të cilët i justifikojnë akte të tilla: "Për fat të keq disa i justifikojnë aktet e shpërthimeve vetëvrasëse me retorikën e 'atyre të cilët nuk kanë mjete të tjera.' Nëse ky është mjeti i vetëm që myslimanët kanë, le të pranojnë më mirë të varrosen thellë në tokë, së bashku me ata të cilët i përdorin këto mjete."[24]

Zgjidhja e zotit Gylenit për pakënaqësitë dhe konfliktet njerëzore është ndryshimi brenda vetë personit. Me qëllim për të zgjidhur probleme sociale të tilla si mungesa e arsimimit, varfëria, dizavantazhi në shoqëri dhe konfliktet midis grupeve, z. Gylen mbron arsimin cilësor, respektin reciprok, ofrimin e mundësive për njerëzit, dhe krijimin e shpresës për përmirësimin e individit dhe shoqërisë si objektiv përfundimtar. Për të arritur këto objektiva, ai i inkurajon ata të cilët ia dëgjojnë fjalën, për të ngritur shkolla që do të ofrojnë shpresën e ecjes përpara për të rinjtë dhe të cilat do të nxisin dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor dhe respektin e ndërsjelltë. Qëllimi i tij është që këto shkolla të sigurojnë një alternativë ndaj rekrutimit nëpër grupe terroriste dhe që rezultati i tyre të jetë një zgjidhje e qëndrueshme për konfliktet e dhunshme shoqërore.

Në përfundim, frika e shprehur nga kritikët e lëvizjes se shekularizmi i Turqisë, një nga shtyllat më të respektuara të Republikës Turke, do të sfidohet nga grupet fetare fanatike, të cilat përpiqen të krijojnë një shtet islamik (d.m.th. të vendosin sheriatin) është e kuptueshme duke marrë parasysh historinë e Turqisë. Megjithatë, duke pasur parasysh të dhënat e paraqitura në këtë

libër, unë nuk shoh asnjë shenjë se lëvizja Gylen ka synime të tilla. Ndërsa është e pamundur të thuhet me siguri absolute se lëvizja nuk do të shndërrohet në të ardhmen në një lëvizje "radikale" me qëllim përmbysjen e një qeverie legjitime, fakti që lëvizja nuk shfaq asnjërën nga karakteristikat që kanë lidhje zakonisht me lëvizje të tilla sektare, e zvogëlon në minimum mundësinë që lëvizja të zhvillohet ndonjëhrë në një drejtim të tillë. Fakti që lëvizja është e dukshme dhe transparente, që synon integrimin me shoqërinë dhe jo izolimin nga shoqëria, që është joautoritare në strukturë, që nuk kundërshton modernizimin në favor të tradicionalizmit, dhe që dënon dhunën si një strategji për arritjen qëllimit, e vendos këtë lëvizje edhe në vazhdimësi larg cilësive që janë të lidhura shpesh me grupime sektare apo potencialisht "të rrezikshme" për shoqërinë. Përkundrazi, siç dëshmohet edhe nga fakti që zoti Gyleni u ftua për të mbajtur një fjalimin kryesor në Parlamentin e Feve Botërore në vitin 2009 në Melburn, Australi, lëvizja Gylen është e njohur nga shumë njerëz në botë, si nxitëse e dialogut dhe paqes globale.

---

[1] Çetin (2008).

[2] Përjashtimet kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë të tilla si kufizimet e vendosura ndaj Sikhëve në lidhje me mbajtjen e shpatave apo heshtave metalike nëpërmjet detektorëve metalikë apo të drejtës për të veshur çallmën në situata specifike ushtarake. Ndërsa Yoruba-t dhe amerikanët indigjenë janë të detyruar për të marrë leje të veçantë për të therur kafshë të caktuara apo për të përdorur *peyote-n* gjatë ceremonive të tyre fetare.

[3] Barker (1984); Robbins dhe Anthony (1990); Bromley dhe Richardson (1984).

[4] Për sa i takon çështjes së mbajtjes së shamisë, shih Read (2004); (2000).

[5] Për shembuj në lidhje me të tilla grupe shih Juergensmeyer (2000); Zeskind (1986); Sprinzak (1991); Reader (1996); Das (1990); Madan (1991); Wright (1995); Roy (1996); Stern (1996); Tabor dhe Gallagher (1995); Friedman 1990; Mümtaz 1991.

[6] Wright (1995).

[7] Juergensmeyer (2000).

[8] Kaplan dhe Marshall (1996).

[9] Hostetler (1993); Weaver-Zercher (1999).

[10] Gallagher (2008).

[11] Barker (1984).

[12] Gylen (2004).

[13] Gylen (1996).

[14] Intervistë me gazetarin dhe autorin Abdullah Aymaz, janar, 2005, e kryer nga Çetin Muhamed dhe e prezantuar në Çetin (2007).

[15] Webb (2000).

[16] Barker (2002).

[17] Akman (1995).

[18] Intervistë me Y. Alp Aslandogan, Prill, 2008.

[19] Marrë nga faqja e internetit e Institutit për Dialog Ndërfetar, Hjuston, Teksas.

[20] Michels (2005).

[21] Gylen (1999).

[22] Aslandogan dhe Cinar (2007).

[23] http://en.fGülen.com/content/view/968/2/.

[24] Gylen, "Toleranca, Bombat dhe Pakicat Fetare" në dispozicion online në http://www.herkul.org.

BIBLIOGRAFIA:

Abu-Rabi, I. M., Editor's introduction. Abu-Rabi IM. Contemporary Islamic conversations: M. Fetullah Gülen on Turkey, Islam and the West. State University of New York Press, New York, 2008.

Agai, B., (2003) The Gülen Movement's Islamic Ethic of Education. Yavuz M, Esposito JL. Turkish Islam and The Secular State: The Gülen Movement. The Syracuze University Press. Discursive and Organisational Strategies of the Gülen Movement. Belgeler: Islam and the Contemporary World: the Fetullah Gülen Movement in thought and practice. Rice University, Houston, TX, Kasim, 2005

Aman, N., Interwiew with Fetullah Gülen. *Sabah* gazetesi, Ocak 27, 1995

Aktay, Y., Diaspora and Stability. Yavuz M. Esposito JL. Turkish Islam and the Secular State: The Gülen Movement. The Syracuse University Press, Syracuse. NY, 2003

Akyol, M., The context of the Gülen Movement: the exceptional story of Turkish Islam, 'Küresel Meydan Okuma Çağı'nda İslam: Gülen Hareketi'nin Perspektifleri' konferansında dağıtılan belgeler', Georgetown University, 2008.

Aras. B. And Bacık, G., The nacional action party and Turkish politics. Nation Ethnic Politics 6: 48-64, 2000.

Aslandoğan, Y. A., Defamation as a smoke screen: A case study in modern Turkey. Paper presented at the Second Annual Conference on Islam in the Contemporary World: The Fetullah Gülen Movement in Thought and Practice. The University of Oklahoma in Norman, OK, 2006.

Aslandoğan, Y. A. and Cetin, M., The Educational Philosophy of Gülen in thought and practice. Hunt RA, Aslandoğan YA. Muslim

citizens of the global world: Contributions of the Gülen Movement. The Light, Somerset, NJ(chapter 2), 2006.

Aslandoğan, Y. A. and Çinar, B., "A Sunni Muslim Scholar's humanitarin and religious rejection of violence against civilians." Paper delivered at the Muslim World in Transiotion: Contributions of the Gülen Movement Conference, London, 2007.

Axelrod, R., The evolucion of cooperation, Basic Books, New York, 1984.

Aymaz, A., *Zaman* gazetesinde köşe yazısı, March 2001, 2006.

Bacik, G. and Aras, B., Exile: a keyword in understanding Turkish Politics. Muslim World 92:387-418, 2002.

Balcı, B., Fetullah Gülen's missionary schools in central Asia and their role in spreading of Turkism and Islam. Religjion State soc 31(2):151-116, 2003.

Balcı, T., Turkish Nationalism during Cold War: The Turkish-Islamic Synthesis. Unpublished dissertation, Claremont Graduate University, 2007.

Barker, E., The Making of a Moonie: choice or brainwashing? Basil Blackwell, New York, NY, 1984.

Introducing new religious movements. Fathom Knowledge Network. Available from www.fathom.com/feature/121938 (May, 2006, II.II), 2002.

Başkan, F., The political Economy of Islamic finance in Turkey: the role of Fetullah Gülen and Asya Finance. Henry CM, Wilson R. The politics of Islamic finance, s. 216-239 Edinburgh: Edinburgh University Press, 2004.

Bölükbaş, E., Interview with the koordinator of information precessing.

Bosworth, C. E., van Donzel, E., Heinrichs, W. P and Lecomte, C., (1997) Encyclopedia of ISLAM, C. 9. Boston, MA: Brill Publishers.

Brewer, M. B and Kramer, R. M., Choice behavior in social dilemmas: effects of social identity, grup size and decision framing. J Personality Social Psychol 50:543-549, 1986.

Bromley, D. and Richardson, J., The brainwashing/deprogramming controversy. Mellen, Lewiston, NY, 1984.

Buchanan, B., Building organizational commitment: socialization of managers in work organizations. Adm Sci Q 19:533-546. 1974.

Buechler, S. M., Social movements in advanced capitalism. Oxford University Press, London, 1999.

Byrne, P., Social movements in Britain. Routledge, London, 1997.

CAIR (Council on American-Islamic Relations Research Center) (2006) American public opinion abort Islam and Muslims. www.cair.com

Cardona, P., Lawrence, B. S ., and Bentler, P. M., The influence of social and work Exchange relationships on organizational citizenship behavior. Grup Organ Manage 29:219-247, 2004.

Carroll, B. J., A dialogue of civilizations: Gülen's Islamic Ideals and humanistic discourse(). The Light, Somerset, NJ, 2007.

Çetin, M., Mobilization and countermobilization: the Gülen movement in Turkey. Proceedings from Islam in the contemporary world: The Fetullah Gülen movement in thought and practice. Rice University, Houston, TX, 2005. The Gülen Movement: its nature and identity. Muslim world in transition: contributions of the Gülen movement. International Conference Proceedings, Leeds Metropolitan University Press, London, 2007. Collective identity and action of the Gülen movement: implications for social movement theory. Ph. D Dissertation, Derby University, UK, 2008. The Gülen Movement: civic servile without borders. Blue Dome Press, New York, NY, 2009.

Collins, C. S., Gibb, H. A. R., Kramers, J. H., Levi-Provencal, E., Schacht, J. Encyclopedia of Islam, c. I, Boston, MA: Brill Publishers, 1960.

Cook, S. A., Ruling but not governing: the military and political developement in Egypt, Algeria and Turkey. John Hopkins University Press, Baltimore, MD, 2007.

Curtis, R. and Zurcher, L. A., Social movements: an analytical exploration of organizational forms. Social problems 21:356-370, 1974.

Das V Mirrors of violence: Communities, riots and survivors in

South Asya. Oxford University Press, Delhi, 1990

Delaney, C. L., The seed and the soil: gender and cosmology in Turkish village society. University of California, Berkeley, 1991. *Della Porta D,* Social movements, political violence and the state. Cambridge University Press, Cambridge, 1995.

Doney, P. M, Canon, J. P., Mullen and M. R., Understaning the influence of nacional kulture on the developement of trust. Acad Manage Rev 23:601-620, 1998.

Ebaugh, H. R. and Koç, D., Funding Gülen-inspired good Works: demonstrating and generating commitement to the movement. Internacional konference proceedings. Muslim World in Transition: Contributions of the Gülen/Hizmet movement. London, 2007.

Eck, D., A new religious America: how a 'Christian Country' has become the most religiously divers nations on earth. Harper San Francisco, San Francisco, 2001.

Edwards, B. and McCarthy, J. D., Resorces and social movement mobilization. Snow DA, Soule SA, Kriesi H. The Blackwell companion to social movements. Blackwell, Malden, MA, 2004.

Ergene, M. E., Tradition witnessing the modern age: an analysis of the Gülen movement. The Light, New Jersey. Originally published in Turkey as Geleneğin Modern Çağa Tanıklığı: Gülen Hareketi'nin Analizi (2005), 2007.

Ergun, O. N., Mecelle-i Umur-i Belediye, Instanbul, 1922.

Eyerman, R. and Jamison, A., Social movements: A cognitive approach. Polit, Cambridge, 1991.

Fine, G. A., Friendship in the workplace. Derlega, V. J., Winstead, B. A. Friendship and social interaction, Springer, New York, 1986.

Fireman, B. and Gamson, W., Resource mobilization and strategy. Zald MN, McCarthy JM. The dynamics of social movements. Winthrop, Cambridge, MA, s. 167-189, 1979.

Freeman, J., Utalitarian Logic in the Resource mobilization Perspective. Zald MN, McCarthy JM. The Dynamics of social Movement. Winthrop, Cambridge, MA, s. 167-189, 1979.

Friedman, R., Zealots for Zion; inside Israel's West Bank movement. Random House, New York, 1992.

Fuller, G., The New Turkish Republic: Turkey as a pivotal state in the Muslim world. United States Institute of Peace Press, Washington, DC, 2008.

Gallagher, E. V., FLDS, Texas O. Religion in the neps. Trinity College, Hartford, 2008.

Gamson, W. A., The strategy of social protest. Dorsey, Homewood, IL, 1975.

Garner, R., Contemporary movements and ideologies. McGraw-Hill, New York, 1996.

Gerlach, L. and Hines, V., People, poker, cange. Bobbs- Merrill, New York, 1970

Gülen, F., E. Baharı soluklarken. Nil Yayınları, İzmir, 1998.

Yitirilmiş Cennet'e Doğru, Towards the Lost Paradise, İzmir, TOV, 1994.

Toward the lost paradite. Kaynak, İzmir, 1998.

The Relatinship of Islam with Science and the concepts of science (İslam ve bilim ve bilim kavramları ilişkisi). The Fountain Magazine Published by The Light, Inc. Somerset, NJ Kasım-Aralık, 1999.

In True Islam, terror does not exist (Hakiki İslam'da terör yoktur). Çapan, E. Terror and Suicide attacks: an İslamic Perspective. The Light, New Jersey, 2004.

The State of our Souls: revival in İslamic thought and activism (Ruhlarımızın devleti: İslami düşünce ve aktivizmde yeniden diriliş). The Light, Somerset, NJ, 1970.

Gurr, T., Why men rebel? Princeton University Press, Princeton, NJ, 1970

Hales, T., Power, authority and influence. Harris A, Bennet Nm Preedy M. organizational effectiveness and improvement in education. Open University Press, Buckingham, Philadephia, 1993.

Henry, C. M. and Wilson, R., The Politics of Islamic finance.

Edinburgh University Press, Edinburgh, 2004.

Hostetler, J., Amish society. The John Hopkins University Press, Baltimore, MD, 1993.

Howard, D. A., The History of Turkey. Greenwood, Westport, CT, 2001.

Howe, M., Turkey Today: A kation dividend over Islam's revival. Westview Press, Boulder, Colorado, 2000.

Hunt, R. and Aslandoğan, Y. A., Muslim citizens of the globalized world: contributions of the Gulen movement. The Light, Somerset, NJ, 2006.

Jacobsen, C., Expecting consideration: further insights, Israeli Soc Sci Res 6:83-86, 1988.

Joireman, J., Daniels, D., Kamdar, D. and Duell, B., Resource mobilization theory and the study of social movements. Ann Rev Sociol 9: 527-553, 1983.

Jurgensmeyer, M., Good citizens to the end? It depends: ephaty and koncern with future consequences moderate the impact of a short-term horizont on organizational citizenship behaviors. J Appl Psychol 91:1307-1320, 2006.

Kalyoncu, M., Terror in the mind of God: The global rise of religious violence. University of California Press, Berkeley, CA, 2000.

Kanter, R. M., A civilin response to ethno-religious conflict: the Gulen movement in southeast Turkey. The Light, NJ, 2008.

Kaplan, D. E. And Marshall, A., Commitment and social organization: a study of commitment mechanisms in utopia communities. Am Social Rev 33:499-517, 1968. Commitment and community: communes and utopia in sociological perspective. Harvard University Press, Cambridge, MA, 1972.

Karakaş, V., Niçin zekat?, Timaş Yayınları, İstanbul, 2002.

Kendall, D., Sociology in our times, Tomas Wadsworth, Belmont, CA, 2005.

Klandermans, B., Organizing for change: social movements organizations across cultures. JAI Press, Greenwich, CT, 1989.

Knoke, D., Commitment and detachment in voluntary associations. Am Sociol Rev 46: 141-158, 1981.

Koç, D., Generating and understanding of financial resources in the Gulen movement: Kimse Yok Mu? Solidarity and Aid Association. Paper presented at the Georgetown Conference, Washington, DC, 2008.

Kömeçoğlu, U., A Sociological interpretative approach to Fethullah Gulen community movement. M.A. thesis (unpublished). Sociology Department, Boğaziçi, Üniversitesi, İstanbul, 1997.

Kanovsky, M. A. and Nolt, S. M., Citizenship behavior and social exchange. Acad Manage J 37: 656-669, 1994.

Kraybill, D. B. and Nolt, S. M., Amish Enterprise: from plows to profits. John Hopkins University Press, Baltimore, 2004.

Kuru, A. T., Fethullah Gulen's search for a middle way between modernity and Muslim tradition. Turkish İslam and the secular state: the Gulen movement. University of Syracuse Press, Syracuse, NY, 2003.

Madan, T. N., The double-edged sword: fundamentalism and the Sikh religious tradition. Fundamentalisms Observed. University of Chicago Press, Chicago, 1991.

Magnarella, P. J., Tradition and change in a Turkish town. Halsted, New York, 1974.

Mardin, Ş., Religion and social change in modern Turkey: the case of Bediuzaman Said Nursi, The State University of New York Press, Albany, NY, 1989.

Mason, W., The future of political İslam in Turkey. World Pol J XVII(2): 56-57, 2000.

McAdam, D., McCarthy, J. D. and Zald, M. N., Socıal movements. Smelser NJ, The Handbook of sociology. Sage, Beverly Hills, CA, fq. 695-737, 1988.

McAdam, D., McCarthy, J. D. and Zald, M. N., Introduction: opportunities, mobilizing structures and framing processes-Toward a synthetic, comparative perspective on social movements. McAdam D, McCarthy JD, Zald MN, Comparative perspectives on social movements: political opportunities, mobilizing structures and cultural framings. Cambridge University Press, Cambridge, 1996.

McCarthy, J. D. and Wolfson, M., Resource mobilization by local social movement organizations: agency strategy and organization in the movement against drinking and driving. Am Sociol Rev 61: 1070-1088, 1996.

McCarthy, J. D and Zald, M. N., Resource mobilization and social movements: a partial theory. Am J Sociol 82: 1212-1241, 1977.

McChesney, R. D., Charity and philanthropy in İslam: institutionalizing the call to do good. Indiana University Press, Indianapolis, 1995.

Mecham, R. Q., From the ashes of virtue, a promise of light: the transformation of political Islam in Turkey. Third World, Q 25(2): 339-358, 2004.

Melucci, A., Challenging codes: collective action in the information age. Cambridge University Press, Cambridge, UK, 1999.

Michels, T., Fethullah Gulen as Educator. Turkish Islam and the Secular State: The Gulen movement. Syracuse University Press, Syracuse, NY, 2003.

Sufism and modernity in the thought of Fethullah Gulen. Muslim World 95(3): 341-358, 2005.

Welcoming address, presented at: Islam in the Age of Global Challenges Conference, Georgetown University, Washington, DC, November, 2008.

Morris, A. D. and Staggenborg, S., Leadership in social movements. Snow DA, Soule, SA., Kriesi, H, The Blackwell Companion to social movements. Blackwell, Malden, MA, 2004.

Mümtaz, A., Islamic Fundamentalizm in South Asia: Jamaat-i Islami and Talbighi Jamaat of South Asia. Martin M, Appleby RS, Fundamentalisms observed. University of Chicago Press, Chicago, 1991.

Nugent, P. D. and Abolafia, M. Y., The Creation of trust through interaction and exchange: the role of consideration in organizations. Group Organ Manage 31: 628-650, 2006.

Oberschall, A., Social Conflict and social movements. Prentice Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1973.

Oliver, P. and Marwell, G., Mobilizing technologies for collective action. Frontiers of social movement theory. Yale University Press, New Haven, CT, fq. 251-172, 1992.

Olson, E. A., The logic of collective action. Cambridge University Press, Cambridge, MA, 1965.

Özdalga, E., Worldly ascetism in Islamic casting: Fethullah Gulen's inspired piety and activism. Critique: Crit Middle Eastern Stud 17: 84-104, 2000.

Park, W., The Fethullah Gulen movement as a transitional phenomenon. International conference proceedings. Muslim World in transition: contributions of the Gulen movement. Leeds Metropolitan Press, Londra, 2007.

Piece, J. E., Life in a Turkish village. Holt, Rinehart and Winston, New York, 1964.

Pope, H., Sons of conquerors: the rise of the Turkish world. Overlook Press, New York, NY, 2005.

Read, J. G., ., Culture, class and work among Arab-American women. LFB Scholarly Publishing, New York, 2004.

Read, J. G. and Bartowski, J. P., To veil or not to veil: a case study of identity negotiation among muslim women in Austin, Texas. Gender Soc 14(3): 395-417, 2000.

Reader, I., A poisonous cocktail: Aum Shrinrikyo's path to violence. Nordic Institute of Asian Studies, Copenhagen, 1996.

Rioux, S. M. and Penner, L. A., The causes of organizational citizenship behavior: a motivational analysis. J Appl Psychol 86: 1306-1314, 2001.

Robbins, T. And Anthony, D., In God we trust. Transaction, New Bruswick, NJ, 1990.

Roy, J. T., False patriots: the threat of antigovernment extremists. Southern Property Law Center, Klanwatch Project, Montgomery, Alabama, 1996.

Sakin, M, and Albayrak, M., *Zaman* gazetesi, fq. 5, 2007

Salamon, L. M., Sokolowski, W. And List, R., The John Hopkins

comparative nonprofit sector project. John Hopkins Center for Civil Society Studies, Baltimore, fq. 70, 2003.

Sarıtoprak, Z., An Islamic approach to peace and nonviolence: a Turkish experience. Muslim World 95 (3): 329-340, 2005.

Sarıtoprak, Z. and Griffith, S., Fethullah Gulen and the "People of the Book": a voice from Turkey for interfaith dialogue. Muslim World 95(3): 329-340, 2005.

Sevindi, N., The New York interview with Fethullah Gulen. *Sabah* kitapları, İstanbul, 1997.

Contemporary Islamic Conversations: M. Fethullah Gulen on Turkey, Islam and the West. State University of New York Press, New York, 2008.

Singer, A., Constructing Ottoman beneficence: an imperial soup kitchen in Jerusalem. SUNY, New York, 2002.

Smelser, N.J., Theory of collective behavior. Free Press, New York, 1962.

Snow, D. A., Zurcher, L. A. and Ekland –Olson, S., Social networks and social movements: a microstructural approach to differential recruitment. Am Sociol Rev 45: 787-801, 1980.

Solberg, A., The Gulen Schools: a perfect compromise or compromising perfectly? *Paper read at the Kotor Network Conference,* 2005.

Sprinzak, E., The process of delegitimization: towards a linkage theory of political terrorism. McCauley C, Terrorism and public policy. Frank Cass, Londra, 1991.

Stern, K. S., A force upon the plain: the American militia movement and the politics of hate. New York University Press, New York, 1996.

Tabor, J. D. and Gallagher, E. V., Why Waco: cults and the battle for religious freedom in America. University of California Press, Berkeley, CA, 1995.

Tapper, R., Introduction. In Tapper R. Islam in Modern Turkey: Religion, politics and literature in a secular state. I. B. Tauris, London, 1991.

Tekkalan, S. A., A movement of volunteers. Proceedings from Islam in the contemporary world: the Fethullah Gulen movement in thought and in practice. Rice University, Houston, TX, 2005.

The Book of Dede Korkut, Translation, introduction and notes by Geoffrey Lewis. Penguin, New York, 1974.

Tilly, C., From mobilization to revolution. Addison-Westley, Reading, MA, 1978.

Tolson, J., Finding your voices of moderate Islam. Faith Matters (www.usnews.com), 2008.

Turam, B., A bargain between the secular state and Turkish Islam: politics of ethnicity in Central Asia. Nations Nationalism 10: 353-374, 2004.

Turner, R. and Killian, L., Collective behavior, 2nd ed. Prentice Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1972.

Ünal, A., The Qu'ran with annotated interpretation in modern English. The Light Publ, Somerset, NJ, 2007.

Ünal, A. and Williams, A., Fethullah Gulen: advocate of dialogue. The fountain, Fairfax, VA, 2000.

Van, V. M. and DeCremer, D., Leadership in social dilemmas: the effects of group identification on collective actions to provide public goods. J Pers Soc Psychol 67: 126-141, 1999.

Weaverw-Zercher, D., Putting the Amish the work: Mennoties and the Amish culture market, 1950-1975. Church Hist. March 68:1, 1999.

Webb, L. E., Fethullah Gulen: Is there more to him than meets the eye? Mercury, Izmir, 2000.

Weller, P., Fethullah Gulen, religions, globalization and dialogue. Hunt RA, Aslandoğan YA, Muslim citizens of the globalized world: Contributions of the Gulen movement. The Light, Sommerset, NJ, 2006.

Woodhall, R., Organizing the organization, educating the educators: an examination of Fethullah Gulen's teaching and the membership of the movement. Proceedings from *Islam in the contemporary world: the Fethullah Gulen movement in thought and practice.* Rice University, Houston, TX, 2005.

Wright, S. A., Armageddon in Waco: Critical Perspectives on the Branch Davidian conflict. University of Chicago Press, Chicago, 1995.

Wuthnow, R., America and the challenges of religious diversity. Princeton University Press, NJ, 2005.

Yavuz, M. H., (1999) Search for a new social contract in Turkey: Fetullah Gülen, the virtue party and the curds. SAIS Rev 19(1): 114-143, 1999. The Gülen movement: The Turkish Puritans. Yavuz MH, Esposito JL. Turkish Islam and the secular state: The Gülen movement. Syracuse University Press, Syracuse, NY (chapter 2), 2002.

(2003a)Islam in the Public Sphere: the Case of the Nur Movement. Yavuz MH, Esposito JL. Turkish Islam and the Secular State: The Gülen movement. Syracuse University Press, Syracuse NY (chapter 1)

(2003b) The Gülen Movement: The Turkish Puritans. Yavuz MH, Esposito JL, Turkish Islam and the Secular State: the Gülen movement. Syracuse University Press, Syracuse, NY (chapter 2).

(2005)Cleansing Islam from the publik sphere. Posted in the website for the Sunni Rvzi Society International, General Islamic Topics, mars, 2005.

Esposito JL (2003) Introduction. Yavuz MH, Esposito JL. Turkish Islam and the Secular State: the Gülen Movement. Syracuse University Press, Syracuse, NY.

Yediyıldız, B., 18. Yüzyıl'da Türkiye'de Vakıf Müessesesi, Bir sosyal tarih incelemesi, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 2003.

Yılmaz, I., Ijtihad and Tacdid by conduct. Yavuz MH, Esposito JL. Turkish Islam and the secular state: the Gülen Movement. Syracuse University Press, Syracuse NY, 2003. State, law, Civil society and Islam in Contemporary Turkey. The Muslim World,. C. 95, no. 3. Special issue: Islam in Contemporary Turkey: The Contributions of Gülen: 385-412, 2005.

Yousef, T. M., The Murabaha Syndrome in Islamic finance: laws, institutions and politics. Henry CM, Wilson R. the politics of Islamic finance. Edinburgh, England, s. 63-80 (chapter 3), 2004.

Zald, M. N. and Ash, R., Social movements organizations: growth, decay and change. Soc Forces 44:32-340, 1966.

Zald, M. N. and McCarthy, J. D., The dynamics of social movements organizations: resource mobilizations, social control and tactics. Winthrop, Cambridge, MA, 1979.

Zeskind, L., The 'Christian Identity' Movement: analyzing its theological rationalization for racist and anti-Semitic violence. Division of Church and Society of the National Council of the Churches of Christ in the U. S. A., New York, 1986

Zeskind, L. and Tuncer, F., Foundations of the intellectual development of Fetullah Gülen.